




HZK - K.K FUSHË KOSOVË

Harta Zonale e Komunës së Fushë Kosovës

2020 - 2028





Bartës i hartimit të dokumentit: Komuna e Fushë Kosovës, përkatësisht Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis, në bashkëpunim me Drejtoritë dhe sektorët tjerë të Komunës.

Profesionalisht dokumenti është mbështetur nga kompania konsulente “**INSI**” ShPK.

Fushë Kosovë, Shkurt 2020.



FJALA E KRYETARIT

Duke e konsideruar Hartën Zonale të Komunës si dokumentin më të rëndësishëm multi-sektorial, i cili përcakton rregullimin, shfrytëzimin dhe zhvillimin hapësinor mbi territorin tonë, Komuna ka marrë vendimin për hartimin e këtij dokumenti.

Ky vendim mbështetet në nevojën për zhvillimin e qëndrueshëm, të baraspeshuar dhe afatgjatë të mbrojtjes dhe zhvillimit të planifikuar të komunës së Fushë Kosovës, si dhe në përmbushjen e obligimeve ligjore që burojnë nga Ligji Nr.04L-174 për Planifikimin Hapësinor.

Kushtet Zhvillimore që janë definuar në këtë dokument do të përmirësojnë dukshëm aspektin social, funksional, ekonomik, hapësinor dhe mjedisor të njerëzve që dhe jetojnë dhe punojnë në Komunën tonë. Duke marrë parasysh që ne jemi Komuna e parë, që ka përfunduar procesin e hartimit Harte Zonale të Komunës sipas kërkesave të reja ligjore, përgatitja e këtij dokumenti ishte një sfidë për ne, dhe jemi shumë mirënjohës për përkrahjen profesionale të ofruar nga kompania Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë – “INSI”, e cila ka ndihmuar Komunën që të përgatis një dokument, që sipas mendimit tonë është shumë cilësor, si dhe në përputhje me kërkesat e reja ligjore.

Zbatimi i këtij dokumenti do të bëhet në rrethana edhe më të përshtatshme dhe ne të gjithë së bashku do të kemi privilegjin, por edhe përgjegjësinë, për zbatimin sa më të përpiktë të këtij dokumenti, i cili do të jetë udhërrëfyes në fazën e zhvillimit dhe të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe të arritjes së standardeve.

Krahasuar me Komunitat tjera, zhvillimi ekonomik, social, si dhe numri i banorëve ka shënuar rritje në Komunën tonë. Kështu nevojitet një qasje integruar e integruar nga ekspertët tonë në Komunë, qytetarët dhe organizatat e ndryshme që përpos planifikimit do të jenë partner të përkushtuar gjatë zbatimit të këtij dokumenti.

Përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent gjatë hartimit të këtij dokumenti, ne kemi arritur një konsensus të gjerë nga banorët dhe ekspertët e fushave të ndryshme. Një qasje e tillë ka bërë që në këtë Hartë Zonale të përfshihen interesat dhe specifikat e të gjitha grupeve të shoqërisë në komunë që është një bazë e mirë që zbatimi i tij të ketë një përkrahje të gjerë nga të gjitha palët e interesit. Komuna ka mirëpritur angazhimin e të gjithë akterëve që kanë marrë pjesë në këtë proces, të cilët përmes të dhënave, vërejtjeve, sugjerimeve dhe propozimeve të tyre kanë përmirësuar këtë Hartë Zonale të Komunës.

Me këtë rast, dëshiroj të shpreh mirënjohjen dhe falënderimin tim dhe të Komunës për grupet punuese, përfaqësuesit e shoqërisë civile, sektorin privat, liderimin e të gjitha partive politike si dhe të gjithë ata që kanë marrë pjesë në përgatitjen e këtij dokumenti të rëndësishëm. Një mirënjohje të veçantë për të gjitha mediat që krijuan hapësirë për paraqitjen e këtij dokumenti strategjik para qytetarëve.

Komuna pret nga institucionet, donatorët, partnerët dhe miqtë e Komunës së Fushë Kosovës që të ndihmojnë zbatimin e këtij dokumenti, në mënyrë që bashkërisht të hapim perspektiva të reja për zhvillim të qëndrueshëm.

Me punën tonë të përbashkët në implementim të këtij dokumenti do të kontribuojmë që qytetarët tanë të jetojnë me dinjitet. Besoj thellësisht se bashkërisht mund të sigurojmë energjitë dhe burimet për zbatimin e mirëfilltë të kësaj Hartë Zonale të Komunës.

Burim Berisha

Kryetar i Komunës

Përmbajtja tekstuale

1. HYRJA.....	11
1.1. Baza ligjore për hartimin e Hartës Zonale të Komunës.....	11
1.2. Proceset dhe ekipet e përfshira në hartimin e Hartës Zonale të Komunës	11
1.3. Qëllimi i Hartës Zonale të Komunës.....	20
1.4. Përshkrimi i kërkesave që rrjedhin nga planet zhvillimore sektoriale të Planit Zhvillimor Komunal....	21
1.5. Ndërlidhjet me Planet Rregulluese Urbane në fuqi dhe me Planet Rregulluese të Hollësishme.....	23
1.6. Ndryshimet në tematikë ose në strategjitë sektoriale lokale që nga miratimi i Planit Zhvillimor Komunal	23
1.7. Shqyrtimi i përgjithësuar i dokumentit të planifikimit paraprak të po të njëjtit nivel.....	26
2. ARSYETIMI	27
2.1. Zonat	29
2.2. Zonat mbishtresore	33
2.3. Pjesa e arsytimit që përfshin Raportin e shqyrtimit publik.....	34
2.4. Pjesa e arsytimit që përfshin obligimet e dokumenteve e nivelit qendror	34
3. KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIM PËR TË GJITHA ZONAT	36
3.1. Cilat rregulla brenda kushteve zhvillimore të përgjithshme na shërbejnë më mirë?.....	38
3.2. Masat mbrojtëse	42
3.3. Aktivitetet e kufizuara janë si në vijim:.....	49
3.4. Qasja në parcelën kadastrale	69
3.5. Qasja në infrastrukturën teknike.....	70
3.6. Rregulla për parkim dhe shkarkim.....	70
3.7. Rregullat për zhvillim të peizazhit dhe shiritave të gjelbër mbrojtës.....	72
3.8. Rregullimi i peizazhit.....	73
3.9. Brezi i gjelbër	76
3.10. Kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyror dheartificial	76
3.11. Kërkesat për zvogëlimi të zhurmës.....	78
4. LISTA E ZONAVE DHE LISTA E ZONAVE MBISHTRESORE.....	79
4.1. Lista e Zonave.....	79
4.2. Lista e Zonave Mbishtresore	80
5. ZONAT E DESTINUARA (PËRCAKTUARA) DHE KUSHTET ZHVILLIMORE PËRFSHIRË KUSHTET NDËRTIMORE.....	83
5.1. Zonat e Banimit me shumë njësi (ZB1,ZB2 dhe ZB3).....	83



5.2. Zonat e Banimit me shumë njësi (ZB4,ZB5,ZB6 dhe ZB7).....	88
5.3. Zonat për Shfrytëzim të Përzier (ZSHP1 dhe ZSHP2).....	94
5.4. -A Normat hapësinore për zhvillimin e infrastrukturës përcjellëse në kuadër të Blloqeve të Banimit.	100
5.5. -B Normat hapësinore për zhvillimin e infrastrukturës përcjellëse në kuadër të Komplekseve të Banimit	102
5.6. Zonat Komerciale (ZK1, ZK2 – ZK3)	103
5.7. Zona Industriale (ZI).....	108
5.8. Zonë Ushtarake e Sigurisë (ZuS).....	113
5.9. Zonë Rekreative-Turistike (ZrT).....	114
5.10. Zonat e komunikacionit-transportit (ZkT)	115
5.11. Zonë Bujqësore (Zb).....	116
5.12. Zonë Pyjore (ZP)	117
5.13. Zonë-minierë sipërfaqësore (ZmS)	118
5.14. Sipërfaqe Ujore (SU).....	120
5.15. Zonë e Mbrojtur Arkeologjike-Historike (ZmaH)	121
6. ZONAT MBISHTRESORE DHE KUSHTET ZHVILLIMORE.....	123
7. INFRASTRUKTURA TEKNIKE.....	127
7.1. Rrjeti i ujësjellësit	127
7.2. Rrjeti i kanalizimit.....	139
7.3. Sistemet e drenazhimit.....	150
7.4. Impianti për trajtimin e ujerave të zeza	150
7.5. Kushtet zhvillimore të Projektimit të Ujësjellësve, Kanalizimeve të ujerave të ndotura dhe Drenazheve	152
7.6. Kushtet e përgjithshme për zhvillimin (ndërtimin) e infrastrukturës së ujësjellësit, kanalizimit dhe drenazhimit.....	155
7.7. Rrjeti i shpërndarjes lokale me energji elektrike.....	166
7.8. Rrjeti i shpërndarjes lokale me energji termike	176
7.9. Rrjeti i grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave mbitorësore dhe nëntokësore.....	179
8. INFRASTRUKTURA RRUGORE.....	189
8.1. Rrugët publike të motorizuara.....	189
8.2. Kapaciteti i rrugëve	193
8.3. Kushtet e përgjithshme teknike për projektim dhe ndërtim.....	194
8.4. Rrugët në kompetencë të komunës së fushë kosovës.....	194
8.5. Kushtet e përgjithshme teknike për projektim dhe ndërtim të rrugëve të reja	195



8.6. Trafiku i pamotorizuar	200
8.7. Sipërfaqet për lëvizje të këmbësorëve	200
8.8. Rrjeti hekurudhor	205
8.9. Vendparkimet.....	206
8.10. Lëvizshmëria dhe rregullimi i qarkullimit dhe transportit	211
9. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE.....	213
9.1. Parqet publike dhe hapësirat e hapura.....	213
9.2. Fushave sportive dhe hapësirave rekreative	214
9.3. Hapësirat dhe ndërtimet për shërbime mjekësore.....	219
9.4. Ndërtesat për shërbime sociale.....	221
9.5. Ndërtesat e institucioneve parashkollore	222
9.6. Shkollat dhe universitetet.....	223
9.7. Qendrat administrative.....	226
9.8. Hapësirat dhe ndërtesat e sigurisë publike	226
9.9. Varrezat	227
10. ARSYETIMI PËR NEVOJËN E HARTIMIT TË PLANEVE RREGULLUESE TË HOLLËSISHME TË PLANIFIKUARA.....	228
11. TRAJTIMI I VENDBANIMEVE JOFORMALE.....	229
12. PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIM	233
12.1. Plani i veprimit për vitin 2019	233
12.2. Plani i veprimit për vitin 2020	241
12.3. Plani i veprimit për vitin 2021	249
12.4. Plani i veprimit për vitin 2022	255
12.5. Plani i veprimit për vitin 2023	261
12.6. Plani i veprimit për vitin 2024	267
12.7. Plani i veprimit për vitin 2025	274
12.8. Plani i veprimit për vitin 2026	279
13. ADMINISTRIMI, ZBATIMI DHE MONITORIMI I ZBATIMIT	285
13.1. Administrimi i zbatimit dhe monitorimi i zbatimit të Hartës Zonale Komunale të Fushë Kosovës.....	285
13.2. Zbatimi i Hartës Zonale Komunale të Fushë Kosovës	287
13.3. Monitorimi i zbatimit	295
14. NDRYSHIM PLOTËSIMET DHE PËRJASHTIMET	302
15. PËRJASHTIMET	305
16. JO KONFORMITETET.....	307



17. BONUSSET E ZONIMIT	309
18. INTERPRETIMI	310
19. ANKESAT.....	314
20. PJESA HARTOGRAFIKE	315



Lista e Hartave

Harta 1 Ndikimi i HZK-së në ekosistemet natyrore.....	18
Harta 2 Parashikimi i ndikimeve të HZK-së në aspektin hapësinor.	19
Harta 3 Sipërfaqet e destinuara sipas PZhK-së.....	24
Harta 4 Sipërfaqet e destinuara sipas PZhU-së.....	25
Harta 5 Gjendja aktuale në raport me atë të planifikuar në Planin Rregullues Urban.....	31
Harta 6 Zonimi i pjesës urbane sipas Planit Zhvillimor Urban.....	32
Harta 7 Zonimi i pjesës urbane sipas Hartës Zonale të Komunës.....	33
Harta 8 Zonat Mbishtresore të përcaktuara.....	34
Harta 9 Skema e Shtrirjes së rrjetës së ujësjellësit Fushë Kosovë dhe vendbanimet rurale (fshatra)/ Referencë-INSI 2018.....	132
Harta 10 Rrjeti i kanalizimit të ujërave të zeza dhe rrjeti i shërbimit /Referencë PZHK-Fushë Kosovë.....	140
Harta 11 Rrjeti i ujitjes dhe objektet hidroteknike.....	165
Harta 12 Shpërndarja e instalimeve	171
Harta 13 Rrjeti rrugor në Komunën e Fushë Kosovës	193
Harta 14 Rrjeti i transportit urban.....	204
Harta 15 Zonat që duhet trajtuar me Plane Rregulluese të Hollësishme	228
Harta 16 Lokacionet e vendbanimeve joformale.....	231
Harta 17 Shembull i ilustrimit të përjashtimeve nga kushtet zhvillimore ku parcelat siç shihen nuk kanë qasje në parcelë.....	306
Harta 18 Shembulli ku zona është e parapar për industri kurse në zonë kemi objekt të banimit.....	307
Harta 19 Shembulli ku objekt me vlera arkitektonike i cili ndodhet në zonë të banimit kolektiv.....	308
Harta 20 Zonat ku mund të aplikohen bonuset e zonimit.....	310



Lista e Figurave

Figura 1 Nivelet e standardeve.....	41
Figura 2 Zbatueshmëria standardeve.....	42
Figura 3 Kategoritë e shfrytëzimit të tokës sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ për Normat Teknike	52
Figura 4 Kategoritë e shfrytëzimit të tokës sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ për Normat Teknike	55
Figura 5 Brezi i gjelbër	76
Figura 6 Shembulli i llogaritjes së lartësisë për bazuar në këndin 45°	77
Figura 7 Skema e mbrojtjes së burimeve të ujit /Referencë-UA për mbrojtjen e ujerave sanitare-INSI 2018 ..	130
Figura 8 Detali i Ujëmatësit Zonal me standard	135
Figura 9 Kolektoret Kryesor /Referencë- Studimi i Fizibilitetit për Impiantin e trajtimit të ujerave të zeza- WYG International.....	142
Figura 10 Kolektoret për largimin e ujerave të zeza me prioritet.....	142
Figura 11 Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në zonën nën urbane në Fushë-Kosovë /Referencë- Studimi i Fizibilitetit për Impiantin e trajtimit të ujerave të zeza- WYG International.....	143
Figura 12 Zëvendësimi dhe përmirësimi i rrjetit ekzistues të kanalizimit /Referencë- Studimi i Fizibilitetit për Impiantin e trajtimit të ujerave të zeza- WYG International	144
Figura 13 Vendosja e tubave në rrugë me kategori të ndryshme	149
Figura 14 Lëshimi i ujit në breg të lumit i pajisur me mbyllës	150
Figura 15 Pamja e trasës së linjës 2x110 kV Kosova A-F Kosova –Lipjani(ajrore /nëntokësore)	169
Figura 16 Grumbullimi i mbeturinave komunale.....	181
Figura 17 Skema e grumbullimit të mbeturinave komunale [Burimi: nga PLMM]	182
Figura 18 Struktura karakteristike e rrugës.....	198
Figura 19 Kriteret për vendosjen e udhëkryqeve sipërfaqësore dhe udhëkryqeve në disnivel.....	200
Figura 20 Gjerësia minimale e shtegut për këmbësorë për një kahe (varg) të këmbësorëve	201
Figura 21 gjerësia e kalimeve ndërmjet pengësive fikse.....	201
Figura 22 Shtegu dhe korsia për biçikleta.....	202
Figura 23 Brezi mbrojtës dhe rregullues hekurudhor.....	205
Figura 24 Llojet e vendparkimeve	210
Figura 25 Vend-parkimet për qëllime të veçant	211



Lista e Tabelave

Tabela 1 Sipërfaqet e destinuar sipas PZhK-së	24
Tabela 2 Sipërfaqet e destinuar sipas PZhU-së	25
Tabela 3: Kërkesat minimale për vende të parkingut për biçikleta sipas llojit të ndërtesës	72
Tabela 4 Kriteret e planifikimit të rrugëve brenda vendbanimeve	72
Tabela 5 Kufizimet e nivelit të lejuar të zhurmës.....	78
Tabela 6 Analiza e shpenzimeve për vitin 2018	128
Tabela 7 Analiza e shpenzimeve deri në vitin 2043.....	129
Tabela 8 Specifikimi i Burimeve të ujit/ Referencë PZHK-Fushë-Kosovë	131
Tabela 9 Mbulueshmëria (kyçja) e popullsisë me rrjetë të ujësjellësit/ Referencë-PZHK-Fushë Kosovë.....	131
Tabela 10 Normat për nevoja familjare dhe publike	136
Tabela 11 Normat e përdorimit të ujit për sektorë të ndryshëm.....	136
Tabela 12 Normat për nevojat komunale në ndërmarrjet e prodhimit.....	137
Tabela 13 Tabela e Rrjedhjes totale të ujërave të zeza (m ³ /ditë) /Referencë- WYG International dhe KUR Prishtina	139
Tabela 14 Kostoja e përafërt e investimit.....	144
Tabela 15 Normat për objekte të veçanta.....	146
Tabela 16 Norma e ujërave të përdorura L/ ditë	146
Tabela 17 Norma mesatare ditore (L)	146
Tabela 18 Kosto(Vlera) për ndërtimin e Impiantit të trajtimit të ujërave të zeza/ Referencë- Konsulenca -WYG International dhe KUR Prishtina.....	151
Tabela 19 Sipërfaqet e tokave bujqësore të ujitura sipas komunave.....	163
Tabela 20 Kapacitetet egzistuese dhe ato të planifikuara.....	167
Tabela 21 Kërkesat për energji deri në vitin 2023 me një shtim vjetor të kërkesës prej 1.5%.....	168
Tabela 22 Planet deri në vitin 2023 si dhe skema e shpërndarjes së instalimeve.....	170
Tabela 23 Zonat funksionale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën Fushë Kosovë [Burimi: PLMM]	183
Tabela 24 Kategorizimi i rrugëve	190
Tabela 25 Vlerat minimale të rrezes së rrubullakësimit (harkut) në udhëkryqe	199
Tabela 26 Numri i vend-parkingjeve për biçikleta.....	203
Tabela 27 Kriteret për shfrytëzimin e infrastrukturës së përbashkët nga çiklistët dhe këmbësorët.....	203
Tabela 28 Gjerësia e sipërfaqeve për lëvizje të biçikletave SISTEMI I TRANSPORTIT PUBLIK	203
Tabela 29 Numri i vendparkimeve varësisht nga përmbajtja.....	209
Tabela 30 Vendbanimet joformale në komunën e Fushë Kosovës	230

1. HYRJA

1.1. Baza ligjore për hartimin e Hartës Zonale të Komunës

Me nxjerrjen e ligjit për planifikimin hapësinor Nr. 04/l-174, janë përcaktuar parimet bazë të planifikimit hapësinor, kushtet dhe mënyrën e zhvillimit dhe rregullimit hapësinor, llojet, ecuritë dhe përmbajtjen e planeve, përgjegjësitë e subjekteve administrative të nivelit qendror dhe lokal për hartimin dhe zbatimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor, mbikëqyrjen administrative për zbatimin e këtij ligji, si dhe aktivitetet të cilat ndërmerren në planifikim hapësinor dhe rregullim territorial në Republikën e Kosovës.

Ligji i ri i planifikimit por edhe ndërrimi i disa ligjeve tjera të sistemit e planifikimit hapësinor, ndryshuan bazën ligjore, me këtë rast edhe përgjegjësitë dhe kërkesat në kuvendin dhe autoritetin përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor në nivel qendror dhe lokal. Në këtë drejtim, me Nenin 16 të këtij ligji u kërkohej komunave (Fushë Kosovës) të përgatisin Hartën Zonale të Komunës. Duhet theksuar se baza ligjore është kompletuar edhe me nxjerrjen e akteve nënligjore si: Udhëzimit Administrativ Nr. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut, e sidomos Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2017 mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor. Në këtë vazhdimësi, kemi edhe shumë akte tjera nënligjore që janë miratuar dhe janë të rëndësishme në sistemin e planifikimit hapësinor.

Duke u bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencat e nivelit komunal, me datën 31.02.2017, Komuna e Fushë Kosovës mori vendimin për hartimin e Hartës Zonale të Komunës, kopja e së cilës është vendosur në **Shtojcën 1** të këtij dokumenti.

1.2. Proceset dhe ekipet e përfshira në hartimin e Hartës Zonale të Komunës

Pas marrjes së vendimit për hartimin e Hartës Zonale të Komunës, Komuna shpalli konkurs projektimi për përkrahje profesionale në procesin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës dhe përzgjodhi kompaninë "INSI" Prishtinë me ekspertët e tyre vijues:

	Emri e mbiemri	Fusha e ekspertizës
1	MSc. Ismajl Baftijari	Ing. i Diplomuar i Ndërtimtarisë / Planer urban
2	Dr.sc. Flamur Kuçi	Ing. i Diplomuar i Arkitekturës/ Planer urban
3	MSc. Valon Gërmizaj	Ing. i Diplomuar i Arkitekturës/ Planer urban
4	Armend Sokoli	Ing. i Diplomuar i Arkitekturës/ Planer urban
5	Rrustem Baftijari	Ing. i Diplomuar i Arkitekturës/ Planer urban
6	Nysret Gashi	Gjeodet/GIS ekspert
7	Dr.sc. Sylejman Berisha	Ekspert Mjedisor
8	Dr.sc. Mevlan Bixhaku	Ing. i Diplomuar i komunikacionit
9	MSc. Arben Hajrizi	Ing. i Diplomuar i Hidroteknikës
10	MSc. Lulzim Kryeziu	Ing. i Diplomuar i Makineris
11	MSc. Astrite Neziri	Ing. i Diplomuar i Elektroteknikës



12	Bexhet Basha	Ekspert i Bujqësisë
13	Reshat Azizi	Ekspert i Ekonomisë
14	MSc. Mentor Rexhepi	Ekspert i Ekonomisë

Pas përzgjedhjes së Kompanisë, Komuna ka përcaktuar Grupin Punues përgjegjës për hartimin e Hartës Zonale të Komunës me Udhëheqësen Komunale të projektit Znj. Antigona Sahiti Njësia e Planifikimit Hapësinor e Komunës së Fushë Kosovës, si vijon:

Ekipi komunal si bartës i procesit të përgatitjes së HZK-së

	Emri e mbiemri	Pozita	Komuna\Drejtoria
1	Burim Berisha	Kryetar	Komuna e Fushe Kosovës
2	Fadil Krasniqi	Nënkryetar	Komuna e Fushe Kosovës
3	Vjollca Konjusha	Kryesues	Kuvendi i Komunës
4	Nuriye Fazliu	Drejtore	Drejtoria për Administratë
5	Ramadan Jashanica	Drejtore	Drejtoria për Financa dhe Buxhet
6	Abdulla Prebreza	Drejtore	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbikëqyrje
7	Ekrem Berjani	Drejtore	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Tatim në Pronë
8	Afrim Krasniqi	Drejtore	Drejtoria e Inspeksionit
9	Islam Shabani	Drejtore	Drejtoria për Arsim
10	Nuriye Avdiu	Drejtore	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
11	Jakup Dumani	Drejtore	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
12	Jakup Ternava	Drejtore	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
13	Mehmet Gërguri	Drejtore	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
14	Maliq Berisha	Drejtore	Drejtoria për Shërbime Publike

Lista e kontribuesve nga komuna përfshin

	Emri e mbiemri	Komuna\Drejtoria
1	Abdullah Prebreza	Drejtoria për Urbanizëm
2	Antigona Sahiti	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbikëqyrje
3	Hysen Sllamniku	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
4	Hasan Xhyrevci	Drejtoria për Administratë
5	Ejup Qyqalla	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencës
6	Adnan Bullatovci	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
7	Vlora Berjani	Drejtoria për Arsim
8	Arta Gerguri	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
9	Nurie Fazliu	Drejtoria Administratë
10	Samire Gerguri-Gashi	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbikëqyrje
11	Adelina Gashi	Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë



12	Dorontina Durmani	Drejtoria e Inspeksionit
13	Sylejman Shabani	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
14	Muhamet Xhigoli	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Tatim në Pronë
15	Bardhyl Koiçiçi	Drejtoria për Financa dhe Buxhet
16	Fatlum Berisha	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
17	Fatime Ismajli	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbikëqyrje
18	Mobere Hyseni	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbikëqyrje
19	Fatmire Miftari	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbikëqyrje
20	Besa Budakova	Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
1	Abdullah Prebreza	Drejtoria për Urbanizëm
2	Antigona Sahiti	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbikëqyrje
3	Hysen Sllamniku	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale

Lista e kontribuesve nga institucionet publike

	Emri e mbiemri	Institucioni
1	Faruk Gjyckaj	KEDS
2	Burbuqe Baruti	KEDS
3	Sabina Demaj	KEDS
4	Nevzat Xhigoli	LKA "Adem Jashari"
5	Ali Azemi	KOST
6	Misin Berisha	KRM, Pastrimi FK
7	Naim Çitaku	Infrakos SHA
8	Bukurie Emini	KRU, Prishtina
9	Sokol Xhafa	KRU, Prishtina

Autoriteti komunal, përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor në Fushë Kosovë, gjatë hartimit të Hartës Zonale të Fushë Kosovës është kujdesur që të sigurojë pjesëmarrjen publike, të ketë një proces transparent dhe pa diskriminim, të ofrojë qasje publike në të gjitha të dhënat, të ndërmarrë fushatë informimi për informimin dhe sigurimin e pjesëmarrjes publike gjatë hartimit të këtij dokumenti, të organizojë diskutime publike dhe forma tjera të pjesëmarrjes publike.

Procesi ka qenë i konceptuar dhe i organizuar në atë formë që iu ka përshtatur punës së komunës dhe mund të konsiderohet racional dhe i qëndrueshëm. U formua ekipi komunal i planifikimit dhe bartësi kryesor në procesin e hartimit të Hartës Zonale të Fushë Kosovës ishte komuna. Roli i kompanisë profesionale në proces ishte udhëzimi për procesin, hapat, pjesëmarrjen e të gjithë akterëve dhe transparenca, si dhe për ngritjen e kapaciteteve të komunës, pasi që kapacitete dhe përvoja për hartimin e Hartës Zonale të Fushë Kosovës nga komuna dhe akterët tjerë ishte më e kufizuar.



Në fillim u organizuan trajnimet për ta kuptuar njëjtte procesin e hartimit dhe përmbajtjen e të Hartës Zonale të Fushë Kosovës. Trajnimet janë organizuar edhe për GIS dhe mund të themi se shumica e informatave janë digjitalizuar. Vlen të thuhet se në këto trajnime morën pjesë edhe përfaqësues të shoqërisë civile si dhe përfaqësues të kompanive publike. Në fillim të procesit u dakordua që të sigurohet të paktën një diskutim publik në secilën fazë të procesit, të sigurohet diskutime publike që sjellin së bashku të gjitha palët e interesuara dhe relevante (qytetarët, sektorin publik dhe privat, OJQ-të, ekspertët etj.

1.2.1. *Proceset dhe ekipet e përfshira në hartimin e Hartës Zonale të Komunës*

Në fillim të procesit u sqarua dhe u dakordua që udhëzimi administrativ i MMPH-së Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor të zbatohet në plotëni.

Kështu, bazuar në përgjegjësitë e autoritetit të planifikimit hapësinor si dhe procedurat për pjesëmarrje dhe përfshirje të spektrit të gjerë të publikut, që nga fillimi dhe përgjatë të gjitha fazave të procesit të planifikimit u bë njoftim paraprak i palëve të interesuara dhe publikut, për kohën, vendin dhe qëllimin e mbajtjes së diskutimeve publike, u siguroa pjesëmarrja e personave fizikë dhe juridikë, pjesëmarrje e shoqatave apo organizatave në hartimin e Hartës Zonale Komunale të Fushë Kosovës, për të cilat ka edhe fotografi dhe procesverbale nga takimet e mbajtura.

Në këtë formë pati disa diskutime, konsultime, debat të lirë dhe të hapur me publikun dhe hisedarët tjerë, të organizuar nga komuna bazuar në parimet e qeverisjes së mirë. Procesi ishte cilësor që nga fillimi dhe në disa takime pati përfaqësues edhe të MMPH-së, si vijon:

Vendi i Takimit	Data	Nr i pjesëmarrësve	Qëllimi i Takimit
Komuna Fushë Kosovë	16.11.2017	8	Takim pune me kompaninë konsulentë
Komuna Fushë Kosovë	11.12.2017	22	Takim me grupin punës të përberë nga Zyrtar komunal dhe kompania
Komuna Fushë Kosovë	12.12.2017	22	Takim me grupin punës të përberë nga Zyrtar komunal dhe kompania
Komuna Fushë Kosove	15.12.2017	5	Takim me Drejtorin për planifikim Urban
Komuna Fushë Kosovë	15.12.2017	5	Takim me Drejtorinë për Kadastër
Komuna Fushë Kosovë	15.12.2017	7	Takim me Drejtorinë e Financave
Komuna Fushë Kosovë	18.12.2017	5	Takim me Drejtorinë e Shëndetësisë
Komuna Fushë Kosovë	18.12.2017	6	Takim me Drejtorinë e Arsimit
Komuna Fushë Kosovë	26.12.2017	20	Takim me përfaqësuesit e drejtorive
Komuna Fushë Kosovë	01.08.2018	11	Takim Informues nga kompania konsulentë
Komuna Fushë Kosovë	16.02.2018	6	Takim me drejtorinë e shërbimeve publike
Komuna Fushë Kosovë	16.02.2018	6	Takim me Drejtorinë e Urbanizmit
Komuna Fushë Kosovë	16.02.2018	8	Takim me Drejtorinë e Kadastrit,pron dhe Gjeodezi
Komuna Fushë Kosovë	16.02.2018	6	Takim me Drejtorinë për buxhet dhe Financa
Komuna Fushë Kosovë	19.02.2018	8	Takim me Drejtorinë e Arsimit



Komuna Fushë Kosovë	19.02.2018	5	Takim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Komuna Fushë Kosovë	19.02.2018	5	Takim me Drejtorinë për Rini, Sport dhe Kulture
Komuna Fushë Kosovë	19.02.2018	12	Takim me Drejtorinë e Administratës
Komuna Fushë Kosovë	19.02.2018	9	Takim me Drejtorinë e Inspeksionit
Komuna Fushë Kosovë	19.02.2018	10	Takim me Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport
Komuna Fushë Kosovë	19.03.2018	6	Takim me Drejtorinë Gjeodezi Kadastër dhe Pronë
Komuna Fushë Kosovë	19.03.2018	4	Takim me Drejtorinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
Komuna Fushë Kosovë	20.03.2018	5	Takim me Drejtorinë për Shërbime Publike
Komuna Fushë Kosovë	20.03.2018	7	Takim Drejtoria për Ekonomi Buxhet dhe Financa
Komuna Fushë Kosovë	20.03.2018	8	Takim me Drejtorinë e Arsimit
Komuna Fushë Kosovës	20.03.2018	8	Takim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Komuna Fushë Kosovë	20.03.2018	7	Takim me Drejtorinë e Inspeksionit
Komuna Fushë Kosovë	22.03.2018	8	Drejtoria e Administratës
Komuna Fushë Kosovë	15.04.2018	22	Takim me grupin punues te përberë nga Zyrtar komunal dhe kompania
Komuna Fushë Kosovë	24.05.2018	20	Takim me grupin punues te përberë nga Zyrtar komunal dhe kompania

Konsultimet publike dhe

Komuna Fushë Kosovë	15.01.2018	19	Takim konsultativ me ndërmarrjet Private dhe publike
Komuna Fushë Kosovë	15.02.2018	10	Takim konsultativ me drejtorinë e bujqësisë
Komuna Fushë Kosovë	15.02.2018	27	Takim me Kryetarin e Komunës dhe Grupin Punues

Diskutimet publike

Vendi i Takimit	Data	Nr i pjesë-marrësve	Qëllimi i Takimit
Fushë Kosovë	02.02.2018	54	Punëtori për informim për procesin e hartimit
Fushë Kosovë (Zona Çerdhja dhe Hekurudha)	14.03.2018	50	Punëtori për informim për procesin e hartimit
Fushë Kosovë - Rruga Tahir Zemaj	19.04.2018	70	Punëtori për informim për procesin e hartimit



Komuna Fushë Kosovë	20.06.2018	70	Prezantimi i Draftit
---------------------	------------	----	----------------------

1.2.2. Pëlqimi i MMPH-së të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Hartës Zonale të Komunës

Në fazën e fundit të procesit, Komuna mori vendimin për të përgatitur Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Hartës Zonale të Komunës, i cili i është bashkangjitur këtij dokumenti në **Shtojcën 2**.

Në mënyrë që të i hapet rruga zhvillimit të shqyrtimi publik. Përmes Vendimit Nr. 18/6041/1-ZSP/343/18 të datës 19.11.2019, MMPH ka aprovuar Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Hartës Zonale të Komunës, i cili i është bashkangjitur këtij dokumenti në **Shtojcën 3**.

Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Hartës Zonale të Komunës ka identifikuar rekomandimet vijuese:

1. Masat e nevojshme në HZK për mbrojtjen e mjedisit

Në analizën e terrenit është vërtetuar se në Fushë Kosovë kemi problem me shtrirjen shumë disperse (objekte të shpërndara) dhe shtrirje lineare sidomos përgjat rrugës të ndërtimeve të cilat më tutje paraqesin problem në ofrimin e infrastrukturës dhe elementeve tjera urbane. Cilësohet si problem me përmasa serioze zgjerimi i tokës ndërtimore në mënyrë spontane, pastaj shtrirja e ndërtimeve në tokat bujqësore sidomos në zonën përgjat magjistrave Fushë Kosovë - Pejë sidhe përgjat rrugës së Obiliqit.

Harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës tregon destinimin për përdorim të tokës deri në vitin 2022. Këtu prezantohen edhe kufijt e rinjë ndërtimor dhe kushtet zhvillimor të përgjithshme, kushtet zhvillimore dhe masa tjera për zhvillimet. Kjo do të sjellë humbjen e mëtejshme të tokës bujqësore, por njëkohësisht do të sigurojë ruajtjen e pjesës së konsiderueshme të tokës me pllëshmëri, tokës së pasur me resurse dhe pyjeve. Kemi të prezantuar edhe zonat e shënuara me ngjyrë e cila potencialisht mund të paraqesin pikat e nehta mjedisor. Konfliktet e mundshme për hapsira mund të adresohen vetëm nëpërmjet zbatimit më të mirë të këtyre planeve. Masa e parë duhet të jetë arritja e një marrëveshjeje për mbrojtjen e këtyre zonave, e cila duhet të ndiqet nga plane rregulluese dhe tjera për komunën, të cilat do të vireshin më pas në zbatim. Kjo është një sfidë e madhe për qeverinë komunale. Gjatë procesit të hartimit janë organizuar takimet me komunitetin për të filluar këtë proces.

Zhvillimi dhe rritja e Fushë Kosovës besohet se do të vazhdojë, e në fakt sa më shumë sukses ekonomik të prodhojë Fushë Kosovës, aq më shumë do të përshpejtohet rritja e saj. Kjo do të ishte e dëshirueshme dhe është në të mirë të Kosovës, duke supozuar se realizohen investimet në infrastrukturën mjedisore dhe menaxhimi efektiv komunal, komuna e Fushë Kosovës me kushte zhvillimore nga HZK ka mundësi të akomodojë një numër shumë më të madh popullsie me zgjerimin e kufinjve ndërtimore dhe turistëve me zgjerimin e kapaciteteve receptive turistike. Burimet ujore nuk janë të mjaftueshme. Kapaciteti mjedisor mbajtës i Fushë Kosovës nuk përbën problem, ndërkohë që problem përbëjnë menaxhimi dhe planifikimi urban jo-efektiv dhe nevoja për financimet mëdha në infrastrukturën mjedisore. Plani i njeh këto probleme dhe përpiqet në mënyrë realiste të punojë brenda këtyre kufizimeve.

2. Ndikimi në klimë

Komuna e Fushë Kosovës vlerësohet se nuk ka indikacione se me aktivitetin aktual dhe ate që do të ket në perspektivë të ndikoj në klimën globale, pasi që komuna e Fushë Kosovës përpos disa industrive përpunuese të vogla nuk ka ndonjë industri apo objekt industrial që do të emitonte gazra të serrës në atë mas sa të ketë ndikim në klimën globale. Ndërsa si komunë është nën ndikim të ndotjes së ajrit nga termoelektrant e Obiliqit si dhe nga deponitë e hirit. Është e rëndësishme që të bëhen studime për të vlerësuar rritjen e temperaturës dhe faktorëve tjerë klimatik. Megjithatë komunikacioni hekurudhor dhe ai rrugor sidomos tani me ndërtimin e autostradave në mënyrë të pashmangshme do të shkaktojë një ndikim në mikroklimën rajonale duke ndikuar edhe në ngritjen e temperaturave dhe praninë e ndotësve në ajër, ujë dhe tokë.

3. Mbrojtja e pyjeve, zonave të gjelbra ekzistuese dhe zhvillimi i zonave të reja

Destinimet për shfrytëzim dhe të planifikuara të tokës të propozuara nga PZHK-ja dhe kushteve zhvillimore nga HZK-ja krijojnë mundësinë për struktura reja të pyjeve, kryesisht për përdorim të ndryshëm, kështu duke krijuar edhe habitate natyrore dhe mjedise atraktive. Komuna duhet që në kuadër të zbatimit të planit të ketë në prioritet projektet si:

- Projekte pyllëzimi konform HZK-së;
- Projekte ripyllëzimi dhe mirë mbajtje konform planit;
- Numrin e këtyre strukturave që do të lejohet dhe ku do të lejohet (apo nuk do të lejohet) ngritja e tyre;
- Projekte për ndërtim të infrastrukturës si rrugët malore melorim dhe drenazhim për pyjet, etj.
- Arkitekturën e tyre për të siguruar harmoninë vizuale me mjedisin rrethues;

4. Cilësia e ajrit

Harta Zonale Komunal adresonë problemet ajrit në aspektin e ndotjes dhe cilësisë së tij. Duke qenë në distance të afërt me termoelektranat e Obiliqit Prania e komunikacionit hekurudhor e autostradës "Ibrahim Rugova" dhe "Arbën Xhaferi" dhe magjistraleve Fushë Kosovë - Pejë, në këtë komunë është një element që tregon se ka shkarkim të konsiderueshëm të gasrave në atmosferë, si dhe lirim të zhurmave të ndryshme që vijnë nga komunikacioni. Ndërkohë që ndërtimi i termocentralet kosova C dhe rritja e parashikuar për trafikun në vitin 2022 do të bëjë që cilësia në përgjithësi e ajrit të përkeqësohet, veçanërisht për Pb, SO_x, NO_x, të cilat aktualisht janë brenda normave të BE-së dhe Kosovës. Zbatimi i standardeve më strikte për çlirimet në ajër nga automjetet, permiresimi dhe kontrolli i cilesisë së karburanteve menaxhimi më i mirë i trafikut, përfshirë përdorimin e rritur të bicikletave, si dhe furnizimi i plotë me energji (për të ulur përdorimin e gjeneratorëve) ka shumë gjasa të ngadalësojnë përkeqësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit për njëperiudhë afat-shkurtër deri në afat-mesme. Grimecat e imëta PM₁₀ (të ngurta, të lëngshme ose gaz) mund të depërtojnë në mushkëri duke shkaktuar efekte të mëdha shëndetësore të tilla si sulmet në zemër, kanceri në mushkëri, bronkitin kronik dhe ndikim më seriozi katek të moshuarit, fëmijët dhe diabetikët. Efekte të vogla shëndetësore përfshijnë. Këto efekte shëndetësore ndikojnë në cilësinë e jetës së çdo kujt dhe ndërhyjnë në mirëqenien ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore të banorëve të komunës së Fushë Kosovës. Duhet bërë vlerësimi i ndikimit të cilësisë së ajrit mbi shëndetin dhe ekonominë nëpërmjet llogaritjes së shkallës së sëmundshmërisë me qëllim vlerësimin sasior të dëmit në shëndet dhe koston ekonomike që sjell ndotja e ajrit për Komunën. HZK-ja adreson mirë problemet e zhurmës përmes kushteve, si dhe ka dhënë disa rekomandime dhe ka propozuar masa se si zhurma të reduktohet.


5. Rrugët e propozuara

Rrugët kryesisht janë të propozuara nga PZHK, PZHU dhe PRRU, kurse Harta Zonale Komunale jep kushtet për zhvillimin e rrugëve dhe ndërtimin e tyre. HZK propozon një kategorizim të rrugëve lokale dhe ndryshim ose zgjerim të traseve të disa rrugëve regjionale dhe magjistraleve si dhe propozon unazën e jashtme komunale dhe unazën urbane, poashtu HZK përcakton edhe brezat mbrojtës rrugor dhe hekurudhorë. Komuna e Fushë Kosovës është një territor tranzit në mes të qendrave nacionale vjen në shprehje edhe infrastruktura tjetër e cila diktohet nga niveli nacional dhe e cila ka impaktet më të larta mjedisore. Me probleme të përafërta përballen edhe rrugë të tjera të propozuara, të cilat kalojnë nëpër zona të gjelbra në të cilat janë masat adekuate për ruajtjen e tyre.


6. Ndikimi i Planit në Ekosistemet natyrore

Në disa zhvillime të cilat janë planifikuara ka disa ndikime të cilat janë të kthyeshme dhe të riparueshme. Në HZK janë propozuar masa kundër zhurmës dhe masa kundër ndotjes në pjesët ku ndjeshmëria në ekosisteme

është e lartë. Ekosistemet ku atakohen janë ekosisteme pyjore në disa korie (zabele) dhe në disa pjesë ekosisteme lumore por që ndikimi nuk është shumë i madh. Ndërkaq Plani parashe edhe projekte të cilat kanë ndikim pozitiv në ekosisteme siç shihen në hartat më poshtë:



Harta 1 Ndikimi i HZK-së në ekosistemet natyrore



Harta 2 Parashikimi i ndikimeve të HZK-së në aspektin hapësinor.

1.2.3. Rekomandimet të cilat dalin nga raporti i VSM-së për HZK

Rekomandimet që dalin nga VSM-ja janë:

- Definimi i korridoreve ekologjike gjatë realizimit të rrugëve të planifikuara;
- Studime mbi gjendjen e biodiversiteti dhe i habitateve natyrore në komunën e Fushë Kosovës;
- Hartim i projekteve për rehabilitim të zonave me potenciale rrezatimi, por edhe planifikimi i mundësive për trajtimin e rrezatimit dhe uraniumit të varfëruar në vendet ku është goditur me bomba në luftën e fundit mendohet të paraqitet si një burim vazhdueshëm i ndotjes në komunën e Fushë Kosovës;
- Harta i projekteve për rehabilitim të zonave erozive dhe të vërshimeve por edhe planifikimi i mundësive, masave dhe projekteve për trajtimin e Erozionit dhe Vërshimeve në aspektin e zonave dhe shkallëve të erozionit;
- Definimi i zonave ekonomike në aspektin e tipit të industries apo afarizmit dhe krijimit të bazave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishme të zonave duke ofruar bazat për trajtim të zonave ekonomike me masa fizike, natyrore dhe teknologjike që të jetë miqësor edhe në aspektin mjedisor;
- Të bëhen projekte duke u bazuar edhe në HZK vendet dhe mundësit, projektet dhe zhvillime për pyllëzim dhe ripyllëzim si mas të rëndësishme mjedisore;
- Projekte për rehabilitim të zonave, vijave ose mundësisht edhe pikave të zeza të ndotura nga mbeturinat dhe planifikohen mundësi trajtimi edhe se është përmend riciklimi si një mundësi por ka edhe mundësi tjera, definimi i hapësirave për deponi tranzite dhe sistemit të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave dhe proceset tjera;



- Definimi dhe trajtimi si zona konform standardeve dhe ligjeve në fuqi për ujrat nëntokësor dhe sipërfaqësor;
- Konservimi i veçorive natyrore (Monumentet e Natyrës) si objekte natyrore dhe si zona;
- Definimi i pejsazheve, parqeve me vlera ose ndikime mjedisore dhe parashikimi i masave;
- Trajtimi i ngrohjes së qytetit të Fushë Kosovës por edhe vendbanimeve si një dimension i rëndësishëm i ndotjes dhe ndikimit në ekosisteme;
- Projekte për caktimin e zonave të zhurmës;
- Definimi dhe trajtimi i zonave të pasura me florë dhe faunë.

1.2.4. *Proceset dhe ekipet e përfshira në hartimin e Hartës Zonale të Komunës*

Në fazën e fundit të procesit, komuna mori vendimin për organizimin e shqyrtimit publik duke përcaktuar me hollësisht format e pjesëmarrjes publike gjatë fazës së shqyrtimit publik, duke e konsideruar shqyrtimin publik si një ngjarje të hapur për pjesëmarrje publike, e zhvilluar në vendin e përshtatshme (sallën e Kuvendit komunal të Fushë Kosovës) nga autoriteti i planifikimit hapësinor, i cili përmes njoftimit publik i ka ftuar qytetarët, ekspertët dhe palët e interesuara për të parashtruar kundërshtimet, komentet apo sugjerimet, para finalizimit të Hartës Zonale Komunale të Fushë Kosovës.

Njoftimi publik u bë tetë (8) ditë para hapjes së shqyrtimit publik dhe u përcaktua kohëzgjatja e shqyrtimit publik prej tridhjetë (30) ditësh. Njoftimi për organizimin e shqyrtimit publik u publikua në tri gazeta të përditshme, në faqen e internetit të komunës dhe në mediat televizive qendrore dhe lokale. Brenda vendimit ishin të gjitha përmbajtjet e parapara me udhëzim administrativ.

Në fund pas marrjes së pëlqimit nga MMPH më datën 21.12.2019 dhe njoftimit publik tetë (8) ditë para hapjes së shqyrtimit publik dhe u përcaktua kohëzgjatja e shqyrtimit publik prej tridhjetë (30) ditësh. Njoftimi për organizimin e shqyrtimit publik u publikua në tri gazeta të përditshme, në faqen e internetit të komunës dhe në mediat televizive qendrore dhe lokale. Komuna hapi shqyrtimin publik nga data 25.01.2019 deri në datën 25.02.2019 dhe gjatë kësaj periudhe janë pranuar gjithsej 72 vërejtje, sugjerime, komente dhe 7 peticione, me shkrim në fletoren zyrtare, adresë elektronike si dhe përmes arhivës. Përmes Vendimit nr. 98 të datës 17.08.2012 është përcaktuar Komisionin Komunal për shqyrtimin e secilës vërejtje, koment, sugjerim të pranuar, i cili me datën 19.03.2019 ka trajtuar kërkesat e qytetarëve dhe ka përgatitur Raportin e Shqyrtimit Publik të bashkangjitur në **Shtojcën 4**.

Te gjitha propozimet dhe vërejtjet që janë paraqitur nga publiku brenda mënyrës dhe afatit kohor të përcaktuar, u përfshinë në Raportin mbi Shqyrtimin Publik. Raporti përfshin edhe regjistrin e pjesëmarrësve që kanë dhënë propozime dhe vërejtje me shkrim në projekt dokumentin Hartës Zonale Komunale të Fushë Kosovës brenda afatit dhe mënyrës së përcaktuar në udhëzimin administrativ.

Raporti përmban arsyetimin për miratimin apo refuzimin e propozimeve dhe vërejtjeve, mirëpo jo të propozimeve dhe vërejtjeve pas afatit të dhënë. Raportit i janë bashkëngjitur edhe procesverbalet nga prezantimet dhe diskutimet gjatë shqyrtimit publik, pesë (5) ditë pas përfundimit të Raportit mbi shqyrtimin publik. Raporti është publikuar në faqen zyrtare të internetit të komunës.

Projekt dokumentit të plotësuar të planifikimit hapësinor, i është bashkëngjitur edhe Raporti i shqyrtimit publik, Pëlqimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe është proceduar për pëlqim dhe për aprovim në subjektet përgjegjëse të përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.

1.3. Qëllimi i Hartës Zonale të Komunës



Një ndër qëllimet e para të Hartës Zonale të komunës së Fushë Kosovës, është përmbushja e kërkesës ligjore, e cila obligon komunën për hartimin e HZK-së dhe e cila është rezultat i zbatimit të projektit të reformës së integruar ligjore, që ka filluar për t'u zbatuar, me aprovimin e ligjit të ri të planifikimit Ligji Nr. 04/L-174.

Qëllimi tjetër i rëndësishëm i Hartës Zonale të Fushë Kosovës është të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e komunës së Fushë Kosovës, e cila do krijojë bazat e qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Kjo Hartë nëpërmes kushteve, rregullave, masave, standardeve ka për qëllim të sigurojë qeverisje të qëndrueshme, shfrytëzim efikas të fondeve publike, parakushte për zhvillim social dhe ekonomik të baraspeshuar, rregullim të qëndrueshëm të hapësirës, duke siguruar trajtim të barabartë, lëvizje të lirë dhe qasje adekuate në shërbimet publike për qytetarët dhe banorët e komunës së Fushë Kosovës.

Duke marrë për bazë zhvillimet e viteve të fundit (2012-2018) që janë bërë në Fushë Kosovë, në të gjitha fushat që nga banimi, zhvillimi ekonomik deri te infrastruktura teknike, rrugore dhe sociale, zhvillime të cilat janë me intensitet ndër më të lartat në Kosovë, ne si komunë e Fushë Kosovës i kemi vënë vetes për qëllim të HZK-së edhe ndërtimin e një procesi transparent, gjithëpërfshirës dhe më të disiplinuar në funksion të ruajtjes së shëndetit, pasurisë dhe mirëqenies publike duke kontrolluar vendndodhjen, volumin dhe shfrytëzimin e të gjitha parcelave, ndërtesave dhe strukturave, nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm të tokës brenda territorit të komunës.

Ne e kuptojmë Zonimin si një mjet, i cili i mundëson komunës sonë, që përmes kushteve, masave, bonuseve dhe përmbajtjeve tjera, të rregullojë shfrytëzimin dhe zhvillimin e tokës për tërë territorin e komunës.

Kjo nënkupton kushte dhe masa për rregullimin e resurseve dhe mjedisit, infrastrukturës dhe shërbimeve përcjellëse, me synim të sigurimit të zhvillimit hapësinor, fizik, ekonomik, social dhe mjedisor, shëndetit, si dhe mirëqenies së komuniteteve urbane dhe rurale, andej qëllimi i Hartës Zonale është ti rregulloj këto sa ma mirë që mundet, bazuar në raportet sektoriale nga PZHK por ehe gjenden ekzistuese.

Harta Zonale e Fushë Kosovës për qëllim kryesor ka trajtimin për nga aspekti hapësinor i zonave:

- Të përcaktojë kushtet e përgjithshme për zhvillim për të gjitha zonat, Zonat e destinuara dhe kushtet zhvillimore përfshirë Kushtet ndërtimore, Zonat Mbishtresore dhe Kushtet Zhvillimore, rregullat për shfrytëzim dhe zhvillim që ofron mundësi të zhvillimit dhe kufizimeve për qytetarët, pronarët, investitorët dhe institucionet qeveritare.
- Zbatimin e projekteve kapitale nga: Infrastruktura teknike, Infrastruktura rrugore, Infrastruktura publike dhe sociale në përgjegjësi të autoriteteve qeverisëse qendrore dhe lokale, në harmoni me buxhetin dhe afatet kohore të dokumenteve të planifikimit hapësinor.

Qëllimet dhe objektivat e PZHK-së së Fushë Kosovës dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshme (QZHQ) do jenë qëllime bazë edhe për HZK-në, pasi që Harta Zonale Komunale paraqet një mjet për arritjen e qëllimeve dhe objektiveve të Planit Zhvillimor Komunal si dhe për shtrirjen hapësimore dhe gjeografike të qëllimeve dhe objektiveve.

Edhe qëllimi tjetër i Hartës Zonale të Fushë Kosovës është arsyetim për nevojën e hartimit të planeve rregulluese të hollësishme të planifikuar, përgatitja e Plani i Veprimit për Zbatim, mundësimi i administrimit, zbatimit dhe monitorimit të zbatimit të këtij dokumenti.

Krejt në fund harta Zonale e Fushë Kosovës ka për qëllim që në një proces transparent të mundësojë marrjen e kushteve dhe lejes ndërtimore pa proceduara të komplikuar burokratike në komplet territorin e komunës.

1.4. Përshkrimi i kërkesave që rrjedhin nga planet zhvillimore sektoriale të Planit Zhvillimor Komunal



Duke u bazuar në konceptin kryesor të Planit Zhvillimor Komunal i cili është zhvillim i komunës policentrik me elementet balancuese, i cili synon një zhvillim të balancuar dhe një shpërndarje gjithëpërfshirëse të zonave të banimit dhe funksioneve publike nëpër territorin komunal. Teorikisht kjo ndikon në ruajtjen e vendbanimeve dhe afron banorët me tokën e punueshme. Sipas këtij koncepti komuna zhvillohet në Qendrën urbane, Subqendrat urbane dhe në Bashkësitë lokale.

Korniza e zhvillimit hapësinor komunal 2011–2016 e bazuar në konceptin final kategorizon këto zona për zhvillim:

1. Zona e biznesit: 2324 ha
2. Zona e bujqësisë: 4511 ha
3. Zona e industrisë: 235 ha
4. Zona e turizmit: 1619 ha
5. Vendbanimet (shtrirja 2004) 986 ha

Ndërsa si kërkesa të cilat dalin nga PZHK të cilat duhet të trajtohen më tutje në Hartën Zonale Komunale janë:

1. Mbrojtja dhe kultivimi i tokës bujqësore,
2. Shtimi i prodhimit bujqësor dhe ngritja e agrobizneseve,
3. Ngritja e impianteve për përpunimin e prodhimeve bujqësore,
4. Zhvillimi i NVM,
5. Funksionalizimi i brezit të biznesit,
6. Funksionalizimi i pikave dhe zonës me potencial turistik, mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturore,
7. Promovimi i turizmit,
8. Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve në Arsim,
9. Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve në shëndetësi,
10. Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve publike,
11. Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së përmbajtjeve kulturore,
12. Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së përmbajtjeve për sport e rekreim,
13. Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale,
14. Përmirësimi i objekteve dhe hapësirave ekzistuese komunale të infrastrukturës sociale, funksionale e fshatrave të Fushë Kosovës përmes ndërtimit të rrugëve të reja; përmirësimi i elementeve gjeometrike të rrugëve ekzistuese,
15. Ndërlidhja dhe funksionalizimi i rrjetit rrugor në mënyrë që të mundësohet qasje sa më e shkurtër në vendet ku mund të bëhet shkëmbimi; kyçje dhe shkyçje e sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion,
16. Përmirësimi i shkallës së sigurtisë dhe kapacitetit në trasenë ekzistuese të rrugës magjistrale M9; semaforët; pajisjet inteligjente,
17. Vendosja e linjës urbane,
18. Përmirësimi i rrjetit të kanalizimit,
19. Ndërtimi i impiantit,
20. Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit,

21. Shtimi i kapaciteteve prodhuese të ujit.

1.5. Ndërlidhjet me Planet Rregulluese Urbane në fuqi dhe me Planet Rregulluese të Hollësishme

Komuna e Fushë Kosovës ka një Plan Rregullues Urban (PRrU) i cili mbulon gjithë pjesën Urbane të qytetit të Fushë Kosovës. Zona urbane e mbuluar me PRrU aktualisht ka një sipërfaqe prej 577,92 ha. Pas decentralizimit të komunave, pjesës urbane të mbuluar me PRrU të Fushë Kosovës iu kanë ndarë (hequr) 103 ha dhe iu kanë bashkëngjitur komunës së Graçanicës. Kjo ndarje e tillë paraqet sfidë në vete në funksionimin e qytetit në kuptimin e infrastrukturës rrugore dhe infrastrukturës tjetër teknike, në kuptimin e destinimeve brenda qytetit, etj.

Lista e zonave që dalin nga destinimi i sipërfaqeve nga PRrU për qytetin të Fushë Kosovës është: Banim Individual, Banim Kolektiv, Institucione Parashkollore, Institucione shkollore, Institucionet Kulturore, Institucionet publike, Objekt Fetar, Park Biznesi, Park/shesh, Pikë karburanti, Tokë e punuar, QKMF, QMF, Shtëpi e Kulturës, Shtëpi Integruese për të sëmurë mental, Sipërfaqe me gjelbërim mbrojtës, Sport/rekreim, Zonë Industriale, Terminal, Tokë e rezervuar urbane, Treg, Varrezat.

Sa i përket kushteve ndërtimore dhe kushteve tjera në PRrU janë të paraqitura etazhiteti, vija rregulluese dhe vija ndërtimore, distancat në mes të objekteve, kurse mungojnë Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale të zhvilluar (ISHPKZH) dhe Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar (ISN).

Qyteti i Fushë Kosovës ka një zhvillim të hovshëm në të njëjtën kohë edhe kërkesat për ndërtim janë shumë të mëdha sidomos vërehet kërkesa e madhe për banim të lartë apo banesa kolektive, Komuna e Fushë Kosovës duke e parë këtë zhvillim të hovshëm ka marrë disa vendime në Kuvendin Komunal duke shndërruar disa zona të banimit individual në banim kolektiv të lartë duke i harmonizuar kushtet urbanistike dhe kushtet tjera të shërbimit publik me kërkesat e investitorëve. Zonat të cilat janë shndërruar me vendime komunale nga banim individual në kolektiv shumëbanesor me etazhitet të lartë janë zonat nga rruga “Nënë Tereza” në drejtim të veriut deri te hekurudha, kështu duke përfshirë rrugët kryesore urbane të kësaj zone si “Rruga e Llapit”, “Hamdi Grajçevci”, “Pajazit Islami”, “Rexhep Mala”, “17 Shkurti”, “Hajrullah Zymi”, “Shefki Kuleta”, “Abedin Sogojeva”, etj. Gjithashtu me vendim të Kuvendit Komunal në këtë pjesë edhe Brezi Rregullues Hekurudhor është zvogëluar nga 40m sa ka qenë, në 25m sipas Udhëzimit Administrativ për Normat Teknike të Planifikimit. Ndërsa në pjesë jugore me vendim të Kuvendit Komunal kemi shndërrim të destinimit nga banimi individual në atë kolektiv nga Rruga “Nënë Tereza” deri te rruga “Tahir Zema”. Të gjitha këto ndryshime duhet të barten edhe në Hartën Zonale të Komunës (HZK), si dhe të analizohen edhe kushtet tjera zhvillimore. Në HZK duhet të analizohet dhe të projektohet infrastruktura teknike, duke u bazuar edhe në PZHK, si: furnizimi me ujë, largimi i ujërave të zeza, furnizimi me ngrohje, menaxhimi i mbeturinave, etj.

Po ashtu mbetet të analizohet edhe infrastruktura sociale si shkollat, objektet fetare, shëndetësore, administrative, etj. pasi që në këto pjesë tani më kemi koncentrimin më të madh të banorëve dhe të bizneseve afariste

Disa nga destinimet janë Tokë e Rezervuar Urbane të cilat është menduar që në të ardhmen të ketë zgjerim të kufijve ndërtimorë urbanë në këtë pjesë. Po ashtu në disa pjesë të zonës me PRrU kemi destinim tokë e punuar, kurse tani ato pjesë vetëm se janë të ndërtuara me objekte banime edhe objekte tjera, respektivisht *de facto* tani ato zona vetëm se janë ndërtimore.

1.6. Ndryshimet në tematikë ose në strategjitë sektoriale lokale që nga miratimi i Planit Zhvillimor Komunal

Në fushat e ndryshme tematike të cilat janë trajtuar në Planin Zhvillimor Komunal konsiderohet se deri me tani kemi ndryshime të mëdha në terren. Disa nga zhvillimet ishin në presion të madh nga zhvillime me intensitet dhe vëllim më të madh dhe si të tilla mund të konsiderohen zhvillimet në zonën urbane dhe përgjatë rrugës rajonale, janë zhvillime të shtyra nga ekonomia e tregut dhe mund të konsiderohen si të pa kontrolluara dhe si të tilla janë pjesërisht më ndryshe nga tematikat ose strategjitë sektoriale lokale të miratuara me Planin Zhvillimor Komunal. Duhet konsideruar se gjendja ekzistuese prezanton edhe projektet e ndryshme për infrastrukturën hekurudhore, largpërcues, shfrytëzimin e pasurive nëntokësore dhe përmbajtjeve tjera që janë kompetencë e nivelit qendror dhe nuk janë prezantuar në PZHK, pra gjendja ekzistuese ka ndryshime por edhe te banimi dhe infrastruktura që është kompetencë e nivelit lokal, edhe aty ka ndryshime dhe duhet të trajtohen më tutje në HZK si gjendje ekzistuese. Në PZHK janë paraparë këto destinime me sipërfaqet e paraqitura në tabelën me poshtë.


Destinimi i sipërfaqeve	Sipërfaqja ha
Banimi	986
Biznesi	2324
Bujqësi	4511
Industri	235
Pyjore	1619

Tabela 1 Sipërfaqet e destinuara sipas PZHK-së

Pjesën më të madhe të territorit e zë zona bujqësore, ndërsa zona e ndërtuar këtu është mjaft e zgjeruar sidomos ajo e bizneseve e cila siç vërehet edhe në hartë është e planifikuar në PZHK duke u bazuar edhe në një vendim të Kuvendit Komunal, ku sipas tij zona për biznese të jetë nga 200m në të dyja anët e rrugës nacionale, brenda saj duke u paraparë edhe tri zona industriale.

Siç vërehet në gjendjen ekzistuese të fundit, kemi shtrirje më të zgjeruar të objekteve të banimit, objekteve afariste

dhe objekteve industriale në dëm të tokës bujqësore, duke e zvogëluar fondin e tokës së punueshme bujqësore dhe duke i rritur dhe zgjeruar vendbanimet në mënyrë shpërndarëse.




Harta 3 Sipërfaqet e destinuara sipas PZHK-së

Destinimi i sipërfaqeve	Sip. ha
Biznese	1405.64
Industri	215.83

TokëBujqësore	4152.26
TokëPyjet	1352.6
Vendbanimet	1283.63

Tabela 2 Sipërfaqet e destinuara sipas PZhU-së



Harta 4 Sipërfaqet e destinuara sipas PZhU-së

1.7. Shqyrtimi i përgjithësuar i dokumentit të planifikimit paraprak të po të njëjtit nivel

Gjatë kësaj kohe kur jemi duke përgatitur Hartën Zonale të Fushë Kosovës, nuk mund të bëhet shqyrtimi i përgjithësuar i dokumentit të planifikimit paraprak saktësisht i të njëjtit nivel, pasi që komuna e Fushë Kosovës po bën për herë të parë Hartën Zonale Komunale.

Pas miratimit të këtij dokumenti me siguri se do të kemi edhe hartime të dokumenteve të reja të të njëjtit nivel, ku mund të kemi shqyrtim të përgjithësuar të dokumentit të planifikimit paraprak të po të njëjtit nivel pra të kësaj HZK-je, edhe gjatë rishikimit dhe plotësimit nëse ndodh pas 4 viteve mund të ketë shqyrtim të përgjithësuar të Hartës Zonale Komunale.

Prandaj këtu kemi trajtuar si dokumente paraprake të njëjtit nivel Planin Zhvillimor Komunal por edhe Planin Zhvillimor Urban, pasi që më lart kemi shqyrtuar Planin Zhvillimor Komunal dhe PrrU, fokusi ynë i shqyrtimit do jetë te Plani Zhvillimor Urban i cili mund të konsiderohet si dokument i po të njëjtit nivel.

Dhe në këtë dokument janë shqyrtuar në mënyrë të përgjithësuar të gjitha përmbajtjet dhe në veçanti: Kushte të përcaktuara nga qeveria lokale mbi çështje të rëndësishme për zhvillimin dhe shfrytëzimin e tokës në qytet, Kushtet për përcaktimin e destinimit të sipërfaqeve në territorin e qytetit, Kushtet për rregullimin e hapësirës, Kushtet për vendosjen e veprimtarive ekonomike, Kushtet për vendosjen e veprimtarive publike, Kushtet për vendosjen e korridoreve apo traseve, sipërfaqeve komunikuese dhe sistemeve tjera të infrastrukturës; Duhet të hartohet në detaje koncepti i mobilitetit (përfshirë edhe transportin publik, këmbësorët dhe çiklistët) për komunën e Fushë Kosovës, Masat për mbrojtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturore-historike, Mënyra e trajtimit të hedhurinave, Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis, Mbrojtja e ujit, Mbrojtja nga zhurma, Mbrojtja e ajrit.



2. ARSYETIMI

Gjatë përgatitjes së HZK-së së Fushë Kosovës, në harmoni edhe me kërkesat ligjore, kemi trajtuar dhe sqaruar arsyet ligjore, mjedisore, ekonomike, financiare dhe sociale për krijimin e Zonave, zonave mbishtresore si dhe zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit që rrjedh nga Plani Zhvillimor Komunal.

Arsyeshmëria e përdorur në pjesën e arsyetimit përfshin marrjen në konsideratë të kritereve të përcaktuara në nenin 5 të Udhëzimit Administrativ 24/2015, të cilat duhet t'i marrim për bazë, që në fakt paraqesin parimet e tilla si:

Parimet e përgjithshme gjatë hartimit të Hartës Zonale Komunale të Fushë Kosovës:

- Harta Zonale e Komunës bazohet në parimin e demokracisë, subsidiaritetit, pjesëmarrjes, integritetit, proporcionalitetit dhe parandalimit.

Parimet e zonimit të përdorura gjatë hartimit të Hartës Zonale Komunale të Fushë Kosovës:

- Harta Zonale Komunale e Fushë Kosovës trajtohet si mjet për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të Planit Zhvillimor Komunal dhe për shtrirjen hapësinore si dhe gjeografike të tyre.

Në bazë të Hartës së Shfrytëzimit të Planifikuar të Tokës nga Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale e Komunës ofron elaboratin e hollësishëm të kufijve të zonave dhe kushteve zhvillimore për çdo zonë.

Përveç parimeve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 4 të Ligjit të planifikimit hapësinor Nr.04/L-013 dhe në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ Nr 24/2015, Harta Zonale e Komunës hartohen në pajtim me parimet specifike në vijim:

6. promovimin e objektivave të planeve zhvillimore sektoriale dhe hartat e shfrytëzimit të planifikuar të tokës të përcaktuara në Planin Zhvillimor Komunal;
7. promovimin e objektivave të komunitetit, ashtu si janë deklaruar në Planin Zhvillimor Komunal si: krijimi i mundësive të reja për punë, ofrimi i banimit të përballueshëm, etj.;
8. promovimin e shëndetit dhe sigurisë publike dhe të mirëqenies së përgjithshme;
9. sigurimin e llojllojshmërisë së shfrytëzimit dhe densiteteve të përshtatshme me karakterin e komunës që pasqyrojnë nevojat aktuale dhe ato të planifikuara;
10. nevoja për të balancuar interesin publik me të drejtat e pronës private dhe shfrytëzimin të arsyeshëm të pronës në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi;
11. sigurimin e zhvillimit të planifikuar të bazuar në:
 - modelet e shfrytëzimit të tokës të bazuara të Planit Zhvillimor Komunal;
 - gjendjen ekzistuese, marrë parasysh mjedisin e ndërtuar faktik dhe të drejtat pronësore me qëllim që hartimi i dokumenteve të planifikimit hapësinor të jetë real dhe i zbatueshëm;
 - karakteristikat natyrore të tokës, përfshirë përshtatshmërinë e shfrytëzueshmërisë të bazuar në karakteristikat e dheut, topografisë dhe ndjeshmërisë ndaj ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
 - kapacitetet ekzistuese dhe të planifikuara të shërbimeve dhe ndërtesave publike dhe private;
 - nevoja për të formësuar dhe balancuar zhvillimin urban dhe rural;
 - harmonizimin e kërkesave të interesit publik me të drejtat në pronën private nëpërmjet shfrytëzimit të arsyeshëm të pronës;
 - promovimin e teknikave inovative për zhvillim;
 - sigurimin e kontrollit të ndotjes së ajrit, ujit, tokës, ujërave tokësore dhe ndotjes akustike;
 - sigurimin e masave mbrojtëse ndaj zjarrit, erozionit, rrëshqitjes së dheut, ortekeve, tërmeteve dhe vërshimeve;
 - sigurimin e mbrojtjes së karakterit natyror, historik, kulturor dhe peizazhor të territorit të komunës;



- ruajtjen dhe promovimin e traditës në prodhimtarinë bujqësore, pylltari, peshkim, rekreacionit dhe aktiviteteve në hapësirë të hapur;
- promovimin e veprimtarive të organizuara në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, në zonat rurale në funksion të ruajtjes së tokës bujqësore kualitative dhe kulturave të ndryshme;
- sigurimin e mbrojtjes së investimeve të infrastrukturës publike, sociale, teknike dhe zhvillimit të integruar e të arritshëm në funksion të transportit urban, ndër urban, rural dhe menaxhim të mbeturinave;
- promovimin e mundësive të barabarta për banim të qëndrueshëm për familjet që nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të banimit me qëllim të stabilitetit social, shëndetit dhe zhvillimit të mirëqenies njerëzore për të gjithë qytetarët nën administrimin territorial të komunës së Fushë Kosovës;
- sigurimin e mundësisë së shfrytëzimit të tokës në koordinim me komunat fqinje, qeverinë qendrore dhe agjencitë tjera, veçanërisht në lidhje me resurset dhe shërbimet që shtrihen përtej kufijve të komunës së Fushë Kosovës apo që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në komunë;
- sigurimin që shfrytëzimi i tokës të përfshijë udhëzime të planifikimit dhe obligimet të cilat rrjedhin nga dokumentet dhe planet hapësinore për rajon më të gjerë e të cilat afektojnë komunën e Fushë Kosovës;
- sigurimin e përfshirjes së elementeve hapësinore të transportit, zhvillimit ekonomik, shoqëror, mjedisor dhe politikat tjera strategjike për komunën në procesin e planifikimit hapësinor; dhe
- sigurimin e rishikimit efikas të propozimeve për zhvillim dhe kërkesave për leje ndërtimore për sqarim dhe përshejtim të procedurës.

Harta Zonale e Komunës së Fushë Kosovës është bazuar në Planin Hapësinor të Kosovës, në Hartën Zonale të Kosovës (ky dokument ende nuk është hartuar nga niveli qendror dhe për momentin nuk është relevant) dhe interesat kombëtare të paraqitura si objektiva, plane dhe politika zyrtare të Qeverisë.

Harta Zonale e Komunës së Fushë Kosovës ka marrë parasysh mundësitë e integritetit të Planeve Rregulluese Urbane që janë në fuqi. Harta Zonale e Komunës së Fushë Kosovës është hartuar në përputhje me normat teknike të planifikimit hapësinor.

Harta Zonale e Komunës së Fushë Kosovës është hartuar në formën e cila e bën më të lehtë përdorimin dhe lehtëson monitorimin dhe rishikimin dhe ka kaluar në procese të diskutimeve dhe shqyrtimit publik, ku janë marrë në konsideratë kërkesat e të gjithë qytetarëve si dhe kërkesat dhe nevojat specifike të personave me nevoja të veçanta, të të moshuarve, minoriteteve, fëmijëve, të rinjve dhe aspektet e ndjeshme gjinore.

Hartimi i Hartës Zonale të Fushë Kosovës është bazuar edhe në parimet e mëposhtme:

- Promovimin e interesave të përbashkëta të qytetarëve të komunës së Fushë Kosovës, dukembrojtur burimet natyrore, trashëgiminë kulturore dhe përkrahur zhvillimin e qëndrueshëm
- Promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes publike dhe përfshirjen ndër-sektoriale në formulimin e strategjive zhvillimore dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor;
- Promovimin e transparencës së plotë në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes, duke siguruar qasje publike për palët e interesuara në të dhëna, harta, grafikone, të drejta dhe në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor;
- Promovimin e kornizës themelore, transparente dhe të planifikuar të shfrytëzimit dhe zhvillimit, mbrojtjes së mjedisit, trashëgimisë kulturore, si dhe të drejtave pronësore;
- Promovimin e mundësive të barabarta të zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor për të gjithë qytetarët e Fushë Kosovës;
- Promovimin e cilësisë së lartë të jetesës dhe sistemeve të qëndrueshme për zhvillimin e vendbanimeve;
- Promovimin e planifikimit hapësinor të integruar përmes ecurive efikase;
- Promovimin e pjesëmarrjes publike në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor;
- Promovimin e zhvillimit të balancuar dhe të qëndrueshëm bazuar në nevojat publike dhe ekonomike; dhe



- Promovimin e vazhdueshëm të harmonizimit me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe me parimet Evropiane për zhvillim hapësinor;
- Zhvillim të qëndrueshëm dhe proporcional të komunitetit, duke shfrytëzuar në mënyrë efikase fondet publike; dhe
- Parimet ndërkombëtare të planifikimit hapësinor, zhvillim të qëndrueshëm, dhe qeverisje në harmoni me normat e BE-së.

Elementet dhe kërkesat themelore e përdorura gjatë hartimit të Hartës Zonale Komunale të Fushë Kosovës janë:

1. Harta Zonale e Komunës së Fushë Kosovës bazohet në aktivitetet zhvillimore hapësinore të cilat rrjedhin nga Plani Zhvillimor Komunal, përkatësisht nga harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës, planet zhvillimore sektoriale dhe plani i veprimit.
2. Harta Zonale e Komunës së Fushë Kosovës përcakton ndarjen precize të territorit të komunës në zona funksionale dhe për secilën zonë përcakton shfrytëzimet e tokës, kushtet zhvillimore dhe masat mbrojtëse për periudhën e planifikuar të zhvillimit.
3. Harta Zonale e Komunës së Fushë Kosovës përmban zonat funksionale të cilat rrjedhin nga Plani Hapësinor i Kosovës, dhe Planet Hapësinore për Zona të Veçanta.

Gjatë hartimit të Hartës Zonale të Fushë Kosovës në funksion të kompletimit të kërkesave ligjore që rrjedhin nga ligji i ri i planifikimit, po edhe më shumë të krijimit një baze reale për trajtimin zhvillimeve të ardhme hapësinore përmes me HZK, si dhe sigurimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e komunës së Fushë Kosovës për precizimin e **Zonave, Zonave mbishtresore si dhe zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit që rrjedh nga Plani Zhvillimor Komunal.**

Është bërë një analizë e hollësishme, reale dhe e qëndrueshme ligjore, mjedisore, ekonomike, financiare dhe sociale siç edhe është kërkuar në këtë pjesë të dokumentit.

Pasi që kjo pjesë e Hartës Zonale të Komunës së Fushë Kosovës ofron arsyen e definimit dhe të precizimit të zonave, zonave mbishtresore si dhe zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit që rrjedh nga Plani Zhvillimor Komunal, mund të konstatojmë se shumica e zonave bazë që janë trajtuar në Hartën e Shfrytëzimit të Planifikuar të Tokës të Planit Zhvillimor Komunal do jenë zona bazë për trajtim të mëtejshëm, me precizimin e kërkuar në HZK.

Duhet theksuar se në disa zona kemi ndryshime nga ajo që është paraparë Hartën e Shfrytëzimit të Planifikuar të Tokës në Planin Zhvillimor Komunal të Fushë Kosovës. Këto ndryshime nuk janë rezultat i një zhvillimi të menjëhershëm por i një zhvillimi disavjeçar dhe këto zhvillime tanimë janë një realitet në terren, të cilat nuk mund të mos përfillen, duke prezantuar njërin nga dy bazat e hartës zonale, e cila nuk ishte e precizuar në planet zhvillimore sektoriale, siç është kërkuar në HZK, por është precizuar duke marrë për bazë gjendjen ekzistuese, si njërin nga dy bazat të kërkuara me Udhëzim Administrativ.

2.1. Zonat

Arsyeja e precizimit si zona të cilat në elemente të caktuara dallojnë nga planet e më hershme të shfrytëzimit të tokës, rrjedh nga analizat e hollësishme, reale dhe të qëndrueshme ligjore, qoftë vendimet nga Kuvendi Komunal i Fushë Kosovës apo edhe i nivelit qendrorë, qoftë arsyeja se shumica e objekteve pa leje ndërtimore janë në proces të legalizimit bazuar në Ligjin Nr. 04/L-188 Për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje, te arsyet mjedisore janë analizuar ndikimet e mundshme negative në mjedisore për tu propozuar ose jo ndryshimi. Në aspektin ekonomik janë vlerësuar se sa kemi zhvillim të bizneseve në zonë, cilat janë potencialet ekonomike dhe cilat do ishin pasojat nga aspekti ekonomik nëse nuk do lejohej ndryshimi, edhe në kuptimin financiar janë analizuar se cilat janë kostot endërtesave dhe zhvillimeve në zonë dhe cilat do ishin kostot e rrënimave eventuale dhe në aspektin financiar është vlerësuar se sa ja vlen ndryshimi ose ruajtja e destinimit të



mëhershëm dhe krejt në fund nga aspekti social është vlerësuar se sa do të ishte numri i familjeve që do kishin pasoja nëse nuk merret për bazë gjendja ekzistuese.

Një element tjetër përmbajtësor që e kemi analizuar gjatë precizimit të zonave bazë janë edhe parimet e hartimit të Hartës Zonale të Komunës dhe dihet se hartimi i këtij dokumenti bazohet në parimet e lartpërmendura dhe ndër më të rëndësishmet janë: parimi i demokracisë, subsidiariteti, pjesëmarrja, integriteti, proporcionaliteti dhe parandalimi.

Në këtë kuadër edhe parimet specifike si promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes publike dhe përfshirjen ndërsektoriale në formulimin e strategjive zhvillimore dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor; Promovimin e transparencës së plotë në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes, duke siguruar qasje publike për palët e interesuara në të dhëna, harta, grafikone, të drejta dhe në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor;

Promovimin e kornizës themelore, transparente dhe të planifikuar të shfrytëzimit dhe zhvillimit, mbrojtjes së mjedisit, trashëgimisë kulturore, si dhe të drejtave pronësore;

Promovimin e mundësive të barabarta të zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor për të gjithë qytetarët e Fushë Kosovës.

Duke i kuptuar këto parime profesionalisht, seriozisht dhe si obligim për hartimin e HZK-së është marrë për bazë gjendja ekzistuese në disa zona dhe në këtë drejtim duhet theksohet se në mesin e një numri të vogël të zonave, të paraqitura në kaptullin 5 Lista e Zonave dhe Zonave Mbishtresore, të cilat ose janë precizuar ose janë ndryshuar nga Harta e Shfrytëzimit të Planifikuar të Tokës në Planin Zhvillimor Komunal të Fushë Kosovës, janë:

Zonat që tanimë trajtohen si zona me banim kolektiv në zonën urbane, fillimisht nga aspekti social, ku në këto zona jetojnë mijëra banorë dhe mostrajtimi si zona të tilla do të shkaktonte trazira sociale të ndjeshme në Fushë Kosovë. Nga aspekti ekonomik do ta dëmtonte rëndë ekonominë e komunës pasi me dhjetëra biznese funksionojnë dhe kanë funksionuar në këto zona, por kemi edhe zhvillime tjera ekonomike private dhe publike. Nga aspekti financiar, në zonë janë investuar miliona euro në banim kolektiv dhe në rast vendimi për një gjendje të ndryshme nga ajo që është zhvilluar, Komuna nuk ka mundësi që të përballojë ngarkesat financiare, qoftë në rrënimin objekteve dhe kthimin në gjendjen e mëparshme, por edhe sektori privat dhe pronarët do të falimentonin, krejt në fund edhe nga aspekti legal në zonë një pjesë e madhe e objekteve kanë leje ndërtimi, pjesa tjetër me nënshkrime dhe peticione kanë kërkuar trajtimin e zonës si banim kolektiv duke shfrytëzuar edhe parimet e lartcekura dhe për më shumë kemi vendimet edhe të kuvendit komunal të Fushë Kosovës për ndërrim destinimi, duke e ritheksuar edhe një herë se Harta Zonale precizon zonat dhe parasheh kushte zhvillimore të përgjithshme, kushte zhvillimore dhe masat tjera, përfundimisht bazuar në të gjitha këto analiza të hollësishme, reale dhe të qëndrueshme ligjore, mjedisore, ekonomike, financiare dhe sociale por edhe parimet e hartimit të Hartës Zonale kemi këto zona për banim kolektiv.

Duke marrë parasysh, rrethanat e krijuara, me datën 05.05.2017 Kuvendi Komunal ka marrë vendim për lejimin e ndërtimeve të larta në disa zona të zonës urbane të Komunës, kopja e së cilës është bashkangjitur në **Shtojcën 5** të këtij dokumenti.

Me datën 09.08.2017, përmes Ministrisë së Pushtetit Lokal, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka rekomanduar që ky vendim të përfshihet në Hartën Zonale të Komunës, kopja e së cilës është bashkangjitur në **Shtojcën 6** të këtij dokumenti.




Harta 5 Gjendja aktuale në raport me atë të planifikuar në Planin Rregullues Urban


Blloqet urbane të cilave u është ndryshuar destinimi nga Banimi Individual që kanë qenë në Planin Rregullues Urban në Banim Kolektiv sipas Hartës Zonale Komunale, janë paraqitur në vijim:

ZB5:72; ZB6:94; ZB6:103; ZB6:104; ZB6:106; ZB6:107; ZB6:108; ZB7:109_ZB7:110_ ZB7:111_ ZB6:113_ZB6:114_ZB6:115; ZB6:116; ZB6:117; ZB4:118; ZB5:119; ZB4:124; ZB4:125; ZB4:126; ZB5:127; ZB5:128; ZB6:129; ZB6:131; ZB6:132; ZB5:133; ZB5:136; ZB4:137; ZB4:138; ZB4:139; ZB6:144; ZB4:166; ZB4:167; ZB4:168; ZB4:169; ZB4:170; ZB4:171; ZB4:172; ZB5:173; ZB6:176; ZB6:177; ZB6:179; ZB6:180; ZB6:181; ZB4:182; ZB4:183; ZB4:184; ZB6:185; ZB6:186; ZB4:187; ZB4:188; ZB6:190; ZB6:191; ZB6:192; ZB6:193; ZB6:194; ZB6:195; ZB6:197; ZB6:198; ZB6:199; ZB6:201; ZB4:202; ZB4:203; ZB4:204; ZB4:205; ZB4:206; ZB4:207; ZB6:1245; ZB6:1246; ZB6:1247; ZB6:1248; ZB6:1249; ZB6:1250; ZB4:1254; ZB4:1258; ZB4:1261; ZB4:1262; ZB4:1263; ZB4:1264; ZB5:1265.

Ndryshim destinimi nga Tokë e rezervuar urbane sipas PRRU-së në Banim Kolektiv sipas HZK-së
ZB2:162; ZB6:178; ZB4:208; ZB4:209.



Harta 6 Zonimi i pjesës urbane sipas Planit Zhvillimor Urban



Harta 7 Zonimi i pjesës urbane sipas Hartës Zonale të Komunës

2.2. Zonat mbishtresore


Bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 24/2015 Mbi Elementet Dhe Kërkesat Themelore Për Hartimin, Zbatimin Dhe Monitorimin E Hartës Zonale Të Komunës por edhe në shembujt e vendeve që përgatisin Harta Zonale, ekipet punuese kemi trajtuar zonat mbishtresore si një teknikë të zonimit që përdoret për vendosjen e kushteve zhvillimore alternative, në kuadër të një sipërfaqeje specifike të komunës së Fushë Kosovës, e cila kërkon vëmendje të veçantë dhe zonat për të cilat duhen kushte plotësuese përpos kushte zhvillimore dhe kushte ndërtimore në zonën bazë, vendosen mbi një apo disa zona bazë dhe krahas kushteve të zonës bazë, për zonat mbishtresore vendosen kushte apo masa plotësuese dhe në rastet kur janë përcaktuar kushte që janë në kundërshtim në mes të zonës bazë dhe zonës mbishtresore atëherë kushtet e zonës mbishtresore kanë përparësi ndaj atyre të zonës bazë.

Duke e ditur se zonat mbishtresore - përdoren për vendosjen e kushteve zhvillimore më strikte dhe masave mbrojtëse shtesë në disa hapësira specifike gjeografike, për definimin e zonave mbishtresore kemi analizuar komplet territorin e Komunës së Fushë Kosovës se ku ka nevojë:

- Të përcaktohen masa mbrojtëse për resurset kulturore, historike, ekonomike, turistike, bujqësore të cilat nuk janë adresuar me zonën bazë;
- Të përcaktohen masa mbrojtëse dhe parandaluese për Sipërfaqet e Mbrojtura, Zonat e Veçanta, Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe Zonat Mbrojtëse;
- Të përcaktohen masa mbrojtëse për resurset lokale natyrore, si: mbrojtja e natyrës, e sipërfaqeve ujore, klimës, pyjeve, etj. të cilat nuk janë të adresuara me zonën bazë;
- Të përcaktohen masa mbrojtëse për ndikimet në mjedis, si: ndotja e ajrit, zhurmës, etj.;

- Të përcaktohen masa mbrojtëse dhe parandaluese për sipërfaqet me rrezikshmëri nga zjarri, nga përmbytja, sipërfaqet sizmike, erozive, rrëshqitja e gurëve, ortekëve, tërmetet, e të tjera dhe Standarde të caktuara që nuk janë të nevojshme për t'u zbatuar në gjithë territorin e Komunës së Fushë Kosovës.

Gjatë analizës së hollësishme është konstatuar se zona e Aeroportit, zonat sizmike, zona e vërshimeve, zona e mihjeve dhe disa zona të tjera në Fushë Kosovë të pasura me pasuri nëntokësore plotësojnë kushtet e trajtimit si zona mbishtresore, të paraqitura në kapitullin 5 Lista e Zonave dhe Zonave Mbishtresore.



Harta 8 Zonat Mbishtresore të përcaktuara

2.3. Pjesa e arsytimit që përfshin Raportin e shqyrtimit publik

Një pjesë e zhvillimeve është rezultat edhe i miratimit apo refuzimit të propozimeve dhe vërejtjeve publike por edhe peticioneve nga pronarët e tokave gjatë procesit të hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Fushë Kosovës që është pjesë e Raportit të shqyrtimit publik dhe mund të konstatojmë se të gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe peticionet janë trajtuar nga Komisioni Vlerësues Komunal dhe të gjitha kërkesat e arsyeshme janë inkorporuar në Hartën Zonale të Komunës.

2.4. Pjesa e arsytimit që përfshin obligimet e dokumenteve e nivelit qendror

Te pjesa e arsytimit në vazhdimësi kemi trajtuar obligimet të cilat rrjedhin nga dokumentet e planifikimit hapësinor për rajonin më të gjerë e të cilat ndikojnë në identifikimin e hapësirave dhe përcaktimin e zonave, në këtë drejtim kemi trajtuar:



Në komunën e Fushë Kosovës përfshihen dy zona të identifikuara si Zona me Interes të veçantë për Kosovën me Planin Hapësinor të Kosovës:

1. Zona e mihjes sipërfaqësore të linjtit dhe prodhimit të energjisë (Plani Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik “Fusha e Mihjes së Re”); dhe
2. Zona e veprimit të koordinuar (Trekëndëshit të Zhvillimit Ekonomik të Kosovës – TZHEK);
3. Po ashtu në Komunën e Fushë Kosovës shtrihet edhe një pjesë e deponisë së hirit nga termoelektranat në Obiliq zonë në të cilën duhet të rigjenerohet mjedisi i degraduar, rekomandim ky edhe i Planit Hapësinor të Kosovës.

Në Komunë të Fushë Kosovës përfshihen edhe zonat vijuese të identifikuara si Zona me Interes të veçantë për Kosovën, si:

1. Zona e Aeroportit;
2. Hekurudhat e Kosovës;
3. Autoudha;
4. Pasuritë nëntokësore;
5. Në këto zona duhet të vendoset regjim i caktuar i zhvillimit;
6. Ligatina e Hencit.



3. KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIM PËR TË GJITHA ZONAT

Kushtet zhvillimore të përgjithshme përcaktojnë rregullat dhe standardet e përgjithshme për zhvillim që zbatohen për të gjitha zonat. Kushtet zhvillimore të përgjithshme mund të përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në kërkesat dhe rregullat, masat mbrojtëse, modelet e projektimit dhe udhëzimet si:

1. Shfrytëzimet e tokës: shfrytëzimet të lejuara, dytësore, të lejuara të veçanta, të përkohshme dhe të ndaluaranë të gjithë territorin e Komunës;
2. Qasja në parcelën kadastrale;
3. Qasja në infrastrukturën teknike;
4. Rregulla për parkim dhe shkarkim;
5. Rregullat për zhvillim të peizazhit dhe shiritave të gjelbër mbrojtës;
6. Kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyror dheartificial ; dhe
7. Kërkesat për zvogëlimi të zhurmës.

Emërues i përbashkët i kushteve zhvillimore të përgjithshme, është se duhet të jenë të vlefshme për komplet territorin e komunës, dhe duhet të zbatohet gjatë zhvillimeve dhe përdorimeve sipas asaj që është përcaktuar për zonat e përfshira në këtë dokument, dhe ky emërues është trajtuar me kujdes gjatë hartimit të Hartës Zonale Komunale të Fushë Kosovës. Duke e trajtuar më tutje këtë materie, bazuar në udhëzimin administrativ të MMPH-së nr. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të komunës ku edhe specifikohet se Kushtet zhvillimore të përgjithshme përcaktojnë rregullat dhe standardet e përgjithshme për zhvillim që zbatohen për të gjitha zonat dhe sfida e parë ishte cilat janë rregullat dhe standardet e përgjithshme.

Në këtë drejtim pati të tillë që ngritën edhe sfidën e vet çka janë rregullat dhe cilat janë rregullat e përgjithshme për zhvillim që zbatohen për të gjitha zonat, njëjtë edhe çka janë standardet dhe cilat janë standardet e përgjithshme për zhvillim që zbatohen për të gjitha zonat. Në këtë drejtim **rregullat** u trajtuan nga aspekti praktik të cilat nënkuptojnë, por edhe nga aspekti teknik që nënkuptojnë:

Rregullat nga aspekti praktik në zhvillim por edhe në shkencë janë deklarata që përshkruajnë mënyrën se si gjërat zakonisht ndodhin në një situatë të caktuar, mund të përshkruhen edhe si udhëzime që tregojnë se çfarë lejohet të bëhet dhe çfarë nuk ju lejohet të bëhet; ose edhe si deklaratë që u tregon njerëzve se çfarë duhet të bëjnë për të arritur sukses ose një përfitim të një lloji.

Rregullat janë parime të nxjerra nga lidhjet ligjore dhe praktike të dukurive, që shërbejnë si mbështetje dhe si drejtim për ecurinë ose për zhvillimin e diçkaje ose për punën në një fushë, rregullsi, normë a parim në sjelljen e në marrëdhëniet e njerëzve: Rregulla të përgjithshme (të veçanta); Rregulla të brendshme; Rregulla të reja (të caktuara); Rregulla teknike; Rregullat e qarkullimit; Rregullat e mirësjelljes; Rregullat e shoqërisë; Rregullat e qitjes; Rregullat e lojës.

Pasi që planifikimi është multisektoral dhe përgatitja e Hartës Zonale Komunale trajton Kushtet zhvillimore të përgjithshme përcaktojnë në këtë rast rregullat e përgjithshme për zhvillim që zbatohen për të gjitha zonat, ne kemi trajtuar me kujdes dhe mund të themi qoftë nga aspekti praktik qoftë edhe teknik e ligjor se këto rregulla do përdoren si të përgjithshme:

Me qëllim që çdo zhvillim, funksion dhe aktivitet të bëhet në vendin e vet, aty ku duhet dhe ashtu siç duhet të jetë dhe të reflektojë një gjendje në të cilën çdo gjë është ose bëhet sipas parimeve të caktuara të organizimit e të drejtimit; të qenit në pajtim me kërkesat e vendosura ligjore dhe të akterëve dhe institucioneve të ndryshme



dhe avancohen si rregulla duke i përsëritur pa mungesa kohë pas kohe sipas një rendi të caktuar deri në fund të procesit.

Rregullat e përgjithshme i kemi vendosur ashtë që të zbatohen ligjet dhe aktet nënligjore, planet, raportet sektoriale relevante për komplet zonat, mos të ketë trajtim të veçantë dhe subjektiv as për tokën private (si dhe brenda parcelave dhe pronarëve të ndryshëm privat) as për atë publike dhe shtetërore, por vendosin për përdorim të arsyeshëm të tokës dhe përcaktojnë mënyrat se si këto mund dhe duhet të zbatohen, me informata profesionale për pasuritë nëntokësore dhe sipërfaqësore si dhe në konsultime dhe tryeza profesionale dhe transparente. Pra, autoritetet e planifikimit dhe ekipet punuese, bashkë me të gjithë akterët jemi dakorduar që si rregull i përgjithshëm të jetë përdorimi i parametrave teknik dhe zhvillimor që promovojnë një rrugë të drejtë për zhvillime të qëndrueshme dhe me rregulla tregu, e njëkohësisht publike.

Një tjetër rregull i rëndësishëm për të ardhmen e mirë administrimit të tokës, është edhe ndërtimi me rregulla dhe sipas parametrave ligjorë, ku përcaktohen normat dhe kushtet teknike bazë të detyrueshme të projektimit, zbatimit, të punimeve, përdorimit, mirëmbajtjes, prishjes dhe heqjes së strukturave, zbatimit të punimeve etj, në këtë funksion ekipet do zbatojnë të gjitha rregullat praktike dhe teknike.

Me rregullat që kemi planifikuar ti zbatojmë do t'i paraprijmë një kulture të re mjedisore, si rezultat edhe i kalimit të shoqërisë në një fazë të re, duke lënë prapa tranzicionin dhe duke hyrë në rrugën e pakthyeshme të demokracisë funksionale, që presupozon një raport të ri të qytetarit dhe institucioneve me mjedisin publik në komplet territorin e komunës, presupozon rregulla të reja, përgjegjësi të re dhe angazhime më të plota të institucioneve dhe të gjithë shoqërisë për kontrollin dhe mbajtjen pastër të zonave urbane dhe rurale. Zbatimi i rregullave të sigurisë në të gjitha dimensionet është pjesë e këtij trajtimi dhe në vazhdimësi do jetë e komplet procesit dhe dokumentit. Gjatë diskutimeve publike, takimeve të ekipeve punuese dhe tryezave të ndryshme synohet debatim i vazhdueshëm me qëllim të avancimit të cilësisë së procesit dhe produktit, dhe vazhdimisht do trajtohen edhe rregullat praktike dhe teknike. Megjithatë, ka disa rregulla si pjesë e kushteve zhvillimore të përgjithshme sipas të cilave mund të sigurohet:

1. Qëllimi i qëndrueshmërisë: rregull i përgjithshëm do të jetë një trajtim nga aspekti social, ekonomik dhe mjedisor për të gjitha zonat për arritjen e qëllimeve të qëndrueshmërisë.
2. Realizueshmëria: rregull i përgjithshëm do të jetë analiza financiare dhe e KAB (Korniza Afatmesme Buxhetore) dhe mundësitë tjera financiare për realizim.
3. Drejtësia: rregull i përgjithshëm do të jetë trajtimi i zhvillimeve, pronës dhe kushteve me HZK në mënyrë të barabartë për të gjithë, pa marrë parasysh statusin etnik, gjinor, social etj.
4. Demokracia dhe të drejtat e njeriut: rregull i përgjithshëm informimi cilësor, kycja në proces dhe pjesëmarrje në vendimmarrje si dhe përmbushja e rregullave dhe standardeve tjera të demokracisë dhe të të drejtave të njeriut?
5. Legjitimitimi: rregull i përgjithshëm do jetë që Komuna është bartëse e procesit të përgatitjes së HZK-së, kompania obligohet në përkrahje profesionale, akterët tjerë është shumë e mirëseardhur që të jenë pjesë sa më shumë e vendimeve në kuadër të rregullave që do ishte shumë e dëshirueshme. Për disa zhvillime anëtarët e komunitetit do të duhej të bien dakord për një seri rregullash të brendshme.

Jo vetëm nga ana e komunës por edhe për vetë komunitetin, për takime të rëndësishme ku definojnë kushtet zhvillimore të zonave kërkohet një kuadër i rregullave. Anëtarët duhet të bien dakord për këto rregulla para se të fillojnë me takimet. Pa një marrëveshje të tillë paraprakisht, mund të lindin situata të vështira nëse anëtarët nuk mund të bien dakord me rregullat për prodhim të rezultateve, takimet duhet kenë agjendën e qartë, udhëheqësin e takimit, procesmbajtësin dhe memorandumet e pajtimeve.

E cekëm më lart se rregullat u trajtuan edhe nga aspekti teknik që nënkuptojnë: Sipas Ligjit për standardizim(Nr.2004/12) të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, termi rregulla teknike përkufizohet si vijon: Rregullat Teknike - janë aktet nënligjore me karakter teknik të cilat i përcaktojnë karakteristikat, proceset, ku përfshihen edhe masat administrative që zbatohen në rast të shkeljes së tyre. Rregullat teknike mund të përmbajnë terminologjinë, simbolet, ambalazhin, shënjimet ose kërkesat për etiketimin që kanë të bëjnë me produktin, procesin apo metodën e prodhimit.

Rregullat teknike janë të detyrueshme për zbatim nga subjektet fizike dhe juridike, të fushës përkatëse. Gjatë këtij procesi do të zbatohen edhe rregullat teknike për të gjitha fushat relevante, qoftë të ndërtimit, të infrastrukturës etj.

Këto rregulla teknike paraqiten edhe nëpërmes rregulloreve të caktuara që janë marrë për bazë si p.sh.:

- Rregullore MMPH nr. 23 2014 për rendin e brendshëm të monumentit të natyrës me rëndësi të veçantë shpella e Gadimes
- Rregullorenr. 21/2013 për rendin e brendshëm të parqeve kombëtare
- Rregullorja nr. 24/2012 për normat teknike për mbrojtje nga zjarri të objekteve të larta duhet aplikohet
- Rregullorja nr. 25/2012 për normat teknike të mbrojtjes nga zjarri në ndërtimin e impianteve për lëngjet e ndezshme, deponimin dhe toçitjen e tyre duhet aplikohet
- Rregullorja për rrugë lokale (vetëm për ilustrim e komunës së Prishtinës)

Por ka edhe dhjetëra rregullore lokale dhe qendrore që mund të na shërbejnë pasi kemi një proces multisektoral.

3.1. Cilat rregulla brenda kushteve zhvillimore të përgjithshme na shërbejnë më mirë?

Duke e kuptuar se një kuadër i rregullave është shtylla kurizore institucionale e një komuniteti dhe se rregullat janë mjete përmjet qasje konstruktive dhe për të kuptuar institucionet, mjete që shërbejnë për qëllime të tilla si këto në vijim:

- Ato zgjidhin problemet serioze në procesin e hartimit të HZK-së;
- Ato neutralizojnë burimet potenciale të konfliktit, pasi prodhojnë stabilitet dhe siguri në procesin e hartimit të HZK-së;
- Ato përcaktojnë marrëdhëniet e pushtetit mes grupeve me interesa të ndryshme ato pastaj mund të mbrojnë të dobët, ose të japin ekskluzivisht mjetet e pushtetit tek një grup, apo edhe individ i caktuar në procesin e hartimit të HZK-së.

Prandaj, për të kuptuar Rregulla ne duhet të kuptojmë qëllimin ose interesin që krijuesit e tyre kishin në mendje. Rregullat janë sisteme komplekse për të zgjidhur problemet komplekse. Ato dalin nga proceset. Në demokraci, zhvillimi i rregullave është një proces i të mësuarit kolektiv që vetë zhvillohet në një kuadër të rregullave procedurale.

Rregullat të cilat i kemi trajtuar dhe shfrytëzuar në procesin e hartimit të HZK-së kanë bazën në aktet nënligjore, ligjet, Kushtetutën dhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut mund të përmbledhen nën konceptin e rregullave. Në këtë rast, rregullat shihen edhe si produkte praktike të cilat u krijuan që të shërbejnë për një qëllim të caktuar. Në këtë kuptim, "të gjitha rregullat – janë mjete që do të na shërbejnë mirë".

Njëjtë u ngrit edhe sfida se çka janë standardet dhe cilat janë standardet e përgjithshme për zhvillim që zbatohen për të gjitha zonat. Në këtë drejtim **standardet** u trajtuan nga aspekti praktik të cilat nënkuptojnë, por edhe nga aspekti teknik që nënkuptojnë:

Çfarë janë "standardet" në kuptimin praktik? Dhënia e përgjigjes në këtë pyetje ka qenë një sfidë e vërtetë për të gjithë pjesëmarrësit e këtij projekti: bashkëpunëtorët, profesionistët apo edhe ata që u angazhuan si këshilltarë një proces të hartimit të një dokumenti të tillë. Sipas shumicës së pjesëmarrësve, **një standard është ideal në kuptimin se na jep mundësinë të gjykojmë diçka mbi bazën e tij**; për shembull "Ata rrojnë në përputhje me standardet e komunitetit" ose një standard është një bazë për krahasim, një pikë referimi në

lidhje me të cilën mund të vlerësojmë zhvillimet ose veprat e mëvonshme: për shembull "Ata vendosen standarde për të gjitha zhvillimet ose veprat e tjera" dhe në aspektin praktik pra u konstatua se standardi paraqet një nivel të cilësisë, por në kuptimin teknik: Çka janë standardet?

Standardet janë dokumente teknike, vullnetare, të cilët:

- përmbajnë specifikime teknike për produkte apo shërbime të fushave të ndryshme,
- përgatiten me propozimin e palëve të interesuara, pjesëmarrës ose jo në Komitetet Teknike të formuara për këtë qëllim,
- bazohen në rezultatet e zhvillimit bashkëkohor të teknologjisë,
- miratohen me konsensus nga Komitetet Teknike dhe ratifikohen edhe nga organe tjera më të larta, varësisht prej nivelit të standardit
- vihen në dispozicion të kujtdo.

Sipas Ligjit për standardizim (Nr.2004/12) të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, termi standard përkufizohet si vijon:

Standardi është specifikim teknik, i miratuar nga Agjencia për standardizim e Kosovës, për përdorim të vazhdueshëm, aplikimi i të cilave është i paobligueshëm dhe shërben si dokument për arritjen e nivelit të cilësisë.

Qëllimet e standardizimit

Të bazuar në rregullat dhe parimet e përgjithshme, qëllimet e standardizimit janë:

- ngritja e nivelit të sigurisë së prodhimeve dhe proceseve, ruajtja e shëndetit të njerëzve dhe mbrojtja e ambientit,
- nxitja e cilësisë së prodhimeve, proceseve dhe shërbimeve,
- sigurimi gjithëpërfshirës i përdorimit në punë, material dhe energji,
- përmirësimi i efikasitetit të prodhimit, përkufizimi i dallimeve, sigurimi i pajtueshmërisë dhe këmbimeve,
- mënjanimi i pengesave teknike në tregtinë botërore.

Organizatave dhe standardizimi në botë

Në botë ekziston rrjeti botëror për standarde - WSSN - *World Standards Services Network*. Ai është rrjet publik i organizatave për standardizim.

International Organization for Standardisation (ISO) – Organizata Ndërkombëtare për Standardizim është lidhje e institucioneve ndërkombëtare për standarde. Ajo është agjencia më e rëndësishme për standarde, në punën e të cilës janë të përfshirë rreth 40.000 ekspertë. Si organizatë joqeveritare është themeluar në vitin 1947.

Sot ka 157 anëtarë nga tërë bota dhe deri me tani ka publikuar më tepër se 16.000 standarde ndërkombëtare.

Në botë ekzistojnë edhe shumë organizata tjera, të ranguar në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe nacional. Ndër organizatat më të njohura për standardizim duhet përmendur:

- IEC (*International Electrotechnical Commission* - Komisioni Ndërkombëtar për Elektroteknikë),
- ITU (*International Telecommunication Union* - Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit),
- ANSI (*American National Standards Institute* - ANSI - Instituti Nacional Amerikan për Standarde). ANSI nuk përpilon norma, por organeve të tij u ndihmon në punën e tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në përpilimin e standardeve,
- NISO (*National Information Standards Organization* - Organizata Nationale Informative për Standarde),
- CEN (*Comité Européen de Normalisation* - Këshilli Evropian për Standardizim),
- CENALEC (*Comité Européen de Normalisation Electrotechnique* - Këshilli Evropian për Standardizim Elektroteknik),
- WTO (*World Trade Organization* - Organizata Botërore e Tregtisë),
- ETSI (*European Telecommunications Standards Institute* - Instituti Evropian për Standarde të Telekomunikacionit).

ISO (Organizata Ndërkombëtare për Standardizim) është federatë botërore e organeve kombëtare për standarde (anëtarët e ISO). Puna në përgatitjen e standardeve ndërkombëtare bëhet në komitetet teknike të ISO. Çdo anëtare e ISO, kur është e interesuar për objekt të punës së ndonjë nga komitetet teknike themelore, ka të drejtë që të delegojë përfaqësuesit e vetë në atë komitet. Në këtë punë marrin pjesë organizatat ndërkombëtare, organizata qeveritare dhe joqeveritare, të cilat janë të ndërlidhura me ISO-n. ISO bashkëpunon ngushtë me Komisionin Ndërkombëtar të Elektroteknikës (IEC) në lidhje me të gjitha çështjet e standardizimit në lëmin e elektroteknikës.

Projektet e standardeve ndërkombëtare përpilohen sipas rregullave që janë dhënë në ISO/IEC Udhëzimet, Pjesa 3.

Detyra themelore e komitetit teknik është përgatitja e standardëve ndërkombëtare. Projektet e standardeve ndërkombëtare të cilët i kanë aprovuar komitetet teknike përkatëse ua dërgojnë të gjithë anëtarëve të saj për votim. Në mënyrë që standardi ndërkombëtar të publikohet, është e nevojshme që ta aprovonjë së paku 75% e anëtarëve që votojnë. Në raste të jashtëzakonshme, kur komiteti teknik ka grumbulluar të dhëna të cilat dallohen nga ato të cilat në mënyrë të rëndomtë janë publikuar në standardet ndërkombëtare ("shkalla e zhvillimit", p.sh.) mund të vendoset edhe me shumicën e votave të anëtarëve me të drejtë të plotë që të publikohet raporti teknik.

Agjencia për standardizim e Kosovës (ASK), si institucion ekzekutiv, është themeluar në prill të vitit 2005, në kuadër të Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë. ASK-ja, është organ i vetëm standardizues kosovar, në harmoni me ligjin dhe me Kartën Evropiane të Ndërmarrjeve të Vogla.

Qëllimi kryesor i ASK-së është:

- Të kontribuojë në kualitetin e prodhimeve vendore dhe shërbimeve si dhe konkurrencës së brendshme,
- Të ndihmojë në reduktimin e barrierave teknike në tregti,
- Të lehtësojë njohjen e produkteve kosovare në tregun e jashtëm,
- Të ndërgjegjësojë biznesin për rolin dhe rëndësinë e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare,
- Të përafrojë praktikën e IC-së kosovare me ato të organizmave homolog të BE-së,
- T'u përgjigjet kërkesave të OBT-së për standardet dhe rregullat teknike.
- Të adoptojë standardet evropiane dhe ndërkombëtare,
- Të plotësojë kërkesat e anëtarësimit në ISO/IEC dhe CEN/CENELEC,
- Të avancojë standardizimin kosovar në nivelin e organizmave homologe rajonale dhe evropiane.
- ASK-ja ka dy njësi organizative brenda saj:
- Njësinë e standardizimit dhe
- Njësinë e akreditimit.

Niveli i standardeve

Në nivelin më formal standardet përbëjnë rregulla dhe dispozita të cilat i bien dhe i miratojnë organizatat, agjencitë dhe institucionet që kanë të bëjnë me punën e tyre. Mund të jenë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Aplikimi i tyre është obligativ dhe për atë kujdesët qeveria, organet disiplinore dhe shoqatat profesionale.



Figura 1 Nivelet e standardeve




Figura 2 Zbatueshmëria standardeve

Standarde Kombëtare të shteteve në vijim (nacionale):

- ONORM-Austri,
- NBN-Belgjike,
- BDS-Bullgari,
- NS-Norvegji,
- JIS-Japoni,
- PN-Poloni,
- SSH-Shqipëri,
- STAS-Rumani,
- UNE-Spanjë,
- SS-Suedi, etj.

Standardet kombëtare (nacionale) të cilët përdoren më së shumti janë:

- DIN-Gjermani,
- UNI-Itali,
- ANFOR-France,
- ANSI-SHBA,
- BS-Britani e Madhe,
- AS-Australi,

Me qëllim të arritjes së një pajtueshmërie sa më të madhe në mes të standardeve nacionale (kombëtare) është themeluar standardi internacional (ndërkombëtar)-ISO. Vlen të theksohet se ky standard ka karakter rekomandues dhe nga shumë shtete është marrë si bazë për standardet e tyre.

Duke e ditur se kushtet zhvillimore të përgjithshme përcaktojnë edhe standardet e përgjithshme për zhvillim që zbatohen për të gjitha zonat dhe duke kuptuar situatën nga ajo që u prezantua më lart. Mund të konstatojmë se në aspektin praktik duke krahasuar me zhvillimet e mëhershme do të ketë një standard më cilësor në të gjitha fushat, ndërsa në aspektin teknik në fushat ku ka standarde do të aplikohen, ndërsa në fushat që nga Agjencia për standardizim e Kosovës (ASK) nuk janë mbuluar, do të punohet me standarde pozitive ndërkombëtare.

Në fund u konstatuat se çka do që do jetë kërkesë ligjore, praktike dhe funksionale për të gjitha zonat do merret në konsideratë dhe trajtohet në kuadër të rregullave dhe standardeve të përgjithshme.

3.2. Masat mbrojtëse

Për më shumë bazuar në udhëzimin administrativ Kushtet zhvillimore të përgjithshme mund të përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në kërkesat dhe rregullat, masat mbrojtëse, modelet e projektimit dhe udhëzimet, derisa sa shkruhet se përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në kërkesat dhe rregullat, **fare lehtë konstatohet se ekipet punuese mund të shtojnë kërkesa dhe rregulla tjera plotësues** dhe të njëjtat janë trajtuar shumë seriozisht, në vazhdimësi janë trajtuar masat mbrojtëse si pjesë e Kushteve zhvillimore të përgjithshme dhe mund të konstatohet se: Masat mbrojtëse duhet t'i kuptojmë se janë: **veprime apo mënyra të veprimit, urdhra apo udhëzime të nevojshme për të arritur qëllime të caktuara, në këtë rast mbrojtje të jetës, pasurisë ose vlerave tjera sociale, ekonomike apo mjedisore dhe mund t'i klasifikojmë si: masa parandaluese, masa të rëndësishme (të shpejta, të ngutshme, të drejta, të rrepta); Masa konkrete (praktike, energjike, rrënjësore, përgatitore); Masa organizative; Masa lehtësuese; Masat e nevojshme; Masa mjekësore (higjienike, parandaluese, parambrojtëse); Masa sigurimi. etj.**

Shtrohet pyetja se gjatë trajtimit të Hartës Zonale Komunale cilat mund të jenë rreziqet dhe sfidat, duke e ditur se Rreziku – është mundësia e dëmtimit apo kërcënimit të jetës apo shëndetit të njerëzve dhe kafshëve



dhe mundësia e shkaktimit të çrregullimeve dhe dëmeve ndaj pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit; rreziqet mund të jenë dëmtimet apo kërcënimet që rezultojnë nga:

Fatkeqësitë – të cilat paraqesin një ngjarje apo pjesë të ngjarjes të shkaktuar nga forcat madhore të natyrës apo forcat tjera të pakontrolluara, të cilat rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve dhe pronave, shkaktojnë dëme në trashëgiminë kulturore dhe mjedis, në përmasat e atilla që kërkojnë ndërmarrjen e masave dhe dislokimin e forcave dhe resurseve të veçanta; Fatkeqësitë mund të jenë:

- **Fatkeqësi natyrore** – të cilat janë: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, ortek, erë e fuqishme, breshër, borë me shi, acar, thatësi, zjarr fushor, shpërthim i sëmundjeve infektive që ndikojnë në njerëz, kafshë ose bimë dhe fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga forcat natyrore;
- **Fatkeqësi tjera** – të cilat janë: aksidentet që përfshijnë trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, zjarret, fatkeqësitë në miniera, shkatërrimet e pendave, aksidentet nukleare dhe aksidentet tjera ekologjike dhe industriale të shkaktuara nga aktivitetet dhe veprimet e njeriut, lufta dhe gjendja emergjente, përdorimi i armëve dhe mjeteve të shkatërrimit në masë, sulmet terroriste me mjete klasike dhe forma tjera të dhunës në masë; si dhe
- **Kriza** - që paraqet gjendjen e sigurisë në hapësirën regjionale e më gjerë e cila nuk mund të kontrollohet me resurse dhe masa të zakonshme në të cilën janë të kërcënuara vlerat themelore të Republikës së Kosovës për shkaqe ekonomike, sociale, ushtarake dhe shkaqe tjera të cilat mund të kalojnë përtej kufijve dhe paraqesin kërcënim të pashmangshëm tek vendet tjera përkatëse.

Aksidenti ekologjik - një aksident mjedisor, sipas përcaktimit në dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit, të shkaktuar nga një ngjarje e papritur apo e pakontrolluar për shkak të ndërhyrjes në mjedis, e cila për pasojë mund të kërcënojë jetën dhe shëndetin e njerëzve apo cilësinë e mjedisit;

Aksidenti industrial - një ngjarje e cila ka dalë jashtë kontrollit gjatë kryerjes së aktiviteteve apo veprimeve me makineri dhe materie të rrezikshme ose të dëmshme, ku një ngjarje e tillë rezulton në kërcënimin e jetës apo shëndetin e njerëzve, kafshëve, pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit;

Rreziku nga **Materiet e rrezikshme** - që paraqesin çdo materie në gjendje të ngurtë, të gaztë apo të lëngët, e cila me rrjedhje të pakontrolluar në mjedis paraqet rrezik të pashmangshëm për jetën apo shëndetin e njerëzve dhe kafshëve apo shkakton çrregullim apo dëmtim të pronave dhe ndikon dëmshëm në mjedis;

Në mesin e sfidave (**derisa sfida duhet kuptuar si një gjendje, zhvillim ose aktivitet i caktuar që ju vë në provë**) hyn edhe dëmet tjera që janë rezultat i veprimeve të njeriut, që nga cenimi, dëmtimi deri te shkatërrimi i resurseve natyrore (rrethina natyrore, ajri, toka, uji, flora, fauna dhe pasuritë tjera nëntokësore dhe sipërfaqësore), cenimi, dëmtimi deri te shkatërrimi i resurseve kulturore- historike (zonat arkitektonike, arkeologjike, historike), ndotja (Llojet e ndotjes: Ndotja e tokës, Ndotja e ajrit, Ndotja e ujit, Ngrohja globale) nga ndotësit fizikë, biologjikë, nga agjentët kimikë, cenimi, dëmtimi deri te shkatërrimi i zonave të mbrojtura dhe zonave të veçanta të mbrojtura etj. dhe **në të gjitha këto sfida duhet adresuar masa mbrojtëse si pjesë e kushteve zhvillimore të përgjithshme për sigurimin e një mbrojtje, shfrytëzim dhe zhvillim të qëndrueshëm.**

Masat mbrojtëse qoftë ndaj rreziqeve, qoftë potencialeve që duhet mbrojtur, apo edhe potencialeve që duhet ruajtur ashtu që më vonë të zhvillohen, janë pjesë e detyrueshme që rrjedhin nga Kushtetuta, ligjet, aktet nënligjore, konventat ndërkombëtare dhe një gamë e gjerë e obligimeve dhe përgjegjësi që ushtrohen qoftë në nivelin qeveritarë qoftë në atë lokal dhe e një numri institucioneve, për t'u kujdesur për një cilësi të jetës, për florë dhe faunë të pasur dhe për qëndrueshmëri sociale, ekonomike dhe mjedisore, e të cilat për emërues të përbashkët kanë gjitha zonat - në këtë rast territorin e komunës.

Me trajtimin cilësorë të masave mbrojtëse si pjesë e kushteve zhvillimore të përgjithshme mund të konstatohet se ekipet punuese kanë krijuar terren që të lëvizet nga kultura e reagimit në kulturën e zbutjes, amortizimit



deri te neutralizimi i dëmeve dhe nga kultura e shkatërrimit drejt kulturës së mbrojtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të pasurive natyrore dhe kulturore-historike.

Ekipet i kanë trajtuar me kujdes masat mbrojtëse dhe është analizuar se masat mbrojtëse si një formë e kushtit zhvillimor për të vendosur një baraspeshë ndërmjet nevojave të mbrojtjes së pasurive natyrore dhe kërkesave për zhvillim. Për shembull, një pikë me potencial të zhvillimit të turizmit që shtrihet brenda tokës bujqësore, ose mbi pasuri nëntokësore, ose zonës arkeologjike, shpesh krijojnë interesa të ndryshme të zhvillimit dhe ruajtjes.

Vlen të theksohet, se masat mbrojtëse janë efektive kur hartohen në suaza të kapaciteteve të komunës për t'i zbatuar ato, dhe kur iu bëhet e qartë qytetarëve se masat mbrojtëse janë të obligueshme për të gjitha zhvillimet për të cilat vlejnë, por nuk kufizohen vetëm në këtë nivel se komunat sfidohen edhe nga rreziqet që i tejkalojnë kompetencat komunale, ndërsa brenda hartës zonale komunale duhet definohen masa edhe për këto rreziqe.

Masat mbrojtëse mund të përcaktohen edhe për një zonë të vetme me specifika të caktuara, apo për një sipërfaqe më të madhe si p.sh. zonën rurale. Nëse, kufijtë e sipërfaqes në nevojë për tu mbrojtur janë të ndryshme nga kufijtë e zonave të përcaktuara, dhe në çfarëdo rasti kur përveç zonës bazë kemi edhe një shtresë tjetër me specifika si të lartcekura trajtohen me kushte zhvillimore për zonat që janë të determinuarasi Zona Mbishtresore.

Me trajtimin profesional të masave mbrojtëse si pjesë e kushteve zhvillimore të përgjithshme mund të konstatohet se: në rast se kemi informata dhe vlerësohet rreziku, duhet trajtuar

Masat mbrojtëse ndër të tjera përfshinë:

Masat hapësinore, urbanistike, ndërtimore dhe masat tjera teknike;

Masat hapësinore, urbanistike, ndërtimore dhe masat e tjera teknike, ndërmerren gjatë përgatitjes së kësaj harte ku definohen kushte zhvillimore (caktohen kushtet hapësinore, urbane dhe ndërtimore) me qëllim të parandalimit apo zvogëlimit të efekteve të dëmshme si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera si dhe për të mundësuar mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën.

Projektet për ndërtimin e objekteve, të destinuara për shfrytëzim kolektiv, furnizim të qytetarëve, transport publik, si dhe deponim, prodhim dhe përdorim të materieve të rrezikshme, të naftës dhe të derivateve të saj, si dhe të gazrave energjetike, duhet të përmbajnë elaborate për siguri nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Evakuimi

Duhet të mendohet edhe për evakuimin e banorëve të rrezikuar atëherë kur me masa të tjera nuk mund të garantohet siguria e tyre. Lëvizja e banorëve nga zona e paraparë për evakuim në vendin e caktuar, duhet të bëhet sipas mënyrës dhe afateve kohore të përcaktuara në planet e reagimit emergjent apo siç është përcaktuar në vendimin e organit kompetent.

Akomodimi dhe kujdesi i njerëzve të rrezikuar

Qeveria dhe komunat janë të obliguar të sigurojnë strehim dhe kujdes të domosdoshëm për qytetarët, të cilët në rast të fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësisë tjetër kanë humbur shtëpitë dhe mjetet e tyre të jetës dhe nuk mund të kthehen në vendbanimet e tyre për shkak të rrezikut.

Në raste të jashtëzakonshme, kur nuk mund të sigurohet akomodim tjetër, Kryetari i Komunës kërkon nga pronarët ose shfrytëzuesit e ndërtesave të banimit t'i strehojnë përkohësisht banorët e evakuuar të cilët janë të rrezikuar.



Mbrojtja radiologjike, kimike dhe biologjike

Mbrojtja radiologjike, kimike dhe biologjike, përbën masat dhe mjetet për mbrojtje të drejtpërdrejtë nga efektet e armëve nukleare, kimike dhe biologjike, si dhe nga pasojat e incidenteve që përfshijnë materiet e rrezikshme. Pronarët dhe shfrytëzuesit e objekteve dhe të pajisjeve të destinuara për furnizim publik, transport dhe deponim të gjërave ushqimore, medikamenteve, ushqimit për kafshë, shërbimet publike, shëndetësore, ruajtje dhe arsimim të fëmijëve, duhet t'i sigurojnë mjetet mbrojtëse dhe t'i ndërmarrin masat e parapara për mbrojtje kimike, biologjike dhe radiologjike.

Me akt nënligjor qeveria ka rregulluar organizimin e mbrojtjes radiologjike, kimike dhe biologjike, si dhe i ka përcaktuar mjetet dhe masat për mbrojtje. andej kur specifikohen masat mbrojtëse nëse ky rrezik merret në konsideratë duhet bazuar në aktin nënligjorë.

Strehimi

Strehimoret dhe objektet tjera për mbrojtje ndërtohen me qëllim të mbrojtjes së njerëzve në raste të luftës apo rreziqeve të tjera.

Strehimoret ndahen në strehimore të mbrojtjes elementare dhe plotësuese.

Strehimoret e mbrojtjes elementare ndërtohen në qytete dhe vendbanime të rrezikuara brenda ndërtesave të reja, të destinuara për shërbime të shëndetit publik, kujdesit dhe edukimit të fëmijëve, mbrojtje të trashëgimisë kulturore, informimit publik, televizioneve dhe radiove kombëtare, trafikut hekurudhor dhe ajror si dhe në ndërtesat e rëndësishme për furnizim me energji dhe ndërtesat industriale të destinuara për tu shfrytëzuar në kohë lufte për mbajtjen e aktiviteteve të rëndësishme të veçantë për mbrojtje dhe siguri.

Strehimoret në ndërtesat e reja në vendbanimet e caktuara, pllaka e parë duhet të përforcohet deri në masën që i reziston depërtimit të rrënojave. Strehimoret ndërtohen si objekte të përdorimit të dyfishtë deri në masën që nuk e çrregullon funksionin e tyre mbrojtës. Objektet tjera për mbrojtje duhet të ndërtohen në atë formë që sigurojnë strehim nga rrënojat.

Me qëllim të sigurimit të strehimit për njerëzit në vendet publike duhet të përdoren strehimoret publike apo objektet tjera të përshtatshme. Strehimoret publike janë në kompetencë të autoriteteve lokale, komunës dhe duhet diskutohen gjatë hartimit të HZK-së. Strehimoret për mbrojtje elementare duhet të sigurojnë mbrojtje nga mbi-presioni, rrënojat, radioaktiviteti, zjarri dhe efektet e armëve dhe materiet tjera kimike si dhe duhet të furnizohen në masën që mundëson banim për një kohë më të gjatë.

Strehimoret e mbrojtjes plotësuese duhet të sigurojnë mbrojtje nga rrënojat.

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore përfshinë përgatitjet dhe ndërmarrjen e masave për zvogëlimin e rreziqeve, parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit negativ të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera në trashëgiminë kulturore.

Përgatitjet dhe masat zbatohen nga pronarët dhe shfrytëzuesit e trashëgimisë kulturore, shërbimi për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, nivelet qendrore dhe lokale.

Gjatë realizimit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, sipas nevojës, marrin pjesë edhe njësitë dhe shërbimet gjegjëse të mbrojtjes dhe shpëtimit, njësitë e zjarrfikës, si dhe strukturat tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

Qeveria me akt nënligjor rregullon mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

Masat për mbrojtje nga zjarri sipas kategorive të objekteve

Pronarët apo shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve dhe mjedisit janë të obliguar të marrin masat për mbrojtje nga zjarri, të përcaktuara sipas ligjit **LIGJI Nr. 04/L-012 PËR MBROJTJE NGA ZJARRI** dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë të tij, si dhe në përputhje me planin e mbrojtjes nga zjarri.

Pronarët apo shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve dhe mjedisit janë të detyruar të ndërmarrin masat si në vijim:

- Për kategorinë e I (parë) të rrezikshmërisë, janë të obliguar të hartojnë planin e mbrojtjes nga zjarri në bazë të vlerësimeve të rrezikshmërisë, si dhe të formojnë njësitë e mbrojtjes nga zjarri me kuadro të nevojshëm dhe mjetet e domosdoshme për punë për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri;
- Për kategorinë e II (dytë) të rrezikshmërisë nga zjarri, janë të obliguar të hartojnë planin e mbrojtjes nga zjarri në bazë të vlerësimeve të rrezikshmërisë nga zjarri, të kenë numër të mjaftueshëm të punëtorëve të cilët janë të trajnuar në këtë fushë dhe mund të kryejnë kujdestarinë e përhershme për fikjen e zjarrit dhe zbatimin e masave mbrojtëse nga zjarri;
- Për kategorinë e III (tretë) të rrezikshmërisë nga zjarri, janë të obliguar të kenë së paku një punëtor i cili është i trajnuar dhe drejtpërdrejtë organizon dhe përkujdeset për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri;
- Për kategorinë e IV (katërt) të rrezikshmërisë nga zjarri, janë të obliguar të kenë një punëtor të trajnuar dhe ngarkuar me punët e mbrojtjes nga zjarri.

Planin e mbrojtjes nga zjarri, janë të obliguar ta nxjerrin pronarët, përkatësisht shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve dhe mjedisit, të radhitura në kategorinë e parë dhe të dytë të rrezikshmërisë dhe ky plan duhet të jetë i harmonizuar me planin komunal për mbrojtje nga zjarri. Personat juridikë përgjegjës për punët e mbrojtjes nga zjarri, duhet të punësojnë personat të cilët kanë të kryer trajnimet profesionale për zjarrfikës apo drejtimin teknik, dhe të cilët e kanë të dhënë provimin profesional për kryerjen e punëve për mbrojtje nga zjarri.

Do t'i adresojmë disa masa mbrojtëse në gati të gjitha sfidat dhe të gjitha fushat, që trajtohen me HZK, si pjesë e kushteve zhvillimore të përgjithshme, për sigurimin e një mbrojtje, shfrytëzim dhe zhvillim të qëndrueshëm, e disa që nuk adresohen këtu janë adresuar në kushtet zhvillimore.

Duke e kuptuar se masat mbrojtëse nuk kufizohen vetëm te rreziqet por edhe në këto sfida dhe probleme (nuk kufizohen vetëm në këto) të cilat shkaktohen nga ndotja, erozioni, humbja e potencialeve dhe resurseve sipërfaqësore dhe nëntokësore

Masat e përgjithshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës

Këto masa mbrojtëse janë precizuar me ligjin nr. 03/L-233 për mbrojtjen e natyrës, i cili rregullon mbrojtjen e natyrës, shfrytëzimin e qëndrueshëm të sajë dhe veçanërisht:

- Mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, në gjendje të baraspeshës natyrore;
- Përtëritja e natyrës në zonat e dëmtuara ose pjesëve të tyre dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara;
- Vendosjen e rrjetit të zonave të mbrojtura, sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim, monitorim, informim dhe financim me qëllim të mbrojtjes së natyrës;
- Pengimin e shfrytëzimit të tepërt, rrezikimit të llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe vendbanimeve të tyre;
- Sigurimin e të drejtës së publikut për informim për gjendjen e natyrës dhe pjesëmarrje në vendim marrje për mbrojtjen e natyrës;
- Sigurimin e ushtrimit të të drejtës së qytetarëve për jetesë të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë;
- Parandalimin e veprimeve të dëmshme të personave juridikë dhe fizikë në natyrë si pasojë e aktiviteteve ekonomike;
- Mirëmbajtjen ose sanimin në statusin e favorshëm të ruajtjes së vendbanimeve natyrore dhe llojeve me interes për komunat, Kosovën sipas standardeve të BE-së;

- Ruajtjen e të gjitha llojeve të zogjve te cilët natyrshëm jetojnë në gjendje të egër (zogjtë, vezët e tyre, çerdhet dhe vendbanimet e tyre).
- Rekaomandimet dhe të gjeturat që dalin nga VSM të cilat janë të pasqyruara në këtë dokument dhe të cilat do të jenë rekomandime gjat implementimit të HZK-së
- Definimi i korridoreve ekologjike gjatë realizimit të rrugëve të planifikuara;
- Studime mbi gjendjen e biodiversiteti dhe i habitateve natyrore në komunën e Fushë Kosovës;
- Hartim i projekteve për rehabilitim të zonave me potenciale rrezatimi, por edhe planifikimi i mundësive për trajtimin e rrezatimit dhe uranimit të varfëruar në vendet ku është goditur me bomba në luftën e fundit mendohet të paraqitet si një burim vazhdueshëm i ndotjes në komunën e Fushë Kosovës;
- Harta i projekteve për rehabilitim të zonave erozive dhe të vërshimeve por edhe planifikimi i mundësive, masave dhe projekteve për trajtimin e Erozionit dhe Vërshimeve në aspektin e zonave dhe shkallëve të erozionit;
- Definimi i zonave ekonomike në aspektin e tipit të industries apo afarizmit dhe krijimit të bazave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishme të zonave duke ofruar bazat për trajtim të zonave ekonomike me masa fizike, natyrore dhe teknologjike që të jetë miqësor edhe në aspektin mjedisor;
- Të bëhen projekte duke u bazuar edhe në HZK vendet dhe mundësit, projektet dhe zhvillime për pyllëzim dhe ripyllëzim si mas të rëndësishme mjedisore;
- Projekte për rehabilitim të zonave, vijave ose mundsisht edhe pikave të zeza të ndotura nga mbeturinat dhe planifikohen mundësi trajtimi edhe se është përmend riciklimi si një mundësi por ka edhe mundësi tjera, definimi i hapësirave për deponi tranzite dhe sistemit të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave dhe proceset tjera;
- Definimi dhe trajtimi si zona konform standardeve dhe ligjeve në fuqi për ujrat nëntokësor dhe sipërfaqësor;
- Konservimi i veçorive natyrore (Monumentet e Natyrës) si objekte natyrore dhe si zona;
- Definimi i pejsazheve, parqeve me vlera ose ndikime mjedisore dhe parashikimi i masave;
- Trajtimi i ngrohjes së qytetit të Fushë Kosovës por edhe vendbanimeve si një dimension i rëndësishëm i ndotjes dhe ndikimit në ekosisteme;
- Projekte për caktimin e zonave të zhurmës;
- Definimi dhe trajtimi i zonave të pasura me florë dhe faunë.

Rregullimi i tokës – masat për përmirësimin e projektimit të zonës rurale, si zhvillimin e shfrytëzimit më ekonomik dhe racional të tokës, grupimin e tokës bujqësore dhe rritjen e sipërfaqes së fermave, përmirësimin e infrastrukturës dhe mundësinë e qasjes në të, ruajtjen e peizazhit dhe natyrës, zbatimin e masave agroteknike, agromelioruse dhe hidromelioruese, ripyllëzimin e tokës me kualitet të ulët ose tokës së ndotur dhe masat e reja të tokës edhe këtu kemi masat e parapara me **ligjin nr. 04/1-040 për rregullimin e tokës dhe në kuadër të masave meliorative për rregullimin e tokës përfshihet edhe:**

- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemit të ujitjes dhe kullimit;
- Meliorimi i livadheve dhe kullotave;
- Kthimi i tokës së pa punueshme në tokë të punueshme;
- Përmirësimi i cilësisë dhe vetive të tokës bujqësore përmes kalcifikimit, humusimit, kullimit, shkripëzimit, plehrit meliorativ, rikultivimit të tokave të dëmtuara dhe të degraduara.

Ndër masat tjera të rregullimit të tokës janë: Masat mbrojtëse të tokës bujqësore nga erozioni

Me qëllim të mbrojtjes së tokës bujqësore nga efektet e dëmshme të erozionit dhe kontrolli i përmbajtjeve në zonën e erozionit ndërmerren masat kundëroerozive si në vijim:

1. ndalimi i përkohshëm ose i përhershëm i lërimit të livadheve, kullotave dhe tokave të tjera bujqësore për shkak të konvertimit të tyre në tokë të punueshme me kulturat bujqësore vjetore;
2. prezantimi i kulturave bujqësore në rotacion;

3. kultivimin e plantacioneve shumëvjeçare;
4. ngritjen e ndërtesave specifike përkatëse;
5. përmirësimi i teknikave për trajtimin e tokës bujqësore;
6. ngritjen dhe kultivimin e brezave mbrojtës bujqësor apo mbjelljen e bimëve drunore shumëvjeçare;
7. ndalimi i kullotjes së bagëtive në një kohë të caktuar ose kufizimi i numrit të kafshëve që mund të lirohen në hapësira të caktuara;
8. ndalimi i prerjes së pyjeve dhe plantacioneve pyjore mbi tokë të rrezikuar;
9. masa të tjera mbrojtëse.

Masat mbrojtëse të tokës tokës bujqësore nga fragmentimi

Masat kundërfragmentuese janë:

- toka e punueshme bujqësore, sipërfaqja e së cilës është ≤ 0.50 ha, nuk mund të fragmentohet në parcela;
- toka e punueshme bujqësore e konsoliduar, sipërfaqja e së cilës është ≤ 1.00 ha, nuk mund të fragmentohet në parcela.

Masat mbrojtëse dhe rregullimi i tokës pyjore

Masat mbrojtëse dhe rregullimi i tokës pyjore bëhet nëpërmjet formave si në vijim:

1. mbrojtja e tokës pyjore nga shpyllëzimi- prerja e të gjitha bimëve pyjore dhe më pas përdorimi i kësaj toke për shfrytëzime të tjera jopyjore;
2. mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore nëpërmjet pyllëzimit- krijimi i një pylli apo të një grumbulli të bimëve pyjore (ekskluzivisht autoktone) në një tokë ku nuk kishte pyll;
3. mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore nëpërmjet ripyllëzimit- rivendosja e mbulesës pyjore (ekskluzivisht autoktone), në formë të natyrshme (nëpërmjet mbjelljes natyrore, nëpërmjet kthimit të pyjeve cungishte në trungishte) ose në forme artificiale (nëpërmjet mbjelljes së drejtpërdrejtë të bimës dhe farës).

Masat për rikultivimin e tokës për bujqësi dhe industri

Ndër masat e para është përgatitja e projektit për rikultivim

E projekti për rikultivim duhet të përmbajë:

1. Mënyrën e heqjes dhe ruajtjes së shtresës së plleshme dhe shtresës me potencial të plleshëm.
2. Procedurat teknike, agroteknike, dhe biologjike të rikultivimit të tokës bujqësore dhe afatet e kryerjes së rikultivimit biologjik të tokës bujqësore.
3. Dinamika e kthimit të tokës prodhimtarisë bujqësore.
4. Hulumtimi i materieve të dëmshme dhe të rrezikshme në tokën e rikultivuar dhe
5. Shumën financiare të projektit.

Shfrytëzuesi apo investitori i përkohshëm i tokës bujqësore është i detyruar që përsigurimin e rikultivimit të tokës bujqësore, të paguajë paraprakisht në llogarinë të cilën e cakton organi kompetent komunal për bujqësi shumën prej së paku 30% të mjeteve të nevojshme për rikultivim.

Mjetet të cilat mund të shfrytëzohen vetëm për qëllime të rikultivimit dhe pas rikultivimit mjetet i kthehen shfrytëzuesit.

Nëse gjatë eksploatimit të lëndëve industriale dhe lëndëve tjera minerale nga toka bujqësore, çrregullohet regjimi ujor, apo vjen deri te përmbytjet dhe grumbullimi i ujit, shfrytëzuesi është i detyruar që para kryerjes të rikultivimit biologjik t'i kryej edhe punët hidroteknike me të cilat do të vendos regjimin e mëparshëm ujor në tokë.

Nëse shfrytëzuesi pas përfundimit të eksploatimit të lëndëve industriale dhe mineraleve të tjera nuk e kryen rikultivimin e tokës bujqësore, organi kompetent për bujqësi do të angazhojë organizatën tjetër e cila do të bëjë rikultivimin e tokës me shpenzimet e shfrytëzuesit të tokës bujqësore për qëllime jo bujqësore.

Ministria me akt nënligjor përcakton metodologjinë unike për hartimin e projektit të rikultivimit.

Organi kompetent komunal përkatësisht organi tjetër kompetent për dhënien e lejes për ndërtim të objektit apo për kryerjen e punëve ose për dhënien e lejes për eksploatim të lëndëve industriale dhe mineraleve të mihjeve sipërfaqësore dhe nëntokësore, deponimine mbeturinave, hirit, mbetjet e përpunimit të drurit dhe të ngjashme mund të jap leje nëse investitori apo shfrytëzuesi përveç dokumentacionit tjetër të nevojshëm paraqet edhe dëshmi për pagesën e kompensimit për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.

Masat Mbrojtës për zonat e veçanta të mbrojtura

Në zonat e veçanta të mbrojtura merren masat e ndalimit apo kufizimit të aktiviteteve si në vijim:

Aktivitetet e ndaluara janë:

- Ndërtimet apo zhvillimet industriale, si gjërmimi dhe shfrytëzimi i burimeve minerale, ndërtimi i pendave, centraleve elektrike apo linjave të tensionit, furrave, fabrikave dhe rrugëve transite;
- Ndërtimet apo zhvillimet që çojnë në shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit.

3.3. Aktivitetet e kufizuara janë si në vijim:

- Strukturat ose godinat më të larta se monumenti kulturor që duhet të mbrohet;
- Ndërtimi i rrugëve, magazinave, punëtorive, shitoreve, restoranteve, bareve, kafeneve, hoteleve/moteleve, tezgave dhe kioskeve ushqimore, stacioneve të karburanteve dhe riparimit të automjeteve, "supermarketeve", klubeve të natës, apo ndonjë ndërtimi tjetër;
- Tubimet, argëtimi dhe zbavitja publike;

Transformimi i tokës bujqësore

Te sipërfaqet apo hapësirat në të cilën ekzistojnë vlera arkeologjike, historike dhe zona tjera të mbrojtura.

Në sipërfaqet apo hapësirat në të cilën ekzistojnë vlera të tilla merren masat e ndalimit të ndërtimit të deponisë për mbeturina. Në lokacionin ku ndërtohet deponia e mbeturinave apo zona e deponisë planifikohet zona neutrale (së paku 50 m) përreth deponisë e cila duhet të jetë 600 m në distancë nga zona e monumenteve kulturore, historike dhe religjioze.

Masat për mbrojtjen e ujit nga ndotja

Masat për mbrojtjen e ujit nga ndotja janë:

1. Me eliminimin e shkaqeve të ndotjes së ujit,
2. Me zvogëlimin e sasisë së materieve ndotëse në ujë,
3. Me ndërmarrjen e masave të posaçme të pastrimit.

Shkalla e ndotjes së ujit mund të zvogëlohet me montimin e instalimeve të veçanta për spastrimin e ujërave të ndotura.

Mbrojtja e ujit nga ndotja mund të bëhet edhe duke ndaluar hedhjen e ndotësve në ujë. Zvogëlimi i sasisë së lirim të materieve ndotëse në ujë është formë e rëndësishme e luftës kundër ndotjes. Kjo nënkupton vendosjen e filtrave përkatës dhe e sistemeve për fundërrim në vendet ku lirohen ujërat e ndotura si dhe ftohjen e obliguar të ujit para se ai të lirohet në rrjedhën e lumit ose në ndonjë recipient tjetër.

Një formë e mbrojtjes së ujërave rrjedhës nga ndotja është edhe mbrojtja speciale e burimeve, planifikimi i lokacionit të deponive për hedhurina sa më larg ujërave rrjedhëse, zvogëlimi i përdorimit të pesticideve dhe plehrave artificiale në bujqësi si dhe pyllëzimi dhe ruajtja e tokës nga erozioni {kur prehen pyjet krojet sterrin}.

Me konventa ndërkombëtare ndotja e ujërave është e sanksionuar. Por, vështirë është të binden njerëzit që të mos e ndotin atë. Prandaj, është me rëndësi vetëdijesimi dhe edukimi i popullatës për shfrytëzim racional të resurseve ujore. Mbrojtja e ujërave nga ndotja sigurohet me ndalesë, me përkufizim dhe me pengim të shkarkimit të materieve të dëmshme dhe të rrezikshme në ujëra si dhe marrjen e masave për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ujërave.

Masat mbrojtëse prej Shqetësimit dhe dëmtimit nga zhurmat

Çdo shtetas ka të drejtë të mbrohet dhe të përfitojë mbrojtje nga organet shtetërore nga efektet e dëmshme të zhurmës mjedisore. Mbrojtja zbatohet për zhurmën, ndaj së cilës njerëzit ekspozohen në mjedisin ku ndodhen, në zona të banuara, në mjediset e institucioneve publike, në parqe publike dhe hapësira të tjera, të qeta, çlodhëse, në zona të qeta në natyrë, në institucionet për fëmijë, institucione shëndetësore, arsimore, kulturore, fetare dhe në mjedise të tjera të ngjashme me to.

3.3.1. Cilat janë masat e mbrojtjes nga zhurma?

Me masa të mbrojtjes nga zhurma do të kuptojmë ndërhyrjet dhe veprimet që ndërmerren ndaj burimit të zhurmës, si dhe në vendin ku ai ka ndikim negativ, duke e sjellë atë në një nivel të lejueshëm.

Masat kryesore të mbrojtjes nga zhurma janë:

- Përzgjedhja e makinerive apo pajisjeve që nuk bëjnë shumë zhurmë;
- Përzgjedhja e vendit ku do të vendosen dhe do të punojnë pajisjet që lëshojnë zhurmë që të garantojë një nivel të lejueshëm zhurme në mjediset rreth tyre.

3.3.2. Çfarë duhet të mbahet parasysh gjatë projektimit dhe realizimit të ndërtesave?

Çdo ndërtim dhe rikonstruksion ndërtesash, për banim apo për veprimtari të tjera ekonomike e shoqërore, projektohet dhe realizohet në mënyrë që zhurma në brendësi apo në afërsi të saj, të jetë brenda nivelit të lejueshëm.

3.3.3. Ku duhet të kërkohet miratimi për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme?

Për zhvillimin e veprimtarive argëtuese, të veprimtarive me grumbullime, manifestime të përkohshme, në mjedise të jashtme apo të brendshme, të cilat mund të bëhen burim shqetësimi për banorët, duhet kërkohet miratimi nga organet kompetente dhe për kohë të caktuar, në territorin e komunës ku zhvillohet aktiviteti. Pasi që planifikimi është multisektorial edhe masat duhet jenë për të gjitha fushat por po i trajtojmë edhe disa të përgjithëshme si të tërmetet:

- Përgatitja e një rregulloreje për të gjitha ndërtimet në pajtim me shkallën e rrezikut sizmik. Përgatitja e projektit dhe ndërtimi duhet të bëhen sipas standardeve.
- Në rastet e objekteve të veçanta si dhe në ndërtesat shumëkatëshe duhet bërë ndërtimi sipas konceptit dhe rregullave të arkitekturës kundërsizmike.
- Ndërtimi i stacioneve kundër breshrit.
- Masat në periudhën dimërore e veçanërisht në zonat kodrinore-malore.
- Përgatitja e objekteve për akumulim të ujërave lumore dhe të përroskave që mund t'u nevojitet pendave ashtu që në rast të ndonjë thatësie eventuale ky ujë të përdoret për ujitje
- Përgatitja e projekteve për hapjen e kanaleve të reja, pastrimin, mirëmbajtja e kanaleve ekzistuese.
- Ndërmarrja e masave për eliminimin e kthesave të ashpra të lumenjve dhe menaxhimi i brigjeve të lumenjve.
- Ndërmarrja e masave për mbrojtjen e lumenjve nga hedhja e mbeturinave që në këtë rast do të thotë pengim i rrjedhës së lirë të ujit.
- Ndërmarrja e masave për ndalimin e ndërtimeve të objekteve banuese dhe objekteve të karakterit ekonomik afër brigjeve të lumenjve, në largësi prej më së paku 10 metrave nga shtrati lumor (pikës së ujit).

- Ndërmarrja e masave për moslejimin e ndërtimeve ose zbatimi i standardeve atje ku është e nevojshme për objektet apo pajisjet që shkaktajnë zjarr ose ndihmojnë zjarret në pyje dhe vendet tjera të rrezikuara nga zjarret.
- Ndërmarrja e masave mbështetëse për objektet apo pajisjet që pengojnë ose ndihmojnë shuarjen e zjarreve në pyje apo vendet tjera të rrezikuara nga zjarret.
- Hartimi i projekteve për vendosjen e sa më shumë hidrantëve dhe ujit të akumuluar në sa më shumë vende dhe vendbanime.
- Hartimi i projektit për sigurimin e qasjes për veturat që shfrytëzohen për fikjen e zjarrit deri tek secila njësi banesore në komunë.
- Masa kontrolluese kundër shkelësve të ligjit.
- Masat ndëshkuese.

3.3.4. *Modelet e projektimit*

Republika e Kosovës është duke përgatitur Kodin Unik të Ndërtimit i cili duhet të zbatohet në tërësi pas miratimit të tij. Deri në miratimin e tij, brenda këtij dokumenti të jenë paraqitur kushtet zhvillimore dhe modelet e projektimit të cilat duhet të zbatohen për zhvillimet e reja përderisa nuk shfuqizohen me akte ligjore të reja të cilat mund të hyjnë në fuqi pas miratimit të këtij dokumenti.

Deri sa me MODEL definojmë diçka që zakonisht është punuar në mënyrë të veçantë dhe merret si shembull për të bërë edhe një tjetër ose disa të tjera si ajo ose edhe shprehur më ndryshe: diçka në të cilën një kopje mund të bazohet sepse është një shembull jashtëzakonisht i mirë i llojit të tij, dhe me PROJEKTIM definojmë paraqitjen në letër, planin e një objekti të infrastrukturës teknike ose sociale.

Modelet e projektimit si pjesë e kushteve zhvillimore të përgjithshme brenda HZK-së do jenë të tilla që të plotësojnë kriteret e funksionalitetit, qëndrueshmërisë, cilësisë së shërbimit, përshatshmërisë me ambientin.

Modelet e projektimit si pjesë e kushteve zhvillimore të përgjithshme brenda HZK-së janë hulumtuar te llojet e ndryshme të projekteve për të cilat duhet dhënë kushte zhvillimore. siç janë: Ndërtesat e banimit, Ndërtesat e banimit me një njësi, Shtëpitë e veçanta, Shtëpitë dyshe, Shtëpitë në varg, Ndërtesat e banimit me shumë njësi, Ndërtesat e veçanta, Ndërtesat në varg, Ndërtesat tarracore.

Gjithashtu edhe te projektet infrastrukturës rrugore dhe sipërfaqet transportuese të përcaktuara për zhvillim si: rrugët publike me nivelimin sipas kategorizimit, të motorizuar dhe jo të motorizuar; rrjeti hekurudhor i lehtë dhe i rëndë; ndërtesat dhe sipërfaqet për transport ajror dhe ndërtesat dhe sipërfaqet për transport publik urban, rural dhe ndërrurban.

Te projektet e infrastrukturës publike dhe sociale, ku përfshihen, paraqet të gjitha sipërfaqet e infrastrukturës publike dhe sociale të përcaktuara për zhvillim, si: parqet publike dhe sipërfaqet e hapura, fushat sportive dhe hapësirat rekreative, hapësirat dhendërtimet e shërbimeve mjekësore, ndërtesat për shërbim social, ndërtesat e institucioneve parashkollore për përkujdesje ditore, shkollat dhe universitetet, qendrat administrative, hapësirat dhe ndërtesat e sigurisë publike dhe varrezat.

Modelet e projektimit si pjesë e kushteve zhvillimore të përgjithshme brenda HZK-së janë bazuar në llojet e ndryshme të projekteve të infrastrukturës teknike për të cilat duhet dhënë kushte zhvillimore, modele që do bazohen në shtrirjen e rrjeteve dhe kapacitetet e ndërtesave përcjellëse, shiritët mbrojtës dhe pajisjet, të përcaktuara për zhvillim, si: Rrjetin e ujësjellësit, Rrjetin e kanalizimit, Impiantet e trajtimit të ujërave të zeza, Sistemet e drenazhimit, Rrjetin e ujitjes, Rrjetin e shpërndarjes lokale me energji termike, Rrjetin e shpërndarjes lokale me energji elektrike, Rrjetin e telekomunikacionit dhe instalimet e ngjashme, Rrjetin e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave mbitokësore dhe nëntokësore, si dhe Ndërtesa dhe hapësira për riciklim dhe dekompozim.

Modelet e Projektimit në përgjithësi mund të jenë të shumta dhe të ndryshme dhe t'u përgjigjen fushave multisektorale si pjesë e HZK-së. Këto modele mund të bazohen duke u bazuar në projektet e zhvilluara më herët, që kanë treguar rezultate të mira ose modele të reja që ende po evoluojnë dhe po paraqiten me

përmbajtje më të mira. Sidomos zhvillimi i teknologjive të reja po ndihmojnë në definimin e modeleve të reja të projektimit dhe zhvillimit. Modeli i projektimit mund të definohet si model me të cilën komunat krijojnë dhe përdorin resurset e tyre për t'u ofruar konsumatorëve, partnerëve, furnizuesve dhe pjesëmarrësve të tjerë të projektimit vlera më të mira për të realizuar përfitim nga ky aktivitet. Modeli i projektimit duhet të paraqesë faktorin që i mundëson komunës të ketë një përparësi, për të performuar më mirë në raport me sfidat dhe problemet në një periudhë afatgjatë.

Përmbajtjet kryesore të Modeleve të Projektimit, do të paraqesim llojet e ndryshme të projekteve, për të cilat duhet dhënë kushte zhvillimore dhe të gjitha këto lloje të zhvillimeve që duhet hartuar një projekt, do të synohet modeli i projektimit, bazuar në përvojat, parimet, rregullat, standardet dhe elementet e tjera që do ta definojnë edhe si model të Projektimit.

Modeli i projektimit për ndërtesat të cilat potencialisht shtrihen në zonat sizmike, do të zhvillohet ashtu, që stabiliteti i objektit të jetë në harmoni me normat dhe standardet e fushës, dhe një ndër kushtet e këtij modeli është të përmbajë një analizë të sistemeve strukturore që mund të përdoren në zonat sizmike, analizë e cila mund të bëhet në dy mënyra: Mënyra e parë dhe më e shpeshtë është në bazë të konceptit mbajtës të sistemit struktural, pra, në varësi të menyrës së përcjelljes së forcës sizmike. Ndërkaq, mënyra e dytë e ndarjes është në varësi të materialeve konstruktive, pra, ndarja në strukturat nga betonarmeja, çeliku, druri apo edhe materiale të tjera dytësore.

Në përgjithësi literatura profesionale preferon ndarjen e parë dhe në këtë drejtim mundësia për zgjidhje të sistemeve strukturore përmbledhet në: Sistemet me mure, Sistemet me rama rigjide, Sistemet e shtanguara (sisteme kapriatë, me rama të shtanguar, perimetër të shtanguar etj), Sistemet duale (me rama dhe mure).




Figura 3 Kategoritë e shfrytëzimit të tokës sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ për Normat Teknike

Në përgjithësi këto sisteme (dhe nënsistemet që derivohen) kundrejt forcës sizmike veprojnë si një konsolë vertikale e ngarkuar me forca horizontale.

Shtangësia, rigjiditeti dhe konfiguracioni i kësaj konsolle përcakton edhe reagimin sizmik të strukturës.

Në vazhdimësi për të përvetësuar një model ose do përdoret modeli i punuar më herët për zonën bazuar në këto analiza, ose do të merremi me detajisht me secilin prej këtyre sistemeve strukturore asizmike dhe do të përvetësojmë një si model projektimi edhe për rastet tjera bazuar në normat, standardet, parimet dhe kriteret e funksionalitetit, qëndrueshmërisë, cilësisë së shërbimit, përshtatshmërisë me ambientin.

Dhe ky model për pos sigurimit të një sistemi i cili do t'i kundërvihet forcave sizmike. Modeli me shpesh projektohet ashtu që mos t'i konkurrojnë arkitekturës së objektit, përkatesisht, që ndikimi i strukturës në arkitekturë të jetë minimal.

Modelet e projektimit janë të rëndësishme në të gjitha zonat por sidomos këto modele fitojnë në peshë te zonat mbishtresore ku përpos kushteve të rëndomta kërkohen edhe kushte shtesë gjatë projektimit dhe duhat

përvetsuar modelet e dëshmuara si të qendrueshme funksionale, cilësore dhe të përshtatshme në ambientet dhe situatat e tilla, dhe jo në pak raste edhe materialet që përdoren janë jo të njëjta me kushtet e rëndomta.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës së lejes ndërtimore përpos vlerësimit të përputhshmërisë me kushtet zhvillimore, Komuna do të vlerësojë gjithashtu edhe përputhshmërinë e projekteve të propozuara me modelet e projektimit.

Në rast se ndërtesat, infrastruktura teknike dhe sociale përmbush kushtet zhvillimore, mirëpo projekti nuk është në harmoni edhe me modelet e projektimit të përcaktuara për disa lloje të ndërtimeve, atëherë Komuna është e detyruar për të kërkuar plotësimin edhe të përshtatshmërisë me modelet e projektimit të përvetësuar qoftë nga përvojat, qoftë nga analizat, qoftë edhe nga modelet e përvetësuar nga zhvillimet teknologjike ose kërkesat tjera në trend (si objektet e gjelbërta, SMART(objektet e mençura)etj, ose zhvillimet nëse nuk përshtaten me modelet duhet refuzuar kërkesën ndërtimore.

Një pjesë e konsiderueshme modeleve të projektimit bazohet në aktet nënligjore në fuqi apo në praktikën më të mira të projektimit. Në rast se në të ardhmen shfuqizohet nga një akt i ri nënligjor i cili do ta shfuqizojë atë në të ardhmen, atëherë të gjitha zhvillimet e reja duhet të përmbushin kërkesat minimale të projektimit të përcaktuara me aktin e ri nënligjor të miratuar në të ardhmen.

3.3.5. Udhëzimet

Edhe për udhëzimet u ngritën sfidatse çka janë udhëzimetdhe cilat janë udhëzimet e përgjithshme për zhvillim që zbatohen për të gjitha zonat. Në këtë drejtim **edhe udhëzimet** u trajtuan nga aspekti praktik të cilat nënkuptojnë: përcaktimi i rrugës dhe mënyrave për të bërë një punë a për të zhvilluar një veprimtari, që tregon si të veprosh, që përmban udhëzime: Material udhëzues, Shkresë udhëzuese, Rregulla udhëzuese, Tekst udhëzues, që përcakton drejtimin nga duhet të lëvizë një zhvillim, aktivitet.

Në këtë drejtim udhëzimet si pjesë udhëzuesit, i cili ofron udhëzime dhe sqarime të nevojshme për të kuptuar dhe hartuar Hartën Zonale Komunale (HZK), përmbledhur në *Udhëzuesin për Hartim dhe Miratim të Hartave Zonale Komunale* përkrahur nga USAID, ose udhëzues praktik nga UN-Habitat i KB. Ndërsa udhëzimet nga aspekti legal nënkuptojnë udhëzimet administrative të cilat janë akte juridike të përgjithshme të cilat i nxjerr organi administrativ me qëllim të drejtimit, këshillimit ose përcaktimit për zbatimin e ligjit ose normave administrative. Udhëzimi i përgjithshëm administrativ është akt juridik normativ ose akt i përgjithshëm dhe nxirret me qëllim të drejtimit, këshillimit ose dhënies së instruksioneve të ndryshme, lidhur me zbatimin e ligjeve apo të dispozitave të tjera dhe të akteve të përgjithshme të kuvendeve e organeve ekzekutive të tyre.

Duke e marrë për bazë se hartat zonale komunale janë multisektorale por edhe bazohen në dokumente dhe strategji të niveleve të ndryshme, edhe numri i udhëzimeve administrative që do shfrytëzohen për bazë dhe do vlejë për të gjitha zonat, gjegjësisht komplet territorit të komunës së Fushë Kosovës është mjaft i madh dhe atë duke filluar nga:

- Udhëzim Administrativ MMPH-NR.06/2016 Për pjesët dhe kërkesat themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Hapësinor të Kosovës
- Udhëzim Administrativ MMPH-NR.10/2015 Mbi Elementet dhe kërkesat themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Kosovës
- Projekt-Udhëzim Administrativ për Klasifikimin, Detyrat, Përgjegjësitë dhe Përmbytjen e elementeve dhe kërkesave themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Hapësinore për Zona të Veçantë
- Udhëzim Administrativ MMPH-NR.11/2016 mbi Elementet dhe kërkesat themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal
- Udhëzim Administrativ MMPH-NR.24/2015 Mbi elementet dhe kërkesat themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës

- Projekt-Udhëzim Administrativ për Elementet dhe Kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme.
- Udhëzim Administrativ MMPH-NR.05/2014 Për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor
- Projekt-Udhëzim Administrativ për metodën e mirëmbajtjes së Bazës së të Dhënave dhe obligimet e autoriteteve publike dhe personave tjerë fizikë dhe juridikë
- Udhëzim Administrativ MMPH-NR.03/2017 Mbi fushëveprimin dhe përgjegjësitë e Institutit për Planifikimin Hapësinor
- Udhëzim Administrativ MMPH-NR.08/2017 Për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor
- Propozim –Udhëzimi Administrativ Për rregullimin e mbikëqyrjes, ndëshkimeve dhe marrjen e masave
- Udhëzim Administrativ për llojet e tipave të vendbanimeve natyrore hartat e vendbanimeve natyrore tipat e vendbanimeve natyrore të rralla
- Udhëzim Administrativ për kushtet e mbajtjes mënyrën e shenjëzimit dhe evidentimit të shtazëve të mbrojtura në internim
- Udhëzimet administrative që mbulojnë fushën e ujësjellësit, kanalizimit, trajtimit të ujërave të zeza, sistemet e drenazhimit, rrjetin e ujitjes, energjisë termike, energji elektrike, telekomunikimit, rrugëve, transportit, tokës bujqësore, pasurive nëntoksore, trashëgimisë, infrastrukturës sociale

Me një fjalë udhëzimet e të gjitha fushave vlejné për të gjitha zonat dhe në fushat përkatëse duhet marrë për bazë gjatë hartimit të këtij dokumenti.

3.3.6. *Shfrytëzimet e tokës*

Dhe krejt në fund duke i kuptuar dhe trajtuar Kushtet zhvillimore të përgjithshme të cilat përcaktojnë rregullat dhe standardet e përgjithshme për zhvillim që zbatohen për të gjitha zonat. bazuar në atë që është trajtuar më lartë, dhe se Kushtet zhvillimore të përgjithshme që mund të përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në kërkesat dhe rregullat, masat mbrojtëse, modelet e projektimit dhe udhëzimet si për:

3.3.6.1. *Shfrytëzimet e tokës*

Kushtet zhvillimore sipas shfrytëzimeve të tokës në vijim janë përcaktuar në përputhje me ligjin, udhëzimet dhe nomenklaturën e Sistemit Hierarkik të Klasifikimit të Shfrytëzimit të Tokës (HILUCS) të përcaktuar në Udhëzimin Administrativ Mmph-Nr.08/2017 Mbi Normat Teknike Të Planifikimit Hapësinor, i cili përcakton llojet e aktiviteteve të cilat lejohen për secilën kategori të shfrytëzimit të paraqitura në këtë kapitull.

Për të kuptuar cilat aktivitete specifike përfshihen në shfrytëzimet e tokës të paraqitura në vijim, referojuni Udhëzimin Administrativ Mmph-Nr.08/2017 mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.



Figura 4 Kategoritë e shfrytëzimit të tokës sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ për Normat Teknike

3.3.6.1.1. SHFRYTËZIMET E LEJUARA

Shfrytëzimet e lejuara të tokës janë shfrytëzimet të cilat potencialisht mund të zbatohen dhe janë të lejuara në komplet territorin e komunës, por të cilat realisht zbatohen në një zonë ose më shumë zona specifike e cila ose të cilat janë përcaktuar me Plan Zhvillimor Komunal të Fushë Kosovës dhe ka për qëllim zhvillimin e atyre shfrytëzimeve. Shfrytëzimet e lejuara janë e drejtë e cila mund të zhvillohet nga pronarët e tokave derisa i plotësojnë dhe kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për zonën ku gjendet prona.

Disa lloje të shfrytëzimeve mund të lejohen në shumicën e zonave si për shembull banimi, parqet, etj. Shfrytëzime tjera, si për shembull industri e rëndë, mund të mos lejohet në shumicën e zonave, bile dhe zonat përreth industrive të rënda mund të përdoren si tampon zona me qëllim të zvogëlimit të ndikimit negativ në

zonat përreth. Megjithatë, mund të ketë më shumë se një shfrytëzim/ndërtim të lejuar në zonë/parcelë përveç shfrytëzimit dominues. Për shembull, shfrytëzime të lejuara të tokës janë¹:

- 5.1. Banim i përhershëm i kufizuar në shtëpi të veçanta të rrethuara me kopshte dhe / ose oborre, apo në kombinim të shtëpive të veçanta, shtëpive dyshe dhe shtëpive në varg.
- 3.3.2. Shërbim arsimor kufizuar në qerdhe dhe kopshte dhe shkolla fillore.
- 4.1.1. Infrastruktura e transportit rrugor si hapësirat për transport rrugor, si rrugët, zonat e parkimit dhe stacionet e shërbimit.
- 3.3.5. Shërbim tjetër i komunitetit si ndërtesat e institucioneve për shërbime sociale dhe familjare dhe ndërtesa të institucioneve të komunitetit. Funksionet si institucione të komunitetit mund të jenë në kuadër të ndërtesave tjera.
- 3.1.3. Shërbim i akomodimit dhe ushqimit si hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e akomodimit në hotel, motel, restorant, kafene, bar dhe sallë mbledhjeje. Funksionet si restorante, kafene dhe bare mund të jenë maksimum 500 m² hapësirë e shfrytëzueshme.

Bazuar në LPH janë përcaktuar dhjetë kategori parësore të zonave: zonë banimi (ZB), zonë komerciale (ZK), zonë industriale (ZI), zonë teknologjike (ZT), zonë bujqësore (Zb), zonë për shfrytëzim të përzier (ZM), zonë e mbrojtur (Zm), sipërfaqe e mbrojtur (SM), zonë e veçantë e mbrojtur (ZVM), dhe zonë e veçantë (ZV). Në kuadër të NTPH janë krijuar edhe disa kategori tjera të zonave, siç janë: zonë ushtarake-sigurisë (ZuS), zonë rekreative-turistike (ZrT), zonë e komunikacionit-transportit (ZKT), zonë e shërbimeve (ZSh), Zonë pyjore (ZP) dhe zonë-minierë sipërfaqësore (ZmS). Këto zona të dhëna shitesë në kuadër të NTPH do të gjejnë më shumë përdorim në Hartën Zonale të Kosovës, gjegjësisht në dokumentet e planifikimit hapësinor të nivelit qendror.

Një komunë mund të përcaktojë disa zona të ndryshme në kuadër të një kategorie parësore, dhe asnjë zonë në një kategori tjetër parësore. Komunitat gjithashtu mund të përcaktojnë nën-zona për secilën zonë, si dhe zona mbishtresore për pjesë të ndryshme të territorit komunal. Ndonjëherë, një kategori e zonës përsëritet disa herë brenda një komune. Për shembull, mund të ketë disa zona banimi me dendësi të ulët në vende të ndryshme në një komunë. Sipërfaqja ndërmjet zonave gjithashtu mund të ndryshojë shumë. Një zonë nuk mund të jetë një parcelë e vetme, por një numër i parcelave që kanë destinim të njëjtë dhe si pjesë e një lagje të madhe që ka diçka të veçantë në lidhje me të, ose një sipërfaqe shumë e madhe.

Jo të gjitha kategoritë e zonave nga LPH mund të krijohen në kuadër të një HZK. Për shembull, në një komunë kryesisht rurale, do të ketë nevojë të krijohen një numër i vogël i nënkategorive të zonave, si ato bujqësore, banim dhe industriale. Në kuadër të hartave zonale për komunitat më të mëdha, do të ketë nevojë për krijim të një numër më të madh të nënkategorive të zonave.

Është me rëndësi të merren parasysh të mirat dhe të metat e krijimit të numrit të vogël ose numrit të madh të nënkategorive të zonave. Gjatë krijimit të një numri të madh të nënkategorive të zonave, interpretimi, përdorimi dhe zbatimi i HZK vështirësohet. Derisa, gjatë krijimit të një numri më të vogël të zonave, vështirësohet ndarja e shfrytëzimeve jo të pajtueshme në mes vete (si industria e rëndë nga banimi).

3.3.6.1.2. SHFRYTËZIMET E LEJUARA DYTËSORE

Shfrytëzimet e lejuara dytësore janë funksione dhe aktivitete që janë dytësore dhe/ apo vartëse nga shfrytëzimi parësor i lejuar në zonë dhe mund të gjenden në të njëjtën parcelë me shfrytëzimin. Një shfrytëzim dytësor mund të kufizohet të zhvillohet në kuadër të së njëjtës parcelë me shfrytëzimin kryesor. Zakonisht,

shfrytëzimi dytësor ndalohet të zhvillohet pa prezencën apo zhvillimin e shfrytëzimit kryesor ndaj të cilit është vartës apo i shërben.

Edhe shfrytëzimet e lejuara dytësore, ashtu si shfrytëzimet e lejuara kryesore, mund të jenë subjekt i kufizimeve në zonëlidhur me madhësinë, formën dhe vendndodhjen. Një shfrytëzim dytësor mund të rezultojë me një ndërtim dytësor, për të cilin do të ketë ose nuk do të ketë nevojë për një leje ndërtimore, në varësi të madhësisë dhe karakteristikave, në përputhje me *Udhëzimin Administrativ Nr.08/2013 për ndërtimet për të cilat nuk kërkohet leje ndërtimore*.

Shfrytëzimet dytësore në kuadër të zonave të banimit mund të jenë verandat, garazhet, pishinat për konsum vetjak, ndërtime të pa banueshme më të vogla se 25 m², ose të ngjashme. Kurse, shfrytëzim dytësor në kuadër të një zone komerciale mund të jetë një kopsht për fëmijë, ose kënd i lojërave për fëmijë. Gjeni më poshtë shembuj të shfrytëzimeve të lejuara dytësore:

- Një garazhe si funksion dytësor i shërben vetëm ndërtesës kryesore- shtëpisë dhe si funksion varet nga shfrytëzimi/ndërtesa kryesore si nga aspekti i formës/ madhësisë, prandaj është shfrytëzim dytësor vartës; kurse
- Një çerdhe si pjesë e një parcele/ ndërtesë zyrtash si funksion dytësor i shërben jo vetëm ndërtesës/ parcelës ku gjendet, dhe mund ti shërbejë dhe ndërtesave përreth dhe më gjerë, por nuk varet nga shfrytëzimi kryesor në këtë rast zyrat, si nga aspekti i funksionit/ formës/ madhësisë, prandaj është shfrytëzim dytësor jo vartës.

Praktikë e zakonitë në kuadër të hartave zonale është të përcaktohen shfrytëzime dytësore që vlejné për të gjitha zonat apo për të gjitha zonat urbane apo rurale. Raste tjera përcaktojnë shfrytëzime dytësore për të gjitha zonat banimore, komerciale apo industriale.

Shembuj që mund të përdoret për përshkrim dhe përcaktim të shfrytëzimeve të lejuara dytësore:

Lejohen shërbimet rekreative që i shërbejnë dhe janë pjesë e integruar në kuadër të blloqeve banimore. Si shërbim rekreativ mund të jenë por nuk kufizohen në hapësirat e hapura, hapësirat dhe lodrat për fëmijë, terrenet sportive e të gjitha madhësive dhe parkingjet e hapura në shërbim të bllokut në kuadër të blloqeve banimore.

Praktika të mira:

Shfrytëzimet Dytësore në Zona Bujqësore

Prodhimi bujqësor komercial apo prodhimi bujqësor për konsum vetjak zakonisht është shfrytëzimi dominues në zonat bujqësore. Sidoqoftë një sërë shfrytëzime tjera kompatible mund të përcaktohen si shfrytëzime dytësore.

Për shembull shumë harta zonale në kuadër të zonave bujqësore mund të lejojnë funksione si industri

Lejohen shfrytëzime dhe objekte ndërtimore si 1. pishina dhe të ngjashme; 2. fusha për tenis, basket, dhe fusha tjera sportive të ngjashme; 3. Ndërtesa ose struktura që shërbejnë zyrat e menaxhimit ose mirëmbajtjes, ose pajisje të mirëmbajtje ose pajisje të tjera dhe furnizime që lidhen me hapësirën e hapur ose shfrytëzimin rekreativ; 4. Lodra për fëmijë apo mbuloja për piknik; 5. Fontana dhe art publik.

3.3.6.1.3. SHFRYTËZIME TË LEJUARA TË VEÇANTA

Shfrytëzime të lejuara të veçanta janë shfrytëzime të cilat janë në pajtueshmëri me shfrytëzimet e lejuara në zonë dhe lejohen me kusht që aplikuesi të përmbushë disa kushte plotësuese të përcaktuara në HZK. Shfrytëzimet e lejuara të veçanta janë të nevojshme, por mund të paraqesin shqetësime ose rreziqe të cilat duhet të parandalohen, prandaj edhe i nënshtrohen kushteve plotësuese. Është e rëndësishme të theksohet se shfrytëzimet e lejuara të veçanta duhet të lejohen nëse aplikuesi mund të dëshmojë se propozimi i zhvillimit i plotëson të gjitha kushtet e HZK dhe kushtet plotësuese të shfrytëzimit të veçantë dhese është në pajtueshmëri

të plotë (nuk kanë ndikim negativ në mjedis dhe nuk pengojnë zhvillimin normal të shfrytëzimeve bazë) dhe që do të lejohen me dhënien e *lejes së veçantë për shfrytëzim*.

Leja e veçantë për shfrytëzim jepet, pasi të plotësohen kushtet plotësuese të përcaktuara në mënyrë specifike në shërbim të shfrytëzimit të veçantë dhe mbrojtjes së mjedisit rrethues nga ndikimet negative të shfrytëzimit të veçantë. Nëse shfrytëzimi i lejuar i veçantë përfshin punë ndërtimore, atëherë kërkohet edhe leje ndërtimore.

Kushtet plotësuese trajtojnë vendndodhjen, shiritat mbrojtës nga llojet specifike të shfrytëzimeve, sipërfaqe minimale ose maksimale të parcelave, rregullin e rrafshit 45°, sipërfaqe minimale gjelbëruese, numër i caktuar i parkingjeve shtesë, dhe të tjera. Rezultati i kushteve plotësuese është se ndërsa një shfrytëzim lejohet në zonë, kushtet plotësuese kontrollojnë që shfrytëzimi i veçantë mos funksionojë ose ndërtohet në çdo pronë brenda zonës. Kjo qasje është e orientuar drejt performancës sepse ndikon direkt në zhvillim dhe arritjes së standardeve.

Për shembull, le të imagjinojmë një zonë banimi ka një restorant të mirë. Banorët e zonës e pëlqejnë restorantin. Megjithatë, gjatë natës, restoranti shndërrohet në një diskotekë. Muzika është me zë të lartë deri natë vonë, duke i mbajtur njerëzit të zgjuar që jetojnë në apartamente mbi disko dhe duke krijuar një shumë trafik të zhurmshëm nga klientët e diskos. Komuna mund të reagojë: "Restoranti është në rregull. Ashtu që, ky është një shfrytëzim i lejuar në zonë. Megjithatë, diskotekat duhet t'i ndjekë këto kushte plotësuese: të ndalet muzika me zë të lartë pas një kohë të caktuar në mbrëmje, dritaret dhe dyert e mbyllura në mbrëmje, duhet siguruar izolim nga zhurma në dyshemetë lart dhe mureve që prekin hapësirat e banimit dhe duhet të sigurojnë parkim shtesë në mbrëmje."

Shumë prej masave mbrojtëse ndaj ndriçimit, zhurmës, vibrimeve, mbrojtja e mjedisit, shiritat mbrojtës dhe standarde të peizazhit aplikohen si kushte zhvillimore të përgjithshme. Në raste të tjera, masat mbrojtëse të diskutuara më lart përdoren për t'u kontrolluar shfrytëzime veçanërisht shqetësuese, që mund të shkaktojnë shqetësime për pronarët përreth.

Rrjedhimisht, lista e shfrytëzimeve të lejuara të veçanta duhet të përmbajë vetëm ato shfrytëzime që komuna është e sigurt që duhet të lejohen nëse përmbushen kushtet plotësuese dhe standardet e duhura. Në rastet ideale, lejohet një numër më i madh i shfrytëzimeve të lejuara, dhe shumë pak shfrytëzime të veçanta. Në këtë mënyrë, komunat mund të arrijnë të lejojnë fleksibilitet maksimal për zhvillim për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut.

Gjeni më poshtë disa shembuj që mund të përdoren nga komunat për të specifikuar si shfrytëzime të lejuara të veçanta:

- Gërmimi i dheut apo nxjerja e mineraleve dhe materialeve natyrore, dhe përpunimi dhe prodhimi i tyre, jo në shërbim të zhvillimit të bujqësisë, do të jetë shfrytëzim i lejuar i veçantë në kuadër të zonave bujqësore.
- Kamp shtëpizat apo shtëpizat për gjueti profesionale do të jenë shfrytëzim i lejuar i veçantë në kuadër të zonave pyjore.
- Shërbimet dhe objektet ndërtimore fetare.
- Shërbimet e autolarjeve.
- Objektet ndërtimore për trajtimin e ujërave të zeza.
- Objektet ndërtimore për trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave.
- Ndërtesat për shërbim shëndetësor të kafshëve (ndërtesat e ambulancave veterinare)."

3.3.6.1.4. Shfrytëzimet e lejuara të përkohshme

Shfrytëzimet e lejuara të përkohshme janë funksione dhe aktivitete që janë të lejuara për shfrytëzimin e një ndërtese apo parcele për një periudhë të përkohshme kohore për diçka të ndryshme nga shfrytëzimet e lejuara. Pas periudhës specifike kohore shfrytëzimet e tilla duhet që plotësisht të tërhiqen nga ndërtesa apo parcela.

Shfrytëzime të përkohshme mund të përfshihen edhe instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, si objekte të përkohshme ndërtimore në vend ndërtim, tenda, konstruksion festivalesh dhe koncertesh, pika shitjeje dhe kioske. Shfrytëzimet e lejuara të përkohshme mund të përdoret nga komunat si më poshtë:

- Shfrytëzime të lejuara me afat kohor të përcaktuar në certifikatën e përdorimit, por jo më shumë se dy vjet.
- Nuk do të rezultojnë në ngritje të objekteve ndërtimore të përhershme, edhe pse objektet ndërtimore dhe ndërtimet ekzistuese mund të përdoren për shfrytëzime të përkohshme.

Nëse objektet e përkohshme ndërtimore nuk largohen brenda periudhës kohore të përcaktuar në lejen ndërtimore dhe/apo në certifikatën e përdorimit, inspektori i ndërtimit ka për detyrë dhe autorizim që të “urdhërojë poseduesin e lejes ndërtimore të rrënojë objektet ndërtimore të përkohshme që nuk janë rrënuar brenda afatit të përcaktuar”, apo të “marrë masa për rrënim të këtyre objekteve ndërtimore të përkohshme, nga ana e komunës”.

3.3.6.1.5. *Shfrytëzimet e ndaluara*

Shfrytëzime që nuk janë të lejuara në një zonë nën asnjë rrethanë apo kusht, përcaktohen si shfrytëzime të ndaluara. Mirëpo, një listë specifike me shfrytëzime të ndaluara është e rrallë. Shumë harta zonale thjesht do të përcaktojnë që çdo shfrytëzim që nuk është i listuar si i lejuar, dytësor, përkohshëm apo i lejuar i veçantë, konsiderohet si i ndaluar.

Shfrytëzimet e ndaluara janë ato shfrytëzime të cilat është e nevojshme të specifikohen si të palejuara, me qëllim të sigurimit që zhvillimet apo funksionet e tilla të mos kenë efekte negative mbi zhvillimet përreth në zonë. Efektet negative mund të jenë si ndotje mjedisore apo zhurmë, dhe që paraqesin rrezik për jetesën dhe mirëqenien e pronave përreth.

Për shembull, shfrytëzim i ndaluar në një zonë me shfrytëzim dominues banim, mund të jetë industria e rëndë. Shfrytëzimet e ndaluara në zonë përcaktojnë funksione dhe aktivitete që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në zonë dhe janë të deklaruara në mënyrë specifike si të pa lejuara.

Kriteret për përcaktimin e zhvillimeve të ndaluara në një zonë, por pa u kufizuar vetëm në to, janë:

- Kategoritë e shfrytëzimit të tokës që bien në kundërshtim me qëllimet e zonimit sipas përcaktimeve të HZK-së zhvillimi dhe instrumenteve të planifikimit në fuqi;
- Kur një zhvillim kërkohet të realizohet në një zonë që i përket një kategorie bazë të ndryshme nga ajo e zhvillimit të kërkuar, për sa kohë që nuk parashikohet ndryshe dhe në mënyrë të argumentuar në instrumentin e planifikimit në fuqi;
- Çdo përdorim që pavarësisht nga kategoria bazë të cilës i përket, krijon ndotje në mjedis përtej parametrave dhe standardeve të parashikuara në legjislacionin e posaçëm mjedisor, dëmton shëndetin, dëmton strukturat dhe monumentet e trashëgimisë kulturore;
- Çdo zhvillim në tokë bujqësore që edhe pse mund të jetë brenda kategorisë bazë të shfrytëzimit të tokës dhe strukturave në të, nuk respekton rregullat, standardet dhe treguesit e planifikimit dhe të zhvillimit sipas përcaktimeve të HZK-së zhvillimi dhe të instrumenteve të planifikimit në fuqi;
- Përdorime të ndaluara janë ato që përcaktohen për çdo njësi strukturore/zonë më prioritet zhvillimi në HZK. Sirregull i përgjithshëm, përveç sa përcaktohet ndryshe në këtë HZK.
- Përdorimet e ndaluara përmbushin përcaktimet HZK-së.
- Përdorime të ndaluara për zonat e banimit janë: industrinë e rëndë, kimikë dhe të tjera ndotëse më ndikim të lartë në mjedis, ndërtimet ushtarake, varrezat, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura; zonat ku bëhet kompostimi i mbetjeve organike.
- Aktivitetet në zonën e banimit në zonat rurale, përpos rritja e bletëve, mbajtja e bagëtive dhe gjedhëve si ekonomi familjare në kapacitete të vogla janë të ndaluara stallat me numër të madh të gjedhëve, kurse në zonën urbane ndalohen gjitha këto aktivitete të sipërpërmendura. Në zonën urbane lejohen vetëm aktivitete të kultivimit dhe hortikulturës në oborret dhe kopshtet individualë të ndërtesave, në kuadër të bujqësisë urbane.



- Nuk lejohen aktivitete si djegia e mbeturinave të çfarëdo lloji në zonat e banimit, të sistemit natyror apo në brigjet e burimeve ujore.
- Përdorimet industriale janë të ndaluara të vendosën në brigjet ujore, në zonat të mbrojtura natyrore pavarësisht kategorive, në zonat që mbrohen nga legjislacioni për monumentet e kulturës, përfshirë zonat buferike apo brezat mbrojtës të këtyre zonave/objekteve.
- Përdorimet e ndaluara në territoret e zonave të mbrojtura natyrore dhe në zonat e tyre buferike, si dhe në zonat që mbrohen nga legjislacioni për trashëgiminë kulturore, përfshirë brezat mbrojtës/zonat buferike të këtyre zonave/objekteve, përcaktohen në legjislacionin në fuqi.
- Të gjitha funksionet janë të ndaluara në hapësirën e përcaktuar si brez mbrojtës, apo tampon/buferik përinfrastrukturën rrugore dhe kanalet e kullimit dhe ujitjes të tokave bujqësore nga legjislacioni në fuqi.

3.3.6.2. Kushtet e pergjithshme për shfrytëzim të tokës

Tërësia e llojeve të Përdorimit të Tokës është e organizuar në nomenklaturën S.H.K.P.T.I, Sistemi Hierarkik i Klasifikimit të Përdorimit të Tokës INSPIRE. Një parcel, njësi territoriale apo pjesë e tij mund të ketë vetëm një përcaktim të kategorisë dhe nënkategorisë dhe nuk mund t'i përkasë njëkohësisht dy kategorive apo nënkategorive të kësaj nomenklature. I gjithë territori i komunes mbulohet më një nga këto kategori dhe nënkategori dhe asnjë parcele, njësi territorial apo pjesë e saj nuk mund të mbesë pa u trajtuar me një nga kategoritë apo nënkategoritë e kësaj nomenklature.

Nomenklatura e Përdorimit të Tokës është e organizuar në hierarkinë e kategorive të mëposhtme:

- Prodhimi Parësor
- Prodhimi Dytësor
- Shërbime Terciare
- Rrjeti i Transporteve, Llogistikës dhe Infrastrukturës
- Përdorimi Banim
- Përdorime të tjera

3.3.6.2.1. Prodhimi Parësor

Përdorimi i prodhimit parësor i referohet funksionit të prodhimit të mallrave bazuar direkt në burimet natyrore lokale. Sektori primar prodhues transformon burimet natyrore në produkte primare. Si rregull, shumica e produkteve nga ky sektor janë ose lëndëve të para për industri të tjera, por një pjesë e tyre konsumohen direkt nga përdoruesit përfundimtar.

Nënkategoritë e prodhimit parësor janë:

- Bujqësia
- Pylltaria
- Minierat dhe Karrierat
- Akuakultura dhe Peshkimi
- Përcaktime të tjera

Nënkategoria Bujqësi i referohet funksionit të prodhimit të kulturave bimore dhe produkte të kafshëve për ushqim, shitje, konsum vetjak apo qëllime industriale. Kjo nënkategori përfshin kultivimi e bimëve për biokarburante, rritjen e të lashtave në fushë të hapur, si dhe në serra. Gjithashtu, toka ugar e vënë mënjanë për rotacion kulture takon kësaj klase. Përfshihet në këtë kategori edhe përgatitja e produkteve për tregjet parësore, punimet fushore, terracimi, kullimi përgatitja e orizoreve, si dhe kujdesi për peizazhin dhe mirëmbajtjen e tij.

Nënkategoria Pylltari i referohet funksionit të prodhimit të drurit dhe produkteve të tjera parësore me bazë druri. Përveç prodhimit të drurit, në këtë nënkategori janë pëfshirë edhe aktivitetet pyjore që i nënshtrohen një përpunimi minimal si dru zjarri, qymyr dhe dru të përdorura në një formë të papërpunuar. Gjithashtu në këtë nënkategori përfshihen fidanishtet dhe zonat e magazinimit të transportit të lidhura me prerjet pemë dhe bimëve drusore për karburantet bio.

Nënkategoria Miniera dhe Karriera i referohet funksionit të minierave dhe karrierave gurore në nxjerrjen e mineraleve dhe materialeve natyrore si gurë, qymyr, minerale, zhavorr, rërë, kripë, lëngjeve, naftë, gaz, torfë apo biomasë, ku nxjerrja arrihet me metoda të ndryshme të tilla si nëntokësore apo edhe sipërfaqësore.

Nënkategoria Akuakulturës dhe peshkimit i referohet funksionit të mbarështimit të peshkut dhe peshkimit profesional.

Nënkategoria Përcaktim të tjera i referohet funksioneve të gjuetisë profesionale, mbledhjes së produkteve që rriten në gjendje të egër, produkteve pyjore jodrusore, mbarështimit të kafshëve migratore dhe çdo prodhimi tjetër parësor që nuk përfshihet në kategoritë Bujqësi, Pylltari, Miniera dhe karriera, Akuakulturë dhe Peshkim.

3.3.6.2.2. Prodhimi Dytësor

Përdorimi i prodhimit dytësor i referohet funksionit të prodhimit industrial dhe aktiviteteve prodhuese të cilat marrin prodhimin e sektorit primar dhe gjenerojnë mallra të përfunduar apo produkte të ndërmjetme për biznese të tjera. Ky funksion përfshin gjithashtu zonat e magazinimit dhe transportit që lidhen drejtpërdrejt me prodhimin. Degët e industrive që mbulohen nga kjo klasë janë përpunimi; ushqimor, tekstil, i lëkurës, i drurit dhe produkteve të drurit, pulpë, i letrës, i naftës dhe karburanteve të tjera, i lëndëve kimike apo produkteve kimike, fibrave të bëra nga njeriu, goma apo prodhimet plastike, i produkteve minerale jo metalike, metaleve bazë dhe produkteve metalike, produkteve metalike të fabrikuara, makineritë dhe pajisjet, pajisjet elektrike dhe optike, pajisjet e transportit dhe mobiljet.

Nënkategoritë e prodhimit dytësor janë;

- Industria e Papërpunuar
- Industria e Rëndë
- Industria e Lehtë
- Prodhimi Energjistik
- Industri të tjera

Nënkategoria Industri e Papërpunuar i referohet funksionit të aktiviteteve industriale që transformojnë prodhimin e sektorit parësor në produktet gjysëm të përpunuara si; produkte tekstili, druri dhe produkte me bazë druri, produkte letre, produkte të naftës së rafinuar dhe karburantit bërthamor, produkte kimikate, fibrave të bëra nga njeriu, metaleve bazë dhe metaleve të fabrikuara, produkteve minerale jo metalike, produkte gome plastike dhe të lëndëve të tjera të para.

Nënkategoria Industri e Rëndë i referohet funksionit të aktiviteteve që shndërrojnë produktet e papërpunuara në produkte në të prodhimit të rëndë të tilla si; prodhim i makinerive, prodhim i automjeteve dhe pajisjeve të transportit, prodhim të produkteve tjera fundore të rënda.

Nënkategoria Industri e Lehtë i referohet funksionit të aktiviteteve që shndërrojnë produktet e papërpunuara në produkte në të prodhimit të lehtë të tilla si; prodhim i pijeve, ushqimit dhe produktet e duhanit, prodhim e rrobave dhe lëkurës, shtëpi botuese, tipografi, prodhimin e pajisjeve elektrike dhe optike.

Nënkategoria Prodhim Energjistik i referohet funksionit të aktiviteteve të prodhimit të energjisë elektrike përmes; energjisë bërthamore, fosileve, karburantit, biomasës apo të rinovueshme.



Nënkategoria Industri të tjera i referohet funksionit të aktiviteteve të prodhimit industrial që nuk janë të përfshira në nënkategoritë Industria e Papërpunuar, Industria e Rëndë, Industria e Lehtë, Prodhimi Energjistik.

3.3.6.2.3. Shërbime Terciare

Përdorimi i shërbimeve komunitare i referohet funksionit të shërbimet që janë produkte për bizneset e tjera dhe konsumatorët si privatë ashtu dhe publikë. Ajo përfshin shitjen me shumicë dhe tregtinë me pakicë, shërbimet e riparimit, hotelet dhe restorantet, shërbimet financiare, shërbimet biznesi, shërbimet me qira, administratën publike, mbrojtjen dhe sigurinë sociale, edukimin, shëndetin dhe punën sociale dhe shërbime të tjera komunitare dhe sociale.

Nënkategoritë e shërbimeve komunitare janë;

- Shërbime Tregtare
- Shërbime Financiare dhe të Informacionit
- Shërbime Komunitare
- Shërbime Kulturore, Çlodhëse dhe Argëtuese
- Shërbime të tjera

Nënkategoria Shërbime Tregtare i referohet funksionit të shitjes me shumicë dhe pakicë të automjeteve, karburantit, lëndëve të para bujqësore, kafshëve të gjalla, mineraleve, metaleve, kimike, lëndëve drusore, makinerive, anijeve, mobiljeve, mallrave shtëpiake, tekstileve, ushqimeve, pijeve, produkteve të duhanit, produkteve farmaceutike, mallrave të dorës së dytë, produkteve të tjera, mbetjeve, skrapit, si dhe funksionit të shërbimeve e pasurive të patundshme, akomodimit hotelier dhe ushqimit. Kjo klasë përfshin edhe riparimin e automjeteve, personale dhe mallrave shtëpiake.

Nënkategoria Shërbime Financiare dhe të Informacionit i referohet funksionit të ofrimit të shërbimeve profesionale, financiare apo informative si; fusha bankare, kreditë, sigurimet dhe shërbime të tjera financiare, konsulence për teknologjinë dhe informacionin, përpunim i të dhënave, kërkim dhe zhvillimin, asistencë ligjore dhe të kontabilitetit, menaxhim i biznesit, projektim arkitektonik, inxhinierik, reklamim, hetim, konsulencë, dhe shërbime të tjera profesionale, botime, regjistrim, programim dhe transmetim mediatik, film, radio transmetim, telekomunikacion, asistencë kompjuterike dhe përpunim i të dhënave të shërbimeve, shërbime administrative dhe mbështetëse.

Nënkategoria Shërbime Komunitare i referohet funksionit të ofrimit të shërbimeve për komunitetin, atyre të përgjithshme administrative, të mbrojtjes, të drejtësisë, të sigurisë publike, të mbrojtjes nga zjarri dhe të sigurimit të detyrueshëm shoqëror, të arsimit të të gjitha niveleve, të shëndetit të njeriut dhe të kafshëve dhe të shërbimeve të punës sociale, të shërbimeve fetare apo të kultit dhe atyre të varrimit.

Nënkategoria Shërbime Kulturore, Çlodhëse dhe Argëtuese i referohet funksioneve argëtuese si; infrastrukturë sportive, stadione, salla sporti, pishina, objekte palestre, vendpushime për ski, fusha golfi dhe mjedise të lojërave të fatit, funksioneve kulturore si; art, bibliotekë, muze, kopshte zoologjike, kopshte botanike, vende historike, dhe funksioneve çlodhëse e dëfryese si; parqet urbane, parqet kombëtare dhe zonat natyrore që përdoren për qëllime rekreative.

Nënkategoria Shërbime të tjera i referohet funksioneve që nuk përfshihen në shërbime tregtare, shërbime financiare dhe të informacionit, shërbime komunitare, shërbime kulturore, çlodhëse dhe argëtuese.

3.3.6.2.4. Rrjeti i Transporteve, Logjistikës dhe Infrastrukturës

Përdorimi i Rrjeti i Transporteve, Logjistikës dhe Infrastrukturës i referohet funksionit të infrastrukturës bazë, që të gjithë sektorët e tjerë përdorin për të prodhuar mallra dhe shërbime dhe që është gjithashtu jetike për

aspektin e banimit. Ky funksion përfshin tokën që përdoret për furnizimin me ujë, mbledhjen, trajtimin dhe riciklimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave, transportin, energjinë elektrike, telekomunikacionin, rrjetet dhe komunikimin.

Nënkategoritë e rrjetit të transporteve, logjistikës dhe infrastrukturës janë;

- Rrjetet e Transportit
- Shërbimet Komunale

Nënkategoria Rrjete të Transportit i referohet funksioneve të infrastrukturës bazë së transportit rrugor; duke përfshirë rrugët, zonat e parkimit, stacionet e shërbimit, transportit hekurudhor, transportit ajror; duke përfshirë aeroportet dhe shërbime të lidhura me to, transportit ujor; duke përfshirë portet, limanet, doket dhe shërbime të lidhura me to.

Nënkategoria Shërbimeve Komunale i referohet funksioneve të sigurimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, gazit dhe energjisë termike. Kjo klasë përfshin, tubacionet e përdorura për transportimin e naftës dhe gazit. Gjithashtu përfshihet fusha e nxjerrjes, grumbullimit, ruajtjes, pastrimit dhe shpërndarjes së ujit, grumbullimi, duke përfshirë dhe tubacionet, dhe trajtimi i ujërave të zeza, mbledhja, grumbullimin, trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave urbane dhe ato të veçanta.

3.3.6.2.5. Banimi

Përdorimi i Banimit i referohet funksionit të strehimit të njerëzve përmes format që ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga zona në zonë. Kjo fushë përfshin strehim e veçuar, banimin shumëfamiljar, ose shtëpitë e lëvizshme si në qytete ashtu dhe zonat rurale, gjithmonë në qoftë se këto nuk janë të lidhura me prodhimin prima, duke lejuar si densitet të lartë përdorimin e tokës ashtu edhe përdorimet me densitet të ulët. Kjo klasë përfshin edhe funksionin banim në zona të përziera me përdorime të tjera jo-konfliktuale me banimin.

Nënkategoritë e banimit janë;

- Banim i Përhershëm
- Banim i përzier me përdorime të tjera të pajtueshme
- Banim tjetër

Nënkategoria Banim i Përhershëm i referohet funksioneve të banimit të tipit shtëpi të veçuara rrethuar me oborr, përzierje e shtëpive të veçuara me shtëpi gjysmë-shërbim, shtëpive të qytetit, shtëpi në rrjesht si dhe blloqe të banesave shumëfamiljare që përdoren për qëndrim të përhershëm

Nënkategoria Banim i përzier me përdorime të tjera të pajtueshme i referohet funksioneve të banimit kur ai përzjehet me përdorime të tjera jo-konfliktuale me banimin si ai industrial apo trajtim mbetje dhe ujëra të zeza.

Nënkategoria Banim tjetër i referohet funksioneve të banesa të përkohshme, kampeve të emigrantëve apo të qëllimeve të tjera, shtëpiza pushimi jo permanente.

3.3.6.2.6. Përdorime të Tjera

Përdorime të tjera i referohen funksioneve jo të parashikuara në klasat prodhim parësor, prodhim dytësor, shërbime terciare, rrjet i transporteve, llogjistikë dhe infrastrukturë, përdorim banim etj.

Nënkategoritë e përdorimeve të tjera janë:

- Përdorim i Përkohshëm
- E Braktisur
- Natyrore pa Përdorim Ekonomik

Nënkategoria Përdorim i Përkohshëm i referohet gjendjes në ndërtim e sipër. Kjo klasë përdoret vetëm për përdorim ekzistues të tokës dhe jo për përdorim të planifikuar tokës

Nënkategoria E braktisur, i referohet situatës kur territore bujqësore, banimi, industriale, transporti apo infrastrukture janë braktisur nga funksioni i tyre fillestar, nuk është në përdorim dhe nuk mund të përdoret për qëllimin fillestar pa punë rinovuese, riparim apo kompensim të tyre.

Nënkategoria natyrore pa përdorim ekonomik i referohet funksionit të territoreve të cilat janë në gjendje natyrore por jo në përdorim tjetër ekonomik si ato; pyjore, ligatinore si dhe tokat e zhveshura. Gjithashtu territoret e mbrojtura mund t'i takojnë kësaj klase, veç nëse nuk janë subjekt i përdorimeve të tjera.

3.3.6.2.7. Zonë e Veçantë

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara, brenda zonës së veçantë janë, si më poshtë:

- Përdorime të Prodhimit parësor si: Miniera dhe Karriera
- Përdorime të Prodhimit dytësor si: Prodhim Energetik
- Shërbime Terciare si: Shërbime Komunitare si; Burg, Varreza, Repart Ushtarak,
- Rrjete të Transporteve Logjistikës dhe Infrastrukturës si: Rrjete transportesh si: Rrugë të kategorive magjistrale dhe regionale, transport hekurudhor, transport ajror, transport ujor; Shërbime Komunale si: Rrjete të gjenerimit dhe transmetimit të energjisë elektrike, gazit, energjisë termike, impiante të grumbullimit të grumbullimit dhe trajtimit të ujrave të zeza dhe mbetjeve.
- Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e ndaluara, brenda zonës së veçantë janë, si më poshtë:
- Përdorime të Prodhimit parësor si: Bujqësi, Pylltari, Akuakulturë dhe Peshkim
- Shërbime Terciare
- Përdorim të Banimit
- Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara me kusht, brenda zonës së veçantë janë, si më poshtë:
- Rrjete të Transporteve Logjistikës dhe Infrastrukturës si: Rrugë të kategorive lokale dhe në vendbanime, parkim, stacione shërbimi, shërbime komunale të rendit të shpërndarjes sekondar dhe terciar.

3.3.6.3. Zonë Mbrojtëse

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara, brenda zonës mbrojtëse janë, si më poshtë:

Përdorime të Prodhimit parësor si: Bujqësi, Pylltari, Akuakulturë dhe Peshkim

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e ndaluara, brenda zonës mbrojtëse janë, si më poshtë:

- Përdorime të Prodhimit parësor si: Miniera dhe Karriera
- Përdorime të Prodhimit dytësor
- Shërbime Terciare
- Rrjete të Transporteve Logjistikës dhe Infrastrukturës
- Përdorim të Banimit
- Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara me kusht, brenda zonës mbrojtëse janë, si më poshtë:
- Shërbime Terciare si: Shërbime Komunitaresi; Varreza

3.3.6.3.1. Sipërfaqe e Mbrojtur

- Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara, brenda sipërfaqes së mbrojtur janë, si më poshtë:
- Përdorime të Prodhimit parësor si: Bujqësi, Pylltari, Akuakulturë dhe Peshkim.
- Shërbime Terciare si: Shërbime Kulturore Çlodhëse dhe Argëtuese.
- Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e ndaluara, brenda sipërfaqes së mbrojtur janë, si më poshtë:
- Përdorime të Prodhimit parësor si: Miniera dhe Karriera
- Përdorime të Prodhimit dytësor
- Shërbime Terciare si: Shërbime Komunitare si; Burg, Varreza, Repart Ushtarak;

- Rrjete të Transporteve, Logjistikës dhe Infrastrukturës si: Rrjete transportesh si: Rrugë të kategorive magjistrale dhe regjionale, transport hekurudhor, transport ajror, transport ujor; Shërbime Komunale si: Rrjete të gjenerimit dhe transmetimit të energjisë elektrike, gazit, energjisë termike, impiante të grumbullimit të grumbullimit dhe trajtimit të ujrave të zeza dhe mbetjeve.
- Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara me kusht, brenda sipërfaqes së mbrojtur janë, si më poshtë:
- Shërbime Terciare si: Shërbime Tregtare, Shërbime Financiare dhe të Informacionit, Shërbime Komunitare
- Përdorim të Banimit
- Rrjete të Transporteve, Logjistikës dhe Infrastrukturës si: Rrugë të kategorive lokale dhe në vendbanime, parkim, stacione shërbimi, shërbime komunale të rendit të shpërndarjes sekondar dhe terciar.

3.3.6.3.2. Zonë e Veçantë e Mbrojtur

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara, brenda zonës së veçantë të mbrojtur janë, si më poshtë:

- Përdorime të Prodhimit parësor si: Bujqësi, Pylltari, Akuakulturë dhe Peshkim.
- Rrjete të Transporteve, Logjistikës dhe Infrastrukturës si: Rrugë të kategorive lokale dhe në vendbanime, parkim, stacione shërbimi, shërbime komunale të rendit të shpërndarjes sekondare dhe terciare.

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e ndaluara, brenda zonës së veçantë të mbrojtur janë, si më poshtë:

- Përdorime të Prodhimit parësor si: Miniera dhe Karriera
- Përdorime të Prodhimit dytësor
- Rrjete të Transporteve Llogjistikës dhe Infrastrukturës si: Rrjete transportesh si: Rrugë të kategorive magjistrale dhe regjionale, transport hekurudhor, transport ajror, transport ujor; Shërbime Komunale si: Rrjete të gjenerimit dhe transmetimit të energjisë elektrike, gazit, energjisë termike, impiante të grumbullimit të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza dhe mbetjeve.

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara me kusht, brenda zonës së veçantë të mbrojtur janë, si më poshtë:

- Shërbime Terciare
- Përdorim të Banimit

3.3.6.3.3. Zona Industriale

Norma udhëzuese teknike për planifikimin e madhësisë së zonës industriale është si më poshtë:

- Për përdorim industrial, një minimum prej 25 m² për punëtor;
- Për magazina, një minimum prej 700 m² për punëtor;
- Për zyra të industrisë, një minimum prej 20 m² për punëtor;
- Për park shkencor, një minimum prej 15 m² për punëtor;
- Për industri rurale, një minimum prej 30 m² për punëtor.

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara, brenda zonës industriale janë, si më poshtë:

- Përdorime të Prodhimit parësor si: Miniera dhe Karriera.
- Përdorime të Prodhimit dytësor si: Industri i papërpunuar, Industri e rëndë, Industri e Lehtë, Prodhim Energjetik dhe, Industri të tjera.
- Rrjete të Transporteve Llogjistikës dhe Infrastrukturës si: Rrjete transportesh si: Rrugë të kategorive lokale dhe në vendbanime, transport hekurudhor, transport ajror, transport ujor, parkim, stacione shërbimi; Shërbime Komunale si: Rrjete të gjenerimit dhe transmetimit të energjisë elektrike, gazit, energjisë termike, impiante të grumbullimit dhe të trajtimit të ujrave të zeza dhe mbetjeve, shërbime komunale të rendit të shpërndarjes sekondare dhe terciare.

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e ndaluara, brenda zonës industriale janë, si më poshtë:

- Përdorime të Prodhimit parësor si: Bujqësi, Pylltari, Akuakulturë dhe Peshkim.



- Shërbime Terciare si: Shërbime Komunitare si: Burg, Varreza, Repart ushtarak;
- Përdorim të banimit;

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara me kusht, brenda zonës industriale janë, si më poshtë:

- Shërbime Terciare si: Shërbime Tregtare, Shërbime Financiare dhe të Informacionit, Shërbime Komunitare, Shërbime Kulturore Çlodhëse dhe Argëtuese

Norma teknike udhëzuese për qasjen e zonës industriale është:

- Zona industriale duhet të ketë qasje direkte në rrugën e jashtme kryesore të trafikut të shpejtë;
- Zona industriale duhet të jetë e ndarë nga vendbanimi urban, zonat mjedisore dhe bujqësore përmes një zonë mbrojtëse prej të paktën 200 m gjërësi;
- Infrastruktura teknike e zonës industrial duhet të jetë e ndarë nga ajo e vendbanimit urban;
- Zona industriale duhet të ketë një teknologji të pavarur dhe të shkëputur nga rrjeti i vendbanimeve për trajtimin e ujrave industrial, mbetjeve industriale dhe vajrave industrialë.

3.3.6.3.4. Zona Teknologjike

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara, brenda zonës teknologjike janë, si më poshtë:

- Shërbime Terciare si: Shërbime Komunitare, Shërbime Kulturore Çlodhëse dhe Argëtuese
- Përdorim të banimit si: Banim i përzier me përdorime të tjera të pajtueshme
- Rrjete të Transporte, Logjistikës dhe Infrastrukturës si: Rrugë të kategorive lokale dhe në vendbanime, parkim, stacione shërbimi, shërbime komunale të rendit të shpërndarjes sekondare dhe terciare.

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e ndaluara, brenda zonës teknologjike janë, si më poshtë:

- Përdorime të Prodhimit parësor si: Miniera dhe Karriera
- Përdorime të Prodhimit dytësor
- Shërbime Terciare si: Shërbime Komunitare si: Burg, Varreza, Repart Ushtarak;
- Rrjete të Transporte, Logjistikës dhe Infrastrukturës si: Rrjete transportesh si: Rrugë të kategorive magjistrale dhe regjionale, transport hekurudhor, transport ajror, transport ujor; Shërbime Komunale si: Rrjete të gjenerimit dhe transmetimit të energjisë elektrike, gazit, energjisë termike, impiante të grumbullimit të grumbullimit dhe trajtimit të ujrave të zeza dhe mbetjeve.

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara me kusht, brenda zonës teknologjike janë, si më poshtë:

- Përdorime të Prodhimit parësor si: Bujqësi, Pylltari, Akuakulture dhe Peshkim
- Shërbime Terciare si: Shërbime Tregtare, Shërbime Financiare dhe të Informacionit.
- Përdorim të Banimit si: Banim i Përhershëm.

3.3.6.3.5. Zona për Shfrytëzim të përzier

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara, brenda zonës për shfrytëzim të përzier janë, si më poshtë:

- Shërbime Terciare: Shërbime Tregtare, Shërbime Financiare dhe të Informacionit, Shërbime Komunitare, Shërbime Kulturore Çlodhëse dhe Argëtuese
- Rrjete të Transporte, Logjistikës dhe Infrastrukturës si: Rrugë të kategorive lokale dhe në vendbanime, parkim, stacione shërbimi, shërbime komunale të rendit të shpërndarjes sekondare dhe terciare.
- Përdorim të Banimit

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e ndaluara, brenda zonës për shfrytëzim të përzier janë, si më poshtë:

- Përdorime të Prodhimit parësor si: Miniera dhe Karriera.



- Përdorime të Prodhimit dytësor si: Industri i papërpunuar, Industri e rëndë
- Shërbime Terciare si: Shërbime Komunitaresi: Burg, Varreza, Repart Ushtarak;

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara me kusht, brenda zonës për shfrytëzim të përzier janë, si më poshtë:

- Përdorime të Prodhimit parësor si: Bujqësi, Pylltari, Akuakulturë dhe Peshkim.
- Përdorime të Prodhimit dytësor si: Industri e Lehtë, Prodhim Energjetik dhe Industri të tjera.
- Rrjete të Transporteve, Logjistikës dhe Infrastrukturës, si: Rrjete transportesh si: Rrugë të kategorive magjistrale dhe regjionale, transport hekurudhor, transport ajror, transport ujor; Shërbime Komunale si: Rrjete të gjenerimit dhe transmetimit të energjisë elektrike, gazit, energjisë termike, impiante të grumbullimit të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza dhe mbetjeve.
- Përdorim të Banimit

3.3.6.3.6. Zona Komerçiale

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara, brenda zonës komerciale janë, si më poshtë:

- Shërbime terciare si; Shërbime Tregtare, Shërbime Financiare dhe të Informacionit, Shërbime Kulturore Çlodhëse dhe Argëtuese.
- Rrjete të Transporteve, Logjistikës dhe Infrastrukturës si; Rrugë të kategorive lokale dhe në vendbanime, parkim, stacione shërbimi, shërbime komunale të rendit të shpërndarjes sekondare dhe terciare.
- Përdorim të banimit

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e ndaluara, brenda zonës komerciale janë, si më poshtë:

- Përdorime të Prodhimit parësor
- Përdorime të Prodhimit dytësor
- Shërbime Terciare si: Shërbime Komunitare si; Burg, Varreza, Repart ushtarak;
- Rrjete të Transporteve Logjistikës dhe Infrastrukturës si: Rrjete transportesh si: Rrugë të kategorive magjistrale dhe regjionale, transport hekurudhor, transport ajror, transport ujor; Shërbime Komunale si: Rrjete të gjenerimit dhe transmetimit të energjisë elektrike, gazit, energjisë termike, impiante të grumbullimit të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza dhe mbetjeve.

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara me kusht, brenda zonës komerciale janë, si më poshtë:

- Shërbime terciare si: Shërbime Komunitare

3.3.6.3.7. Zona e Banimit

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara, brenda zonës së banimit janë, si më poshtë:

- Shërbime terciare si: Shërbime Financiare dhe të Informacionit; Shërbime Komunitare administrative, të drejtësisë, të sigurisë publike, të mbrojtjes nga zjarri, të sigurimit të shoqëror, të arsimit, të shërbimit shëndetësor, të shërbimeve të kultit; Shërbime Kulturore Çlodhëse Argëtuese, Shërbime të tjera.
- Rrjete të Transporteve, Logjistikës dhe Infrastrukturës si: Rrugë të kategorive lokale dhe në vendbanime, parkim, stacione shërbimi, shërbime komunale të rendit të shpërndarjes sekondare dhe terciare.
- Përdorim të banimit;

Kushtet e përgjithshme zhvillimore për përdorimet e ndaluara, brenda zonës së banimit, janë si më poshtë:

- Përdorime të Prodhimit parësor:
- Përdorime të Prodhimit dytësor:
- Shërbime Terciare si: Shërbime Komunitare si: Burg, Varreza, Repart ushtarak;
- Rrjete të Transporteve, Logjistikës dhe Infrastrukturës si: Rrjete transportesh si: Rrugë të kategorive magjistrale dhe regjionale, transport hekurudhor, transport ajror, transport ujor; Shërbime Komunale si: Rrjete të gjenerimit dhe transmetimit të energjisë elektrike, gazit, energjisë termike, impiante të grumbullimit të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza dhe mbetjeve.

Kushtet e pergjithshme zhvillimore për përdorimet e lejuara me kusht, brenda zonës së banimit, janë si më poshtë:

- Shërbime terciare si: Shërbime Tregtare

3.3.6.3.8. Njësitë strukturore të zonave të banimit

Vendbanimet janë të organizuara në njësi strukturore. Bashkimi i disa njësive përbën një njësi të një rendi më të lartë. Ato përbëhen nga komponentet e mëposhtme:

- Parcela Banim;
- Parcelë për Përdorim Shoqëror;
- Parcelë për Gjellërim Publik;
- Parcelë për aktivitet Sportiv; dhe
- Rrugë dhe Sheshe.

Vendbanimet mbi 10.000 banorë, do të kenë njësitë strukturore që janë të organizuara në rendin e mëposhtëm hierarkik:

- Grupi i Banimit;
- Blloku i Banimit;
- Kompleksi i Banimit; dhe
- Lagja e Banimit.

3.3.6.3.8.1. Grupi i Banimit

Grupi banimit është njësia më e vogël strukturore me një madhësi maksimale prej [1.5] ha për banim shumëfamiljar ose [5] ha për banim të veçuar, dhe që strehon një popullatë nga minimum [1.000] deri maksimumi [2.000] banorë. Grupi i banimit është i përbërë nga:

- Parcela Banim;
- Hapsirë Publike;
- Shesh Lojëra për fëmijë

Normat udhëzuese teknike për planifikimin komponentëve të grupit të banimit në zonat e banimit shumëfamiljar janë si më poshtë:

- Parcela neto strehim kërkon një minimum prej [14, 5] m² për banor;
- Parcela shesh lojërash për fëmijë 0-6 vjeç kërkon një minimum prej [1, 3] m² për banor;

3.3.6.3.8.2. Blloku i Banimit

Blloku banimit është njësia strukturore që përbëhet nga maksimum 4 grupe banimi me një madhësi prej minimum [6] ha dhe maksimale [8] ha për banim shumëfamiljar ose [20] ha për banim të veçuar, dhe që strehon një popullatë prej [3.000] deri në [5.000] banorë.

Blloku i banimi përbëhet nga:

- Parcela Banim;
- Hapsirë e lirë;
- Shesh Lojëra për fëmijë;
- Parcelë për aktivitet Sportiv; dhe
- Rrugë dhe Sheshe

Normat udhëzuese teknike për planifikimin e komponentëve të kësaj njësie strukturore në zonat për banim shumëfamiljar janë si më poshtë:

- Parcela neto strehim kërkon një minimum prej [14,5] m² për banor;



- Parcela shesh lojërash për fëmijë 0-6 vjeç kërkon një minimum prej [1,5] m² për banor;
- Parcela për aktivitete sportive kërkon një minimum prej [0,5] m² për banor;
- Rugët dhe sheshet kërkojnë një minimum prej [1,5] m² për banor.

3.3.6.3.8.3. Kompleksi i Banimit

Kompleksi Rezidencial është njësi strukturore që përbëhet nga maksimumi 4 blloqe banimi me një madhësi nga minimumi [15] ha në maksimumi [30] ha për banim shumëfamiljar ose [60] ha për banim të veçuar, që strehon një popullatë prej [12.000] deri në [20.000] banorë.

Përveç të gjitha elementet e bllokut të banimit, kompleksi i banimit është e pajisur edhe me komponente të mëposhtme:

- Kopsht publik;
- Shërbime tregtare;
- Kopsht/Çerdhe; dhe
- Objekt për arsimin parashkollor publik, për arsimin fillor, për arsimin e mesëm të ulët.

Normat udhëzuese teknike për planifikimin e komponentëve të kësaj njësie strukturore për banim shumëfamiljar janë si më poshtë:

- Parcela neto strehim kërkon një minimum prej [14,5] m² për banor;
- Parcela shesh lojërash për fëmijë 0-6 vjeç kërkon një minimum prej [1,5] m² për banor;
- Parcela për aktivitete sportive kërkon një minimum prej [1,5] m² për banor;
- Rugët dhe sheshet kërkojnë një minimum prej [3] m² për banor;
- Parcela për kopsht publik kërkojnë minimum [1,5] m² për banor;
- Parcela për shërbime tregtare kërkojnë një minimum prej [1] m² për banor;
- Parcela për kopsht ose çerdhe kërkon një minimum prej [0,5] m² për banor;
- Parcela për Objekt për arsimin parashkollor publik, për arsimin fillor, për arsimin e mesëm të ulët kërkojnë një minimum prej [1] m² për banor.

3.3.6.3.8.4. Lagjja e Banimit

Lagja e banimit është njësi strukturore që përbëhet prej maksimalisht 4 komplekseve të banimit me një madhësi prej minimumi [45] ha dhe maksimumi [100] ha për banim shumëfamiljar ose [200] ha për banim të veçuar, që strehon një popullatë prej [35.000] deri në [80.000] banorë.

Përveç të gjithë elementëve të kompleksit të banimit, lagja e banimit është e pajisur me komponentin e objektit të arsimit mesëm të lartë.

Norma udhëzuese teknike përcakton që për planifikimin e sheshit për objekt të arsimit të mesëm të lartë, për banim shumëfamiljar, kërkohet një sipërfaqe minimumi [1, 5] m² për banor;

3.4. Qasja në parcelën kadastrale

Është synim të sigurohet qasje në të gjitha parcelat kadastrale, dhe në këtë formë në të gjitha zonat, pra në tërë territorin e komunës së Fushë Kosovës.

Qasja do të sigurohet nëpërmes të rrugëve të niveleve dhe kategorive të ndryshme, e sidomos me anë të rrugëve lokale ku komuna është kompetente, por edhe me rrugë bujqësore dhe rrugë pyjore.

Qasja do të sigurohet edhe nëpërmjet servituteve bujqësore, energjetike, mjedisore etj.

Do të përkrahen zhvillimet e reja që nuk cenojnë të drejtën apo nuk pamundësojnë qasjen me mjete transporti apo në këmbë të pronarit apo shfrytëzuesi i parcelës kadastrale fqinjenë rrugë publike.

Në rast se për parcelat fqinje nuk ekziston ndonjë alternativë e qasjes në rrugë publike, atëherë pronarët e tokave dhe investorët duhet të përcaktojnë një shteg përbrenda parcelës kadastrale që do të shërbejë si servituti i qasjes në parcelat fqinje për pronarët apo shfrytëzuesit e tyre.

Pronari i tokës apo investitori që dëshiron të ushtrojë një zhvillim të ri duhet të dëshmojë që zhvillimi i propozuar nuk cenon qasjen e papenguar të për pronarët apo shfrytëzuesit e parcelave kadastrale fqinje. Në rast se zhvillimi i ri propozohet për parcelë kadastrale e cila gjendet në mes të rrugës publike dhe parcelës fqinje nuk ka qasje tjetër në rrugë publike, atëherë pronari i tokës apo investitori duhet të krijojë një shteg me gjerësi prej së paku 3 metra dhe lartësi prej së paku 4 metra përgjatë kufirit të parcelës kadastrale nga rruga publike deri në kufirin e parcelës kadastrale fqinje që nuk ka qasje tjetër në rrugë publike.

Para se të jepet pëlqimi për zbatimin e zhvillimit të ri, pronari i tokës apo investitori duhet të dorëzojë marrëveshjen mes pronarit apo shfrytëzuesit të parcelës fqinje të cilit i cenohet e drejta e qasjes në parcelën e tyre kadastrale.

Në rast se pronari i tokës apo investitori që synon të shfrytëzojë parcelën kadastrale për zhvillime të reja nuk ka pas mundësi të gjej shfrytëzuesin apo pronarin e parcelës kadastrale fqinje, atëherë pronari i tokës apo investitori duhet të dorëzojë një deklaratë të nënshkruar që shtegu i qasjes me gjerësi prej së paku tre metra do të jetë në disponim të pronarit apo shfrytëzuesve të parcelës fqinje.

3.5. Qasja në infrastrukturën teknike

Qasja në infrastrukturën teknike si pjesë e kushteve zhvillimore të përgjithshme synon të ofrojë qasje për të gjithë akterët qasje sa më të lehtë dhe të lirë bazuar në rregullat dhe standardet e përgjithshme për zhvillim, dhe që nuk kufizohen vetëm në kërkesat dhe rregullat por edhe në masat mbrojtëse dhe modelet më të përshatashme të projektimit dhe në harmoni me udhëzimet për Infrastrukturë teknike.

Bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe marrë parasysh gjendjen ekzistuese duhet që me hartë zonale të trajtohet infrastruktura teknike si: kapaciteti dhe shtrirja e rrjeteve, ndërtesat përcjellëse, shiritat mbrojtës dhe pajisjet për të siguruar qasje për të gjitha zonat, në varësi të specifikave në:

- rrjetin e ujësjellësit;
- rrjetin e kanalizimit;
- impiantet e trajtimit të ujërave të zeza;
- sistemet e drenazhimit;
- rrjetin e ujitjes;
- rrjetin e shpërndarjes lokale me energji termike;
- rrjetin e shpërndarjes lokale me energji elektrike;
- rrjetin e telekomunikacionit dhe instalimet e ngjashme;
- rrjetin e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave mbitokësore dhe nëntokësore; dhe ndërtesat dhe hapësirat për riciklim dhe dekompozim.
- qasja duhet sigurohet në harmoni me normat e planifikimit hapsinor dhe standardet për infrastrukturë teknike.

3.6. Rregulla për parkim dhe shkarkim

Qëllimi i këtij kapitulli është që përmes krijimit të rregullave që synojnë zvogëlimin e ngarkesave të automjeteve dhe rreziqeve që kanosen nga trafiku të zhvillohet një mjedis i sigurtë dhe adekuat.



Përpos në raste se kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore kanë përcaktuar ndryshe, në kushtet vijuese paraqesin kërkesat minimale për vendparkingje të cilat duhet të vendosen përbrenda parcelave kadastrale për të cilën kërkohet leja ndërtimore:

Përmbajtja	Lloji i ndërtesës	Numri minimal i vend-parkimeve (VP)
Banimi	Banim me shumë njësi mbi 4 kate	▪ 2 VP/ 100 m ²
	Banim me shumë njësi nën 4 kate	▪ 1.5 VP/ 100 m ²
	Shtëpi	1VP/ 100 m ²
Hoteleria	Hotele deri në 3*	0.2 VP/ një shtrat
	Hotele deri në 4*	0.5 VP/ një shtrat
	Hotele deri në 5*	0.75VP/ një shtrat
	Restorante, kafene dhe të ngjashme	4 VP/ 100 m ²
Komeriale	Shitje me pakicë	4 VP/ 100 m ² të hapësirës shitëse
	Treg	3 VP/ 100 m ² të hapësirës shitëse
	Depo dhe shitje me shumicë	1 VP/ 100 m ²
	Artizanale	2 VP/ 100 m ²
Zyre	Afarizëm	▪ 4 VP/ 100 m ²
	Administratë publike	▪ 2 VP/ 100 m ²
Industriale	Industriale	1 VP/ 100 m ²
Institucione kulturore	Kinema, teatro, salla për mbledhje publike	1 VP/ 100 m ²
	Ndërtesa religjioze	1 VP/ 100 m ²
	Muze, galeri dhe biblioteka	1 VP/ 100 m ²
	Sallat e kongreseve	1 VP/ 100 m ²
Institucione arsimore	Kopshte/ çerdhe të fëmijëve	1 VP/ 100 m ²
	Shkollë fillore dhe të mesme të ulëta	0.5 VP/ 100 m ²
	Shkollë mesme e ultë	1 VP/ 100 m ²
	Institucionet e arsimit të lartë	1 VP/ 100 m ²
Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	Spitale, klinika, dhe të përmbajtjeve të tjera të ngjashme	1 VP/ 100 m ²
	Ambulantë, poliklinikë dhe shtëpi të shëndetit	6 VP/ 100 m ²
	Shtëpi për të moshuar	0.5 VP/ 100 m ²
Sportidherekreacioni	Fushat sportive dhe fushat e lojës të hapura për fëmijë	1 VP/ 100 m ²
	Salla sportive të hapura dhe të mbyllura pa spektator	3 VP/ 100 m ²



Përmbajtja	Lloji i ndërtesës	Numri minimal i vend-parkimeve (VP)
	Ndërtesat e sporteve dhe fushave sportive me spektator	5 VP/ 100 m ²

Tabela: Kërkesat minimale për vende të parkingut sipas llojit të ndërtesës

Të gjitha hapësirat e dedikuara për vendparkingje duhet të jenë shënuara me vijat ndarëse në projektin e propozuar dhe në sipërfaqet e ndërtuara.

Duke u bazuar në konfiguracionit të rrafshët të terrenit që shtrihet në territorin e Komunës dhe vonesat që udhëtimi me automjet shkakton për shkak të ngarkesave të mëdha të trafikut, në të ardhmen pritet një rritje në numër të udhëtimeve në Komunë me biçikleta.

Në mënyrë që të mbrohet mjedisi dhe shëndeti i banorëve të Komunës, Harta Zonale Komunale ka përcaktuar edhe numrin minimal të vendparkimeve sipas llojit të ndërtesës të cilat duhet të përmbushen gjatë projektimit dhe ndërtimit të tyre.

Lloji i ndërtesës	Numri minimal i vend-parkimeve për biçikleta (VPB)
Banim me shumë njësi	1 VPB/ 100 m ² të bruto sipërfaqes se ndërtuar (BSN) për vizitor
Përmbajtjet tregtare dhe komunale	5 VPB/ 100 m ² të bruto sipërfaqes se ndërtuar (BSN) për vizitor
Përmbajtjet e bizneseve dhe publike	1 VPB/ 100 m ² të bruto sipërfaqes se ndërtuar (BSN) për të punësuar
Përmbajtjet arsimore	1 VPB/ 5 nxënës, për vizitor + 1 VPB/ 10 të punësuar
Përmbajtjet kulturore- teatro dhe muze	20 VPB/ 100 ulëse, për vizitor
Përmbajtjet shëndetësore- spitale	10 VPB/ 100 shtretër, për vizitor
Përmbajtjet sportive dhe rekreative	20 VPB/ 100 ulëse, për vizitor

Tabela 3: Kërkesat minimale për vende të parkingut për biçikleta sipas llojit të ndërtesës

3.7. Rregullat për zhvillim të peizazhit dhe shiritave të gjelbër mbrojtës

Qëllimi i këtij kapitulli është që të përcaktojë kushte të cilat do të përmirësojnë mjedisin dhe shëndetin e banorëve të Komunës.

Varësisht nga kategoria e rrugëve publike, Harta Zonale e Komunës ka përcaktuar gjerësitë minimale të brezave të gjelbër të cilat zhvillimet e reja duhet të respektojnë dhe përmbushin:

Lloji i institucionit arsimore para-universitar	Vendbanime Urbane
Rrugë nacionale	35m
Rrugë regjionale	22m
Rrugë urbane	10m
Rrugë në vendbanime	8m

Tabela 4 Kriteret a planifikimit të rrugëve brenda vendbanimeve

Të gjitha ndërtimet e ardhme duhet të respektojnë distancat minimale të parashtruara sipër dhe këto kritere janë të detyrueshme përgjatë të gjithë rrugëve publike, ku nuk është planifikuar zhvillimi i ndërtimeve me

PZhK. Në sipërfaqet ku është paraparë zhvillimi i ndërtimeve, kushtet ndërtimore përcaktojnë brezin e gjelbër rrugor.

Peizazhi nënkupton çdo kombinim të vegetacionit të gjallë, si bar, bimë, shkurre ose drunjtë, dhe mund të përfshijë edhe objekte ndërtimore në shërbim të peizazhit siç janë shëtitoret, gardhet, bankat, sheshet publike, artet publike, fontanat dhe të ngjashmet. Rrugët publike ose hapësirat për ngarkim, parkim ose ruajtje të automjeteve ose materialeve nuk janë sipërfaqet të trajtohen nga këto rregullat vijuese:

- Çdo pjesë e një parcele me shfrytëzim të përzier, komerciale, industriale, teknologjike, shërbimeve publike ose banim që nuk përdoret për ndërtim, rrugë publike, ngarkim dhe parkim dhe hapësira të caktuara të magazinimit do të zhvillohet me peizazhe që do të mirëmbahen.
- Për çdo dhjetë (10) hapësira të reja parkimi në kuadër të vendparkimeve jashtërrugore, nevojitet të paktën mbjellja e një (1) druri gjetherënës. Nëse një vendparkim jashtë-rrugor do të përfshijë 20 ose më shumë hapësira të reja parkimi, hapësira me peizazh të rregulluar do të sigurohen brenda hapësirës së parkimit. Përndryshe, në rastet kur një parcelë do të përfshijë më pak se 20 hapësira të reja parkimi, drunjtë mund të mbillen përreth hapësirës së parkimit. Peizazhi i rregulluar do të mbrohet me anësore, ose pajisje të tjera për mbrojtje nga dëmtimi i automjeteve.
- Si pjesë e ndërtimit të çfarëdo rruge të re ose ndërtese të re duhet të kërkohet që të mbillen drunjtë përgjatë rrugëve. Një mesatare prej një druri për çdo 20 m² do të mbillen përgjatë gjatësisë së rrugës. Drunjtë e rrugëve mund të mos mbillen në intervale të caktuara, por mund të lëvizin për t'u përshtatur me infrastrukturën teknike, infrastrukturën publike, infrastrukturën sociale, rrugët publike dhe karakteristika të tjera. Lokacionet për mbjelljen e drurëve mund të jenë ose të mos jenë ndërmjet vijës së rregulluese dhe skajit të rrugës, në varësi të rrethanave të vendit. Nëse drunjtë nuk janë të vendosur ndërmjet të vijës rregulluese dhe skajit të rrugës, ato vendosen brenda parcelës menjëherë pranë vijës rregulluese, apo përgjatë vijës aksiale qarkulluese të rrugëve publike. Drunjtë të ri rrugor nuk do të kërkohen aty ku ka drunjtë ekzistues përgjatë rrugëve publike janë të shëndetshëm. Drunjtë e tillë do të ruhen dhe do të shërbejnë për të njëjtin qëllim.

Të gjitha rregullimet e nevojshme të peizazhit mirëmbahen vazhdimisht nga pronari i pronës dhe mbahen të pastra nga mbeturinat. Çdo peizazh i kërkuar që vdes, hiqet ose dëmtohet rëndë, duhet të zëvendësohet nga pronari aktual i pronës sa më shpejt që është praktike duke pasur parasysh sezonet e rritjes, brenda një maksimumi prej 150 ditësh.

3.8. Rregullimi i peizazhit

Rregullimi i peizazhit për hapësira të përbashkëta dhe parcela individuale, bashkë me arkitekturën e ndërtesës, mundet që në një sasi të madhe t'i shtoj vlerat e zonës. Rregullimi i peizazhit plotëson qarkullimin e këmbësorëve dhe automjeteve dhe duhet të jetë i vendosur në atë mënyrë që të përforcojë karakteristikat funksionale dhe vizuale të rrugës. Karakteristikat fizike të lokacionit si destinimi i tokës, kushtet klimatike, karakteristikat topografike, vegetacioni ekzistues, menaxhimi i ujërave atmosferik, etj, janë të rëndësishme së veçantë në zhvillimin e planit të gjelbërimit. Në këtë komunë janë paraparë disa sheshe të reja, korridore gjelbërimi përgjatë rrugëve si breza mbrojtës rrugor. Brenda ngastrave individuale detyrimisht duhet të parashihi sipërfaqe të lira/të pa ndërtuara si hapësira gjelbërimi, për lojëra të fëmijëve, pllakosje, etj. Këto sipërfaqe të lira brenda ngastrave private kushtimisht do të balancojnë raportin me sipërfaqen e ndërtuar. Klasifikimi i sipërfaqeve të lira /të pa ndërtuara është e ndarë në:

1. Shesh
2. Park/hapësirë e gjelbër
3. Sport dhe rekreacion
4. Shirit gjelbërimi
5. Gjelbërimi në kuadër të ngastrës

6. Elementet mikro-urbane

7. Ndriçimi

1.Sheshet janë hapësira të lira publike të dedikuara kryesisht për lëvizjen dhe grumbullim e qytetarëve. Sheshet karakterizohen edhe nga kufizimi i tyre me funksione aktive. Sheshe tjera publike janë propozuar brenda oborreve të brendshme të ndërtesave ekzistuese shumëbanesore dhe se lidhja e tyre me rrugët kryesore duhet të jetë e qartë me qëllim të shfrytëzimit sa më të mirë të këtyre hapësirave. Për të krijuar hapësirë sa më të madhe të lirë është propozuar që nën këto sheshe të ndodhen parkingje publike.

2.Hapësirat e gjelbra apo parqet e pushimit janë elemente shumë me rëndësi. Në këtë zonat e komunës së Fushë Kosovës sidomos në zonën urbane ekzistojnë këto hapësira, mirëpo ato mund të organizohen në brendi të blloqeve më të mëdha urbanistike ku mund të ketë përmbajtje të lojës për fëmijë, shtigje të këmbësorëve, hapësira për rekreacion duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve. Nëse ekziston kërkesa dhe hapësira po ashtu në këto hapësira të hapura mund të parashihen përmbajtje të përkohshme hoteliere.

3.Sporti dhe rekreacioni hyn në sipërfaqet e dedikuara për sport dhe rekreacion në kuadër të hapësirave të lira. Hapësirat për sport dhe rekreacion si lojëra për fëmijë, fusha për sport të përshtatshme për lokacionin duhet të parashihen edhe brenda blloqeve të banimit varësisht prej kërkesës së banorëve.

4.Shiritat e gjelbërimit janë hapësira të gjelbërimit të lartë të parapara si barrierë mbrojtëse ndaj zonave të caktuara dhe rrugëve. Shiritat e gjelbërimit përgjatë rrugëve përmbledhëse dhe lokale janë planifikuar në të dy anët e rrugëve dhe janë shiritat ndarëse në mes të rrugës dhe shtigjeve për këmbësorë. Përveç mbrojtjes nga zhurma dhe ndotja ato në të njëjtën kohë përmirësojnë pamjen vizuale të rrugës dhe hapësirës përreth. Sipërfaqet e gjelbra në profilet e rrugës duhet të jetë rezistuese ndaj nivelit të lartë të ndotjes. Duhet kontrolluar lartësinë dhe kurorën e tyre në mënyrë që të mos pengohet trafiku.

Drunjtë e rrugëve duhet:

- të sigurojnë definimin e profilit
- të jenë rezistues ndaj ndotjes dhe pluhurit (me gjethe të mëdha, kurorë të madhe)
- të mos jenë gjetherënëse, nuk lëshojnë fruta ose rënie të degëve të mos pengojnë shikueshmërinë

5.Gjelbërimi: në kuadër të ngastrës është i detyruar dhe duhet të parashihet nga secili zhvillues i ngastrës. Nëse raporti i sipërfaqes së ndërtuar dhe të pa ndërtuar është i ndryshueshëm dhe ajo përcaktohet varësisht prej etazhitetit. Hapësira e gjelbër duhet të përfshijë min 20% të sipërfaqes së përgjithshme, ose 40% të sipërfaqes së pandërtuar. Gjelbërimi i lartë në kuadër të ngastrës duhet të vendoset në mënyrë proporcionale përgjatë qarkullimit të trafikut, oborrit, në hapësirat e parkingjeve dhe në qasjet e parcelës. Pasi që këto hapësira nuk janë publike ato mund të organizohen në kuadër të ngastrave individuale varësisht prej kërkesës së investitorit por nuk duhet të kenë karakter komercial dhe të përfshijnë një hapësirë më të madhe se 20% të sipërfaqes së lirë. Raporti i hapësirave të pllakëzuara dhe atyre të gjelbra duhet minimum të jetë 80% : 20% në të mirë të sipërfaqeve të gjelbëruara në të cilën duhet të jenë rekuizitat për rekreacion. Kjo sipërfaqe duhet të jetë e mbrojtur me shirit për gjelbërim të lartë (për mbrojtje nga zhurma dhe ndotja). Në pjesën grafike të HZK-së së Fushë Kosovës nuk janë paraqitur hapësirat e tilla. Kushtet e rregullimit të sipërfaqeve të lira janë:

- Trajtimi i gjelbërimit përgjatë rrugëve;
- Përqindja e sipërfaqeve të gjelbra në ngastër;
- Zonat e përcaktuara për sipërfaqe të lira (vija rregulluese, vija ndërtimore, tampon gjelbërimi, pjesa e pasme, etj)



- Llojet specifike të bimëve;
- Madhësia minimale e bimëve dhe diametri i drunjve;
- Sistemi i ujitjes;
- Forma e hapësirës së parkimit;
- Standardet e nivelimit së paku një dru me kurorë të gjerë duhet të mbillet për 500 m² të sipërfaqes së pa ndërtuar të zonave të ndërtimit. Sugjerohet mbjellja e bimëve autoktone, që i përshtaten klimës dhe vendit. Trupat ekzistues të drunjve të ruhen. Nëse një numër i caktuar duhet të prehen për shkak të ndërtimit, atëherë ato duhet të zëvendësohen me drunj të rinj të mbjellë në pjesën e lirë të parcelës. Gjatë ndërtimit të sipërfaqeve të gjelbra duhet pas parasysh largësinë e nevojshme nga instalimet nëntokësore. Këto janë raporte që duhet respektuar. Në rast të mbjellës së drunjve me rrënjë shumë të zhvilluara, largësia duhet të jetë më e madhe, ose më e vogël në rastin e kundërt.

6. Sipërfaqja gjelbëruese e absorbuese e parcelës (SGJAP): paraqet raportin mes sipërfaqes gjelbëruese dhe absorbuese dhe sipërfaqes së parcelës kadastrale për zhvillim shumëzuar me 100. Kjo përqindje mund të jepet si vlerë e vetme e përqindjes së SGJAP apo si shumë e kalkuluar nga shumta e përqindjes së sipërfaqes gjelbëruese të parcelës (SGJP) dhe përqindjes së sipërfaqes absorbuese të parcelës (SAP).

7. Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (SGJP): paraqet raportin mes sipërfaqes gjelbëruese dhe sipërfaqes së parcelës kadastrale për zhvillim, shumëzuar me 100.

Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (SGJP) e lejuar me dokument të planifikimit hapësinor mund të arrihet përmes kombinimit të sipërfaqes private, të përbashkët, gjysmëpublike dhe/ose sipërfaqes së hapur publike të ofruar në parcelë apo bllok.

Sipërfaqja e përdorshme e gjelbër mund të mos jetë e vendosur në tokë, por mund të shtrihen edhe në mënyrë vertikale përbrenda parcelës kadastrale. Kopshtet dhe peizazhet mbi kulm, duke përfshirë kulmet mbi strukturat e parkimit, mund të përdoren për të përmbushur kërkesat për sipërfaqe të hapura. Kërkesa për sipërfaqe të hapura gjelbëruese nuk përmbushet përmes sipërfaqeve përdhesë të parkimit, rrugëve për automjete ose sipërfaqeve shërbyese.

Mundësia e kombinimit, si në aspektin e shtrirjes vertikale të hapësirave të gjelbra, si dhe shtrirjen horizontale të hapësirave të gjelbra i specifikohet në dokumentet e planifikimit hapësinor.

3.9. Brezi i gjelbër

- Brezi i gjelbër përgjatë rrugëve dhe shtigjeve ka për qëllim:
- izolimin e këmbësorëve, çiklisteve dhe ndërtesave nga trafiku i veturave/ zhurma;
- krijimin e kushteve të përshtatshme higjienike dhe mikroklimatike;;
- përmirësimin e cilësisë estetik të peizazhit.

Brezi i gjelbër përgjatë rrugëve dhe shtigjeve ndahet në:

- Brez të gjelbër, përgjatë sistemeve kombëtare të infrastrukturës rrugore, si pjesë e sistemeve lokale të infrastrukturës rrugore:
- rrjeti i rrugëve nacionale: ≥ 35 m;
- 2.2. rrjeti i rrugëve rajonale: ≥ 22 m.

Brez i gjelbër, përgjatë sistemit lokal të infrastrukturës rrugore:

- rrjeti primar: ≥ 10 m;
- rrjeti sekondar: ≥ 8.00 m.
- brez i gjelbër, përgjatë shtigjeve: ≥ 3.00 m.
- brez i gjelbër, përgjatë vend-parkimeve: $\geq 2.50-4.50$ m.




Figura 5 Brezi i gjelbër

3.10. Kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyror dheartificial

Ndriçimi natyror për dritaret paraqet rregullin e rrafshit imagjinar në kënd prej 45° për të siguruar ndriçim natyror dhe diellosje për strukturat ekzistuese. Rrafshi imagjinar është i projektuar për të siguruar dritë dhe ajër në nivelin e dritares më të ulët të ndërtesave të propozuara dhe ekzistuese, të cilat:

- Janë ndërtuar sipas kushteve ndërtimore të këtij dokumenti; dhe
- Posedojnë leje ndërtimore apo certifikatë të shfrytëzimit;

Rregulli i këndit prej 45° kontrollon hijezimin të strukturave dhe pronave fqinje dhe përdoret kryesisht në zonat me dendësi të mesme dhe të lartë, ose ndërmjet dy zonave me intensitet të ndryshëm të zhvillimit. Rregulli kontrollon që asnjë pjesë e vëllimit të zhvillimit të ri të mos e kalojë vijën e tërhequr në këndin prej 45° shkallë vetëm nga qendra e dritares të katit përdhësës së një hapësirë e banueshme, më të afërt në pronat fqinje. Rregulli i i këndit prej 45° nuk është obligativ për dritare të kthinave sanitare, komunikuese, garazheve, depove dhe hapësirave të tjera të katit përdhësë, për të cilat ndriçimi i natyror nuk është obligativ.

- Zhvillimet e reja drejtpërdrejt përballë dritares së prekur si dhe ndërmjet dy parcelave kadastrale fqinje ose dy zhvillimeve ndërmjet rrugëve publike.
- Zhvillimet i reja/ zonat me intensitet shumë më të lartë është i kthyer direkt kah zhvillimi ekzistues/ zona me intensitet më të ultë.
- Sigurimi i ndriçimi natyror të mjaftueshëm për dy zhvillime fqinje në terren të pjerrët arrihet kur këndi 45 shkallë tërhiqet prej një lartësie specifike. Distanca ndërmjet ndërtesave varet nga lartësia e specifikuar dhe varësisht prej terrenit të pjerrtë. Kjo lartësi mund të përcaktohet si plus ose minus në numër dhe varet sipas pjerrësisë së terrenit. Ky rregull mund të përdoret ndërmjet dy parcelave kadastrale fqinje ose zhvillimi në të dy anët i kthyer kah rruga publike.




Figura 6 Shembulli i llogaritjes së lartësisë për bazuar në këndin 45°

Në llogaritjen e lartësisë së ndërtesës konform këtij rregulli që përcakton pikën më të lartë të kulmit, nuk duhet të përfshihen edhe lartësia e strukturave vijuese të cilat tejkalojnë lartësinë e kulmit:

- Oxhaqeve, boshteve e ventilimit, spiraleve, shtyllave ose direkëve (kur shtyllat dhe direkët janë më pak se 9m mbi nivelin e tokës), me kusht që dimensionin maksimal i tyre paralel me kufirin për secilën nga këto struktura nuk kalon 1 metër dhe me kusht që për ndërtesat mbi tre kate, këto karakteristika janë të përfshira brenda ose janë të mbështetura direkt në muret e jashtme strukturore;
- Boshteve të ashensorëve, boshteve e shkallëve, dhe rezervuarëve të ujit në çati me kusht që ka maksimalisht një ndërhyrje të boshtit të ashensorëve ose boshtit të shkallëve ose rezervuarit të ujit në çati (ose strukture që inkorporon më shumë se njërin nga këto) që lejohet për çdo 20 metra gjatësie të kufirit të brendshëm, dhe që dimensionin maksimal i tyre paralel me kufirin për këtë strukturë nuk tejkalon 3m, dhe me kusht që distanca minimale ndërmjet secilës prej këtyre strukturave është 20m, dhe me kusht që për ndërtesat mbi tre kate, këto karakteristika janë të përfshira brenda ose janë të mbështetura direkt në muret e jashtme strukturore;
- Kur një fund çatie i vetëm me një bazë (duke përjashtuar strehët) prej 7.5 metra ose më pak përballë me një kufi dhe rrafshi i tërhequr godet jo më poshtë se në gjysmë ndërmjet strehëve dhe vijës kurizore, fund çatia mund të ndërhyjë në rrafshin e tërhequr.

3.11. Kërkesat për zvogëlimi të zhurmës

Në mënyrë që të sigurohet një mjedis i përshtatshëm për zhvillimin e jetës dhe punës, Komuna ka përcaktuar disa kufizime në për të shmangur, parandaluar ose zvogëluar efekteve e dëmshme, bezdisjen që shkakton zhurma.

Këto kufizime janë të detyrueshme për të gjitha veprimtaritë përbrenda Komunës, të përcaktuara për secilin shfrytëzim të planifikuar të tokës dhe llojit të vendbanimit.

Lloji i zonimit	Zhurma maksimale e lejuar nga ora 08:00 – 22:00	Zhurma maksimale e lejuar nga ora 22:00 – 08:00
ZKZh-A , Zonë Industriale	90 db(A)	90 dB(A)
ZKZh-B , Zona Urbane 1	60 db(A)	50 dB(A)
ZKZh-C , Zonë Komerciale	55 db(A)	45 dB(A)
ZKZh-D , Zonë Mikse – Banim dhe Komerciale	50 db(A)	40 dB(A)
ZKZh-E , Zonë Banimi	45 db(A)	35 dB(A)
ZKZh-F , Zonë Hekurudhore	100 db(A)	100 dB(A)

Tabela 5 Kufizimet e nivelit të lejuar të zhurmës

Efektet më të zakonshme të zhurmës janë shqetësimi dhe bezdisja. Por ato na bezdisin edhe kur punojmë, kur merremi me veprimtari të tjera apo kur pushojmë. Në mënyrë që të mbrohet shëndeti i banorëve, të gjitha veprimtaritë përbrenda Komunës duhet të respektojnë nivelet e përcaktuara për zonat e sipërme, duke përfshirë edhe veprimtaritë ekonomike dhe fetare.

Të gjitha veprimtaritë argëtuese, mihjes sipërfaqësore, gurëthyesve apo të tjera të ngjashme të cilat ndërmerren jashtë këtyre zonave me kufizime maksimale të lejuar të zhurmës duhet të ndërmarrin masat e nevojshme që mos të tejkalojnë kufizimet e parapara të emetimit të zhurmës përtej kufijve të zonave fqinje.

4. LISTA E ZONAVE DHE LISTA E ZONAVE MBISHTRESORE

Duke u bazuar në planet zhvillimore sektoriale, gjendjen e ekzistuese dhe Udhëzimin Administrativ për Normat Teknike për Planifikim Hapësinor kemi listuar Listën e Zonave dhe Lista e Zonave Mbishtresore vijuese.

4.1. Lista e Zonave

Emërtimi i Zonave	Përmbajtja Zonave (Shfrytëzimi i Planifikuar i Zonave)	Kodi	Simboli
Zonë banimi	Banim Individual	ZB1	ZB1
	Banim Individual	ZB2	ZB2
	Banim Individual	ZB3	ZB3
	Banim Kolektiv	ZB4	ZB4
	Banim Kolektiv	ZB5	ZB5
	Banim Kolektiv	ZB6	ZB6
	Banim Kolektiv	ZB7	ZB7
Zonë për shfrytëzim të përzier	Banim Kolektiv me Afarizëm	ZSHP1	ZSHP1
	Banim dhe afarizëm	ZSHP2	ZSHP2
Zonë industriale	Zonë Industriale	ZI1	ZI1
Zonë komerciale	Tregti dhe afarizëm	ZK1	ZK1
	Treg	ZK2	ZK2
	Tregti dhe afarizëm	ZK3	ZK3
	Pikë karburanti	ZK4	ZK4
Zonë e shërbimeve	Objekt Fetar	ZSH1	ZSH1
	Institucione Parashkollore	ZSH2	ZSH2
	Objekt Fetar	ZSH3	ZSH3
	Institucione shkollore	ZSH4	ZSH4
	QMF	ZSH5	ZSH5
	Institucione shkollore	ZSH6	ZSH6
	QMF	ZSH7	ZSH7
	Institucione shkollore	ZSH8	ZSH8
	Varrezat	ZSH9	ZSH9
	Aeroport ndërkombëtar	ZSH10	ZSH10
	Institucionet shëndetësore	ZSH11	ZSH11
	Mulli i ujit	ZSH12	ZSH12
	QMF	ZSH13	ZSH13
	Shtëpi Integruese për të sëmur mental	ZSH14	ZSH14
	Institucione shkollore	ZSH16	ZSH15

Emërtimi i Zonave	Përmbajtja Zonave (Shfrytëzimi i Planifikuar i Zonave)	Kodi	Simboli
	Shtëpi e Kulturës	ZSH17	ZSH16
	Institucionet publike	ZSH18	ZSH17
	Institucionet Kulturore	ZSH19	ZSH18
	QKMF	ZSH20	ZSH19
	Institucionet publike	ZSH21	ZSH20
Zonë rekreative-turistike	Park/ shesh	ZrT1	ZrT1
	Sport / rekreim	ZrT2	ZrT2
	Sipërfaqe me gjelbërim mbrojtës	ZrT3	ZrT3
Zonë e komunikacionit-transportit	Rrugët/hekurudhat/aeroporti	ZkT	ZkT
	Terminal hekurudhor		
Zonë e mbrojtur	Ligatinë e pasur me zogj	ZM	ZM
	Areal i bimës endemike të ballkanit Forsythia europaea		
Zonë bujqësore	Bujqësi	Zb	Zb
Zonë pyjore	Zonë pyjore	ZP	ZP
Sipërfaqe ujore	Lumë	SU1	SU1
	Kënetë/moçal	SU2	SU2
Zonë mbrojtur arkeologjike historike	Zona Arkeologjike dhe arkitektonike	ZmaH	ZmaH
Zonë ushtarake-sigurisë	Kamp Ushtarak	ZuS	ZuS

4.2. Lista e Zonave Mbishtresore

ZONAT MBISHTRESORE	Kodi
Zonë mbishtresore (bazeni i lignitit) +	ZmSh-D
Zonë mbishtresore (bazeni i lignitit) + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-D, A
Zonë mbishtresore (akuifere) + Të gjitha objektet që kalojnë 10 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-C, F2, A
Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-A
Zonë mbishtresore (akuifere) + Zonë mbishtresore (bazeni i lignitit) + Të gjitha objektet që kalojnë 10 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-C, D, F2, A
Zonë mbishtresore (bazeni i lignitit) + Të gjitha objektet që kalojnë 10 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-D, F2, A
Të gjitha objektet që kalojnë 15 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-F3, A



Zonë mbishtresore (akuifere) + Të gjitha objektet që kalojnë 15 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-C, F3, A
Zonë mbishtresore (akuifere) + Zona e Vershimeve + Zonë mbishtresore (bazeni i lignitit) + Të gjitha objektet që kalojnë 15 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-C, B, D, F3, A
Zonë mbishtresore (akuifere) + Zonë mbishtresore (bazeni i lignitit) + Të gjitha objektet që kalojnë 15 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-C, D, F3, A
Zonë mbishtresore (bazeni i lignitit) + Të gjitha objektet që kalojnë 15 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-D, F3, A
Zonë mbishtresore (akuifere) + Zonë mbishtresore (bazeni i lignitit) + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-C, D, A
Zonë mbishtresore (akuifere) + Zonë mbishtresore (bazeni i lignitit) + Trashëgimia natyrore + Të gjitha objektet që kalojnë 15 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-C, D, G, F3, A
Të gjitha objektet që kalojnë 45 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-F4, A
rezerva të mineralve ndërtimore + Të gjitha objektet që kalojnë 45 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-D, F4, A
Zonë mbishtresore (akuifere) + Zonë mbishtresore (interes i veçantë mineral) + Të gjitha objektet që kalojnë 45 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-C, D, F4, A
Zonë mbishtresore (interes i veçantë mineral) + Zonat arkeologjike + Të gjitha objektet që kalojnë 45 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-D, E, F4, A
Zonë mbishtresore (akuifere) + Zona e Vershimeve + Zonë mbishtresore (bazeni i lignitit) + Të gjitha objektet që kalojnë 45 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-C, B, D, F4, A
Zona e Vershimeve + Të gjitha objektet që kalojnë 90 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-B, F5, A
Të gjitha objektet që kalojnë 90 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-F5, A
Zonë mbishtresore (akuifere) + Zona e Vershimeve + Të gjitha objektet që kalojnë 90 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-C, B, F5, A
Zonë mbishtresore (akuifere) + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-C, A
Zonë mbishtresore (akuifere) + Të gjitha objektet që kalojnë 90 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-C, F5, A
Zonë mbishtresore (akuifere) + bazeni i lignitit rezerva të mineralve ndërtimore + Të gjitha objektet që kalojnë 90 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-C, D, F5, A
Zonat arkeologjike + Të gjitha objektet që kalojnë 90 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-E, F5, A



Zonë mbishtresore (akuifere) + Zonë mbishtresore (bazeni i lignitit) + Zonat arkeologjike + Të gjitha objektet që kalojnë 90 m lartësi duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-C, D, F5, A
Zonë mbishtresore (akuifere) + Zonat arkeologjike + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-C, E, A
Zonë mbishtresore (akuifere) + Zonë mbishtresore (bazeni i lignitit) + Trashëgimia arkitektonike + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-C, D, E, A
Zonat arkeologjike + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZmSh-E, A
Zonë mbishtresore (bazeni i lignitit) + Për të gjitha objektet duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZMSH7
Për të gjitha objektet duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZMSH8
Zonë mbishtresore (akuifere) + Zonë mbishtresore (bazeni i lignitit) + Për të gjitha objektet duhet të njoftohet Aeroporti + Shkallë seizmiciteti VII Rihterit	ZMSH9

5. ZONAT E DESTINUARA (PËRCAKTUARA) DHE KUSHTET ZHVILLIMORE PËRFSHIRË KUSHTET NDËRTIMORE

Definimi i zonave është zhvilluar në kuadër të një procesi i cili ka qenë transparent dhe gjithëpërfshirës. Zonat dhe kushtet janë vijimësi e qëllimeve dhe objektivave, e hartave të shfrytëzimit të planifikuar të tokës nga PZHK-ja, PZHU-ja dhe PRrU-ja, si dhe planet tjera zhvillimore sektoriale. Gjithashtu, janë marrë për bazë edhe nevojat dhe zhvillimet e rëndësishme nga gjendja ekzistuese.

Përveç tjerash, gjatë definimit të zonave dhe kushteve janë bërë edhe analiza legale, sociale, ekonomike, mjedisore dhe financiare, gjithnjë duke u mbështetur në parimet e planifikimit hapësinorë, UA për HZKom, UA për NTPH dhe vet ligjit për Planifikim Hapësinorë nr. 04/L-174 dhe ligjeve të tjera ndërlidhëse.

5.1. Zonat e Banimit me shumë njësi (ZB1, ZB2 dhe ZB3)

Gjatë procesit të zonimit është paraqite nevoja e precizimit, zgjerimit dhe ndarjes së zonave në nënzona për shkak të kushteve specifike që janë zhvilluar nga një zonë në tjetrën. Por, në tërësi, zona e banimit është ndarë në dy kategori kryesore dhe në disa nënkategori:

- Zonë banimi me një njësi – ZB1 deri ZB3, dhe
- Zonë banimi me shumë njësi – ZB4 deri ZB7.

5.1.1. Shfrytëzimet e lejuara

Në kuadër të zonave të banimit me një njësi, shfrytëzime të lejuara janë funksionet dhe aktivitetet si në vijim:

- Ndërtesat e banimit me një njësi – objektet e banimit individual, siç janë shtëpitë e veçanta, shtëpitë dyshe dhe shtëpitë në varg, si dhe shërbimet fetare, bujtinat, infrastruktura e transportit rrugorë, infrastruktura e shpërndarjes së energjisë elektrike, termike, gazit, furnizimit me ujë, kanalizimit fekal dhe atmosferik, infrastruktura e post-telekomit dhe internetit, si dhe infrastruktura tjetër në shërbim të ZB-së.

5.1.2. Shfrytëzimet e lejuara dytësore

Në kuadër të zonave të banimit me një njësi, shfrytëzime të lejuara dytësore janë funksionet dhe aktivitetet, të cilat janë në varësi të shfrytëzimeve të lejuara dhe mund të jenë pjesë përbërëse e së njëjtës parcelë me shfrytëzimet e lejuara. Shfrytëzimet e lejuara dytësore janë si në vijim:

- Hapësirat e lejuara rekreative, shërbimet kulturore, administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale, dhe shoqërore, tregtisë me pakicë, mallrave personale dhe shtëpiake, shërbimet financiare dhe të sigurimeve, shërbimet teknike profesionale dhe shkencore, shërbime të informimit dhe komunikimit, shërbime administrative dhe mbështetëse dhe shërbime arsimore.

5.1.3. Shfrytëzimet e lejuara të veçanta

Funksionet dhe aktivitetet të cilat janë në pajtueshmëri me shfrytëzimet e lejuara në kuadër të zonave të banimit me një njësi, por të cilat i nënshtrohen kushteve plotësuese dhe kërkesës për leje të veçantë për shfrytëzim janë:

- Shërbimet argëtuese, hapësirat e hapura rekreative, kampingjet, hotelet, shërbimet shëndetësore, sallonet e ondulimit, shërbimet e auto-servisimeve, infrastruktura e transportit ajror, infrastruktura e transportit ujor, infrastruktura e telekomunikacionit.

5.1.4. Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht

Funksionet dhe aktivitetet e lejuara përkohësisht në kuadër të zonave të banimit me një njësi, pas së cilës largohen plotësisht janë:

- Prodhimet bujqësore për prodhim vetjak, mbledhja e produkteve natyrore, ekstraktimet minerare sipërfaqësorë, peshkimi, gjuetia.

5.1.5. Shfrytëzimet e ndaluara

Funksionet dhe aktivitetet të cilat në mënyrë specifike janë të ndaluara në kuadër të zonave të banimit me një njësi për shkak që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në kuadër të kësaj zone janë:

- Minierat e materialeve për prodhimin e energjisë, xeheve metalike, guroret dhe seperacionet, akuakultura, gjuetia, menaxhimi i kafshëve shtegtare, prodhimi i produkteve të tekstilit, prodhimi i drurit dhe produkteve me bazë të drurit, prodhimi i produkteve të letërës, prodhimi i produkteve të koksit, vajgurit dhe karburantit bërthamor, prodhimi i produkteve kimike dhe fibrave, prodhimi i produkteve bazike dhe metaleve të fabrikuar, prodhimi i produkteve jo metalike minerale, prodhimi i produkteve prej gomës dhe plastikës, prodhimi i lëndëve të tjera të para, prodhimi i makinerive, prodhimi i automjeteve dhe pajisjeve të transportit, prodhimi i produkteve të tjera të rënda, prodhimi i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit, prodhimi i rrobave dhe lëkurës, prodhimi i pajisjeve elektrike dhe optike, prodhimi i energjisë bërthamore, prodhimi i energjisë i bazuar në lëndë të fosilizuara, biomasë, energjisë së ripërtrishme, prodhimet bujqësore komerciale – infrastrukturë bujqësore, pylltari e bazuar në rrotacion kohorë, pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme, infrastrukturë bujqësore.

Tab. 1. Kushtet zhvillimore për zonat e banimit me një njësi

Prodhim primarë					
Bujqësi	LV,N	LV,N	LV,N	1.1.2	1.1.1
Pylltari	N	N	N		
Minierë dhe gurore	N	N	N		
Akuakulturë dhe peshkim	LV,N	LV,N	LV,N	1.4.2	1.4.1
Prodhimtari parësore tjetër	N	N	N		
Prodhim dytësor					
Industri e lëndës së parë	N	N	N		
Industri e prodhimeve të rënda	N	N	N		
Industri e prodhimeve të lehta	N	N	N		
Prodhim i energjisë	N	N	N		
Prodhim tjetër dytësorë	N	N	N		
Prodhim tretësor					
Shërbim tregtar	LD,LV,N	LD,LV,N	LD,LV,N	3.1.2/3	3.1.1
Shërbim profesional financiar dhe i informacionit	LV	LV	LV	3.2.1-3.2.5	
Shërbim i komunitetit	LD,LV	LD,LV	LD,LV	3.3.1	
Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	LD,N	LD,N	LD,N		3.4.2
Shërbim tjetër	LD	LD	LD		
Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike					
Rrjetet e transportit	LD,N	LD,N	LD,N		4.1.3/4
Shërbim i logjistikës dhe magazinimit	N	N	N		
Shërbim publik	LV	LV	LV	4.3.1-4.3.4	
Banim					
Banim i përhershëm	L	L	L		
Banim me funksione të tjera në pajtueshmëri	LD	LD	LD		
Banim tjetër	LV	LV	LV	5.3	



Shfrytëzim tjetër					
Tokë kalimtare	LP	LP	LP		
Tokë e braktisur	LP	LP	LP		
Tokë natyrore e cila nuk është nën ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomik	LP	LP	LP		
Hapësirë në të cilën të gjitha shfrytëzimet janë të lejuara	LP	LP	LP		
Hapësirë pa ndonjë shfrytëzim të specifikuar apo të planifikuar	N	N	N		
Hapësirë me shfrytëzim të panjohur	N	N	N		
L-Lejuar; LD-Lejuar Dytësore; LV-Lejuar e Veçantë; LP-Lejuar e Përkohshme dhe N-Ndaluar					

Kushtet ndërtimore në zonat e banimit me një njësi janë në pajtueshmëri me nenin 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor (nr. 04/L-174) dhe duhet të jenë sipas trajtës dhe elementeve në vijim:

5.1.6. Etazhiteti

- Në ZB1 dhe ZB2, numri i etazheve të lejuara është dy, përkatësisht P+1.
- Në ZB3, numri i etazheve të lejuara është tre, përkatësisht P+2.

5.1.7. Vija rregullative

- Vija rregullative është e definuar nga profili i rrugës së planifikur publike.
- Në raste kur zbatimi i profilit të planifikuar të rrugës publike bëhet i pamundur për arsye objektive, atëherë vija rregullative përcaktohet ashtu siç është 50% i vijës rregullative të rrugës ekzistuese.
- Autoriteti përgjegjës komunal është i obliguar që fillimisht të provojë zbatimin e vijës rregullative të planifikuar përmes procedurave të shpronësimit dhe mekanizmit të bonuseve të zoonimit dhe në raste kur dëshmohet se këta mekanizma nuk mund të zbatohen për arsye objektive, atëherë mund të fillojë me zbatimin e parimit të 50% të vijës rregullative ekzistuese.
- Aty ku Komuna ka nevojë për detajime më të mëdha, atëherë me anë të Planeve Rregulluese të Hollësishme do të përcaktohen më saktësisht vijat rregulluese.

5.1.8. Vija ndërtimore

- Vija ndërtimore përgjatë rrugës publike është variable dhe sillet nga 2-8m siç është përcaktuar në pjesën hartografike të HZK-së së Fushë Kosovës
- Në raste kur zbatimi i vijës ndërtimore bëhet i pamundur për arsye objektive, atëherë vija ndërtimore përcaktohet ashtu siç është 50% e vijës ndërtimore ekzistuese.
- Autoriteti përgjegjës komunal mund edhe të aplikoj bonueset e zoonimit gjatë përpjekjeve për të zbatuar vijën ndërtimore të planifikuar.
- Aty ku Komuna ka nevojë për detajime më të mëdha, atëherë me anë të Planeve Rregulluese të Hollësishme do të përcaktohen më saktësisht vijat ndërtimore.

5.1.9. Lartësia e lejuar

- Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri i parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike është 1.5L/1GJ, ku GJ është gjerësia e rrugës publike (distanca ndërmjet dy vijave rregulluese) dhe L është lartësia e ndërtesës.
- Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri anësor dhe i pasmë i parcelës kadastrale matet si raporti ndërmjet gjatësisë nga kufiri anësor dhe i prapmë i parcelës kadastrale dhe lartësisë së ndërtesës. Ky raport nuk mund të jetë më i vogël se 0.5 L / 1 GJ dhe më i madh se 2 L / 1 GJ, ku GJ- është distanca mes ndërtesës dhe kufiri të parcelës kadastrale dhe L është lartësia e ndërtesës.
- Në ZB1 dhe ZB2, lartësia minimale është 8m, ndërsa lartësia maksimale është 9m.

- Në ZB3, lartësia minimale është 9, ndërsa lartësia maksimale është 12m.

5.1.10. *Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh)*

- Në ZB1, përqindja e sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës është 30%, ndërsa përqindja sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale është 70%.
- Në ZB2 dhe ZB3, përqindja e sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës është 40%, ndërsa përqindja sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale është 60%.
- Përqindja e sipërfaqes nëntokësore të parcelës (SNP) maksimale nuk është më shumë se 80% nga sipërfaqja e përgjithshme në prerje ortogonale e parcelës kadastrale.

5.1.11. *Indeksi i sipërfaqes së ndërtuar (ISN)*


- Në ZB1, indeksi e sipërfaqes së përgjithshme e ndërtimit brenda parcelës kadastrale të lejuar në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISN) është 0.35.
- Në ZB2 dhe ZB3, indeksi e sipërfaqes së përgjithshme e ndërtimit brenda parcelës kadastrale të lejuar në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISN) është 0.45

5.1.12. *Kërkesat minimale për vend-parkingje*

- Kërkesat minimale për vendparkigje është 2 VP/100 m², dy vendparkingje për çdo 100 m².
- Kërkesat minimale për vendparkingje për shfrytëzimet e lejuara dytësore, siç janë funksionet dhe aktivitetet si shërbimet shëndetësore, sallonet e ondulimit dhe shërbimet tregtare të konsumit të përditshëm (marketet) është 3 VP/ për lokal për sallon ondulomi, 5 VP/ për ordinancë shëndetësore dhe për markete deri në 100m².

5.1.13. *E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese*

- Ndriçimi natyror për dritaret paraqet rregullin e rrafshit imagjinar në kënd prej 45° për të siguruar ndriçim natyror dhe diellosje për strukturat ekzistuese. Rrafshi imagjinar është i projektuar për të siguruar dritë dhe ajër në nivelin e dritares më të ulët të ndërtesave të propozuara dhe ekzistuese. Ky kusht ndërtimor është i paraqitur në mënyrë figurative në figurën



Shembulli i llogaritjes së lartësisë për bazuar në këndin 45°

5.1.14. *Qasja adekuate në rrugë publike dhe infrastrukturë teknike*

- Secila shtëpi duhet të gëzojë qasje në infrastrukturë teknike dhe atë publike, duke mos penguar fqinjët, apo infrastrukturën teknike ekzistuese.
- Si pjesë e dokumentacionit për aplikim për Kushte dhe Leje ndërtimore duhet të silllet Situacioni që përmban infrastrukturën teknike ekzistuese.
- Të gjitha objektet e banimit duhet të dizajnohen dhe ndërtohen sipas standardeve që i përgjigjen nevojë të personave me aftësi të kufizuara.

5.1.15. *Kufizimet ndaj zhurmës*

- Kufizimet e depërtimit të zhurmës në mjedis të hapur dhe mjedise të mbyllura fqinje janë sipas intervaleve kohore:
- 08:00-22:00 = 45db (A), dhe
- 22:00-08:00 = 35db (A)

5.1.16. Masat për mbrojtjen e vlerave natyrore, historike dhe kulturore

Nëse brenda zonës ka zona të tilla atëherë masat për mbrojtjen e tyre janë precizuar në kuadër të ligjeve dhe udhëzimeve administrative.

5.1.17. Kërkesa tjera për rregullim të hapësirës gjatë përcaktimit të kushteve ndërtimore

Në ZB1 dhe ZB2, dendësia maksimale banesore e shprehur si numri maksimal i njësive banesore për hektar është 12 njësi banimi/ha, 12 njësi banimi par çdo hektar në zona Rurale, ndërsa në zonë urbane 50 njësi banimi për hektar, ndërkaq madhësia minimale e parcelës kadastrale për zhvillim është 800m². Kurse, gjatësia minimale e parcelës ose pjesës së përparme të parcelës në zonën rurale është 20m, maksimalja 40m, ndërsa gjatësia minimale e parcelës ose pjesës së përparme të parcelës në zonën urbane është 10m, maksimalja 20m.

Në ZB3, dendësia maksimale banesore e shprehur si numri maksimal i njësive banesore për hektar është 10 njësi banimi/ha, 10 njësi banimi par çdo hektar në zona Rurale, ndërsa në zonë urbane 50 njësi banimi për hektar, ndërkaq madhësia minimale e parcelës kadastrale për zhvillim është 1,000m². Kurse, gjatësia minimale e parcelës ose pjesës së përparme të parcelës në zonën rurale është 20m, maksimalja 40m, ndërsa gjatësia minimale e parcelës ose pjesës së përparme të parcelës në zonën urbane është 10m, maksimalja 20m.

Tek parcelat të cilat janë me sipërfaqe <200m² dhe me gjatësi lineare përgjatë rrugës publike <10m, fillimisht duhet shikohet mundësia e rritjes së sipërfaqes dhe gjatësisë lineare përgjatë rrugës përmes bashkimit me parcelën fqinje, por në raste kur kjo nuk mund të arrihet atëherë mund të ndërtohen shtëpi dyshe. Ndërsa, në raste kur kemi 2 e më tepër parcela me sipërfaqe të tilla, atëherë mund të ndërtohen edhe shtëpi në varg.

5.1.18. Formësimi arkitektonik dhe estetik

- Fasada duhet të jetë me ngjyrë të bardhë me sipërfaqe prej 80% duke mos llogaritur sipërfaqen e dritareve.
- Lejohet përdorimi i tullave të fasadës me sipërfaqe prej 20% dhe me ngjyrë të kuqe, Kornizat e dritareve nga druri ose PVC me teksturë druri, ngjyra e tjegullave të kulmeve e kuqe.
- Forma e objektit preferohet të jetë formë gjeometrike katrore.
- Forma e kulmit duhet të jetë dy ose me shumë ujor, Strehët e kulmit duhet të jenë me gjatësi deri në një metër, kjo për arsye të mbrojtjes së dritareve nga rrezet e diellit gjatë periudhës së verës dhe mbrojtjes së mureve anësore nga lagështia gjatë reshjeve atmosferike.
- Në kulme lejohet nxjerrja e baxhave me qëllim të përfitimit të ndriçimit tek nënkulmet, jo më shumë se 20% e sipërfaqes së kulmit.
- Ballkonet, loxhat dhe terasat me qëllim të mënjanimi të rrezeve të diellit në hapësirat e brendshme gjatë verës, duhet të ndërtohen mbi dritaret e vendosura në pjesën jugore, jug-lindore dhe jug-perëndimore të katit përfund duke krijuar strehë.

5.1.19. Rregullat për zhvillimin e peizazhit

- Të gjithë shiritat e gjelbër përgjatë rrugëve duke i përfshirë edhe ata që kanë karakter mbrojtës duhet të jenë me bimë – drunjë të cilët kanë aftësi dhe kapacitete për peizazhe atraktive dhe rregullatorë të mjedisit.

5.1.20. Parkingjet

- Parkingu përgjatë rrugës publike dhe parkingjet e përbashkëta të cilat i kemi shprehur si:
- Aty ku është e nevojshme përgjatë rrugës të ketë parkingje dhe ku paraqitet nevoja të ketë parkingje të përbashkëta këto duhet të punohen sipas normave të planifikimit hapësinor të specifikuar për parkingje përgjatë rrugës dhe parkingje të përbashkëta

Tab. 2. Kushtet ndërtimore për zonat e banimit me një njësi

Kushtet ndërtimore	ZB1	ZB2	ZB3
Vija Ndërtimore	2 - 8m	2 - 8m	2 - 8m
Vija rregullative	Profili i rrugës së planifikuar	Profili i rrugës së planifikuar	Profili i rrugës së planifikuar



Kushtet ndërtimore	ZB1	ZB2	ZB3
Etazhiteti	P+1	P+1	P+2
Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri i parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	1H/0.5L	1H/0.5L	1H/0.5L
Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri anësor dhe i pasëm i parcelës	1H/0.3L	1H/0.3L	1H/0.3L
Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri i pasëm i parcelës kadastrale	1H/0.3L	1H/0.3L	1H/0.3L
ISHPKZh	30%	40%	40%
% e gjelbrimit	70%	60%	60%
SNP	80%	80%	80%
ISN	0.35	0.45	0.4
Kërkesat minimale për vendparkingje	2 VP/100 m ²	2 VP/100 m ²	2 VP/100 m ²
Koeficienti minimal I përçueshmërisë termike (U-value [Ë/m ² K])	Muri 0.5	Muri 0.5	Muri 0.5
	Kulmi 0.3	Kulmi 0.3	Kulmi 0.3
	Dyshemeja 0.5	Dyshemeja 0.5	Dyshemeja 0.5
Kufizimet e ndotjes mjedisore	08:00-22:00 = 45db (A)	08:00-22:00 = 45db (A)	08:00-22:00 = 45db (A)
	22:00-08:00 = 35db (A)	22:00-08:00 = 35db (A)	22:00-08:00 = 35db (A)
Dendësia maksimale banesore	Rurale : 12 njësi banimi/ha	Rurale : 12 njësi banimi/ha	Rurale : 10 njësi banimi/ha
	Urbane : 50 njësi banimi/ha	Urbane : 50 njësi banimi/ha	Urbane : 50 njësi banimi/ha
Madhësia e parcelës kadastrale	Rurale : 8ari	Rurale : 8ari	Rurale : 10ari
	Urbane : 2ari	Urbane : 2ari	Urbane : 2ari
Gjatësia e pjesës së përparme të parcelës	Rurale 20m	Rurale 20m	Rurale 20m
	Urbane 10m	Urbane 10m	Urbane 10m
Lartësia maksimale e ndërtesave	6 deri 12m	6 deri 12m	6 deri 12m

5.2. Zonat e Banimit me shumë njësi (ZB4,ZB5,ZB6 dhe ZB7)

5.2.1. Shfrytëzimet e lejuara

Në kuadër të zonave të banimit me shumë njësi shfrytëzimet e lejuara janë funksionet dhe aktivitetet si në vijim:

Ndërtesa banimit me shumë njësi - ku në këtë lloj të objekteve bëjnë pjesë, Ndërtesat e banimit me shumë njësi të Veçanta, Ndërtesat në Varg dhe Ndërtesat Terracore.

Shërbim fetar, Bujtinë, Infrastrukturë e transportit rrugor, Infrastrukturë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike dhe elektrike, Infrastrukturë e ujësjellësit dhe ujërave të zeza.

5.2.2. Shfrytëzimet e lejuara dytësore

Në kuadër të zonave të banimit me shumë njësi shfrytëzimet e lejuara dytësore janë funksionet dhe aktivitetet, të cilat janë në varësi të shfrytëzimeve të lejuara dhe mund të jenë pjesë përbërëse e së njëjtës parcelë me shfrytëzimet e lejuara. Shfrytëzimet e lejuara dytësore janë si në vijim:

- Hapësirë e mbuluar rekreative, Shërbim kulturor, Shërbim i administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale, , Shërbim shëndetësor dhe shoqëror, Tregti me pakicë, Riparimi i automjeteve, mallrave personale dhe shtëpiake, Shërbim financiar dhe i sigurimit, Shërbim teknik profesional dhe shkencor, Shërbime të informimit dhe komunikime, Shërbim administrativ dhe mbështetës.

5.2.3. Shfrytëzimet e lejuara të veçanta

Funksionet dhe aktivitetet të cilat janë në pajtueshmëri me shfrytëzimet e lejuara në kuadër të zonave të banimit me shumë njësi, por të cilat i nënshtrohen kushteve plotësuese dhe kërkesës për leje të veçantë për shfrytëzim janë:

- Shërbim argëtues, Hapësirë e hapur rekreative, Kamping, Hotel, Infrastrukturë e transportit ajror, Infrastrukturë e transportit ujor, Infrastrukturë e telekomunikacionit.

5.2.4. Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht

Funksionet dhe aktivitetet e lejuara përkohësisht në kuadër të zonave të banimit me shumë njësi, pas së cilës largohen plotësisht janë:

- Prodhimet bujqësore për prodhim vetjak, mbledhja e produkteve natyrore, ekstraktimet minerare sipërfaqësore, peshkimi, gjuetia.

5.2.5. Shfrytëzimet e ndaluara

Funksionet dhe aktivitetet të cilat në mënyrë specifike janë të ndaluara në kuadër të zonave të banimit me shumë njësi për shkak që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në kuadër të kësaj zone janë:

- Minierat e materialeve për prodhimin e energjisë, xeheve metalike, guroret dhe seperacionet, akuakultura, gjuetia, menaxhimi i kafshëve shtegtare, prodhimi i produkteve të tekstilit, prodhimi i drurit dhe produkteve me bazë të drurit, prodhimi i produkteve të letërës, prodhimi i produkteve të koksit, vajurit dhe karburantit bërthamor, prodhimi i produkteve kimike dhe fibrave, prodhimi i produkteve bazike dhe metaleve të fabrikuar, prodhimi i produkteve jo metalike minerale, prodhimi i produkteve prej gomës dhe plastikës, prodhimi i lëndëve të tjera të para, prodhimi i makinerive, prodhimi i automjeteve dhe pajisjeve të transportit, prodhimi i produkteve të tjera të rëndësishme, prodhimi i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit, prodhimi i rrobave dhe lëkurës, prodhimi i pajisjeve elektrike dhe optike, prodhimi i energjisë bërthamore, prodhimi i energjisë i bazuar në lëndë të fozilizuara, biomasë, energji të ripërtitshme, prodhimet bujqësore komerciale – infrastrukturë bujqësore, pylltari e bazuar në rrotacion kohor, pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme, infrastrukturë bujqësore.

Tab. 3. Kushtet zhvillimore për zonat e banimit me një njësi

Lloji i funksioneve dhe aktiviteteve	Kushtet e shfrytëzimit				Hilucs3	
Hilucs2	ZB4	ZB5	ZB6	ZB7	LV	N
Prodhim primarë						
Bujqësi	N	N	N	N		
Pylltari	N	N	N	N		
Minierë dhe gurore	N	N	N	N		
Akuakulturë dhe peshkim	N	N	N	N		
Prodhimtari parësore tjetër	N	N	N	N		



Lloji i funksioneve dhe aktiviteteteve	Kushtet e shfrytëzimit				Hilucs3	
Prodhim dytësor						
Industri e lëndës së parë	N	N	N	N		
Industri e prodhimeve të rënda	N	N	N	N		
Industri e prodhimeve të lehta	N	N	N	N		
Prodhim i energjisë	N	N	N	N		
Prodhim tjetër dytësorë	N	N	N	N		
Prodhim tretësor						
Shërbim tregtar	LD,LV,N	LD,LV,N	LD,LV,N	LD,LV,N	3.1.2/3	3.1.1
Shërbim profesional financiar dhe i informacionit	LV	LV	LV	LV	3.2.1-3.2.5	
Shërbim i komunitetit	LD,LV	LD,LV	LD,LV	LD,LV	3.3.1	
Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	LD,N	LD,N	LD,N	LD,N		3.4.2
Shërbim tjetër	LD	LD	LD	LD		
Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike						
Rrjetet e transportit	LD,N	LD,N	LD,N	LD,N		4.1.3/4
Shërbim i logjistikës dhe magazinimit	N	N	N	N		
Shërbim publik	LV	LV	LV	LV	4.3.1-4.3.4	
Banim						
Banim i përhershëm	L	L	L	L		
Banim me funksione të tjera në pajtueshmëri	LD	LD	LD	LD		
Banim tjetër	N	N	N	N		
Shfrytëzim tjetër						
Tokë kalimtare	LP	LP	LP	LP		
Tokë e braktisur	LP	LP	LP	LP		
Tokë natyrore e cila nuk është nën ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomik	LP	LP	LP	LP		
Hapësirë në të cilën të gjitha shfrytëzimet janë të lejuara	LP	LP	LP	LP		
Hapësirë pa ndonjë shfrytëzim të specifikuar apo të planifikuar	N	N	N	N		
Hapësirë me shfrytëzim të panjohur	N	N	N	N		
L-Lejuar; LD-Lejuar Dytësore; LV-Lejuar e Veçantë; LP-Lejuar e Përkohshme dhe N-Ndaluar						

Kushtet ndërtimore në zonën ZB4 janë në pajtueshmëri me nenin 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor (nr. 04/L-174) dhe duhet të jenë sipas trajtës dhe elementeve në vijim:

5.2.6. Etazhiteti

- Në ZB4 numri i etazheve të lejuara është gjashtë, përkatësisht P+6.
- Në ZB5 numri i etazheve të lejuara është gjashtë dhe nënkulmi, përkatësisht P+7.
- Në ZB6 numri i etazheve të lejuara është tetë, përkatësisht P+8.
- Në ZB7 numri i etazheve të lejuara është tetë, përkatësisht P+9.

5.2.7. Vija rregullative

- Vija rregullative është e definuar nga profili i rrugës së planifikuar publike.

5.2.8. Vija ndërtimore

- Vija ndërtimore përgjatë rrugës publike është variabile dhe sillet nga 6-12m.
- Në raste kur zbatimi i vijës ndërtimore bëhet i pamundur për arsyeje objektive, atëherë vija ndërtimore përcaktohet ashtu siç është 50% e vijës ndërtimore ekzistuese.
- Autoriteti përgjegjës komunal mund edhe të aplikoj bonuset e zonimit gjatë përpjekjeve për të zbatuar vijën ndërtimore të planifikuar.

5.2.9. Lartësia e lejuar

- Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri i parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike është 1.5L/1GJ, ku GJ është gjerësia e rrugës publike (distanca ndërmjet dy vijave rregulluese) dhe L është lartësia e ndërtesës.
- Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri anësor dhe i pasmë i parcelës kadastrale matet si raporti ndërmjet gjatësisë nga kufiri anësor dhe i prapmë i parcelës kadastrale dhe lartësisë së ndërtesës. Ky raport nuk mund të jetë më i vogël se 0.5 L / 1 GJ dhe më i madh se 2 L / 1 GJ, ku GJ- është distanca mes ndërtesës dhe kufiri të parcelës kadastrale dhe L është lartësia e ndërtesës.
- Në ZB4, lartësia minimale është 22m, ndërsa lartësia maksimale është 25m.
- Në ZB5, lartësia minimale është 25m, ndërsa lartësia maksimale është 28m.
- Në ZB6, lartësia minimale është 28m, ndërsa lartësia maksimale është 31m.
- Në ZB7, lartësia minimale është 31m, ndërsa lartësia maksimale është 34m.

5.2.10. Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh)

- Në ZB4 dhe ZB5, përqindja e sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës është 44%, ndërsa përqindja sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale është 60%.
- Në ZB6, përqindja e sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës është 45%, ndërsa përqindja sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale është 55%.
- Në ZB7, përqindja e sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës është 50%, ndërsa përqindja sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale është 50%.
- Përqindja e sipërfaqes nëntokësore të parcelës (SNP) maksimale nuk është më shumë se 80% nga sipërfaqja e përgjithshme në prerje ortogonale e parcelës kadastrale në të gjitha zonat e banimit.

5.2.11. Indeksi i sipërfaqes së ndërtuar (ISN)


- Në ZB4, indeksi e sipërfaqes së përgjithshme e ndërtimit brenda parcelës kadastrale të lejuar në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale, (ISN) është 2.4.
- Në ZB5, indeksi e sipërfaqes së përgjithshme e ndërtimit brenda parcelës kadastrale të lejuar në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale, (ISN) është 2.6.
- Në ZB6, indeksi e sipërfaqes së përgjithshme e ndërtimit brenda parcelës kadastrale të lejuar në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale, (ISN) është 2.8.
- Në ZB7, indeksi e sipërfaqes së përgjithshme e ndërtimit brenda parcelës kadastrale të lejuar në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale, (ISN) është 3.0.

5.2.12. Kërkesat minimale për vendparkingje

- Kërkesat minimale për vendparkingje është 2 VP/100 m², dy vendparkingje për cdo 100 m².
- Kërkesat minimale për vendparkingje për shfrytëzimet e lejuara dytësore, siç janë funksionet dhe aktivitetet si shërbimet shëndetësore, sallonet e ondulimit dhe shërbimet tregtare të konsumit të përditshëm (marketet) është 3 VP/ për lokal për sallon ondulomi, 5 VP/ për ordinancë shëndetësore dhe për markete deri në 100m².

5.2.13. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese

- Ndriçimi natyror për dritaret paraqet rregullin e rrafshit imagjinar në kënd prej 45° për të siguruar ndriçim natyror dhe diellosje për strukturat ekzistuese. Rrafshi imagjinar është i projektuar për të siguruar dritë dhe ajër në nivelin e dritares më të ulët të ndërtesave të propozuara dhe ekzistuese. Ky kusht ndërtimor është i paraqitur në mënyrë figurative në figurën dhe vlen për të gjitha zonat e banimit me shumë njësi.



Shembulli i llogaritjes së lartësisë për bazuar në këndin 45°

5.2.14. Qasja adekuate në rrugë publike dhe infrastrukturë teknike

- Çdo ndërtesë duhet të gëzojë qasje në infrastrukturë teknike dhe atë publike, duke mos penguar fqinjët, apo infrastrukturën teknike ekzistuese.
- Si pjesë e dokumentacionit për aplikim për Kushte dhe Leje ndërtimore duhet të sjellët Situacioni që përmban infrastrukturën teknike ekzistuese.
- Të gjitha objektet e banimit duhet të dizajnohen dhe ndërtohen sipas standardeve që i përgjigjen nevojë të personave me aftësi të kufizuara.

5.2.15. Kufizimet ndaj zhurmës

- Kufizimet e depërtimit të zhurmës në mjedis të hapur dhe mjedise të mbyllura fqinje janë sipas intervaleve kohore:
- 08:00-22:00 = 45db (A), dhe
- 22:00-08:00 = 35db (A)

5.2.16. Masat për mbrojtjen e vlerave natyrore, historike dhe kulturore

Nëse brenda zonës ka zona të tilla atëherë masat për mbrojtjen e tyre janë precizuar në kuadër të ligjeve dhe udhëzimeve administrative.

5.2.17. Kërkesa tjera për rregullim të hapësirës gjatë përcaktimit të kushteve ndërtimore

- Në ZB4, dendësia maksimale banesore e shprehur si numri maksimal i njësive banesore për hektar është 80 njësi banimi/ha, ndërkaq, madhësia minimale e parcelës kadastrale për zhvillim është 1,000m². Kurse, gjatësia minimale e parcelës ose pjesës së përparme të parcelës është 25m, maksimalja 50m.
- Në ZB5, dendësia maksimale banesore e shprehur si numri maksimal i njësive banesore për hektar është 120 njësi banimi/ha, ndërkaq, madhësia minimale e parcelës kadastrale për zhvillim është 1,000m². Kurse, gjatësia minimale e parcelës ose pjesës së përparme të parcelës është 25m, maksimalja 50m.

- Në ZB6, dendësia maksimale banesore e shprehur si numri maksimal i njësive banesore për hektar është 125 njësi banimi/ha, ndërkaq, madhësia minimale e parcelës kadastrale për zhvillim është 1,500m². Kurse, gjatësia minimale e parcelës ose pjesës së përparme të parcelës është 25m, maksimalja 50m.
- Në ZB7, dendësia maksimale banesore e shprehur si numri maksimal i njësive banesore për hektar është 140 njësi banimi/ha, ndërkaq, madhësia minimale e parcelës kadastrale për zhvillim është 1,500m². Kurse, gjatësia minimale e parcelës ose pjesës së përparme të parcelës është 25m, maksimalja 100m.

5.2.18. Formësimi arkitektonik dhe estetik

- Në ZB4 dhe ZB5, fasada duhet të jetë ngjyrë e bardhë me sipërfaqe prej 80%, ndërsa në ZB6 dhe ZB7 60% duke mos llogaritur sipërfaqen e dritareve.
- Në ZB4 dhe ZB5, lejohet përdorimi i tullave të fasadës me sipërfaqe prej 20% dhe me ngjyrë të kuqe, ndërsa në ZB6 dhe ZB7 40%. Kornizat e dritareve duhet të jetë nga druri ose PVC me teksturë druri, ngjyra e tjegullave të kulmeve duhet të jetë e kuqe.
- Forma e objektit preferohet të jetë formë geometrike Katrore.
- Forma e kulmit duhet të jetë dy ose me shumë ujor, Strehët e kulmit duhet të jenë me gjatësi deri në një metër, kjo për arsye të mbrojtjes së dritareve nga rrezet e diellit gjatë periudhës së verës dhe mbrojtjes së mureve anësore nga lagështia gjatë reshjeve atmosferike.
- Në kulme lejohet nxjerja e baxhave me qëllim të përfitimit të ndriçimit tek nënkulmet, jo më shumë se 20% e sipërfaqes së kulmit.
- Ballkonet, loxhat dhe terasat me qëllim të mënjanimi të rrezeve të diellit në hapësirat e brendshme gjatë verës, duhet të ndërtohen mbi dritaret e vendosura në pjesën jugore, jug-lindore dhe jug-perëndimore të katit përfund duke krijuar strehë.
- Distanca në mes të ballkoneve ose loxhave fqinje duhet të jetë 10% e sipërfaqes totale të fasadës (STF) në të cilën projektohet ballkoni ose loxha

5.2.19. Rregullat për zhvillimin e peizazhit

- Të gjithë shiritat e gjelbër përgjatë rrugëve duke i përfshirë edhe ata që kanë karakter mbrojtës duhet të jenë me bimë – drunjë të cilët kanë aftësi dhe kapacitete për peizazhe atraktive dhe rregullatorë të mjedisit.

5.2.20. Parkingjet

- Aty ku është e nevojshme përgjatë rrugës të ketë parkingje dhe ku paraqitet nevoja të ketë parkingje të përbashkëta këto duhet të punohen sipas normave të planifikimit hapësinor të specifikuar për parkingje përgjatë rrugës dhe parkingje të përbashkëta

Tab. 4. Kushtet ndërtimore për zonat e banimit me një njësi

Kushtet ndërtimore	ZB4	ZB5	ZB6	ZB7
Funksionet dhe aktivitetet e lejuara përkohësisht në kuadër të **ZuS**, pas së cilës largohen plotësisht janë:

- Prodhim bujqësor për konsum vetjak, Mbledhje e produkteve natyrore.

5.8.5. Shfrytëzimet e ndaluara

Shfrytëzimet e ndaluara përcaktohen nga autoriteti i sigurisë dhe ushtria.

5.8.6. Kushtet Ndërtimore

Të gjitha karakteristikat lidhur me kërkesat për kushtet ndërtimore në kuadër të **ZuS**-së janë subjekt i legjislacionit dhe rregulloreve specifike të sigurisë dhe çështjeve ushtarake, dhe nuk determinohen nga ky dokument i planifikimit hapësinor.

5.9. Zonë Rekreative-Turistike (ZrT)

Zonat Rekreative-Turistike shënohen me kodin **ZrT** dhe janë kryesisht zona ku zhvillohen aktivitetet si hoteleria dhe rekreacioni, të cilat janë ndarë në tri kategori kryesore:

- ZrT1 janë parqet dhe sheshet urbane;
- ZrT2 janë fushat sportive dhe muzetë;
- ZrT3 janë sipërfaqet me gjelbërim mbrojtës.

5.9.1. Shfrytëzimet e lejuara

Në **ZrT1** dhe **ZrT2** funksione dhe aktivitete e lejuara janë:

- Hapësire e mbuluar rekreative, Hapësire e hapur rekreative, shërbime të tjera rekreative, Tregti me pakicë, Shërbim i ushqimit, infrastruktura rrugore si dhe infrastruktura ujësjellësit dhe ujërave të zeza, infrastrukturë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike dhe elektrike, Infrastrukturë e telekomunikacionit.

Në **ZrT3** funksionet dhe aktivitetet e lejuara janë:

- Infrastruktura rrugore si dhe infrastruktura ujësjellësit dhe ujërave të zeza, infrastrukturë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike dhe elektrike, Infrastrukturë e telekomunikacionit.

5.9.2. Shfrytëzimet e lejuara dytësore

Në **ZrT1** dhe **ZrT2** funksione dhe aktivitete dytësore dhe vartëse nga shfrytëzimi parësor i lejuar në zonë që mund të gjenden edhe në të njëjtën parcelë me shfrytëzimin e lejuar janë:

- Shërbimet argëtuese, shërbimet e komunitetit duke përjashtuar vetëm shërbimin fetar, shërbimet tregtare si: (tregtia me pakicë, Shërbim i ushqimit, Hotel), shërbimet profesionale financiare dhe informacionit.

Në **ZrT3** janë:

- Mbjellja e fidanëve për qëllime edukative dhe dekorative, ecje e lirë në natyrë, etj.

5.9.3. Shfrytëzimet e lejuara të veçanta

Në **ZrT1** dhe **ZrT2** funksionet dhe aktivitetet të cilat janë të lejuara me kushte plotësuese dhe me kërkesë të veçantë janë:

- Shërbim kulturor, hapësirë e mbuluar rekreative, hapësirë e hapur rekreative, infrastrukturë e transportit ajror, infrastrukturë e transportit ujor dhe infrastrukturë e telekomunikacionit.

Në **ZrT3** janë:

- Gjuetia, peshkimi dhe mbledhja e frutave natyrore, bujqësia, pylltari.

5.9.4. Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht

Funksionet dhe aktivitetet e lejuara përkohësisht në kuadër të **ZrT1**, **ZrT2** dhe **ZrT3** pas së cilës largohen plotësisht janë:

- Prodhim bujqësor për konsum vetjak, Mbledhje e produkteve natyrore, Veprimtaritë mobile turistike.

5.9.5. Shfrytëzimet e ndaluara

Në **ZrT1** dhe **ZrT2** kemi edhe shfrytëzimet e ndaluara, të cilat i kemi përcaktuar si funksione dhe aktivitete që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në zonë dhe i kemi deklaruar në mënyrë specifike si të pa lejuara, e këto janë:

- Minierë e materialeve për prodhimin e energjisë, minierë e xeheve metaleve, miniera dhe gurore tjetër, akuakulturë, gjuetia, menaxhim i kafshëve shtegtare, prodhimi i produkteve të tekstilit, prodhimi i drurit dhe produkteve me bazë të drurit, prodhimi i produkteve të letrës, prodhimi i produkteve të koksit, vajurit dhe karburantit bërthamor, prodhimi i produkteve kimike dhe fibrave, prodhimi i produkteve të metaleve bazike dhe metaleve të fabrikua, Prodhim i produkteve jo metalike minerale, prodhimi i produkteve prej gomës dhe plastikës, Prodhim i lëndëve tjera të para, prodhimi i makinerive, prodhimi i automjeteve dhe pajisjeve të transportit, prodhimi i produkteve tjera të rënda, prodhimi i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit, prodhimi i rrobave dhe lëkurës, prodhimi i pajisjeve elektrike dhe optike, prodhimi i energjisë bërthamore, prodhimi i energjisë së bazuar në fosile, prodhimi i energjisë së bazuar në biomasë, prodhimi i energjisë së ripërtëritshme, prodhimi bujqësor komercial, infrastrukturë bujqësore, pylltaria e bazuar në rotacion të shkurtër, pylltaria e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë, pylltaria e bazuar në mbulesë të vazhdueshme, infrastrukturë bujqësore.

5.9.6. Kushtet Ndërtimore

Në kuadër të ZrT-së hyjnë funksione dhe aktivitete me përmbajtje të larmishme, për të cilat kushtet ndërtimore janë specifike dhe rregullohen sipas rregulloreve specifike për normat e projektimit. Sa i përket parqeve, normat e planifikimit japin këto kushte:

- Parqet publike në kuadër të lagjes: 1.00 m²/banor;
- Parqet publike në kuadër të vendbanimit: 2.00 m²/banor;
- Brezat e gjelbër përgjatë rrugëve: 1.00 m²/banor;
- Brezat e gjelbër përgjatë rrjedhave ujore: 2.00 m²/banor.

Të gjitha aktivitetet dhe funksionet, përkatësisht çdo ndërtim në kuadër të kësaj zone duhet të dizajnohet dhe ndërtohet sipas kërkesave dhe standardeve që respektojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

5.10. Zonat e komunikacionit-transportit (ZkT)

Zona e komunikacionit dhe transportit shënohet me kodin ZkT dhe janë zona që shërbejnë për qëllime të transportit, mallrave, shërbimeve, informatave dhe udhëtarëve. Rregullat e shfrytëzimit dhe ndërtimit në kuadër të kësaj zonë rregullohen sipas legjislacionit dhe rregulloreve specifike të kësaj fushe dhe dominojnë ndaj rregullave të HZKom-it.

5.10.1. Shfrytëzimet e lejuara

Në kuadër të ZkT-së, shfrytëzimet e lejuara janë funksionet dhe aktivitetet si në vijim:

- Infrastrukturë e transportit rrugor, Infrastrukturë e transportit hekurudhor, Infrastrukturë e transportit ajror dhe të gjitha formave të tjera të transportit.

5.10.2. Shfrytëzimet e lejuara dytësore

Në kuadër të ZkT-së, shfrytëzimet e lejuara dytësore janë funksionet dhe aktivitetet, të cilat janë në varësi të shfrytëzimeve të lejuara dhe mund të jenë pjesë përbërëse e së njëjtës parcelë me shfrytëzimet e lejuara. Shfrytëzimet e lejuara dytësore janë si në vijim:

- Infrastrukturë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike, Infrastrukturë e ujësjellësit dhe ujërave të zeza-atmosferike,

5.10.3. Shfrytëzimet e lejuara të veçanta

Funksionet dhe aktivitetet të cilat janë në pajtueshmëri me shfrytëzimet e lejuara në kuadër të ZkT-së, por të cilat i nënshtrohen kushteve plotësuese dhe kërkesës për leje të veçantë për shfrytëzim janë:

- Infrastrukturë për trajtimin i mbeturinave, shërbim tregtar me shumice dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake.

5.10.4. Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht

Funksionet dhe aktivitetet e lejuara përkohësisht në kuadër të ZkT-së, pas së cilës largohen plotësisht janë:



- Prodhim bujqësor për konsum vetjak, Mbledhje e produkteve natyrore.
- Shfrytëzimet aktuale-ekzistuese.

5.10.5. *Shfrytëzimet e ndaluara*

Funksionet dhe aktivitetet të cilat në mënyrë specifike janë të ndaluara në kuadër të **ZkT**-së, për shkak që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në kuadër të kësaj zone, janë:

- Prodhim bujqësorë komerciale dhe për konsum vetjak, prodhim i produkteve të tekstilit, prodhim i produkteve të letrës, prodhim i produkteve të koksit, vajurit dhe karburantit bërthamor, prodhim i produkteve kimike dhe fibrave, prodhim i produkteve të metaleve bazike dhe metaleve të fabrikuara, prodhim i produkteve jo metalike minerale, prodhim i produkteve prej gomës dhe plastikës, prodhim i lëndëve tjera të para, prodhim i makinerive, prodhim i automjeteve dhe pajisjeve të transportit, prodhim i produkteve tjera të rënda, prodhim i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit, prodhim i rrobave dhe lëkurës, botim dhe shtyp, prodhim i pajisjeve elektrike dhe optike, prodhim i produkteve tjera të lehta, prodhim i energjisë bërthamore, prodhim i energjisë së bazuar në fosile, prodhim i energjisë së bazuar në biomasë, prodhim i energjisë së ripërtëritshme, shërbim i patundshmërisë, shërbim i akomodimit dhe ushqimit, shërbim tjera tregtar, shërbim financiar dhe i sigurimit, Shërbim teknik profesional dhe shkencor, shërbime të informimit dhe komunikime, shërbim administrative dhe mbështetës, shërbim tjetër profesional financiar dhe informacionit, shërbim i administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale, shërbim arsimor, shërbim shëndetësor dhe shoqëror, shërbim fetar, shërbim tjetër i komunitetit, banim I përhershëm, banim me funksione të tjera në pajtueshmëri, banim tjetër.

5.10.6. *Kushtet Ndërtimore*

Të gjitha karakteristikat lidhur me kërkesat për kushtet ndërtimore në kuadër të **ZkT**-së janë subjekt i legjislacionit, rregulloreve dhe eurokodeve specifike të fushës së ndërtimit dhe transportit dhe komunikacionit.

Zonat e shërbimeve elaborohen tek kërkesat për kushtet e projektimit...

5.11. **Zonë Bujqësore (Zb)**

Zona Bujqësore shënohet me kodin **Zb** dhe është kryesisht sipërfaqe e mbuluar me tokë bujqësore të kualitetit të lartë. Ky grup paraqet tokën e kualitetit më të mirë e cila ka kufizime të menaxhueshme mjedisore. Ka përdorime intensivë bujqësore apo për hortikulturë që duhet mbrojtur në mënyrë të rreptë për shfrytëzim bujqësor. Përderisa zbatohet një standard i lartë, ka gjasa që ky lloj i shfrytëzimit të tokës të shkaktoj dëme minimale mjedisore.

Këto sipërfaqe janë të përshtatshme për prodhim të drithërave, perimeve dhe lloje të tjera intensive të industrive bujqësore, varësisht nga kushtet lokale, qasja dhe parametrat e tokës.

5.11.1. *Shfrytëzimet e lejuara*

Në **Zb** funksione dhe aktivitete e lejuara janë:

- Kultivimi i drithërave (përveç orizit), i bimëve bishtajore dhe i farërave vajore, Kultivimi i perimeve, pjepave dhe shalqirit, bimëve rrënjore, tuberoze, Kultivimi i kallamsheqerit, Kultivimi i duhanit, Kultivimi i hardhive, Kultivimi në serë, Kultivimi i frutave me bërthamë dhe frutave me farë, Kultivimi i frutave të tjera pemore, shkurreve dhe arrave, Shumimi i bimëve, Kultivimi i bimëve të tjera njëvjeçare, Kultivimi i bimëve të tjera shumëvjeçare, Bletaria.

5.11.2. *Shfrytëzimet e lejuara dytësore*

Në **Zb** funksione dhe aktivitete dytësore dhe vartëse nga shfrytëzimi parësor i lejuar në zonë që mund të gjenden edhe në të njëjtën parcelë me shfrytëzimin e lejuar janë:

- Shërbimet tregtare si : Kultivimi i erëzave, bimëve aromatike, farmaceutike dhe mjekësore, Veprimtaritë ndihmëse për prodhimet bimore, Veprimtaritë e pas korjes së bimëve, pas vjeljes së pemëve.



5.11.3. *Shfrytëzimet e lejuara të veçanta*

Në **Zb** funksionet dhe aktivitetet të cilat janë të lejuara me kushte plotësuese dhe me kërkesë të veçantë janë:

Infrastruktura bujqësore, ndërtesat mbështetëse të fermave dhe objektet për grumbullimin dhe trajtimin e produkteve bujqësore, ndërtesat për ruajtje dhe konservim të mishit, kullosat, aktivitetet për nxjerrjen e pasurive nëntokësore dhe sipërfaqësore, kampingu, bujtinat, gjuetia dhe prerja e drunjëve në kuadër të zonës bujqësore ZP janë të lejuara me kushte të veçanta.

5.11.4. *Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht*

Funksionet dhe aktivitetet e lejuara përkohësisht në kuadër të **Zb**-së, pas së cilës largohen plotësisht janë:

- Prodhim bujqësor për konsum vetjak, Mbledhje e produkteve natyrore.

5.11.5. *Shfrytëzimet e ndaluara*

Në **Zb** kemi edhe shfrytëzimet e ndaluara, të cilat i kemi përcaktuar si funksione dhe aktivitete që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në zonë dhe i kemi deklaruar në mënyrë specifike si të pa lejuara, e këto janë:

- Prodhimi bujqësorë komerciale dhe për konsum vetjak, prodhim i produkteve të tekstilit, prodhim i produkteve të letrës, prodhim i produkteve të koksit, vajgurit dhe karburantit bërthamor, prodhim i produkteve kimike dhe fibrave, prodhim i produkteve të metaleve bazike dhe metaleve të fabrikuara, prodhim i produkteve jo metalike minerale, prodhim i produkteve prej gomës dhe plastikës, prodhim i lëndëve tjera të para, prodhim i makinerive, prodhim i automjeteve dhe pajisjeve të transportit, prodhim i produkteve tjera të rënda, prodhim i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit, prodhim i rrobave dhe lëkurës, botim dhe shtyp, prodhim i pajisjeve elektrike dhe optike, prodhim i produkteve tjera të lehta, prodhim i energjisë bërthamore, prodhim i energjisë së bazuar në fosile, prodhim i energjisë së bazuar në biomasë, prodhim i energjisë së ripërtëritshme, shërbim tregtar me shumice dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake, shërbim i patundshmërisë, shërbim i akomodimit dhe ushqimit, shërbim tjera tregtar, shërbim financiar dhe i sigurimit, Shërbim teknik profesional dhe shkencor, shërbime të informimit dhe komunikime, shërbim administrative dhe mbështetës, shërbim tjetër profesional financiar dhe i informacionit, shërbim i administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale, shërbim arsimor, shërbim shëndetësor dhe shoqëror, shërbim fetar, shërbim tjetër i komunitetit, banim I përhershëm, banim me funksione të tjera në pajtueshmëri, banim tjetër.

5.11.6. *Kushtet ndërtimore*

Kërkesat minimale për kushtet ndërtimore në kuadër të **Zb**-së janë:

- Dendësia e banimit është 10b/100ha;
- Madhësia minimale e parcelës për ndërtim është 0.50ha;
- ISHPKZh-ja është 70%, gjelbërim 30%;
- ISN është 1.4
- Etazhiteti është P+1;
- Lartësia minimale 7m, ndërsa maksimalja është 10m;
- Materiali ndërtimor: dru, gur, tulla, metal dhe fasada.

5.12. **Zonë Pyjore (ZP)**

Zona Pyjore shënohen me kodin **ZP** dhe është kryesisht sipërfaqe e mbuluar me pyje të larta dhe shkurre

5.12.1. *Shfrytëzimet e lejuara*

Në **ZP** funksione dhe aktivitete e lejuara janë:

- Pylltari e bazuar në rotacion të shkurtër, pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë, pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme, kultivimi pyjeve (drunjëve), bletaria, mbledhja e frutave natyrore, prerja sanitare e pyjeve.



5.12.2. *Shfrytëzimet e lejuara dytësore*

Në **ZP** funksione dhe aktivitete dytësore dhe vartëse nga shfrytëzimi parësor i lejuar në zonë që mund të gjenden edhe në të njëjtën parcelë me shfrytëzimin e lejuar janë:

- Shërbimet tregtare si : (tregtia me pakicë, Riparimi i automjeteve, mallrave personale dhe shtëpiake), shërbimet profesionale financiare dhe informacionit.

5.12.3. *Shfrytëzimet e lejuara të veçanta*

Në **ZP** funksionet dhe aktivitetet të cilat janë të lejuara me kushte plotësuese dhe me kërkesë të veçantë janë:

- Infrastruktura bujqësore, ndërtesat mbështetëse të fermave dhe objektet për grumbullimin dhe trajtimin e produkteve bujqësore, ndërtesat për ruajtje dhe konservim të mishit, kullosat, aktivitetet për nxjerrjen e pasurive nëntokësore dhe sipërfaqësore, kampingu, bujtinat, gjuetia dhe prerja e pyjeve, kultivimi dhe mbjellja e fidanëve dhe ripyllëzimi.

5.12.4. *Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht*

Funksionet dhe aktivitetet e lejuara përkohësisht në kuadër të **SU1** dhe **SU2**, pas së cilës largohen plotësisht janë:

- Prodhim bujqësor për konsum vetjak, Mbledhje e produkteve natyrore, ndërtimi i objekteve për qëllime të pylltarisë, blegtorisë dhe gjuetisë.

5.12.5. *Shfrytëzimet e ndaluara*

Në **ZP** kemi edhe shfrytëzimet e ndaluara, të cilat i kemi përcaktuar si funksione dhe aktivitete që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në zonë dhe i kemi deklaruar në mënyrë specifike si të pa lejuara, e këto janë:

- Prodhimi bujqësorë komerciale dhe për konsum vetjak, prodhim i produkteve të tekstilit, prodhim i produkteve të letrës, prodhim i produkteve të koksit, vajgurit dhe karburantit bërthamor, prodhim i produkteve kimike dhe fibrave, prodhim i produkteve të metaleve bazike dhe metaleve të fabrikuara, prodhim i produkteve jo metalike minerale, prodhim i produkteve prej gomës dhe plastikës, prodhim i lëndëve tjera të para, prodhim i makinerive, prodhim i automjeteve dhe pajisjeve të transportit, prodhim i produkteve tjera të rënda, prodhim i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit, prodhim i rrobave dhe lëkurës, botim dhe shtyp, prodhim i pajisjeve elektrike dhe optike, prodhim i produkteve tjera të lehta, prodhim i energjisë bërthamore, prodhim i energjisë së bazuar në fosile, prodhim i energjisë së bazuar në biomasë, prodhim i energjisë së ripërtëritshme, shërbim tregtar me shumice dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake, shërbim i patundshmërisë, shërbim i akomodimit dhe ushqimit, shërbim tjera tregtar, shërbim financiar dhe i sigurimit, Shërbim teknik profesional dhe shkencor, shërbime të informimit dhe komunikime, shërbim administrative dhe mbështetës, shërbim tjetër profesional financiar dhe informacionit, shërbim i administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale, shërbim arsimor, shërbim shëndetësor dhe shoqëror, shërbim fetar, shërbim tjetër i komunitetit, banim I përhershëm, banim me funksione të tjera në pajtueshmëri, banim tjetër.

5.12.6. *Kushtet Ndërtimore*

Kërkesat minimale për kushtet ndërtimore në kuadër të **ZP**-së janë:

Madhësia minimale e parcelës për ndërtim është 250m²;

- ISHPKZh-ja është 50%, gjelbërim 50%;
- ISN është 1.0
- Etazhiteti është P+1;
- Lartësia minimale 4m, ndërsa maksimalja është 7m;
- Materiali ndërtimor: dru, gur, dhe pjesërisht tulla dhe beton (themelet).

5.13. *Zonë-minierë sipërfaqësore (ZmS)*

Zona-Miniera Sipërfaqësore shënohen me kodin ZmS dhe është kryesisht sipërfaqe e mbuluar me pyje të larta dhe shkurre

5.13.1. *Shfrytëzimet e lejuara*

Në **ZmS** funksione dhe aktivitete e lejuara janë:

Minierë e materialeve për prodhimin e energjisë, Nxjerrja e gurëve, tregti me shumicë, tregti me pakicë, infrastrukturë e transportit rrugor, Infrastrukturë e transportit hekurudhor, infrastrukturë e transportit ajror, infrastrukturë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike dhe elektrike, infrastrukturë e ujësjellësit dhe ujërave të zeza.

5.13.2. *Shfrytëzimet e lejuara dytësore*

Në **ZmS** funksione dhe aktivitete dytësore dhe vartëse nga shfrytëzimi parësor i lejuar në zonë që mund të gjenden edhe në të njëjtën parcelë me shfrytëzimin e lejuar janë:

- Shërbim administrativ dhe mbështetës.

5.13.3. *Shfrytëzimet e lejuara të veçanta*

Në **ZmS** funksionet dhe aktivitetet të cilat janë të lejuara me kushte plotësuese dhe me kërkesë të veçantë janë: infrastrukturë e telekomunikacionit.

5.13.4. *Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht*

Funksionet dhe aktivitetet e lejuara përkohësisht në kuadër të **ZmS**-së, pas së cilës largohen plotësisht janë:

- Bujqësia, gjuetia dhe çdo shfrytëzim i trashëguar.

5.13.5. *Shfrytëzimet e ndaluara*

Në **ZmS** kemi edhe shfrytëzimet e ndaluara, të cilat i kemi përcaktuar si funksione dhe aktivitete që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në zonë dhe i kemi deklaruar në mënyrë specifike si të pa lejuara, e këto janë:

Në **ZmS** kemi edhe shfrytëzimet e ndaluara ,të cilat i kemi përcaktuar si funksionet dhe aktivitetet që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në zonë dhe i kemi deklaruar në mënyrë specifike si të pa lejuara,e këto janë:

Prodhimi bujqësorë komerciale dhe për konsum vetjak, prodhim i produkteve të tekstilit, prodhim i produkteve të letrës, prodhim i produkteve kimike dhe fibrave, prodhim i lëndëve tjera të para, prodhim i makinerive, prodhim i automjeteve dhe pajisjeve të transportit, prodhim i produkteve tjera të rënda, prodhim i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit, prodhim i rrobave dhe lëkurës, botim dhe shtyp, prodhim i pajisjeve elektrike dhe optike, prodhim i produkteve tjera të lehta, prodhim i energjisë bërthamore, prodhim i energjisë së bazuar në biomasë, shërbim tregtar me shumicë dhe pakicë ,shërbim i patundshmërisë, shërbim i akomodimit dhe ushqimit, shërbim tjera tregtar, Shërbim teknik profesional dhe shkencor, shërbim administrative dhe mbështetës, shërbim tjetër profesional financiar dhe informacionit, shërbim i administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale, shërbim arsimor, shërbim shëndetësor dhe shoqëror, shërbim fetar, shërbim tjetër i komunitetit, banim I përhershëm, banim me funksione të tjera në pajtueshmëri, banim tjetër.

5.13.6. *Kushtet Ndërtimore*

Kërkesat minimale për kushtet ndërtimore në kuadër të ZP-së janë:

Madhësia minimale e parcelës për ndërtim është 300m²;

- ISHPKZh-ja është 60%, gjelbërim 40%;
- ISN është 0.6
- Etazhiteti është P+0;
- Lartësia minimale 4m, ndërsa maksimalja është 7m;
- Materiali ndërtimor: dru, gur, tulla, beton dhe fasada.

5.14. Sipërfaqe Ujore (SU)

Sipërfaqet Ujore shënohen me kodin **SU** dhe janë kryesisht sipërfaqet ujore me hapje sipërfaqësore si: lumenjtë, liqenet, moçalet, kënetat, rezervuarët artificial, pishinat e mëdha, hurdhat e peshqve, pusët e hapura, tokat e lagështa dhe të ngjashme.

Sipërfaqet ujore për nga dinamika ndahen në dy kategori kryesore:

- SU1 rrjedhat ujore dhe liqenet, dhe
- SU2 moçalet dhe kënetat.

5.14.1. Shfrytëzimet e lejuara

Në **SU1** dhe **SU2** funksione dhe aktivitete e lejuara janë:

- Akuakulturë, Peshkim profesional, Infrastrukturë e transportit ujqor, Tokë ujore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik.

5.14.2. Shfrytëzimet e lejuara dytësore

Në **SU1** dhe **SU2** funksione dhe aktivitete dytësore dhe vartëse nga shfrytëzimi parësor i lejuar në zonë që mund të gjenden edhe në të njëjtën parcelë me shfrytëzimin e lejuar janë:

- Mbledhje e produkteve natyrore.

5.14.3. Shfrytëzimet e lejuara të veçanta

Në **SU1** dhe **SU2** funksionet dhe aktivitetet të cilat janë të lejuara me kushte plotësuese dhe me kërkesë të veçantë janë:

- Infrastruktura bujqësore, ndërtesat mbështetëse të fermave dhe objektet për grumbullimin dhe trajtimin e produkteve bujqësore, kampingu, bujtinat.

5.14.4. Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht

Funksionet dhe aktivitetet e lejuara përkohësisht në kuadër të **SU1** dhe **SU2**, pas së cilës largohen plotësisht janë:

- Prodhim bujqësor për konsum vetjak, Mbledhje e produkteve natyrore.

5.14.5. Shfrytëzimet e ndaluara

Në **SU1** dhe **SU2** kemi edhe shfrytëzimet e ndaluara, të cilat i kemi përcaktuar si funksione dhe aktivitete që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në zonë dhe i kemi deklaruar në mënyrë specifike si të pa lejuara, e këto janë:

- Prodhimi bujqësorë komerciale dhe për konsum vetjak, prodhim i produkteve të tekstilit, prodhim i produkteve të letrës, prodhim i produkteve të koksit, vajgurit dhe karburantit bërthamor, prodhim i produkteve kimike dhe fibrave, prodhim i produkteve të metaleve bazike dhe metaleve të fabrikuara, prodhim i produkteve jo metalike minerale, prodhim i produkteve prej gomës dhe plastikës, prodhim i lëndëve tjera të para, prodhim i makinerive, prodhim i automjeteve dhe pajisjeve të transportit, prodhim i produkteve tjera të rënda, prodhim i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit, prodhim i rrobave dhe lëkurës, botim dhe shtyp, prodhim i pajisjeve elektrike dhe optike, prodhim i produkteve tjera të lehta, prodhim i energjisë bërthamore, prodhim i energjisë së bazuar në fosile, prodhim i energjisë së bazuar në biomasë, prodhim i energjisë së ripërtëritshme, shërbim tregtar me shumice dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake, shërbim i patundshmërisë, shërbim i akomodimit dhe ushqimit, shërbim tjera tregtar, shërbim financiar dhe i sigurimit, Shërbim teknik profesional dhe shkencor, shërbime të informimit dhe komunikime, shërbim administrative dhe mbështetës, shërbim tjetër profesional financiar dhe i informacionit, shërbim i administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale, shërbim arsimor, shërbim shëndetësor dhe shoqëror, shërbim fetar, shërbim tjetër i komunitetit, banim I përhershëm, banim me funksione të tjera në pajtueshmëri, banim tjetër.

5.14.6. Kushtet Ndërtimore

- Në kuadër të SU2-së nuk lejohet asnjë lloj ndërtimi.



- Në SU1, përkatësisht në të gjitha rrjedhat ujore lejohet ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse ujore, lejohet ndërtimi i infrastrukturës rrugore, hekurudhore dhe shtigjeve të ecjes, përkatësisht lejohet ndërtimi i urave që janë pjesë përbërëse e transportit tokësor.
- Çdo ndërtim duhet të respektojë standardet mjedisore, përkatësisht kërkesat minimale për biokoridore në zonat e rrjedhave ujore ose korridoret e infrastrukturës së gjelbërt;
- Nuk lejohet shkarkimi i ujërave atmosferike të rrugëve si: autoudha, nacionale dhe regjionale në rrjedhat ujore pa i trajtuar paraprakisht, përkatësisht duhet të ndërtohen laguna ose vendosja e masave tjera të ngjashme.

5.14.7. *Zonë e Mbrojtur (ZM)*

Zona Mbrojtur shënohet me kodin **ZM** dhe është kryesisht sipërfaqe e cila ka veçori natyrore të dedikuara për mbrojtje dhe konzervim.

5.14.8. *Shfrytëzimet e lejuara*

Në **ZM** funksione dhe aktivitete e lejuara janë:

Hapësirë e hapur rekreative, infrastrukturë e transportit rrugor, infrastrukturë e transportit hekurudhor, infrastrukturë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike dhe elektrike, infrastrukturë e ujësjellësit dhe ujërave të zeza, infrastrukturë e telekomunikacionit

5.14.9. *Shfrytëzimet e lejuara të veçanta*

Në **ZM** funksionet dhe aktivitetet të cilat janë të lejuara me kushte plotësuese dhe me kërkesë të veçantë janë:

- Shërbim kulturor, shërbim argëtues, tregti me pakicë, kamping.

5.14.10. *Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht*

Funksionet dhe aktivitetet e lejuara përkohësisht në kuadër të **ZM**-së, pas së cilës largohen plotësisht janë:

Prodhim bujqësor për konsum vetjak, Mbledhje e produkteve natyrore.

5.14.11. *Shfrytëzimet e ndaluara*

Në **ZM** kemi edhe shfrytëzimet e ndaluara, të cilat i kemi përcaktuar si funksione dhe aktivitete që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në zonë dhe i kemi deklaruar në mënyrë specifike si të pa lejuara, e këto janë:

- Minierë e materialeve për prodhimin e energjisë, minierë e xeheve metaleve, miniera dhe gurore tjetër, akuakulturë, gjuetia, menaxhim i kafshëve shtegtare, prodhimi i produkteve të tekstilit, prodhimi i drurit dhe produkteve me bazë të drurit, prodhimi i produkteve të letërës, prodhimi i produkteve të koksit, vajgurit dhe karburantit bërthamor, prodhimi i produkteve kimike dhe fibrave, prodhimi i produkteve të metaleve bazike dhe metaleve të fabrikuara, Prodhim i produkteve jo metalike minerale, prodhimi i produkteve prej gomës dhe plastikës, Prodhim i lëndëve tjera të para, prodhimi i makinerive, prodhimi i automjeteve dhe pajisjeve të transportit, prodhimi i produkteve tjera të rënda, prodhimi i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit, prodhimi i rrobave dhe lëkurës, prodhimi i pajisjeve elektrike dhe optike, prodhimi i energjisë bërthamore, prodhimi i energjisë së bazuar në fosile, prodhimi i energjisë së bazuar në biomasë, prodhimi i energjisë së ripërtëritshme, prodhimi bujqësor komercial, infrastrukturë bujqësore, pylltaria e bazuar në rotacion të shkurtër, pylltaria e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë, pylltaria e bazuar në mbulesë të vazhdueshme, infrastrukture bujqësore.

5.14.12. *Kushtet Ndërtimore*

Kushtet ndërtimore në kuadër të kësaj zone janë subjekt i ligjit të natyrës, planeve për menaxhimin e zonave të mbrojtura apo planeve të tjera.

5.15. *Zonë e Mbrojtur Arkeologjike-Historike (ZmaH)*

Zona e Mbrojtur Arkeologjike-Historike shënohet me kodin **ZmaH**, të cilat kërkojnë trajtim specifik.

5.15.1. *Shfrytëzimet e lejuara*

Në **ZmaH** funksione dhe aktivitete e lejuara janë:

Shërbim kulturor, Shërbime të informimit dhe komunikime Infrastrukturrë e transportit rrugor, Infrastrukturrë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike, Infrastrukturrë e ujësjellësit dhe ujërave të zeza, Hapësire e hapur rekreative.

5.15.2. *Shfrytëzimet e lejuara dytësore*

Në **ZmaH** funksione dhe aktivitete dytësore dhe vartëse nga shfrytëzimi parësor i lejuar në zonë që mund të gjenden edhe në të njëjtën parcelë me shfrytëzimin e lejuar janë:

- Infrastrukturrë bujqësore, Prodhim bujqësor për konsum vetjak, Pylltari e bazuar në rotacion të shkurtër, Mbledhje e produkteve natyrore,

5.15.3. *Shfrytëzimet e lejuara të veçanta*

Në **ZmaH** funksionet dhe aktivitetet të cilat janë të lejuara me kushte plotësuese dhe me kërkesë të veçantë janë:

- Prodhim i produkteve të tekstilit, Prodhim i rrobave dhe lëkurës, Botim dhe shtyp, Prodhim i produkteve tjera të lehta,

5.15.4. *Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht*

Funksionet dhe aktivitetet e lejuara përkohësisht në kuadër të **ZmaH**, pas së cilës largohen plotësisht janë:

- Shërbim tregtar me shumice dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake, Shërbim i patundshmërisë, Shërbim teknik profesional dhe shkencor, Shërbim shëndetësor dhe shoqëror,

5.15.5. *Shfrytëzimet e ndaluara*

Në **ZmaH** kemi edhe shfrytëzimet e ndaluara, të cilat i kemi përcaktuar si funksione dhe aktivitete që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në zone, të cilat janë të deklaruara në mënyrë specifike si të pa lejuara, e këto janë:

- Prodhim i produkteve të letres, prodhim i produkteve të koksit, vajgurit dhe karburantit bërthamor, prodhim i produkteve kimike dhe fibrave, prodhim i produkteve të metaleve bazike dhe metaleve të fabrikuara, prodhim i produkteve jo metalike minerale, prodhim i produkteve prej gomës dhe plastikës, prodhim i lëndëve tjera të para, prodhim i makinerive, prodhim i automjeteve dhe pajisjeve të transportit, prodhim i produkteve tjera të rënda, prodhim i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit, prodhim i pajisjeve elektrike dhe optike, prodhim i energjisë bërthamore, prodhim i energjisë së bazuar në fosile, prodhim i energjisë së bazuar në biomasë, prodhim i energjisë së ripërtëritshme, shërbim i akomodimit dhe ushqimit, shërbim tjera tregtar, shërbim financiar dhe i sigurimit, shërbime të informimit dhe komunikime, shërbim administrative dhe mbështetës, shërbim tjetër profesional financiar dhe i informacionit, shërbim i administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale, shërbim arsimor, shërbim fetar, shërbim tjetër i komunitetit, banim i përhershëm, banim me funksione të tjera në pajtueshmëri, banim tjetër.

5.15.6. *Kushtet Ndërtimore*

- Kusht ndërtimore në kuadër të kësaj zone janë subjekt i rregulloreve specifike të kësaj fushe, ose planeve për menaxhimin e këtyre zonave.
- Në rast se është subjekt i Zonës Mbishtrësore (ZmSh), vlejnë kushtet e ZmSh-së dhe kushtet e zonës bazë.



6. ZONAT MBISHTRESORE DHE KUSHTET ZHVILLIMORE

Përcakton kushtet zhvillimore për sipërfaqet e përcaktuara si zona mbishtresore.

Zonat mbishtresore përcaktojnë kushte zhvillimore dhe kushte ndërtimore plotësuese brenda një sipërfaqe të veçantë të komunës që nevojitet vëmendje e veçantë.

Zonat mbishtresore vendosen mbi një apo disa zona bazë. Krahas kushteve të zonës bazë kushtet mbishtresore vendosin kushte apo masa plotësuese.

Në rastet kur janë përcaktuar kushte që janë në kundërshtim në mes të zonës bazë dhe zonës mbishtresore atëherë kushtet e zonës mbishtresore kanë përparësi ndaj atyre të zonës bazë.

Zonat mbishtresore - përdoren për vendosjen e kushteve zhvillimore më strikte, dhe masa mbrojtëse shtesë në disa hapësira specifike gjeografike, kur:

- përcaktohen masa mbrojtëse për resurset kulturore, historike, ekonomike, turistike, bujqësore të cilat nuk janë adresuar me zonën bazë;
- përcaktohen masa mbrojtëse dhe parandaluese për Sipërfaqet e Mbrojtura, Zonat e Veçanta, Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe Zonat Mbrojtëse;
- përcaktohen masa mbrojtëse për resurset lokale natyrore, si: mbrojtja e natyrës, e sipërfaqeve ujore, klimës, pyjeve, etj. të cilat nuk janë të adresuara me zonën bazë;
- përcaktohen masa mbrojtëse për ndikimet në mjedis, si: ndotja e ajrit, zhurmës, etj.;
- përcaktohen masa mbrojtëse dhe parandaluese për sipërfaqet me rrezikshmëri nga zjarri, nga përmytja, sipërfaqet sizmike, erozive, rrëshqitja e gurëve, orteqeve, tërmetet, e të tjera; dhe
- standarde të caktuara që nuk janë të nevojshme për tu zbatuar në gjithë territorin e Komunës.

Zona Mbishtresore	Kushtet plotësuese
ZmSh-A (Seizmika)	▪ Të gjitha ndërtimet (mbitokësore dhe nëntokësore) në fazën e projektimit dhe ndërtimit (materialet ndërtimore) duhet t'i nënshtrohen rregullave të EuroKodit 8; ▪ Shputa/ themelet e ndërtesave me kapacitet të lartë, përkatësisht disa nga objektet e kategorisë së dytë (II) dhe të gjitha ndërtesat e kategorisë së tretë (III) duhet t'i nënshtrohen studimeve gjeomekanike. ▪ Varësisht nga harta sizmike e Komunës së Fushë Kosovës, duhet të merren në konsideratë gjatë kalkulimeve statike sipas shkallës së Rihterit të përcaktuar për zonën për të cilën jepen kushtet plotësuese, të cilat duhet të sigurojnë stabilitetin e objektit dhe sigurinë e shfrytëzuesve. Referencat: ▪ <u>Ligji nr. 04/L-027 - për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si dhe aktet tjera nënligjore;</u> ▪ Eurokodet e aplikueshme të fushës përkatëse.
ZmSh-B (Vërshimet)	▪ Duhet të bëhen studime hidrologjike dhe duhet të krijohet harta e rrezikshmërisë nga vërshimet për periudhën e hershme ≤ 30 vjeçare, të mesme >30-100 vjeçare dhe periudhën e vonë >100-500 vjeçare; ▪ Të gjitha ndërtimet duhet të ndërtohen në atë mënyrë që themelet e tyre, përkatësisht pllaka bazë të jetë në kuotë të njëjtë me urën më të afërt të lumit më të afërt; ▪ Ndalohet ndërtimi i kapaciteteve prodhuese të ujit, përkatësisht ndërtimi i puseve dhe rezervuarëve për ujë të pijes;

	▪ Ndalohet ndërtimi i stallave të kapaciteteve >50 krerë gjedhe, impiantet për rritjen intensive të shpezëve, rritja artificiale e peshkut në hurdha; ▪ Ndalohet ndërtimi i pishinave dhe kapaciteteve hoteliere; ▪ Ndalohen veprimtaritë si: varrezat e veturave, autoserviset, industritë që kanë për bazë ose që përdorin materie të lëngshme kimike, deponimi i naftës dhe derivateve të sajë, ndërtimi i rrugëve pa sistemin e largimit dhe pastrimin e ujërave atmosferike, eksploatimi i resurseve minerare, industritë ushqimore, gropat septike, deponitë e mbeturinave dhe të gjitha instalimet për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave; ▪ Ndalohet ndërtimi i varrezave të reja dhe zgjerimi i varrezave ekzistuese; ▪ Ndalohet ndërtimi i bodrumeve, përveç rasteve specifike kur garantohet me përdorimin e masave inxhinierike shtesë, të përshkruara në mënyrë të detajuar në dokumentacionin teknik të lejes ndërtimore dhe të testuara ndërkombëtarisht; ▪ Kufizohet përdorimi i plehrave dhe pesticideve sipas rregullores së drejtoratit për bujqësi dhe zhvillim rural. Referencat: ▪ <u>Ligji nr. 04/L-027 - për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si dhe aktet tjera nënligjore;</u> ▪ <u>Ligji nr. 04/L-147 - për ujërat e kosovës, si dhe aktet tjera nënligjore.</u>
ZmSh-C (Akuiferet)	▪ Duhet të bëhen studime hidrogeologjike dhe duhet të krijohet harta e rezervave të ujërave nëntokësor; ▪ Të gjitha bodrumetë i nënshtrohen kushteve specifike të izolimit ashtu siç është e përshkruar në dokumentin obligues; ▪ Stallat dhe impiantet e rritjes intensive të shpezëve duhet të pajisen me gropa septike të izoluar që pengojnë rrjedhjen e lëndëve fekale likuide direkt në ujërat nëntokësor; ▪ Të gjitha veprimtaritë si: varrezat e veturave, autoserviset, industritë që kanë për bazë ose që përdorin materie të lëngshme kimike, deponimi i naftës dhe derivateve të sajë, ndërtimi i rrugëve pa sistemin e largimit dhe pastrimin e ujërave atmosferike, eksploatimi i resurseve minerare, industritë ushqimore, deponitë e mbeturinave dhe të gjitha instalimet për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave duhet të pajisen ose instalojnë sistem të garantuar që asnjë sasi e materieve të rrezikshme likuide nuk do të penetrojë në rezervat e ujërave nëntokësor; ▪ Kufizohet përdorimi i plehrave dhe pesticideve sipas rregullores së drejtoratit për bujqësi dhe zhvillim rural; ▪ Lejohet hapja e minierave të zhavorrit me kusht që pas mbarimit të resurseve, hapësira e caktuar të shndërrohet në sipërfaqe ujore/ zonë rekreative me përmbajtje edhe të funksioneve të banimit; ▪ Ndalohet hedhja e pakontrolluar e ujit të klorifikuar nga pishinat freskuese; ▪ Ndalohet, përveç me leje ujore, shkarkimi i masës nga hedhurinat e lëngëta industriale, bujqësore dhe ujërave të ndotura urbane si dhe vajrave të përdorura në kanalizim, në sistemin për kullim, në trupat ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore, në brigjet buzë lumit dhe tokave të lagëta. Referencat: ▪ <u>Ligji nr. 04/L-147 - për ujërat e kosovës, si dhe aktet tjera nënligjore;</u> ▪ <u>Ligji nr. 04/L-040 - për rregullimin e tokës, si dhe aktet tjera nënligjore;</u> ▪ <u>Ligji nr. 04/L-090 - për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-098 për bujqësinë dhe zhvillimin rural, si dhe aktet tjera nënligjore;</u>

	▪ <u>Ligji nr. 03/L-198 - për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/L-9 për ujitjen e tokave bujqësore, si dhe aktet tjera nënligjore;</u> ▪ <u>Ligji nr. 2003/10 - ligji për plehrat artificiale, si dhe aktet tjera nënligjore.</u>
ZmSh-D (Pasurit Minerare)	▪ Lejohet ndërtimi pa kufizime vetëm mbi resurset minerare metalike që ndodhen në thellësi të mëdha, atëherë kur shfrytëzimi i tyre nuk përbën asnjë kërcënim për strukturat ndërtimore në sipërfaqe; ▪ Ndalohet ndërtimi i të gjitha strukturave të përhershme ndërtimore dhe instalimeve permanente teknike në zonat e rezervave të linjitet të parapara në të gjitha strategjitë nacionale për shfrytëzimin e tyre afatshkurta dhe afatgjatë për nevoja të furnizimit të TC-A, TC-B dhe TC-Kosova e Re; ▪ Të gjitha ndërtimet dhe prona që shtrihen mbi rezervat minerare nacionale, kurdoherë mund të jenë subjekt i shpronësimit dhe zhvendosjes nga komuna ose qeveria e Kosovës; Referencat: ▪ <u>Ligji nr. 04/L-158 - për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-163 - për minierat dhe mineralet, si dhe aktet tjera nënligjore;</u> ▪ <u>Ligji nr. 04/L-147 - Për Ujërat e Kosovës, si dhe aktet tjera nënligjore, si dhe aktet tjera nënligjore;</u> ▪ <u>Ligji nr. 03/L-153 - për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/3 - për pyjet e kosovës, si dhe aktet tjera nënligjore;</u> ▪ <u>Ligji nr. 04/L-040 - për rregullimin e tokës, si dhe aktet tjera nënligjore, si dhe aktet tjera nënligjore;</u>
ZmSh-E (Arkeologjike)	▪ Të gjitha lejet ndërtimore duhet paraprakisht të marrin pëlqimin edhe të institutit arkeologjik të Kosovës; ▪ Në çfarëdo rrethane të zbulimit të artefakteve arkeologjike-historike apo çfarëdo lloj të mire materiale, gjësendet i takojnë Institutit Arkeologjik të Kosovës i cili duhet të njoftohet paraprakisht; ▪ Të gjitha ndërtimet, instalimet dhe prona që ndodhet në këtë zonë mund të jetë subjekt i zhvendosjes dhe shpronësimit kurdoherë që është e domosdoshme, sipas procedurave legale të Republikës së Kosovës; Referencat: ▪ <u>Ligji nr. 02/L-88 - për trashëgiminë kulturore, si dhe aktet tjera nënligjore, si dhe aktet tjera nënligjore;</u>
ZmSh-F (Aeroporti)	▪ Të gjitha kërkesat për ndërtim në kuadër të kësaj zonë duhet të marrin pëlqimin e autoritetit të aviacionit civil të republikës së Kosovës dhe administratës së aeroportit ndërkombëtar “Adem Jashari”, sipas kushteve të specifikuara për nënzonat vijuese: ▪ ZMsh-F1 – për të gjitha objektet duhet të njoftohet Aeroporti; ▪ ZMsh-F2 – të gjitha objektet që kalojnë >10m lartësi duhet të shënjohe; ▪ ZmSh-F3 – të gjitha objektet që kalojnë >15m lartësi duhet të shënjohe; ▪ ZmSh-F4 – të gjitha objektet që kalojnë >45m lartësi duhet të shënjohe; ▪ ZmSh-F5 – të gjitha objektet që kalojnë >90m lartësi duhet të shënjohe; Referencat: ▪ <u>Ligji nr. 03/L-051 - për aviacionin civil, si dhe aktet nënligjore;</u>
ZmSh-G	▪ Të gjitha kërkesat për ndërtim në kuadër të kësaj zone duhet që paraprakisht të marrin pëlqimin e MMPH/IKMN-së.



(Trashëgimia natyrore)	Referencat: ▪ <u>Ligji nr. 03/L-233 - për mbrojtjen e natyres, si dhe aktet nënligjore;</u>
------------------------	--



7. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe marr parasysh gjendjen ekzistuese planifikohet infrastruktura teknike si: kapaciteti dhe shtrirja e rrjeteve, ndërtesat përcjellëse, shiritat mbrojtës dhe pajisjet për rrjetin e ujësjellësve, kanalizimeve te ujerave te ndotura dhe drenazheve (ujerave atmosferike).

7.1. Rrjeti i ujësjellësit

Bazuar në planet zhvillimore sektoriale të hartuara si pjesë e Planit Zhvillimor Komunal, Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Rregullues Urban të Fushë Kosovës por edhe duke marr parasysh gjendjen ekzistuese të sistemit të ujësjellësit, HZK-së në udhëzimin administrativ ka parashikuar planifikimin e infrastrukturës teknike si: Kapacitetin dhe shtrirjen e rrjetit, ndërtesat përcjellëse, shiritat mbrojtës dhe pajisjet për rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit, impiantet për trajtimin e ujerave te zeza dhe drenazhimit.

7.1.1. Kapaciteti

Në planet zhvillimore sektoriale të hartuara në Fushë Kosovës Komuna ka bërë një llogaritje të analizës se shpenzimeve dhe kapacitetit te nevojshëm te ujit te pijes për banoret kësaj zone, e cila duhet jetë në harmoni me kërkesatpërfurnizimuejë tëpijes përgjitha vendbanimet e FushëKosovës për vitin 2011.

Pas analizës së shpenzimeve, nevojat për vitin 2011 (kërkesat) përujë kanë rezultuar: $Q=90.0 \text{ l/s}$

Gjithashtu janë llogaritur kapacitet e ujit për periudhën deri ne vitin 2011-2035 dhe në bazë të këtyre llogaritjeve, kërkesatpërfurnizimuejë tëpijes duke përfshire vendbanimet rurale dhe qytetineFushëKosovës janë projektuar për periudhën 25 vjeçare.

- Normat e Rritjes së popullsisë është marrë 25% ; dhe
- Periudha e projektimit 25 vite
- Norma e përdorimit $q=120 \text{ l/ditë/banor}$

Pas analizës së shpenzimeve; Nevojat (kërkesat) përujë kanë rezultuar:

$Q=133.48 \text{ litra/sec}$

Me qëllim qe te kemi një analizë të qëndrueshme ne kapacitetit e ujit ne HZK komuna ka analizuar shpenzimet për dy (2) skenar dhe sipas demografisë.

Skenari i pare (I-rë) është marrë për vitin 2018 dhe sipas normave teknike te planifikimit hapësinor me te dhënat e mëposhtme:

- Me $Q=200 \text{ l/ banor}$ dhe koeficient të jonjetrajshmerisë $K=1.5$
- Shtimi i popullatës 10% për zonën Urbane
- Shtimi i popullsisë për zonën rurale 1.6%
- Aktivitet tregtare për zonën rurale 5%
- Aktivitet tregtare për zonën urbane 30%

Analiza e hargjimit të ujitin per vitin 2018										
Yendbanimet	Nr Banoreve - 2011	Emërtimi i Përdoruesve	Numri i përdoruesve	Norma e përdori mit [l/ban/ditë]	Koeficienti ditor i jonjetrajtshmerisë kd	Koeficienti orar i jonjetrajtshmerisë ko	Prurja Maksimale ditore Q _{maxdit} [m ³ /ditë]	Prurja mesatare në sekondë Q _{mesark} [l/sek]	Prurja maksimale në sekondë Q _{maxark} [l/sek]	Sasia e nevojshme e ujit per vitin 2019; Q _{maxsek} [l/sek]
Bardh i Madh	2750	Popullsia viti 2016(banorë)	12919							13.81
Bardh i Vogël	494	Përqindja e rritjes së popullsisë [%]	10							2.51
Bresje	5536	Periodha e shfrytëzimit [vite]	7							28.06
Fushë Kosovë	12919	Popullsia viti 2046 (banorë)	25176	200.00	1.40	1.60	7050.00	81.60	130.54	169.23
Graboc i Poshtëm	1017	Familje	2583.8							5.13
Harilaç	936	Bagëti të trasha [krerë]	25	80.00	1.00	1.00	2.00	0.02	0.02	4.73
Henc	747	Bagëti të imta [krerë]	25	40.00	1.00	1.00	1.00	0.01	0.01	3.78
Kuzma	334							81.63	130.58	1.72
Lismir	758	Aktivitetet tregtare	20%					16.33	26.12	3.84
Miradi e Epërme	1424	SHUMA I						97.96	156.69	7.17
Miradi e Poshtme	1647	Humbjet e Ujit	8%					7.84	12.54	8.29
Nakaradë	1506	SHUMA TOTALE						105.80	169.23	7.58
Pamazotin	748									3.73
Sllatinë e Madhe	1839									9.25
Sllatinë e Vogël	538									3.03
Vragoli	1514									7.62
FUSHË KOSOVË	34827								Total:	279.54

Tabela 6 Analiza e shpenzimeve për vitin 2018

Pas analizës ka rezultuar se sasia e nevojshme për furnizim me ujë për banoret e Fushë-Kosovës sipas skenarit të parë (I) është: **Q=279.54/s**.

Kurse për periudhën 32 vjeçare (nga 2011-2043)

Skenari i dytë (II-te) është marrë për vitin 2043 dhe sipas normave teknike të planifikimit hapësinor me të dhënat e ngjashme:

- Me $Q=150l/banor$ dhe koeficient të jonjetrajshmerisë $K=1.5$
- Shtimi i popullatës 2.5% për zonën Urbane
- Shtimi i Popullsisë për zonën rurale 1.6%
- Aktivitet tregtare për zonën rurale 5%
- Aktivitet tregtare për zonën urbane 30%

Analiza e hargjimit të ujitin per vitin 2043										
Veendbanimet	Nr Banoreve - 2011	Emërtimi i Përdoruesve	Numbri i përdoruesve	Norma e përdori mit [l/ban/ditë]	Koeficienti ditor i jonjëttrajtskm ërisë kd	Koeficienti orar i jonjëttrajtskm ërisë ko	Prurja Maksimale ditorë Q _{maxd} [m ³ /ditë]	Prurja mesatare në sekondë Q _{med} [l/sek]	Prurja maksimale në sekondë Q _{maxs} [l/sek]	Sasia e nevojshme e ujit per vitin 2019; Q _{maxsek} [l/sek]
Bardh i Madh	2750	Popullsia viti	34827							18.08
Bardh i Vogël	494	Përqindja e rritjes së popullsisë [%]	2.5							3.28
Bresje	5596	Periodha e shfrytëzimit [vite]	32							36.74
Fushë Kosovë	12919	Popullsia viti 2046	76751	200.00	1.40	1.60	21491.00	248.74	397.97	515.81
Graboc i Poshtëm	1017	Familje	6965.4							6.71
Harilaç	936	Bagëti të trasha [krerë]	25	80.00	1.00	1.00	2.00	0.02	0.02	6.18
Henc	747	Bagëti të imta [krerë]	25	40.00	1.00	1.00	1.00	0.01	0.01	4.94
Kozmin	334							248.77	398.00	2.23
Lismir	758	Aktivitetet tregtare	20%					49.75	79.60	5.01
Miradi e Epërme	1424	SHUMA I						298.53	477.60	9.38
Miradi e Poshtme	1647	Humbjet e Ujit	8%					23.88	38.21	10.84
Nakaradë	1506	SHUMA TOTALE						322.41	515.81	9.32
Pomazotin	748									4.95
Shlatinë e Madhe	1839									12.10
Shlatinë e Vogël	538									3.96
Yragoli	1514									9.97
FUSHË KOSOVË	34827								Total:	660.10

Tabela 7 Analiza e shpenzimeve deri ne viti 2043

Pas analizës ka rezultuar se sasia e nevojshme për furnizim me ujë për banoret e Fushë-Kosovës sipas skenarit të parë (I) është: $Q=660.10/s$.

Mirëpo kapacitetet e projektuara të shpenzimeve në të ardhmen duhet reflektuar edhe në ndryshimet eventuale nga propozimi i shfrytëzimit të tokës të paraqitura ne Hartën Zonale te Komunës (HZK), dhe definimi i kushteve zhvillimore, duke saktësuar koeficientet dhe indekset e zonave dhe zonave mbishtresore, për komplet territorin e komunës dhe duke prezantuar në hartën e kapaciteteve.

Për interes të zbatimit të hartës zonale të komunës së Fushë Kosovës, duke pasur parasysh se nga planin zhvillimor Komuna kishte propozuar ne Cakun-9 e cila e trajton pjesën ujësjellësit ka propozuar **Përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit dhe shtimin e kapaciteteve prodhuese te ujit, dhe rrjetet e reja**, ku duhet merret për bazë shtrirja hapësinore e zonave dhe kapacitetet apo nevojat e ujit te cilat duhet reflektojnë në kapacitetet e nevojshme për furnizim të zonave specifike sipas emërtimeve, kodeve dhe kapaciteteve të prezantuara në Hartën Zonale, siç është paraqitur me zona në hartën zonale dhe me vëllimet për çdo zonë duke e marr në konsideratë edhe kapacitetet transite.

7.1.2. Planifikimet e reja

Komuna ne HZK sipas Cakut-9 ne planifikimet e reja gjate përcaktimit te prurjeve llogaritëse të ujit për shtimin e kapacitetit te ujit (ne pjesën urbane, rurale dhe industriale) duhet të merre baze përdoruesit e ujit për të gjitha kategoritë e përdorimit të ujit sipas normave teknike te planifikimit hapësinor.

Me te qellim te ruajtjes se ujit te pijes dhe rritjes se kapaciteteve te ujit brenda zonës - Komunës, Komuna e Fushë-Kosovës ne planifikimet e reja (tok ara e shfrytëzuara për ndërtim) do te caktoj kushtet e reja zhvillimore te ndërtimit te rezervuarët grumbullues për ujë atmosferik (Ujë teknik).

Uji i grumbulluar përmes pullazeve (çative) te ndërtesave do te dërgohet ne rezervuarin e ndërtuar brenda parcelës ndërtuese i cili pastaj do shfrytëzohet për nevoja te ndryshme te qytetit si: ujitjen e parqeve, larjen e rrugëve, trotuareve, shuarjen e zjarreve apo nevojave tjera.

7.1.3. Masat mbrojtëse te burimeve

Me qëllim të mbrojtjes nga ndotja e qëllimshëm apo aksidentale dhe ndikimet e tjera të cilat mund të ndikojnë negativisht në qëndrueshmërinë e burimit dhe përbërjen natyrore të ujit në burim e të gjitha hapësirave në të cilat ndodhen burimet ujore që shfrytëzohen nga sistemi i qytetit për furnizim me ujë dhe burimeve që nuk shfrytëzohen.

Për të arritur objektivat për ujë të pijshëm dhe te sigurt për të gjitha burimet e ujerave Komuna do të ndërmerë gjitha masat mbrojtjes sipas dispozitave dhe ligjeve ne fuqi për mbrojtjes ujerave sanitare.

Me qëllim të mbrojtjes se burimeve të ujerave në komunën e Fushë Kosovës përcaktohen zonat e mbrojtura ujore, të cilat ndahen në:

1. Zona e mbrojtjes - së regjimit të rreptë (në tekstin e mëtejme Zona I), e cila ka për qëllim të siguroj mbrojtjen e burimit të ujit dhe ndërtesave me instalime për marrjen e ujit si dhe të mbrojtje burimin nga shkarkimet e ndotësve që mund të ndikojnë drejtpërdrejt në ujë nga aktivitetet e njeriut;
2. Zona e mbrojtjes e regjimit të kufizuar (në tekstin e mëtejme Zona II), e cila ka për qëllim të sigurojë mbrojtjen e burimit të ujit nga lëvizjet e ndotësve mikrobiologjik, kimik dhe llojeve të tjera të ndotësve;
3. Zona e mbrojtjes së regjimit të lehtë (në tekstin e mëtejme Zona III), e cila ka për qëllim të siguroj mbrojtjen parandaluese për pellgun përkatës të burimit të ujit dhe të rris efikasitetin e mbrojtjes nga ndotja kimike dhe radioaktive.

Ne figurën e me poshtme janë paraqitur burimet dhe zonat e mbrojtura te tyre sipas Udhëzimit Administrativ për normat e planifikimit hapësinor ku:

Zona e parë (I) $\geq 10m$ -Ngjyra e kuqe

Zona e dytë (II) ≥ 50 - Ngjyra e verdhë

Zona e tretë (III) ≥ 500 - Ngjyra e Gjelbër




Figura 7 Skema e mbrojtjes se burimeve te ujit/Referencë-UA për mbrojtjen e ujerave sanitare-INSI 2018

7.1.4. Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit

Në planin zhvillimor komunal (PZHK) është trajtuar në disa pjesë shtrirja e rrjetit të ujësjellësit dhe vlen të theksohet se në fushën e Zhvillimit **Infrastrukturor** konkretisht në **Cakun 9 - I** është dhënë prioritet **përmirësimit të rrjetit të ujësjellësit**;

Sipas gjendjen ekzistuese burimet kryesore të furnizimit me ujë në territorin e Fushë Kosovës si ne pjesën Urbane ashtu edhe atë Rurale janë pusët e njohura me emrin **Pusët e "Kronit" në Kuzmin** dhe pusët në **Vragoli**. Një pus ne **Miradi të Poshtme**, që menaxhohet nga KUR "Prishtina", dy (2) burime tjera menaxhohen (operohen) nga komunitetet lokale **Henci, Halilaqi**, të cilat janë specifikuar në tabelë:

Burimi	Lloji i burimit	Kapaciteti (l/s)	Prodhiimi 2009 (m3)	Menaxhimi
Kroni-Kuzmin	12 puse	150	2918.508	KRU Prishtina
Vragoli	6 puse	60	Fillon në shtator 2011	KRU Prishtina
Henc	1 pus	5	Nuk ka të dhëna	Komuniteti Lokal
Miradi e ulët	1 pus	20	Fillimi i punës në Qershor 2011	KUR
Kroni i Spahisë Halilaq	1 pus	5	Nuk ka të dhëna	KRU Prishtina

Tabela 8 Specifikimi i Burimeve të ujit/Referencë PZHK-Fushë-Kosovë

Gjithashtu në komunën e Fushë Kosovës ekzistojnë **tre (3)** sisteme të ndryshme për furnizim me ujë:

- Zona urbane e komunës së Fushë Kosovës dhe vendbanimet, siç janë: Miradi e Poshtme, Nakarada, Kuzmini, Vragoli, Miradi e Epërme, Lismir dhe Pomozotin, Bardh i Madh (Rezervuari V=350m³ i lëshuar në funksion në gusht 2011) dhe Bardh i Vogël janë të kyçura në sistemin për furnizim me ujë të pijshëm të menaxhuar nga Kompania Rajonale e Ujit "KRU-Prishtina";
- Fshatrat, Sllatinë e Madhe, Sllatinë e Vogël, do të furnizohen nga FPU (Fabrika për përpunimin e ujit në VRAGOLI) pas kalimit në menaxhim nga Kompania Rajonale e Ujit "Prishtina";
- Fshatrat Henc dhe Harilaq kanë sistemin e tyre për furnizim me ujë e që menaxhohen nga komuniteti lokal, dhe nuk ka të dhëna të detajuara për këto rrjeta.

Totali i popullsisë së komunës	43200	
	Popullata e kyqyr në rrjetin e ujësjellësit	Menaxhohet
Sistemet e KUR Prishtina	37805	KUR Prishtina
Sistemi Harilaq	825	Komuniteti lokal
Sistemi Henc	864	Komuniteti lokal
Totali i popullsisë së kyqyr në furnizim publik me ujë	39464	91%

Tabela 9 Mbulueshmeria (kyqja) e popullsisë me rrjetë të ujësjellësit/Referencë-PZHK-Fushë Kosovë

Nga tabela e mësipërme e mbulueshmerisë rezulton se mbulueshmeria e furnizimit me ujë në Fushë-Kosovë është mbi 90%, por ka rrjeta të cilat janë të vjetërsuar në të cilat duhet intervenuar në përmirësimin e tij.


Nga Studimi i Fisibilitetit për Kualitetin e Ujit të Pijshëm në Kosovë, Hydroplan GmbH, 2009, gjatësia e rrjetit të ujësjellësit për furnizim me ujë dhe të cilat janë të menaxhuar nga KUR "Prishtina" në komunën e Fushë Kosovës janë: **L=100,291 m**. Prej të cilave, 86,938 metra janë ndërtuar para vitit 1999 dhe 13,353 metra janë ndërtuar pas vitit 1999. Kjo tregon se përafërsisht 87% e rrjetit është ndërtuar para vitit 1999.

Në vitet e fundit ne Fushë Kosovë (2013-2015) Komuna dhe Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina kane investuar mjaft ku janë shtruar gjatësi të mëdha të rrjetit të ujësjellësit dhe atë ne shumë pjesë të qytetit dhe ne disa vendbanime rurale të mëdha (kryesore) dhe ku janë përdorur materiale me standarde të larta si **-HDPE , PE-100-RC**, materiale të cilat janë shumë të përshtatshme për sisteme të ujësjellësve për ujë të pijes.

Ne planin zhvillimor komunale tek **Strategjia 9**: Komuna ka parapare dhe ka venë ne fokus përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit dhe shtimin i kapaciteteve prodhuese të ujit e cila është prezantuar edhe në **Planin 9-1** te veprimt tek i njëjtit dokument.

Duke u mbështetur ne Strategjinë e mësipërme dhe duke e marrë bazë Udhëzimin Administrativ për HZK-Komuna do të përcaktojë:

- Shtrirjen e rrjetit të ri sipas shfrytëzimit të tokës ne zona rurale dhe urbane;
- Përmirësimet e rrjetit të vjetër të ujësjellësit të paraparë ne PZHK
- Kalkulimet hidraulike të përafërta të diametrave të gypave ne pjesë të caktuar të zonave urbane dhe rurale duke i marre për baze edhe destinimet e caktuara të shfrytëzimit të tokës;
- Vendndodhjen e rezervuarëve të rinj ne vendbanimet rurale dhe urbane.



Harta 9 Skema e Shtrirjes se rrjetës së ujësjellësit Fushë Kosovë dhe vendbanimet rurale (fshatra)/ Referencë-INSI 2018

Te gjitha këto do te behën sipas kushteve të zhvillimit të projekteve dhe ndërtimit për infrastrukturën teknik të ujësjellësit.

Në koordinim me kompaninë rajonale të ujësjellësit Komuna do të beje plani për shtimin e kapaciteteve prodhuese të ujit duke shfrytëzuar burimet lokale por edhe në kontekst rajonal.

-Pas hartimit të Hartës Zonale të komunës së Fushë Kosovës çdo shtrirje e rrjetit qoftë në funksion të përmbushjes së **Cakut 9** – ku theksohet qëllimi i përmirësimit të rrjetit të ujësjellësit dhe shtimit të kapaciteteve prodhuese të ujit qoftë për furnizimin me ujë të hapësirave të reja, qoftë në planifikimin e rezervuarëve të rinj, duhet bëhet duke u bazuar në një **projekt ideor** dhe **projektkryesor** duhet të përgatitet nga komuna dhe kompania Rajonale e Ujit “Prishtina” dhe aktet tjerë të rëndësishëm (qytetarët, bizneset, OJQ dhe hisedarët e tjerë të zonës për të cilën kryhet projekti) dhe gjitha detyrat projektuese apo kushtet e zhvillimit të projekti dhe zbatimit të tij do të jepen në dokument për kushtet e zhvillimore të projektit dhe zbatimit.

-Shtrirja e rrjeteve të cilat do të planifikohen apo riparohen do të bëhet sipas normave të planifikimit hapësinor, ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi dhe kodit të ndërtimit, vetëm në raste ku nuk lejohet mundësitë në terren të aplikohet një rregull i tillë, apo bien ndesh me rregulla tjera të ndërtimit dhe në rastet kur zgjidhja inxhinierike ose edhe aspekti ekonomik, financiar e mjedisorë e favorizojnë një zgjidhje më të qëndrueshme në segmente të caktuara të zonës.

Shtrirja e rrjeteve brenda projektit duhet të bëhet në harmoni me kushtet për përzgjedhjen e lokacionit të cilat janë të specifikuar të kushtet zhvillimore për projektin.

7.1.5. Ndërtesat përcjellëse-ujësjellës

Objektet përcjellëse të ujësjellësit përfshijnë:

- Rezervuarët,
- Stacioni i pompave,
- Stacioni i Klorifikimit,
- Fabrikat për përpunimin e ujit dhe
- Rezervuarët në formë kulle

Rezervuarët janë objekte në të cilat akumulohet uji që të barazojë prurjen e ujit dhe shpenzueshmërisë në jo të njëtrajtshme të ujit të cilët gjatë ditës janë të ndryshueshme. Rezervuarët kanë rolin edhe të ruajnë ujin për shuarjen e zjarrit dhe të mirëmbajnë shtypjen në rrjetin e ujësjellësit.

7.1.6. Kushtet gjatë përzgjedhjes së lokacionit të rezervuarëve

Gjatë zgjedhjes së lokacionit për rezervuarin duhet të veprohet sipas kushteve si më poshtë:

- rezervuari të gjendet më poshtë se kaptazhi që të mundësohet rrjedhja gravitacione e ujit;
- kaptazhi dhe rezervuari sipas mundësisë duhet të lidhet me gypin prurës të shkurtë;
- në raport të konsumatorit, rezervuari duhet të ndërtohet mjaftueshëm lartë që të mundësojë rrjedhje të ujit edhe deri te vendet më të larta të konsumatorëve;
- që të ketë ekonomizim, gypin prurës ndërmjet rezervuarit dhe konsumatorit duhet të jetë sa më i shkurtë.

Në varësi nga konfiguracioni i terrenit dhe vendi pozitës së burimit të ujit në raport të vendit të shpenzimit (me shpesh vendbanim), rezervuari mundet të jetë i vendosur në vend pozitë të ndryshme.

7.1.7. Vëllimi i rezervuarëve

Vëllimi i rezervuarëve caktohet sipas mënyrës në të cilën uji derdhet në ta. Te sistemet me gravitacione ku rezervuari ka rolin e rregulluesit të rrjedhjes, volumi është përafërsisht 1/3 nga shpenzueshmëria maksimale ditore e ujit. Gjatë krijimit artificial të shtypjes në rrjet, vëllimi i rezervuarit caktohet në varësi nga orët e punës të pompave gjatë ditës dhe shpenzueshmërisë maksimale ditore të ujit.

Shpeshherë në rezervuarët e këtyllë ka lundruar të lidhur me mbyllës, dhe menjëherë pasi që do të arrihet niveli maksimal i ujit, në mënyrë automatike ndërpritet prurja e ujit me mbyllje të mbyllësit. Vëllimi i



rezervuarit për barazim caktohet nga linjat mbledhëse të rrjedhjes së ujit dhe shpenzueshmëri ditore të ujit. Këto madhësi krahasohen prej orës në orë që të caktohet shmangia me të madhe. Prodhimi nga kjo shmangie dhe shpenzueshmëria maksimale ditore e ujit e jep volumin e rezervuarit. Për nevojat për shuarjen e zjarrit në rezervuarët duhet për herë të ruhet sasi e nevojshme ujore.

-Rezervuarët, -Stacioni i pompave, -Stacioni i Klorifikimit, Fabrikat për përpunimin e ujit dhe Rezervuarët në formë kulle do të përcaktohen nga projektuesi dhe duhet të jete në vend lokacionin me të përshtatshëm, materialet të cilat përdoren duhet të jenë sipas normave dhe standardeve në fuqi.

-Kapatazhat-Janë ndërtesa specifike për të cilat duhet kushtuar rendësi gjatë projektimit e sidomos gjatë implementimit të tyre.

Edhe për këto objekte duhet të përdoren materiale me standarde dhe kualitet sipas normave aktuale në fuqi.

7.1.8. *Pajisjet përcjellëse ujës-jellësi*

Në pajisjet përcjellëse përfshihen:

- Pompat
- Hidrantët
- Ujëmatëset Zonal dhe elemente tjera fazonërike

Pompat

Vend lokacioni i pompave (stacioni i pompave) duhet të jete në vende me të përshtatshme dhe sipas normave dhe standardeve për pajisje të tilla. Për llogaritje duhet shfrytëzuar normat e lejuara sipas DIN-it, EC dhe dispozitave ligjore në fuqi.

Hidrantët

Në kuadër të shpërndarjes së gypave, duhet planifikuar edhe instalimi i hidrantëve kundër zjarrit. Hidrantët duhet të vendosen në pjesët ku diametrat e gypave janë $> \varnothing 90\text{mm}$ dhe në pjesët më të përshtatshme ku mundësia e qasjes së makinave për transportimin e ujit është më e lehtë, do të vendosen në distanca nga 330 në pjesët me të ndjeshme dhe deri 1000m në pjesët me të lehta.

Ujëmatësat zonal

Gjatë hartimit të projekteve kryesor duhet të parashihen edhe vendosja e ujëmatësve zonal për çdo vendbanim apo zone të caktuara brenda zone urbane (Ujëmatës digjital) dhe duhet të paraqitet (apo punohen) me kujdes detalet e pusëve të ujëmatësve ku duhet të respektohen kushtet që para ujëmatësit të vendoset valvule jekthyese në drejtimin e kundërt të rrjedhjes në mënyrë që të pengohet kthimi i ujit në raste të ndërprerjes së rrjetit, grumbulluesi i mbeturinave, para ujëmatësit të vendoset FF me gjatësi **5d-10d** (diametri) dhe pas ujëmatësit me gjatësi **3d-5d** (diametri).




Figura 8 Detali i Ujëmatis Zonal me standard

Pjesët Fazonerike

Te gjitha pjesët fazonerike luajnë rolë të rëndësishëm ne sistemet e furnizimit me ujë, secila nga to ka rolin dhe specifiken e tyre ne vete, shfrytëzohen për kalimin prej gypave në pjesë të veçantë, gjatë ndryshimit të diametrit të gypave, atje ku gypi mbaron, ku gypi degëzohet, gjatë ndryshimit të drejtimit, ndryshimit të mënyrës së lidhjes etj.

Andaj gjate projektimit hartuesi i projektit duhet t'i kushtoj një rendësi te veçantë dhe duhet të jete i kujdesshëm edhe ne specifikimin e tyre ne projekt. Te gjitha pjesët fazonerike para montimit duhet t'i kenë ateistet ISO 9001 te prodhuesit.

7.1.9. Normat e Projektimit

Për përcaktimin e prurjeve llogaritëse të ujit për një qytet apo për një qendër banimi duhet te merren parasysh përdoruesit e ujit për te gjitha kategoritë e përdorimit te ujit d.m.th.:

- Për plotësimin e nevojat ekonomike-pirje (komunale) të popullsisë (duke përfshirë edhe nevojat e ujitjes se rrugës, shesheve, lulishteve etj.
- Për nevoja Teknologjike si Prodhimeve Industriale/ Komerciale, Prodhimit te energjisë elektrike dhe bujqësisë dhe ndërtim.
- Nevoja jo-konsumuese – rekreacion/ Ujë për mirëmbajtje të hapësirave publike.
- Për nevoja të shuarjes së zjarrit
- Për nevoja Institucionale –komunale etj.

7.1.10. Normat dhe kushte për hartimin e projekteve të ujësjellësve

Normat e Përdorimit

Bazë për llogaritjen e sasisë meritore të ujërave sanitare duhet të jetë norma e harxhimit të ujit për njësi të shfrytëzuesit. Për llogaritje duhet shfrytëzuar normat e lejuara sipas DIN-it, EC dhe dispozitave ligjore në fuqi. Norma e harxhimit për banorë dhe koeficientet e jonëtrajtshmerisë ditore do të paraqiten ne forma tabelore.



Nr	Emërtimi	Njësia e matjes	Norma	Kapaciteti jonjëtrajtshmerisë	i
1	Për vendbanime $\geq$ 100.000 banorë	L/ banorë	≥ 300 l/banorë	1, 7-1, 65	
2	Për vendbanime $\geq$ 50.000-100.000 banorë	L/ banorë	$\geq 250-300$ l/banorë	1, 6-1, 5	
3	Për vendbanime $\geq$ 20.000-50.000 banorë	L/ banorë	$\geq 200-250$ l/ banorë	1, 45-1, 4	
4	Për vendbanime $\geq$ 5000-20.000 banorë	L/ banorë	$\geq 150-200$ l/banorë	1, 4	
5	Për vendbanime < 5000 banorë	L/ banorë	$\geq 100-150$ l/banorë	2	

Tabela 10 Normat për nevoja familjare dhe publike

Nr.	Emërtimi	Njësia	Norma L/ ditë	Koeficienti Ko
	a. Sektori i shëndetësisë	për 1		
I.	Spital rural	shtrat	150	25
2.	Spital i përgjithshëm	"	300	25
3.	Spital pediatrie	"	400	25
4.	Spital infektiv, sanatorium	"	400	25
5.	Maternitet	"	400	25
6.	Poliklinike	për një vizitor	10	1
7.	Klinike dentare (për te gjitha nevojat).	për 1 vend(8ore)	260	1
8.	Çerdhe fëmijësh	për çdo fëmije	75	3
9.	Farmaci (për te gjitha nevojat)	për 1 punonjës	60	1

Tabela 11 Normat e përdorimit të ujit për sektorë të ndryshëm

Nr.	Emërtimi	Njësia se cilës i përket norma	Norma në litra	Koeficienti Jonjëtrajtshmeris Ko	i
1.	Për punonjës në ndërmarrje e institucione (përfshire pastrimin e ambienteve).	për një punonjës	10	15	
2.	Për punonjës në reparte me temperature të lartë (me shume se 20 K/kal m3 në ore).	" "	35	25	
3.	Për punonjës në ndërmarrje të ndryshme prodhimi, duke përfshire ndërtimin.	" "	25-35	3	
4.	Larja në dushe e punonjësve.	1 larje	40	1	
5.	Larje në dushe për punonjës të ndërmarrjeve me ndotje të madhe.	" "	60	1	



6..	Lavanderi të mekanizuara	1 kg tesha të thata	60	1
7.	WC publike për 8 ore	1 kabinë	350	1
8.	Pisoarë ne WC publike me rrjedhje të vazhdueshme në ore.	1 pisoarë	40	I
9.	Çezma publike me rubinete automatike, ne dite.	1 çezme	3000	1
10	Rrojtore.	1 vend (karrige)	40	1

Tabela 12 Normat për nevojat komunale ne ndërmarrjet e prodhimit

Uji për shfrytëzim për nevoja jo-konsumuese-rekreacion/ ujë për mirëmbajtje te hapësirave publike:
Sipërfaqe të gjelbëruar, rrugët dhe sheshet. 1.50 l/m²

Përcaktimi i Numrit të Banorëve

$N_0 = N (1 + 0,01p)^n$, ku:

- N_0 -Numri i banorëve pas n vjetësh
- N- Numri I banoreve ne kohen e projektimit
- p-Rritja natyrale e popullatës në përqindje (%)
- n-Numri I viteve për periudhën llogaritëse

Prurja e ujit për nevoja ekonomike-pirje të popullatës

$$Q_{\max. \text{ dit}} = \frac{N \times n}{1000} \text{ m}^3/\text{ditë}$$

Ku:

- N- Numri I banorëve të qëndresës së projektuar (Duke e mbajtur parasysh edhe perspektivën)
- n-Norma maksimale e përdorimit të ujit në litra në ditë për një banor.
- Prurja mesatare orare në ditën me përdorim me te madhe përcaktohet

$$Q_{\max. \text{ orare}} = \frac{Q_{\max. \text{ dite}}}{24} \text{ m}^3/\text{orë}$$

Prurja maksimale orare po për këtë dite përcaktohet:

$$Q_{\max. \text{ orare}} = Q_{\text{mes. orare}} \times K \times \frac{N \times n \times K}{1000 \times 24} \text{ m}^3/\text{orë}$$

Ku K- është koeficienti i përdorimit jot të njëtrajtshëm (merret nga tabela 1)

Prurja maksimale për sekondë gjendet:

$$Q_{\max. \text{ sek}} = \frac{Q_{\max. \text{ orare}}}{3,6} = \frac{N \times n \times K}{24 \times 3600} \text{ l/s}$$

Prurja e ujit për ujitjen e shesheve

Përcaktimi i prurjes së shesheve është i ngjashëm me përjashtim të N merret F- Sipërfaqja që i nënshtrohet ujitjes ne m², në vend të n dhe k vetëm n₁ dhe k₁ qe janë norma për ujitjen e 1 me 2 sipërfaqe, dhe koeficienti i jonjetrajshmerise për ujitje.

Prurja e ujit për nevoja teknologjike

- $Q_{\max. \text{ dite}} = P \times n_2 \text{ m}^3/\text{ditë}$



- P-Prodhimi ditor I ndërmarrjes, sipas njësisë matëse te punuar (në ton, m³ etj).
- n₂-Norma e përdorimit të ujit në m³ për njësinë e produktit.

Përcaktimi i prurjes maksimale orare

$$Q_{\text{maks. orare}} = \frac{Q_{\text{maks.ditore}}}{T} \text{ m}^3/\text{orë}$$

T- është kohëzgjatja në orë e punës së ndërmarrjes gjatë ditës.

Përcaktimi i prurjes maksimale në sekondë

$$q_{\text{maks. orare}} = \frac{Q_{\text{maks.ditore}}}{T \times 3,6} \text{ l/s}$$

Infrastruktura e Ujësllësit përbëhet nga:

- Burimet e ujit duke përfshirë Burimet Sipërfaqësore dhe Nëntokësore.
- Objektet e Kaptimit (kaptazhat).
- Rjeti shpërndarës duke përfshirë:
 - Rjetin primar
 - Rjetin sekondar
 - Rjetin e kycjeve shtëpiake (terciar)
- Objektet përcjellëse duke përfshirë:
 - Rezervuar
 - Fabrika për përpunimin e ujit
 - Kulla
 - Stacionet e pompimit dhe
 - Stacioni i Klorifikimit

Kushtet për përzgjedhjen e Lokacionit

Infrastruktura e ujësllësit, duhet të planifikohet në lokacione si në vijim:

- 2.0m nga vija ndërtimore, në rrugët me gjerësi 7.0m dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1.50m.
- 1.50m nga vija ndërtimore, në rrugë me gjerësi 6.0m dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1.0m.
- Trasohet në kuadër të njërit shteg për këmbësor përgjatë rrugës, në rrugët me gjerësi 5.0m dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1.0m.

Pranimi i burimeve-Kaptimi i burimit

Projektimi dhe ndërtimi i kaptazheve është mbi bazën e studimeve vëllimore paraprake. Përcaktohet origjina dhe sasia ujore e burimit. Studiohen thellësia dhe karakteri i shtresave gjeologjike.

Kaptimi i burimit duhet të siguroj veti të pandryshueshme, sasi dhe nivel të ujit prej para kaptimit.

Gjatë zmadhimit më të vogël të nivelit të ujit mbi maksimalen e caktuar, vjen deri te humbja e ujit dhe zvogëlim i kursimit. Për këtë arsye burimi duhet të përfshihet tërësisht në shtratin gjeologjik.

Rrethina më e afërt dhe më e gjerë e burimit duhet në mënyrë rigorozë sanitare të mbrohen. Gropa e themelit për kaptazhën pastrohet nga fundërrinat e shkëmbinjve të grimcuar.

Themelet vendosen në shkëmb të shëndosh ose shtresës që nuk e lëshon ujin.

Kaptazhet ndërtohen prej gurit, betonit dhe betonit të armuar. Të njëjtat duhet plotësisht ta mbrojnë ujin nga ndryshimet e temperaturës dhe ndotjes. Në varësi nga lloji i burimit ndërtohet dhe konstruksioni përkatës i kaptazhit.

Cilësia e ujit

Përmirësimi i cilësisë së ujit Ekzaminimet e resurseve ujore, si burime të mundshme për furnizim me ujë, tregojnë përbërje të ndryshme dhe cilësi, kurse standardet për sistemet e caktuara për furnizim me ujë dallohen. Për këtë arsye resurset ujore duhet të përshtaten standardeve të nevojshme fizike, kimike dhe bakteriologjike – biologjike. Kjo arrihet në objektet për pastrim të ujit.

7.2. Rrjeti i kanalizimit

Bazuar në planet zhvillimore sektoriale të hartuara si pjesë e Planit Zhvillimorë Komunal, Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Rregullues Urban të Fushë Kosovës por edhe duke marr parasysh gjendjen ekzistuese të sistemit të kanalizimeve, HZK-së në Udhëzimin Administrativ ka parashikuar planifikimin e infrastrukturës teknike si: Kapacitetin dhe shtrirjen e rrjetit, ndërtesat përcjellëse, shiritat mbrojtës dhe pajisjet për rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit, impiantet për trajtimin e ujerave te zeza dhe drenazhimit.

7.2.1. Kapaciteti

Në planet zhvillimore sektoriale të hartuara nga Komuna nuk është bërë ndonjë llogaritje e shkarkimit të kanalizimeve (analiza e shkarkimeve), por Unioni Evropian dhe KRU Prishtina ka punuar në studimin e fizibilitetit për ndërtimin e Fabrikës për përpunimin e ujërave te zeza (**Project Preparation Feasibility Studies for waste water Treatment Plants in Kosovo**) nëpërmjet konsulences **WYG International**. Konsulenca ka pasur për detyrë që ti analizoj rrjetat e ekzistuese të ujërave te zeza, kapacitetet e tyre dhe të jepe rekomandime në rehabilitimin e tyre për Prishtinë, Fushe Kosove të cilat janë specifikuar në tabelën e mëposhtme.

Catchment/ Pellgjeve	Calculated total wastewater flow to sewer (m3/day) Kalkulimi i Rrjedhjes totale të ujërave te zeza (m3/dite)			
	2011	2020	2030	2040
Prishtina - Prishtëvka	40,279	49,928	55,263	60,037
Fushe Kosove	3,473	4,949	6,253	7,237
Obiliq	930	1,241	1,412	1,945
PR NW Shkabaj	-	1,295	1,434	1,557
Gracanica	902	988	1,669	2,065
PR S Hajvali	-	2,966	3,283	3,567
Dry Weather Flow/ Rrjedhja në Mot të Thate	45,583	61,368	69,315	76,408

Tabela 13 Tabela e Rrjedhjes totale të ujërave të zeza (m3/ditë) /Referencë- WYG International dhe KUR Prishtina

Pas një analize ka rezultuar dhe Rezultatet e simulimeve hidraulike të modelit përmbledhen si më poshtë:


- Sistemi ekzistues i kanalizimeve në rreth 80% të tij përballon prurjet e ujërave te zeza të periudhës së thatë dhe ujërat e shiut me përsëritje 1 herë në 20 vjet;
- Sistemi nuk funksionon në disa zona të tij si rezultat i pjerrësive të vogla deri në negative duke sjellë deri kapërderdhje në disa prej pusetave;
- Sistemi i ri i kanalizimeve mund të shkarkojë në rreth 60% të pusetave fundore të sistemit ekzistues ndërsa në 40% të tyre duhen thellime të tyre;
- Sistemi i ri i kanalizimeve është projektuar duke përmbushur kriteret teknike të shpejtësisë minimale

- Tubacionet e përdorur ne sistemin e ri duhet te jenë HDPE SN8 Korrugato dhe diametri minimal i përdorur është 200 mm (diametri i jashtëm).

7.2.2. Shtrirja e rrjetit të kanalizimit

Në planet zhvillimore Sektoriale dhe në Planit Zhvillimore Komunal (PZHK) janë identifikuar disa prioritetë në ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave te zeza dhe Impiante për trajtimin e ujërave të tilla, për të cilat do të duhet të caktohen edhe kushtet e zhvillimit në mënyrë që zhvillimi i tyre të jetë më i lehtë dhe më cilësorë dhe duhet të jetë ne përputhje me Direktivat e BE së.

Sipas gjendjes ekzistuese në Fushë Kosovë ekzistojnë 15 sisteme të kanalizimeve , ku vetëm pjesa urbane menaxhohet nga KRU Prishtina dhe 25 km Kolektor, kurse 14 vendbanime rurale (fshatra) kanë sistem te kanalizimit por që menaxhohen nga komunitetet lokale. Pjesa e madhe e kanalizimeve kane te ndërtuar gropat septike dhe te cilat shkarkohen ne 8 pika shkarkimi te cilat janë paraqitur ne figurën e mëposhtme:



Harta 10 Rrjeti i kanalizimit të ujërave të zeza dhe rrjeti i shërbimit /Referencë PZHK-Fushë Kosovë

Sistemi është projektuar dhe operuar si një sistem miqs duke akomoduar ujërat e zeza dhe te shiut

Nuk dihen kriteret origjinale te projektimit te sistemit ekzistues te kanalizimeve

Nga studim i dokumentacionit ekzistues dhe investigimet ne terren rezulton qe sistemi nuk ka qene i projektuar ne nje koncept te qartë teknike me perspektive zhvillimi ne te ardhmen:

- Përrenjtë qe përshkojnë Prishtinën Prishtevka, Vellusha dhe Matican kane shërbyer si kolektorë natyrale te drenimit te ujërave sipërfaqësore dhe ato te përdorura te mbledhura nga sistemi i kanalizimeve



- Ne vitet e fundit kane filluar te ndërtohen interseptoret e ujërave te përdorura ne te dyja anët e përrenjve por qe përsëri ujërat shkarkohen ne to.
- Nga verifikimet e projekteve te interseptoreve te ndërtuar dhe ne ndërtim e sipër rezulton qe nuk janë permasuar bazuar ne llogaritje hidraulike për prurjet llogaritëse te zonave te drenimit

Në planin zhvillimor komunal (PZHK) është trajtuar në disa pjesë rrjeti i kanalizimit dhe vlen të theksohet se në fushën e **Zhvillimit Infrastruktural** konkretisht në **Cakun 8 –Udhëzohet (I është dhënë prioritet) të bëhet Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza dhe përmirësimi i rrjetit të kanalizimit**

Plani 8-1 Përmirësimi i rrjetit të kanalizimit

Përmirësimi i rrjetit të kanalizimit duhet të bëhet në mënyrë suksesive duke mbuluar gradualisht zonat më problematike e kështu me radhë. Po ashtu të mbulohen zonat që nuk shërbimin rrjetin e kanalizimit.

Pas hartimit të Hartës Zonale të komunës së Fushë Kosovës çdo shtrirje e rrjetit qoftë në funksion të përmbushjes së **Cakut 8** – ku theksohet qëllimi i përmirësimit të rrjetit të kanalizimit ndërtimi i impiantit të ujërave te zeza, duhet bëhet një projekt ideor dhe kryesor, projekti duhet të përgatitet nga komuna dhe kompania Rajonale e Ujit “Prishtina” dhe akterët tjerë të rëndësishëm (qytetarët, bizneset, OJQ dhe hisedarët e tjerë të zonës për të cilën kryhet projekti), projektet të cilat hartohen duhet të jenë në përputhje me ligjet aktuale në fuqi, normat teknike, dhe direktivat e BE-se dhe materialet të cilat përdoren duhet të jene ne përputhje me standardet DIN apo ISO.

Shtrirja e rrjeteve te cilat do te riparohen do te behet sipas normave te planifikimit hapësinor, ligjeve dhe udhëzime ne fuqi, vetëm ne raste ku nuk lejojnë mundësit ne teren te aplikohet një rregull i tillë, apo bien ndesh me rregulla tjera dhe në rastet kur zgjidhja inxhinierike ose edhe aspekti ekonomik, financiar e mjedisorë e favorizojnë një zgjidhje më të qëndrueshme në segmente të caktuara të zonës.

Shtrirja e rrjeteve brenda projektit duhet të bëhet në harmoni me kushtet për përzgjedhjen e lokacionit te cilat jane te specifikuara te kushtet zhvillimore për projektim.

Gjatë hartimit të projekteve kryesor duhet të paraqitet me kujdes detalet e pushtave dhe materialeve te përdorura.

Modeli hidraulik është bazuar në:

- Te dhënat topografike te disponueshme ne Ndërmarrjen e Ujësjellësit Rajonal te Prishtinës
- Mbledhja e te dhënave nga grupi i projektimit
- Punimet topografike shtese për zonat e pambuluara nga hartografia ekzistuese
- Verifikime ne terren ne te gjitha zonat e sistemit te ri te trasuar dhe atë ekzistues te kanalizimeve

Llogaritjet e prurjeve ne zonat e reja te shtrirjes se kanalizimeve dhe atë ekzistuese bazuar ne te dhënat e reja te popullsisë dhe zonimit te ri te dendësive te saj. Kolektorët kryesor te cilët dërgojnë ujërat ne drejtim te Impiantit duhet te dimensionohen duke marrë ne konsiderim gjitha prurjet qe vijnë nga grumbullimi i kolektorëve fqinje si zonës se Prishtinës, Obiliqit dhe Lipjanit apo Prurjet transite nga Prishtina, Obiliqi dhe Lipjani. Ne studimin e fizibilitetit janë paraqitur trasetë e kolektorëve te cilat grumbullojnë ujërat deri te impianti për pastrim, ku traseja e kolektorëve për zonën e Fushë Kosovës është paraqitur **me ngjyrë të kaltër**, ndërsa ne zone e Prishtinës **me ngjyre te verdhë**; shih figurën e mëposhtme:




Figura 9 Kolektoret Kryesor /Referencë- Studimi i Fizibilitetit për Impiantin e trajtimit të ujerave të zeza- WYG International

Komuna me prioritet ka planifikuar kolektorët e paraqitur në skicën e mëposhtme:




Figura 10 Kolektoret për largimin e ujerave të zeza me prioritet

Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në zonat nën urbane- me ngjyrë të kuqe është bërë duke marrë parasysh zgjerimin e qytetit në të ardhmen, duke shfrytëzuar hartat e shfrytëzimit të tokës dhe koeficientet e ndërtimit, shiko figurën e mëposhtme ku është paraqitur traseja **me ngjyrë të kuqe**:




Figura 11 Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit ne zonën nen urbane ne Fushë-Kosovë /Referencë- Studimi i Fizibilitetit për Impiantin e trajtimit te ujerave te zeza- WYG International

Gjithashtu ashtu siç parashihet ne PZHK ne HZK është parapare edhe zëvendësimi i rrjetit ekzistues ne disa pjese te qyteti te Fushë-Kosovës. Dhe me këtë duhet te ndahen ujerat e zeza dhe Industriale nga ato atmosferike (drenazhimit), te trasohet rrjeti i ndare ne mënyre qe trajtimi i tyre te behet veçantë dhe objektet për pastrimin e këtyre ujerave te dimensionohen me dimensione reale, trajtimi i tyre te jetë real dhe shfrytëzimi te jete racional me destinacione sipas nevojave te qytetareve. Një pasqyrë e trasesë se zëvendësimit te rrjetit është paraqitur me poshtë me **ngjyre vjollce**:




Figura 12 Zëvendësimi dhe përmirësimi i rrjetit ekzistues të kanalizimit /Referencë- Studimi i Fizibilitetit për Impiantin e trajtimit të ujerave të zeza- WYG International

Për gjithë këto punime është kalkuluar edhe kostoja e Investimeve afatgjate për Kolektorët nga zona e qytetit deti Impianti për trajtimin e ujerave të zeza (IPTUZ), Zgjerimin e rrjetit të kanalizimit dhe riparimin e rrjetit ekzistues, analiza të bëra nga konsulenca **WYG International** në bashkëpunim me “**KUR Prishtina**” e cila është pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Main collector - FK to WWTP / Kolektori kryesor nga FK për në FPUZ	958,347
Primary collector sewers in FK / Kolektori primar i kanalizimeve në FK	3,856,784
Extension of FK sewer network / Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit të FK	4,747,473
Fushe Kosova existing network / Rrjeti ekzistues i Fushe Kosovës	11,383,722

Tabela 14 Kostoja e përafërt e investimit

Gjatë projektimit hartuesi i projekteve duhet t'i ketë parasysh edhe zgjidhjen e sistemit të kanalizimit-sipas ndarjes.

Te rrjeti ndarës duhet të trasohen dy rrjeta të kanalizimit paralele: Në mënyrë që në njërin anë të rrjedhin ujërat e zeza dhe industriale deri te stacioni për pastrim dhe pastaj lëshohen në recipient dhe rrjeti i dytë (atmosferik), më i cekët i cili ndërtohet nën nivelin e rrugës dhe i përcjell ujërat atmosferik deri te pranuesi (recipienti), pa pastrim. Edhe për arsye se ndërtohen dy rrjeta të kanalizimit, kjo mënyra ka përparësi të shumta: stacioni për pastrim ka dimensione më të vogla; rrjetat mund të ndërtohen në etapa (fillimisht për ujërat e zeza); janë të nevojshme investime fillestare më të vogla etj.

Te sistemi i gjysmë i ndarës: Rrjeti gjysmë-ndarës i largon ujërat e zeza dhe industriale në një rrjet të kanalizimit kurse ato atmosferike në tjetër. Ndërmjet këtyre dy rrjetave ekziston pika e përbashkët në lloj të shatës kapërderdhëse (Owerflow chamber).

Në Fushë Kosovë në ndërtimet zonat (ndërtimet) e reja duhet të aplikohen sistemi i ndarës i kanalizimeve dhe në zonat (ekzistuese) sistemi gjysmë i ndarës.

Në HZF do të paraqiten kushtet e nevojshme dhe të domosdoshme për zhvillimin e projekteve të kanalizimit dhe objekteve tjera përcjellëse të bazuara në Raportet Sektoriale dhe Planet zhvillimore Komunale (PZHK).

Sipas fizibilitetit rekomandohen projektet prioritare vijuese:

- **Faza 1:** WWTPs + kolektorët kryesor + intercepte primare të kanalizimeve në pjesët urbane. Qëllimi është për të marrë të gjitha ujërat e zeza ekzistuese të larguara nga lumenjtë Prishtevka, Vellusha dhe Matiqan dhe të transferuar në WWTP – Jo shumë konsumatorë të rinj të kanalizimit janë shtuar në sistem.
- **Faza 2:** Zgjerim i sistemeve të kanalizimeve në vendet rreth pjesëve urbane ku nuk ka kanalizim shumë konsumator të rinj.
- **Faza 3:** Rritja dhe përmirësimi i kanalizimeve ekzistuese në pjesët urbane për të siguruar kapacitet adekuat dhe zvogëlimi i derdhjes së ujërave të shirave në lumenj.

7.2.3. Ndërtesat përcjellëse-kanalizimi

Objektet përcjellëse përfshijnë:

- Pusetat kontrolluese;
- Objektet për ndarjen e kanalizimeve të përbashkëta (Ower Flow Chamber);
- Stacioni i pompave;
- Fabrikat për trajtimin e ujerave të zeza.

Pusetat Kontrolluese

Për të kontrolluar funksionimin e rrjetit të kanalizimit si dhe për të pastruar e mirëmbajtur tubat, ndërtohen puseta kontrolluese. Si në pjesën Urbane ashtu edhe atë rurale në sistemet e vjetra zakonisht nuk janë aplikuar

rregullat e vendosjes se pusetave te kontrollit. Gjate planifikimeve dhe hartimit te projekteve te reja Komuna duhet zbatuar me përpikëri Kushtet e projektimit dhe ndërtimit (zbatimit) te pusetave kontrolluese. Të gjitha materialet te cilat përdoren për ndërtimin e pusetave duhet me standarde te larta dhe sipas ligjeve aktuale ne fuqi.

-Objektet për ndarjen e kanalizimeve të përbashkëta përziera (Owerflow Chamber);

Janë objekte konstruksioni te cilat aplikohen të kanalizimet e përbashkëta përziera, zakonisht aplikohen në zona urbane ku nuk mund të bëhen ndarja e veçantë e tubave atmosferik dhe ujerave te zeza brenda një zone te caktuar. Praktikohen të zbatohen në zona afër lumenjve apo kanaleve te mbyllura.




Figura 8 Puset per ndarjen e ujerave te perziera (Owerflow Chamber)

Stacioni i pompave

Vendlokacioni i pompave (stacioni i pompave) duhet të jene të projektuar ne vende me te përshtatshme dhe sipas normave dhe standardeve për pajisje të tilla. Për llogaritje duhet shfrytëzuar normat e lejuara sipas DIN-it, EC dhe dispozitave ligjore në fuqi.

Implantet industriale

Implantet industriale të përbëra nga më shumë halla punuese dhe ndërtesa administrative (ekonomi të bujqësisë), duhet të kenë rrjetin e vetë vetanak të oborrit prej gypave, pusetave kontrolluese dhe stacionin pastrues.

7.2.4. Normat e Projektimit

Për përcaktimin e prurjeve llogaritëse të ujit për një qytet apo për një qendër banimi duhet të merren parasysh përdoruesit e ujit për te gjitha kategoritë e qe derdhen (shkarkohen) ne kanalizim d.m.th.

- Për plotësimin e nevojat ekonomike-pirje (komunale) të popullsisë (duke përfshirë edhe nevojat e ujitjes se rrugës, shesheve, lulishteve etj.
- Për nevoja Teknologjike si Prodhimeve Industriale/ Komerciale, Prodhimit te energjisë elektrike dhe bujqësisë dhe ndërtim.
- Nevoja jo-konsumuese – rekreacion/ Ujë për mirëmbajtje të hapësirave publike.
- Për nevoja të shuarjes së zjarrit
- Për nevoja Institucionale –komunale etj.

7.2.5. Normat e Përdorimit

Bazë për llogaritjen e sasisë meritorë të ujërave sanitare duhet të jetë norma e harxhimit të ujit për njësi të shfrytëzuesit. Për llogaritje duhet shfrytëzuar normat e lejuara sipas DIN-it, EC dhe dispozitave ligjore në fuqi. Norma e harxhimit për banorë dhe koeficientet e jo njëtrajshmërisë ditore do të paraqiten në forma tabelore.

Normat e Përdorimit

Nr	Nr Objekteve	Njësia matëse	Norma shkarkimit litra	Koeficienti jonjetrajshmerise	
				Kd	Ko
1	Banjo	një larje	150-85 L	1	1
2	Lavanderi	1kg rroba te thata	60-70 L	1	1
3	Mens-Restorant	një klient	15-25 L	1	1.5
4	Spital	një shtrat	250-300 L	1	2.5
5	Dispanceri	një pacient	6 L-10 L	1	2
6	Sanatorium	një shtrat	300-400 L	1	2.5
7	Kopsht	një fëmijë	75-80 L	1	2
8	Çerdhe	një fëmijë	75-80 L	1	2
9	Shkollë	një nxënës	5 L-10 L	1	1.5
10	Institut	një student	7 L-12 L	1	1.5
11	Park kamionësh	një kamion	500 L	1	1
12	Park veturash	një vetur	300 L	1	1
13	Ujitje	1m2 sipërfaqe	2 L-5 L.	1	1
14	Furre buke	1 ton bukë	2000 L	1	1
15	Stacion Treni	1 m2 sipërfaqe	0.5-1.0 L	1	1
16	WC Publike	një vend	500 L	1	1

Tabela 15 Normat për objekte te veçanta

Norma e Ujërave të përdorura L/ditë	Koeficienti Ko për numër te banoreve				
	N<200	N=1000-10000	N=1000-25000	N>25000	Kd
60-90	2.2	1.8	1.7	1.5	1.2
90-120	1.8	1.6	1.4	1.2	1.5
150-200	1.6	1.4	1.3	1.15	1.1

Tabela 16 Norma e ujërave te përdorura L/ditë

Norma mesatare ditore (L)	Koeficientet e jonjetrajshmeris		
	Orare	Ditore	E përgjithshme
60-90	1.3-1.5	1.2-1.2	1.6-1.8
90-120	1.2-1.5	1.10-1.15	1.45-1.75
150-200	1.15-1.3	1.10-1.15	1.3-1.5

Tabela 17 Norma mesatare ditore (L)

Përcaktimi i Numrit të Banorëve



- $N_0 = N(1+0,01p)^n$, ku:
- N_0 -Numri i banorëve pas n vjetësh
- N - Numri I banoreve ne kohen e projektimit
- p -Rritja natyrale e popullatës në përqindje (%)
- n -Numri I viteve për periudhën llogaritëse
- Përcaktimi i prurjes llogaritëse te ujerave te zeza
- $Q_{\max. \text{ dit}} = \frac{N \times n}{1000} \text{ m}^3/\text{ditë}$

Ku: N - Numri I banorëve të qendrës së projektuar (Duke e mbajtur parasysh edhe perspektivën)

n -Norma maksimale e përdorimit të ujit në litra në ditë për një banor.

Prurja mesatare orare në ditën me përdorim me te madhe përcaktohet

$$Q_{\max. \text{ orare}} = \frac{Q_{\max. \text{ dite}}}{24} \text{ m}^3/\text{orë}$$

Prurja maksimale orare po për këtë dite përcaktohet:

$$Q_{\max. \text{ orare}} = Q_{\text{mes. orare}} \times K \times \frac{N \times n \times K}{1000 \times 24} \text{ m}^3/\text{orë}$$

Ku K - është koeficienti i përdorimit jot të njëtrajtshëm (merret nga tabela 1)

Prurja maksimale për sekondë gjendet:

$$q_{\max. \text{ sek}} = \frac{Q_{\max. \text{ orare}}}{3,6} = \frac{N \times n \times K}{24 \times 3600} \text{ l/s}$$

- Përcaktimi i prurjes se ujit për nevoja teknologjike
- $Q_{\max. \text{ dite}} = P \times n^2 \text{ m}^3/\text{ditë}$
- P -Prodhimi ditor I ndërmarrjes, sipas njësisë matëse te punuar (në ton, m^3 etj.).
- n_2 Norma e përdorimit të ujit në m^3 për njësinë e produktit.
- Përcaktimi i prurjes maksimale orare
- $Q_{\max. \text{ orare}} = \frac{Q_{\max. \text{ ditore}}}{T} \text{ m}^3/\text{orë}$

T - është kohëzgjatja në orë e punës se ndërmarrjes gjatë ditës.

- Përcaktimi i prurjes maksimale ne sekondë:

$$q_{\max. \text{ orare}} = \frac{Q_{\max. \text{ ditore}}}{T \times 3,6} \text{ l/s}$$

Raporti h/d -I mbushjes se gypit gjate kalkulimeve hidraulike- duhet te merret i ndryshuar per ujera te ndotura dhe per ujera atmosferike dhe për materialë dhe diametra te ndryshëm.

Procedurat e projektimit te rrjetit të kanalizimit

- Ndarja e territorit qe do te kanalizohet, ne basene kanalizimi;
- Caktimi i skemës se kanalizimit;
- Trasimi i rrjetit;
- Caktimi i thellësisë fillestare te tubave (pesetës), duke u nisur nga objekti i cili ndodhet ne pozitën e pafavorshme te secilit bazën kanalizimi;
- Caktimi i thellësisë se mëtejme
- Caktimin e pjesëve llogaritës te rrjetit
- Përcaktimin e Prurjes llogaritëse
- Llogarit hidraulike te rrjetit te kanalizimit

- Ndërtimin e Profileve gjatësor për gjitha pjesët e rrjetit;
- Ndërtimin e profileve tërthore në seksione karakteristike
- Përcaktimi i rrjetit të Kanalizimit (Ndarja në basene (pellgeje))

Për gjitha pozicionet e përmendura duhet analizuar me kujdes për të hartuar projekti i rrjetit të kanalizimit për ujërat e ndotura dhe atmosferike. Formal për kalkulime i gjeni në literaturën përkatëse për këtë fushë.


Kushtet për përzgjedhjen e Lokacionit

Infrastruktura e ndërtesave ose pajisjeve për trajtimin e ujërave të ndotura, duhet të planifikohet në lokacionet, si në vijim:

1. në parcela kadastrale zhvillimore mesatare nga 5- 10 ha;
2. në afërsi dhe në drejtim të rrjedhës së jashtme të lumit;
3. me qëllim të shkarkimit të ujërave të trajtuara;
4. në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
5. në lokacione jashtë vendbanimeve, dhe të izoluar nga vendbanimet;
6. 6.60 m në largësi nga vija ndërtimore, në rrugë me gjerësi 7.0 m dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1.50 m;
7. 6.00 m në largësi nga vija ndërtimore, në rrugë me gjerësi 6.0 m dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1.00 m;
8. trasohet në kuadër të njërit shteg për këmbësor përgjatë rrugës, në rrugët me gjerësi 5.00 m dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1.00 m

Kushtet e vendosjes së gypave të sipas kategorisë së rrugës

Kushtet e vendosjes së tubave të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike do të caktohen sipas kategorisë së rrugëve dhe atë:



▪ Tubat (gypat) e kanalizimit të ujërave të zeza duhet të trasohen (vendosen) në mesin e rrugës

▪ Tubat (gypat) e kanalizimit të ujërave atmosferike duhet të trasohen (vendosen) në njërin skaj të rrugës dhe vendosen me ceket.

▪ Tubat e ujësllësit në zonat urbane duhet të trasohen (vendosen) në dy anët e trotuarit, kurse në zonat rurale zakonisht zgjidhet pjesa ku është me e ngarkuar me banim.

▪ Tubat kolektor të ujësllësit mund të vendosen edhe në njërin anë të rrugës së asfaltuar në pjesët urbane dhe rurale sipas

figurë se kategorisë së rrugës et paraqitur me poshtë:

Figura 13 Vendosja e tubave ne rruge me kategori te ndryshme

Tubat prej materialit të plastikes

Te gjitha tubat qe do te aplikohen ne zhvillimin e projekteve te reja duhet te

jene min SN8 dhe me standarde EN 13476 dhe certifikata ISO 9001.

Pusetat Kontrollues

Pusetat duhet të vendosen në fillim të çdo dege të tubave (gypave); gjatë ndryshimit të kahjes së kanalit nëpër horizontale; gjatë ndryshimit të rënies së fundit të tubit ; gjatë ndryshimit të prerjes tërthore (sipas madhësisë dhe formës); gjatë bashkimit të më tepër se dy tubave; tek pjesët e drejta të gjata për diametër deri në 60 cm dhe në 40 deri 70 m, kurse për diametër më të mëdhenj në 100 deri 150 m. Nëse gypat takohen nën shumë kënd të ngushtë atëherë ka dy shahte kontrolluese njëri afër tjetrit. Shahti fillon nga niveli i rrugës me kapak prej hekuri të derdhur dhe mbarojnë në fund të gypit.

- Pusetat nga plastika sipas standardeve EN 13598-1, EN 13598-21, EN 479, 14982, EN 14802, DIN 4124 dhe EN 1610 dhe
- Pusetat nga betoni sipas standardit DIN EN 917 dhe DIN V4034-1.

Baza e sipërme e pusetes kontrolluese duhet të jetë në formë të rrethit.

Lëshimi i ujërave të zeza në recipient-Lumë

Lëshimi i ujërave të kanalizimit në Lumë duhet të jetë në drejtim të ujit prej vendeve të banuara.




Figura 14 Lëshimi i ujit ne breg te lumit i pajisur me mbyllës

7.3. Sistemet e drenazhimit

Ujërat atmosferik duhet të kanalizohen në sistem të veçantë të drenazhimit. Kujdes të veçantë duhet të kushtohet drenazhit të ujërave atmosferike në varreza. Në mënyrë që të mbrohet rrjedha e lumenjve, është e nevojshme të kontrollohen të gjitha shkarkimet dhe të bëhet një inventar i ndotësve.

Ne vendet ku nuk ka ujë sipërfaqësor dhe nëntokësor (rrafshnalta, maje të maleve), për furnizim me ujë në amvisëritë mund të pranojmë (shfrytëzojmë) ujin atmosferik. Ky ujë është shumë i butë dhe për këtë arsye nuk është e shijshme për pije por për të gjitha nevoja të tjera në amvisëri është plotësisht i mirë. Shiu dhe bora grumbullohen nga kulmet e ndërtesave ose nga sipërfaqet special dhe përmes rezervuarëve do të mund të shfrytëzohet.

Traseja e rrjetit të kanalizimit atmosferik (drenazhimit) do të ndërtohet më cekët se kanalizimi i ujërave të zeza dhe industriale, do të jete nën nivelin e rrugës, në njërin anë të rrugës dhe do të përcjell ujërat atmosferik deri te pranuesi (recipienti), pa pastrim.

Të gjitha ujërat atmosferike janë të orientuara në lumenjtë dhe përroskat në të cilat duhet të merren masa si:

- hapjen e kanaleve,
- rregullim prej dheu,
- pastrim dhe mirëmbajtje,
- rregullim urban i lumit Sitnica
- Si masa tjera janë paraparë:
- Eliminimi i lavesave të forta të lumit
- Menaxhimi i brigjeve të lumenjve.
- Mbrojtja e lumenjve nga hedhja e mbeturinave, që në këtë rast paraqesin pengesa për lëvizjen e lirë të ujit.
- Ndalimi i ndërtimit të objekteve të banimit si dhe atyre me karakter ekonomik buzë brigjeve të lumenjve së paku 30 m largësi nga brigjet e lumit.
- Ndërtim i argjinaturave në vendet ku vërshojnë lumenjtë.

7.4. Impianti për trajtimin e ujërave të zeza

Sipas Ligjit për ujëra dhe mbrojtje të ujërave, të gjitha ujërat e kanalizimeve duhet të pastrohen dhe pastaj të lëshohen në recipient (Lumë) ose të përdoren për ujë dhe kultivimin e peshqve të ujërave të nxehta. Bazuar në planin zhvillimor sektorial, Planin Zhvillimor Komunal dhe marr parasysh gjendjen ekzistuese planifikohet infrastruktura teknike si:: **Impiantet e trajtimit të ujërave të zeza.**

Ne HZK Komuna do të përmirësojë sistemin e kanalizimit të ujërave të zeza. Ajo do të identifikojë dhe alokojë tokën e përshtatshme për nënstacionin e ujërave të zeza, për trajtimin primar të tyre, duke u bazuar në Strategjinë për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (2004) dhe planet aktuale të kompanisë rajonale. Sipas Strategjisë së Ujërave Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza është një projekt rajonal i cili Fushë Kosovën e kombinon me komunat Prishtinë dhe Obiliq. Komuna e Fushë Kosovës duhet të bëjë përgatitjet nga ana e saj sa i përket lidhjes në këtë projekt.

Unioni Evropian ka filluar studimin e fizibilitetit për ndërtimin e Fabrikës për përpunimin e ujërave të zeza (**Project Preparation Feasibility Studies for Waste Water Treatment Plants in Kosovo**) nëpërmjet konsulentit **WYG International**, Konsulencia ka pasur detyrë që t'i analizoj rrjetat e ekzistuese të ujërave të zeza dhe të jep rekomandime në rehabilitimin e tyre për Prishtinë, Fushe Kosove, Kastriot dhe ku lokacioni i impiantit për Fushë Kosovë mendohet të jete në afërsi të shkarkimit të Prishtevkës në Sitnicë ku Impianti do të mbledhë dhe do të pastroj ujerat e zeza të këtyre tri Komunave.

Në hartimin e fizibilitetit është treguar një pasqyre me të kuart ne lidhje edhe me koston e Ndërtimit të objektit në fjalë, lokacionin, etj. Ku pastaj do të behet edhe projekti Ideor dhe Kryesor i cili duhet t'i plotësoi të gjitha kushtet e ndërtimit sipas ligjeve normave aktuale në fuqi në vendin ton si dhe direktivave të BE-se. Të gjitha materialet të cilat do të përdoren gjatë ndërtimit të Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza duhet të jene në përputhje me normat dhe standardet teknike të ndërtimit, ligjin e ndërtimit dhe standardet ndërkombëtare DIN dhe ISO. Koncept Dizajni dhe një formë e koncept dizajni duket si në figurën e mëposhtme ku e njëjta formë është e realizuar në Irlandë.




Figura 9 Skema e koncept projektit/Referencë- Konsulencia -WYG International dhe KUR Prishtina

	Total Capex Gjithsejt Capex € ,000	Land Cost Kostoja e Tokes € ,000	Cost per PE €/pe	Opex €/year	AIC €/m³
Pristina & Fushe Kosovo WWTP / Pristine & Fushe Kosove FPUZ					
Year / Viti 2030	31,570	850	74	2,046	0.226
Year / Viti 2040 with BNR	43,994	1,149	92	2,307	0.323
Obiliq & North West Pristina WWTP / Obiliq & Prishtina Veri Perendimore FPUZ					
Year / Viti 2030	3,068	42	128	162	0.517
Year / Viti 2040 with BNR	5,300	58	169	228	0.669

Tabela 18 Kosto(Vlera) për ndërtimin e Impiantit të trajtimit të ujërave të zeza/ Referencë- Konsulencia -WYG International dhe KUR Prishtina



7.5. Kushtet zhvillimore të Projektimit të Ujësjiellësve, Kanalizimeve të ujerave të ndotura dhe Drenazheve

Si bazë për hartim të kushteve do të shërbejnë dokumentet legislative të hartuara si:

Ligjet dhe Standardet e projektimit

- Gjatë hartimit të projektit, projektuesi duhet gjithsesi të përmbahet:
- Ligjit mbi ndërtimin të Republikës së Kosovës.
- Ligjit mbi ujerat e Kosovës.
- Ligjeve dhe rregulloreve mbi mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjes në punë.
- Ligjit hapësinor të Republikës Kosovës.
- Ligjit për Kadastër.
- Ligjit mbi shpronësimin.
- Ligji mbi Planifikimin Hapësinor, etj.

Në bazë të dokumentacionit ekzistues dhe shikimit në terren të përcaktohet fillimi, gjatësia dhe mbarimi i trasesë së Ujësjiellësit ose Kanalizimit dhe objekteve (strukturave).

Kërkohej të punohen këto projekte dhe elaborate përcjellëse

Secili person i cili projektin apo kryen punë ndërtimi në instalim apo riparim të ndërtesës, sistemet elektrike, mekanike dhe të ujësjiellësit, për të cilat aplikohet ky Kod, duhet të përmbahet këtij Kodi (Kodi i Ndërtimit).

- Projekti ideor.
- **Projekti kryesor** i cili përmban:
 - Projektin e Ujësjiellësit, Kanalizimit të ujerave të zeza, Industriale dhe Atmosferike.
 - Elaboratet përcjellëse.
 - Elaborati Gjeodezik-Matjet Gjeodezike.
 - Elaborati Gjeoteknik-Matje gjeomekanike përgjatë trasesë
 - Elaborati i mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes në punë.
 - Elaborati i Shpronësimit.

PROJEKTI IDEOR (së paku në dy variante)

Përmbajtja e projektit ideor

Pjesa tekstuale

- Të dhënat e përgjithshme për projektuesin.
- Vendimet për emërimin e projektuesve.
- Detyrën projektuese.
- Raportin teknik.
- Përshkrimi i shtrirjes së trasesë së rrugës në hapësirë.
- Zgjidhjet teknike- përshkrimi i trasesë së planifikuar.
- Përshkrimi i plani të situacionit dhe profilit gjatësor.
- Paraqitja e parametrave ndërtimor për variantet me arsyeshmërinë (përparësitë dhe mangësitë për të dy variantet).
- Propozimi i variantit më të favorshëm me arsyetim.
- Të dhënat preliminare gjeodezike (mbledhja e shënimeve për rrjetin gjeodezik, furnizimi me harta gjeodezike, ortofotot e aeroincizimit të fundit, planet kadastrale vektor (të azhurnuara), për trasenë e kanalizimit.



- Të dhënat preliminare Gjeoteknike.
- Raportet e takimeve me komisionin e Autoritetit Kontraktues i emëruar për përcjelljen e projekteve.
- Pjesa grafike
- Situacioni i rrjetit të ujësjellësit ose kanalizimit publike i paraqitur në hartat shtetërore (P= 1: 5 000) dhe në ortofoto.
- Situacioni i Rrjetit P= 1:5 000.
- Profili gjatësor P= 1: 100/ 1000.
- Detalet karakteristike, P=1: 50.
- Situacionet e veçanta për instalimet nëntokësore dhe mbitokësore, profilet tërthore karakteristike të instalimeve etj.
- Pjesa numerike
- Të dhënat preliminare gjeodezike.
- Paramasa dhe parallogaria e përafërt.

Tabelarin e sasive dhe Paramana për të gjitha punime e Bazuar në llogaritjet dhe vizatimet e projektit duhen të punohet detalisht dhe me dëshmi (Paramasa Parciale dhe kumulative).

Kushtet teknike me përshkrimin e punëve me Sigurimin e kualitetit duhet të përgatiten për çdo projekt dhe pozicion të paramasës.

▪ PROJEKTI KRYESOR

Pas aprovimit të Projektit Ideor nga Komisioni, dhe përzgjedhjes së variantit më të favorshëm, projektuesi mund të fillojë me hartimin e Projektit Kryesor me Elaboratet e veçanta përcjellëse.

Projekti kryesor përbëhet nga projekti:

- Projekti Ndërtimor për Ujësjellës ose Kanalizim.
- Elaboratet përcjellëse.
- PROJEKTI NDËRTIMOR I UJESJELLESIT OSE KANALIZIMIT
- Pjesa tekstuale
- Shënimet mbi veprimtarinë e kompanisë projektuese.
- Dokumentacionin mbi regjistrimin e kompanisë.
- Detyrën projektuese.
- Vendimin për përcaktimin e projektuesit kryesor dhe projektuesve tjerë.
- Procesverbalin mbi kontrollimin e projektit nga komisioni i punëdhënësit.
- Deklaratën se është bërë kontrolli i brendshëm i projektit dhe është bërë harmonizimi i projekteve.
- Përshkrimin teknik dhe pjesa llogaritëse.
- Përshkrimi teknik duhet të përfshijë elementet teknike të projektimit të ujësjellësit dhe kanalizimit publike, mënyrën e kryerjes së punimeve e veçanërisht duhet të epet përshkrimi me të gjitha elementet si më poshtë:
- Përshkrimi i punimeve me kushtet teknike.
- Regjistrin e koordinatave.
- Llogaritja hidraulike
- Paraqitja e masave për mbrojtjen nga zjarri.
- Paraqitja e masave për mbrojtjen në punë.
- Programi i kontrollimit të cilësisë së materialeve, punimeve dhe konstruksioneve
- Gjithsesi duhet të punohet programi i kontrollimit (ekzaminimeve) të materialeve dhe punimeve të realizuara, duke definuar llojin dhe sasinë e ekzaminimeve dhe kushtet të cilat duhen të plotësohen.



- Caktimi i lokacionit për largimin dhe deponimin e materialit të tepërt ndërtimor.
- Paramasën me parallogari parçiale.
- Paramasa me parallogari e ndërtimit (duhet të përmbajë përshkrimin e pozicioneve me sasitë).
- Paramasa dhe parallogaria të punohen në format Excel.
- Pjesa grafike
- Situacioni i ujësjellësit ose kanalizimit publik i paraqitur në hartat shtetërore (P= 1: 25 000) dhe në ortofoto.
- Planin e Situacioni me ortofoto, P=1: 1 000 ose 2500.
- Profili gjatësor, P= 1: 100/ 1000.
- Profilet tërthore në çdo ndryshim të diametrit, P= 1: 25 ose 50. Në profil tërthor të duhet të epen, trashësia e kanalit, thellësia e kanalit, mbushja me rërë e tubave (gypave) sipas normave.
- Detalet tjera si depërtime të rrugëve, lumenjve, prrockave etj, P= 1: 25 dhe P= 1: 50.
- Elaborati Gjeodezik

Qëllimi i hartimit të dokumentacionit gjeodezik është që të formohet baza e shënimeve për punimin e dokumentacionit teknik- projektit, bartjen e shënimeve në terren dhe mirëmbajtjen e të dhënave gjeodezike gjatë eksploatimit të ujësjellësit ose kanalizimit.

Gjithsesi të bashkëngjiten të dhënat për koordinatat e pikave të rrjetit gjeodezik të vërtetuar nga organi kompetent.

Projektuesi duhet të incizoj gjendjen ekzistuese të terrenit në aspektin horizontal dhe vertikal, duke u lidhë në rrjetin gjeodezik referent të Republikës së Kosovës “KosovaRef 01 apo Pozicionimi Satelitor i Kosovës (KOPOS)”.

Të gjitha matjet gjeodezike, llogaritjet dhe barazimet duhet të bëhen me saktësi sipas Kornizave të Matjeve Kadastrale në Republikën e Kosovës.

Të gjitha matjet dhe punët gjeodezike duhet të kryhen sipas Ligjit për Kadastër të Republikës së Kosovës.

Të gjitha objektet e incizuara në terren si: objektet ekzistuese, largpërçuesit, shtyllat elektrike, urat, lëshesat, pikat gjeodezike, pikat detale, kufijtë e njësive kadastrale, rrethojat prej materiali të ndryshëm, instalimet nëntokësore dhe mbitokësore (të paraqiten me shenja topografike përkatëse sipas çelësit topografik) të vizatohen- paraqiten në planin e situacionit në përpjesë P= 1: 1 000, e cila do të shërbejë si bazë për hartimin e projektit ndërtimor dhe projekteve të veçanta.

Në bazë të incizimeve të bëra duhet të dorëzohet elaborati gjeodezik i cili do të jetë pjesë e veçantë dhe përbërëse e projektit ndërtimor. Elaborati gjeodezik duhet të përmbajë:

- Planin e Situacioni në (përpjesë) P= 1: 1 000
- Ortofotot (më të fundit) me situacione të trasës së ujësjellësit ose kanalizimit ose drenazhimit (atmosferik).
- Planet kadastrale vektor zyrtare, të azhuruara.
- Regjistrin e koordinatave për:
 - rrjetin trigonometrik
 - rrjetin poligonal.
 - poligonin operativ.
 - rrjetin e reperëve.
- Regjistrin e koordinatave për pikat kryesore të trasës:
 - drejtimeve.
 - kthesave.

- profileve tërthore.
- stacionazhave të plota.
- objekteve të rrugës (strukturave).
- Elaborati i shqyrtimeve Gjeoteknike (Gjeomekanike)

Për punimin e projektit kryesor të kanalizimeve duhet të bëhen shqyrtimet gjeoteknike. Shqyrtimet gjeoteknike, përfshijnë punimin e shpimeve adekuate dhe sondave, me qëllim të definimit të profilin gjatësor gjeoteknik dhe aftësisë bartëse të tokës.

Në bazë të nxjerrjes së sondave dhe ekzaminimeve laboratorike, duhet të punohet Elaborati Gjeoteknik. Numri i shpimeve do ta përcakton projektuesi, ashtu që niveli i ekzaminimeve të jep numër të mjaftueshëm të dhënave për përcaktimin e stabilitetit të gjurmimit. Në Elaborat të paraqitet Raporti me të dhënat e nevojshme, pas shqyrtimeve gjeomekanike.

- Elaborati i mbrojtjes së mjedisit (VNM) dhe mbrojtjes në punë

Projektuesi duhet të punojë elaboratin e mbrojtjes së mjedisit. Gjatë projektimit nevojitet që të parashihen të përdoren materialet që kanë testet e pranuar ndërkombëtare, në pikëpamje të mbrojtjes së mjedisit dhe punëtorëve. Duhet të parashihet deponimi i materialeve tepër sipas rregullativës për deponimin e hedhurinave. Në lokacionet ku parashihet që niveli i zhurmës të jetë për 5dB më e lartë se lejuar, duhet të parashihen barriera për pengimin e zhurmës, sipas tipit dhe standardeve të aprovuara në shtetet e BE. Për parandalimin e erozioneve të dëmshme duhet që në vend të drunjtëve të prerë të parashihet mbjellja e fidanëve të reja dhe të mbjellët bari në pjerrësitë e mbushjeve dhe gjurmimeve. Dislokimi i rrjedhave të ujërave atmosferike, mund të bëhet vetëm në rastet e domosdoshme. Gjatë projektimit duhet të largohemi gjurmimeve të thella. Mbrojtja e ujërave nëntokësor duhet të bëhet përmes drenazheve adekuate.

7.6. Kushtet e përgjithshme për zhvillimin (ndërtimin) e infrastrukturës së ujësjellësit, kanalizimit dhe drenazhimit

Para se të fillojnë punimet duhet të bëhet:

- Përgatitja e përpiktë e punëve sipas planit dinamik të planifikuar
- Punimet e ndërtimit të kanalizimit duhet të bëhen në përputhje me kodin unik të ndërtimit të Republikës së Kosovës.

Punët përgatitore si:

- Organizimi dhe rregullimi i punishtës sipas planit të rregullimit të punishtës
- Sigurimi i rrethojës në vend punishte
- Vendosja e tabelës Informuese
- Organizimi i hapësirës së deponimit

Të gjitha këto masa, masat tjera apo kushtet tjera duhet të jenë në përputhje me ligjin e ndërtimit në fuqi Ligjin e Ujërave në fuqi, Standardet DIN dhe ISO për çdo material të përdorur, normë të projektimit dhe ndërtimit, dhe rregulloreve tjera të cilat janë në fuqi në Republikën e Kosovës.

7.6.1. Brezi Punues

Organi mbikëqyrës dhe kryesi i punimeve bashkërisht do të caktojnë gabaritin e brezit punues duke pasur parasysh plotësimin e kushtit për ekzekutimin pa pengesa të punimeve, në sa më pak sipërfaqe të shfrytëzuar të tokës, në mënyrë që shpenzimet e dëmtimit të sipërfaqeve të tilla të jenë sa më të vogla, por gjithnjë edhe në përputhje me ligjin e Ndërtimit në fuqi dhe Udhëzimeve Administrative dhe rregulloreve tjera në fuqi për fushën e njëjtë.

Gjithashtu bashkërisht do të caktojnë lokalitetin më të përshtatshëm për ndërtimin e objekteve të përkohshme si për deponimin e materialit dhe në përputhje me ligjin në fuqi.

Investitori është i obliguar që t'ia dorëzojë trasenë kryerësit të punimeve dhe me kohë të sigurojë terrenin e lirë për ekzekutimin e punimeve paraprake pa pengesa.

7.6.2. *Shënjimi i Trasesë*

Gjatë shënjimit të trasesë para fillimit të punimeve duhet që:

- Investitori të dorëzojë punëkryesit listën e reperëve dhe pikat gjeodezike, të rëndësishme për ekzekutimin e punimeve.
- Punëkryesi do të kryejë të gjitha punimet plotësuese gjeodezike dhe është i detyruar që të mirëmbajë shenjat e përhershme, reperët, etj.
- Punimet duhet të ekzekutohen sipas kuotave, masave, dimensioneve dhe detaleve të cilat janë paraqitur në vizatimet e projektit kryesor si dhe sipas udhëzimeve të organit mbikëqyrës.
- Pas përfundimit të projektit duhet që punëkryesi të dorëzojë Investitorit një CD me matje gjeodezike të punimeve të realizuara sipas punëve të përfunduara ku përmban: Koordinatat x, y dhe z, këto matje do të bëhen në kuotën e fundit të gypit, kuotën e nivelit të terrenit objektet e veçanta si në pusetat e ujësjellësit, hidrante, valvola të ajrimit dhe lëshimit si pikat e rezervuarit komplet dhe stacionit të pompimit.

7.6.3. *Materiali*

Kualitetin e materialit i cili instalohet si dhe kualitetin e prodhimeve tjera të gatshme, ekzekutuesi e dëshmon me ateste të shqyrtuara nga institucionet përkatëse:

- Atestet dhe rezultatet e shqyrtimeve ekzekutuesi ia dorëzon organit mbikëqyrës përmes Ditarit të punës.
- Shpenzimet e dëshmisë së kualitetit të materialit si dhe të prodhimeve të gatshme nuk paguhen veçanërisht përveç në rastet kur është e rregulluar ndryshe me kontratë.

7.6.4. *Kadastra instalimeve*

Para fillimit të punimeve punëkryesi është i obliguar që të kërkojë nga investitori incizimin kadastral të instalimeve ekzistuese nëntokësore. Të gjitha risitë që paraqiten gjatë realizimit të punimeve, punëkryesi dhe organi mbikëqyrës do të zgjedhin së bashku.

7.6.5. *Punimet e dheut*

Kushtet e gërmimit të dheut dhe leximit të projektit:

- Gërmimi i kanaleve duhet të bëhet sipas kuotave të treguara në profilin gjatësor.
- Në rastet kur kryesi i punimeve gjatë gërmimit gabimisht gërmon nën kuotat e projektuar ai është i obliguar që të njëjtat ti sanojë duke bërë mbushjen me zhavorr duke e ngjeshur derisa të arrihet tek kuota e projektuar.

Në pjesët e terrenit ku fundi i kanalit, sipas mendimit të organit mbikëqyrës, nuk ka aftësi të mjaftueshme mbajtëse që të pranojë ngarkesat nga gypi, duhet të veprohet siç vijon:

- Kanali duhet të hapet deri tek shtresa me aftësi të mjaftueshme mbajtëse, kurse thellësia e gërmuar do të mbushet me zhavorr ose gurë të thyer me ngjeshje deri sa të arrihet kuota e projektuar dhe me aftësi mbajtëse më së paku 200 kN/m².
- Gypi do të përforcohet me ankera betoni sipas udhëzimeve të organit mbikëqyrës.

Këto punime shtesë duhet të mbulohen nga ana e investitorit.

Gjithashtu gjatë gërmimit të dheut duhet që:

- Dheu i gërmuar të largohet më së paku 0,60 m' nga skaji i kanalit përveç në rastin kur terreni nuk ofron mundësi të tilla.
- Dheu i gërmuar të klasifikohet ashtu që më pastaj të jetë i shfrytëzueshëm për mbulimin e kanalit.
- Fundi i kanalit të planifikohet me saktësi +/-1 cm dhe atë me dorë ndërsa më pas bëhet shtrirja e rërës fraksion 4-16,5 në trashësi d_{min}=15cm dhe nivelohet me kuotat e niveletës me pjerrësi të caktuar në profilet gjatësore;
- Mbrojtja e kanalit të bëhet me pahitë mbrojtëse në të dy anët e kanalit në rast se kalohet thellësia e kanalit h>1,50 m'

Shiko detalet më poshtë:




Figura 1 Mbrojtja e kanalit me palhi

7.6.6. Punimet e betonit

Përzierja, vendosja në vepër si dhe ngjeshja e betonit bëhet në mënyrë mekanike. Kualiteti i betonit dhe i komponentëve të tij duhet ti përgjigjet kërkesave të rregullave teknike dhe standardeve në fuqi si dhe markës së kërkuar të betonit.

Ndërtimi i pushtave nga betoni bëhet paralelisht me instalimin e gypave. Së pari përgatitet kineta sipas detaleve ekzekutuese dhe konform rregullave teknike duke respektuar formën e sipërfaqes me të përshtatshme për rrjedhje pa pengesa të ujërave dhe fekaleve si dhe disnivelemin minimal në mes të gypit zbrazës në pusët dhe gypit thithës nga puseta. Pastaj vendosen gypat e parapërgatitur prej klasës së betonit C 25/30 duke vendosur gomën izoluese në mes tyre. Në pjesën e epërme vendoset konusi dhe mbi të përgatitet baza e betonit ku inkastrohet kapaku nga giza e derdhur me aftësi mbajtëse prej $N=40$ t.

Shqyrtimi i betonit bëhet nga materiali i marrë në vendin e vënies në vepër. Shqyrtimin e bënë institucioni përkatës. Shpenzimet për shqyrtime duhet ti marrë investitori nëse nuk është e rregulluar paraprakisht me kontratë.

7.6.7. Punimet e armaturës

Në zhvillimin e objekteve përcjellëse konstruktive në projektet e ujësjellësve, duke përfshirë, rezervuarët, stacionet e pompave dhe klorinatorëve dhe objekteve tjera duhet të parashihen që:

- Llogaria Statike të kalkulohet sipas Eurocod 8 dhe pozicionet e Armimit të ndërtohen sipas standardëve ku montimi i armaturës duhet të bëhet sipas planeve të armaturës.
- Armatura vendoset pas përgatitjes së kallëpeve sipas gjeometrisë së detalit ekzekutiv.
- Kualiteti i çelikut duhet të përgjigjet standardëve në fuqi.

Punëkryesi është i obliguar që para fillimit të punëve të armaturës të njoftohet me planin e armaturës dhe të bëjë kontrollin në bazë të llogarisë statike.

7.6.8. *Punimet montues-instaluese*

Në punimet montuese duhet të përfshihen të gjitha llojet e instalimet e gypave HDPE-100 (SDR17, PN10); PE100RC(SDR17, PN10); PVC; Zinguar; Çelikut; Polistes etj. Pastaj përfshihen:

- Sigurimi, transporti, bartja përgjatë kanaleve, lëshuarja në kanale e materialit, rrafshimi i rërës dhe zhavorrit si dhe montimi i gypave dhe pjesëve fazonike.
- Saldimi i tyre duhet bërë sipas standardeve të BE-se.

Për ekzekutimin pa pengesa të punëve të montimit, kanalet duhet të përgatiten në mënyrë të rregullt dhe të gjitha parapërgatitjet të bëhen me kohë dhe me kushte të planifikuara me parë.

Gjatë instalimit të gypave të HDPE-100; PE 100-RC-PP; PVC; Zinkuar; Çelikut; Polistes etj;

- Punëkryesi duhet të respektoj edhe udhëzimet e prodhuesit.
- Gypat dhe pjesët fazonike duhet të jenë me standarde DIN dhe ISO të certifikuar dhe me ateste, apo edhe standarde tjera por që përputhen kushtet e njëta me këto standarde.
- Të gjitha lidhjet e gypave duhet të ekzekutohen në atë mënyrë që të siguroj papërshkueshmëri.
- Gypat që instalohen duhet të shtrihen me tërë gjatësinë e tij në bazën e kanalit (fundin e kanalit) në mënyrë që të mos paraqitet rastet e "traut të thjeshtë" apo "konzollës".
- Vendosja e gypave në pusetat e parapërgatitura duhet të sigurohen me material papërshkueshmëri.

7.6.9. *Testimi i rrjetit të ujësjellësit dhe dezinfektimi*

Mënyra e testimit të rrjetit dhe të dezinfektimit janë të caktuara me rregullore dhe varet nga kualiteti dhe lloji i gypave të përdorur:

- Presioni i testimit të gypave nga materiali HDPE i cili aplikohet momentalisht në tregun botëror përveç nëse specifikohet ndryshe më sipër, lidhur me tuba HDPE përfshirë nyje, pajisje dhe fazonitë do të testohen në përputhje me DIN 4279 pjesa 7 dhe në përputhje me ISO 1167, kurse
- Dezinfektimi duhet të bëhet në përputhje me DIN 4279 pjesa 1 deri te pjesa 6.

7.6.10. *Mbulimi i kanalit pas testimit*

Kushtet të cilat duhet respektuar për mbulimin e kanalit janë:

- Mbulimi i gypit me rërë duhet të jetë deri në lartësinë $d_{min}=15\text{cm}$ mbi nivelin e sipërm të gypit.
- Vendosja e dheut apo e zhavorrit mbas mbulimit të gypit të duhet të bëhet në shtresa 25-30cm.
- Duhet të bëhet ngjeshja mekanike me "bretkosë" derisa të arrihet aftësia mbajtëse prej 200 KN/m² dhe
- Mbulimi e kanalit nuk guxon të bëhet para se të bëhet largimi i ujit nga kanali.

Vërejtje 1: Kompaktësimi duhet të kushtohet vëmendje e veçantë në mënyrë që të mos vie deri tek uljet. Posaçërisht duhet të kushtohet vëmendje e veçantë kompaktësimi në pjesët e kanalizimit i cili kalon nëpër rrugë, shtresa e fundit e mbulimit bëhet me gurë të thyer me fraksione 0-60mm dhe 0-31.5 mm.

Vërejtje 2: Në pjesën e trasësë e cila kalon neper ara, shtresa e fundit duhet të mbulohet me humusin e gjermuar kurse në pjesët e trasësë e cila kalon neper rrugë, shtresa e fundit duhet të mbulohet në atë mënyrë që kanali i gjermuar të kthehet në gjendje të mëparshme, punëkryesi duhet të ketë kujdes të veçantë gjatë ngjeshjes në pjesët e transhesë ku kalohet rruga në mënyrë tërthore (ngjeshja të bëhet me vibro-ngjeshjes).

Vërejtje 3: Në rastet ku vendosja e gypave bëhet në pjesët urbane atëherë shtresat e zhavorrit me fraksion 16, 6-32 vazhdojnë deri te kuota e rrugës dhe bëhet ngjeshja me cilindër rrotullues deri në kompaktësimin e tij.

7.6.11. Kushtet e vendosjes se tubave ne kanalin e ujësjiellësit dhe kanalizimit




Figura 2 Prerja tërthore të kanalit

Diametri i gjypave (mm)	Gjerësia minimale e Kanalit (mm)
DN <300	200 në dy anët e gjypit
300 □ DN < 400	300 në dy anët e gjypit
□ DN 400	400 në dy anët e gjypit

Tabela 1 Gjerësisë së kanalit të ujësjiellësit




Figura 3 Prerja tërthore të kanalit dhe gjerësia e kanalit te kanalizimet

7.6.12. Masat mbrojtëse gjatë ndërtimit

Dokumentet teknike të nevojshme për masat mbrojtëse gjatë ndërtimit janë:

- Planin e sigurisë për punëtorët
- Vendosja e shenjave të rrezikut për njerëzit që lëvizin rreth objektit.

Po ashtu gjatë zhvillimit të punimeve të Ujësjiellësve duhet të pasur parasysh që:

- Punëtorët të cilët punojnë në ndërtimin e ujësjiellësve të jenë të shëndosh fizikisht dhe psikikisht, si dhe duhet t'u nënshtrohen kontrollimeve të rregullta mjekësore.
- Duhet të jenë të kualifikuar për punën të cilën duhet ta kryejnë.

- Gjatë kohës së punës punëtorët nuk guxojnë të konsumojnë alkool dhe pije tjera droguese të cilat e zvogëlojnë aftësinë psikofizike tek njeriu.
- Punëtorët janë të obliguar të bashkëpunojnë në punën e përbashkët dhe të ndihmojnë njeri tjetrin.
- Punëtorët në vendin e punës duhet të kenë mbrojtjen e paraparë higjieno-teknike, si vijon: helmetën, dorëzat mbrojtëse, këpucët me shkelëse të fortë dhe pajisjet e tjera të cilat janë të parapara me Rregulloren mbi mbrojtjen në punë për këtë lloj veprimtarie.

Vërejtje: Pa pajisjen e lartpërmendur të mbrojtjes në punë, punëtori nuk guxon të kryej veprime në vendin e tij të punës, ndërsa për këtë duhet të kujdeset udhëheqësi.

7.6.13. *Mjetet për mbrojtje personale*

Gjatë kohës së manipulimit dhe punës në objekte aplikohen mjete përkatëse të mbrojtjes personale dhe pajisje mbrojtëse dhe atë:

- Helmeta mbrojtëse, përdoret gjatë manipulimit dhe punës në objekte.
- Rrobat e punës, shërbejnë si mbrojtëse nga lëndimet mekanike dhe kimike të trupit dhe djegieve gjatë manipulimit dhe punës në objekte.
- Këpucët shërbejnë si mbathje pune dhe mbrojtëse.
- Rripi i sigurisë, shërben për të mbrojtur nga rrëzimi prej lart, dhe se përdoret gjatë punës në lartësi mbi tri metra.
- Dorëzat e lëkurës, shërbejnë për mbrojtjen e duarve nga lëndimet kimike e mekanike
- Pajisjet elektrike që përdoren gjatë ndërtimit të ujësjellësit dhe kanalizimit si aparatet për saldimit dhe gypave, përzierësja e betonit etj. duhet të ketë tokëzim të përkohshëm.

7.6.14. *Sistemi i lidhjeve për komunikim në punishte*

Komunikimi më i përshtatshëm dhe koordinimi i punëve është nëpërmjet sistemit të radiolidhjeve të dorës. Në rast se vendpunishtja është më e vogël, atëherë udhëheqësi i punëve është i obliguar të siguroi mënyrën më të përshtatshme të komunikimit.

7.6.15. *Kontrolli dhe sigurimi i Kualitetit*

Gjatë ndërtimit të rrjeteve të ujësjellësve duhet bëhen kontrollime, shqyrtime dhe matje të ndryshme me qëllim të vërtetimit të kualitetit të elementeve montuese respektivisht kualitetit të punëve të kryera.

Gjatë punëve në objekt, kryesi i punëve duhet të përmbahet projekti në tërësi si dhe kushteve të cekura me sipër.

7.6.16. *Kthimi në gjendje të mëparshme të terrenit*

Kryerësi i punimeve në shpenzime të veta, pas përfundimit të punimeve do të sjellë në gjendje të mëparshme – duke u kontrolluar nga organi mbikëqyrës, terrenin dhe çdo objekt i cili ka qenë i dëmtuar gjatë realizimit të punimeve. I gjithë materiali i tepërt duhet të largohet nga kantieri menjëherë pas mbarimit të punimeve

7.6.17. *Lidhja me gypa ekzistuese*

Procedura e ndërtimit të kycjeve me gypat ekzistues është e njëjtë por gjithmonë duhet verifikuar kualiteti dhe vjetërsia e materialit ekzistues, po ashtu para se të behet lidhja në gypat ekzistues me pare duhet bërë testimin e rrjetit ekzistues në shtypje dhe pastaj të bëhen kycjet. Verifikimin e bën Kompania Menaxhuese e Ujësjellësit.

7.6.18. *Hidrantët*

Hidrantët duhet të jetë të "nëndheshme" tip DN 80, NP 16 sipas DIN EN 14339 dhe DN EN 1074-6. Hidranti kundër zjarrit duhet të ketë mundësinë e shkëmbimit të pjesëve të brendshme nën presion. Materialet e brendshme dhe të jashtë me duhet të jenë të qëndrueshëm ndaj korrozionit. Hidrantët duhet testohen sipas EN 14339 (en 1074-6, 1074-1 dhe EN 12266-1 P10, P11).

Paketimi i hidrantëve duhet të jenë në përputhje me ISO 7 dhe të shënuar me bronz ose kartë çeliku. Materialet për valvulet do të jenë me standarde, duke përfshirë atestet dhe të certifikatat e materialit.



7.6.19. Kushtet zhvillimore të kyqjes në rrjet të ujësjellësit dhe Kanalizimeve

Kërkesë për pëlqimin e kyqjes në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve

Faza e parë (I)

Kushtet për kërkesë (Zyra e Protokollit)

- Pëlqimi urbanistik për ndërtimin e objektit nga Drejtoria e Urbanizmit
- Fleta Poseduese dhe Kopja e Planit
- Kopja e Projektit kryesor të kanalizimit
- Dëshmi nga ujësjellësi se konsumatori i kate kryera pagesat e ujit dhe kanalizimit (Te kontrollohet nga konsumatorët paraprak).

Faza e dytë (II)

Kushtet për kërkesë (Zyra e Protokollit)

- Dëshmi me shkrim mbi pranimin e objektit (Komisioni i Pranimit)
- Dëshmi se ka kryer pagesën e pëlqimit
- Dëshmi nga KURK Bifurkacioni se ka kryer pagesat e ujit dhe kanalizimit

Kushte tjera janë të përcaktuara edhe nga ZRRUK dhe KRU Prishtina:

- Lidhja në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit mund të realizohet vetëm sipas kushteve të përcaktuara nga Kompania. Kompania i përcakton kushtet për lidhje në bazë të projektit të aprovuar të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.
- Aplikuesi për lidhje është i obliguar që të sigurojë të gjitha pëlqimet dhe lejet e nevojshme nga organet kompetente. Po ashtu ai duhet të kryejë të gjitha punimet e nevojshme tokësore në bazë të udhëzimeve të Kompanisë. Ai është përgjegjës për të gjitha dëmet që mund të shkaktohet me rastin e kryerjes së punimeve tokësore.
- Aplikuesi për lidhje është i obliguar që të paguajë paraprakisht të gjitha shpenzimet e lidhjes. Kompania i kalkulon dhe faturon shpenzimet e lidhjes duke përfshi edhe taksën e lidhjes në bazë të tarifave në fuqi të aprovuara nga Autoriteti Rregullator i Ujit (ARRU).
- Aplikuesi për lidhje të është i obliguar që të përgatisë vendin (pusetën) ku do të vendoset ujëmatësi. Puseta e ujëmatësit duhet të ketë formën dhe dimensionet e përcaktuara nga Kompania.
- Kompania përcakton pikën e lidhjes në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe diametrin dhe materialet që do të përdoren për punimin e lidhjes.

7.6.20. Punimi i Lidhjes

Punimet dhe kushtet e lidhjes duhet të realizohen në përputhje me rregulloret e brendshme të KUR dhe ZRRUK.

- Lidhja në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit kryhet nga Kompania. Lidhja mund të kryhet edhe nga persona tjerë të licencuar për kryerjen e këtyre lloj punimeve me kusht që një gjë e tillë të jetë autorizuar nga Kompania dhe të kryhet nën mbikëqyrjen e Kompanisë.
- Lidhjet të cilat janë punuar pa autorizimin e Kompanisë do të konsiderohen si lidhje ilegale dhe do të ndërpriten nga rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit. Në raste të veçanta Kompania mund të vendosi që ti legalizojë lidhjet ilegale me kërkesën e pronarit të lidhjes me kusht që lidhja e tillë të jetë e punuar sipas normave dhe standardeve të pranueshme për Kompaninë si dhe me kusht që të jenë paguar të gjitha obligimet ndaj Kompanisë të faturuara në pajtim me Ligjin.
- Punimet tokësore parimisht nuk kryhen nga Kompania. Me kërkesën specifike të Aplikuesit për lidhje, Kompania mund ti kryejë edhe punët tokësore dhe në këtë rast Aplikuesi për lidhje i bartë shpenzimet në bazë të tarifave të Kompanisë për këto lloje të punëve.

I. Kushtet teknike për ekzekutimin e lidhjes:

- Diametri i rrjetit distributiv ku duhet të bëhet lidhja: _____ mm
- Diametri i gypit të lidhjes: _____ mm
- Kapaciteti i ujëmatësit: _____ m³/orë

II. Specifikacioni i Materialit:

Nr	Përshkrimi i Materialit	DN	Njësi a	Sasia	Vërejtje
1	Qafore/ Amborshelne				
2	Gyp				
3	Valvula				
4	Fiting				
5	Ujëmatësi				

III. Kushtet për Lidhje:

Para se të ekzekutohet lidhja, Aplikuesi është i obliguar që të:

- Nxjerrë Lejen nga autoritetet komunale për gjërmim në sipërfaqe publike;
- Paguajë shpenzimet e lidhjes në lartësi: [] EUR;
- Nënshkruajë kontratën e shërbimit me KRU'Prishtina' Sh. A.
- Kryejë punët tokësore sipas skicës së bashkangjitur;
- Ndërtojë vendstrehimin e ujëmatësit sipas skicës së bashkangjitur;

Mbrojtja nga vërshimet

Ekipet kanë konstatuar se përmbytjet janë fatkeqësi elementare të cilat kërkojnë vëmendje të posaçme, pasi që paraqiten të rrezikshme për jetën e njeriut dhe sjellin dëme të konsiderueshme materiale sipërfaqe të rrezikuara nga vërshimet janë rreth 150 ha). Të vetëdijshëm se përmbytjet nuk mund të parandalohen, por dëmet e tyre mund të amortizohen dhe menaxhohen andaj duhet të merren këto masa:

- Masat hidroteknike

Ndërtimi i terasave, gardoneve dhe pendave në shtretërit e përroskave dhe përrenjve si masa mbrojtëse hidroteknike për ta minimizuar fuqinë gërryese.

- **Ndërtimi i argjinaturave** në brigjet e lumenjve si masë parandaluese
- Mbjellja e fidanëve pyjore në shtretërit e lumenjve
- Ndalimi i nxjerrjes së inerteve në shtretërit e lumenjve Masat bujqësore
- Të mirëmbahen tokat bujqësore
- Të aplikohen drejtë praktikat bujqësore
- Përdorimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit të bëhet në bazë të udhëzimeve të ekspertëve
- Rritja e investimeve për mbrojtjen e tokës në brigjet e lumenjve.
- Masat biologjike
- Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerjet e pa kontrolluara dhe nga zjarri
- Ndalimi i kullotjes në masivet e varfra me bimësi
- Pyllëzimi i viseve të zhveshura dhe atyre të degraduara
- Krijimi i brezave të gjelbër në ato rajone ku shkalla e erozionit është e lartë.
- Erozioni duhet të kufizohet në brigjet e lumenjve kryesor me rregullimin e shtretërve dhe mbëltime të druve që do të mbulonin brezin prej 10 m largësi nga lumi
- Shfrytëzimi i tokave bujqësore në fushat lumore të lumenjve kryesor duhet të kufizohet me kulllosa të përhershme ose pyje.



7.6.21. Rrjeti e ujitjes

Sipas informacioneve nga raportet sektoriale aktualisht komuna e Fushë Kosovës nuk ka ujitje të tokave por sipas një studimi të fisibilitetit, 202 hektar janë në sistem të ujitjes tabela 1. Në projektin Ibër Lepenc është i planifikuar që edhe tokat bujqësore të Fushë Kosovës të hynë në sistem të ujitjes sidomos sipërfaqet e tokave përgjatë lumenjve të mëdhenj të cilat janë më të përshtatshme për ujitje.

Rreth 900 ha të tokave bujqësore janë shumë të përshtatshme për ujitje dhe rreth 850 ha të tjerë do të mund të ishin të favorshme me disa masa përmirësuese. Pjesa më e madhe e tokës sipas informacioneve nga Drejtoria e Bujqësisë kanë një sistem të tubacioneve të shtrirë në disa toka bujqësore por që tani është i demoluar dhe nevojiten investime për të kthyer në gjendjen funksionale.

Komunat	Sipërfaqja e ujitur	Sipërfaqja e përgjithshme e tokave të	Gjithsejtë sipërfaqe (ha)
Kosova	42.226	195.575	237.801
Deçani	5.144	4.423	9.567
Giakova	3.626	7.333	10.959
Glllogoci	108	4.202	4.310
Gjilani	285	8.953	9.238
Dragashi	496	4.174	4.670
Istogu	3.831	6.849	10.680
Kaçaniku	293	3.019	3.312
Klina	2.418	5.623	8.041
Fushë	202	5.817	6.019
Kamenica	509	8.779	9.228

Tabela 19 Sipërfaqet e tokave bujqësore të ujitura sipas komunave²

Sasitë e nevojshme të ujit për ujitje në bujqësi do të varen nga sipërfaqet bujqësore dhe nga struktura e sipërfaqeve të mbjella. Sipas dokumentacionit të hartuar deri tash, janë shqyrtuar mundësitë për ujitjen e rreth 1750 ha të sipërfaqes së punueshme. Duke i llogaritur rreth 3200 m³ ujë për një hektar gjatë vitit me thatësi mesatare, atëherë nevojat e përgjithshme do të ishin rreth 5600000 litra/vit. Mirëpo, në bazë të studimit të mëtejshëm të këtij problemi duhet llogaritur se këto sipërfaqe do të rriten në rreth 50 hektarë për çdo vjet. Bilanci i sasive të përgjithshme të nevojshme të ujit për një vjet dhe njëjtë mund të kalkulohet deri në vitin 2026, që duhet mundësuar realizimin orientues të prodhimit në të gjitha fushat ekonomike dhe t'i plotësojë nevojat e popullsisë së Komunës së Fushë Kosovës.

Duke e pasur parasysh gjendjen ekzistuese të tokave bujqësore dhe informacionet që vijnë nga Drejtoria e Bujqësisë mendohet se tokat bujqësore me sipërfaqe 1798 ha janë më të përshtatshme për ujitje, duke ndikuar në rritjen e bonitetit të këtyre tokave dhe në rritjen e rendimenteve dhe produkteve bujqësore. Komuna ka realizuar disa projekte të rëndësishme në pastrimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e shtretërve të të gjithë lumenjve, përrenjve dhe përroskave që gravitojnë në fshatrat e kësaj komune (me 2013-2014, për të vazhduar pastaj prapë edhe me 2016) janë rregulluar (zgjeruar) dhe pastruar shtretërit e lumenjve:

Drenicës në Grabovc të Poshtëm në gjatësi 2100 m, Bardh të Madh, Pomozotin, Bardh i Vogël, Vragoli në gjatësi prej 4500 m.

Graçankës në Miradi të Poshtme dhe Epërme në gjatësi prej 5000 m,

²Anketat e Ekonomisë Shtëpiake Bujqësore, ESK 2010



Prishtevkës në Bresje në gjatësi prej 1300 m'


Zanogës në Henc në gjatësi prej 1500 m(përrockë)

Po ashtu me 2014 është realizuar edhe projekti i parë i instalimit të sistemit të ujitjes (pragut kapërderdhës bashkë me marrjen e ujit) në lumin Drenica në 2 fshatrat Pomozotin dhe Sllatinë e vogël, me qëllim të grumbullimit të ujit për të mundësuar ujitjen e tokave bujqësore në këtë zonë. Duhet theksuar se, rregullimi i këtyre shtretërve ka reduktuar intensitetin e përmbytjeve gjatë këtyre viteve në minimum dhe ka rritur dukshëm prodhimtarinë bujqësore.

Komuna është e interesuar që t'i rritë sipërfaqet nën ujitje të tokave bujqësore, por pasi që nuk ka impiant dhe kolektorë për trajtimin e ujërave, uji i lumenjve nuk do të mund të shfrytëzohet edhe për një kohë të gjatë për ujitje derisa të mos instalohet impianti, prandaj fermerët detyrohen që për ujitje të shfrytëzojnë ujin nga pusët apo nga ndonjë burim tjetër. Vlen të theksohet se prej 1784 ekonomive bujqësore sa ekzistojnë në Komunën tonë, vetëm 263 ekonomi janë deklaruar se bëjnë ujitjen e tokave, në sipërfaqe prej 100 ha edhe atë kryesisht në parcela të vogla prej 0.25-0.50 ha, që as për së afërmi nuk i plotëson nevojat e fermerëve për ujitjen e tokave bujqësore.

Ish-Ndërmarrja Bujqësore "Lavërtari-Blegtori" e cila ka qenë në kuadër të KBI "Kosova -Export" të Fushë-Kosovës (tani fermë dhe qumështore "Euroлона") nga viti 1998 deri me 1990 ka shfrytëzuar ujin për ujitje të tokave të saj bujqësore në sipërfaqe prej 270 ha, prej 836 ha tokë të punueshme sa kishte në evidencën e kadastrit të asaj kohe në parcelat e bllokut të Veternikut, kryesisht për ujitjen e misrit dhe jonxhës, ujitje e realizuar nga stacioni kryesor i pompimit të instaluar në Çagllavicë me kapacitet prej $Q_{max}=500/s$, nga hidrosistemi "Ibër-lepenc", i cili është furnizuar me ujë nga Liqeni i Badovcit. Edhe sot ekziston rrjeti nëntokësor për ujitje i padëmtuar në parcelat e kësaj kompanie, por që pas lufte (1999) janë plaçkitur, demoluar të gjithë gypat për ujitje, hidrantet dhe i gjithë instalimi tjetër, prandaj me projektin e Bankës Botërore dhe Agjencisë Evropiane për Rindëtim, Qeveria e Kosovës ka dhënë planin e detajuar të Fizibilitetit për mbrojtjen e kanalit "Ibër-Lepenc" me qëllim të rehabilitimit dhe vënien në funksion të këtij hidrosistemi përgjatë tërë kanalit në gjatësi prej 49 km.

Shtrohet imperativ i kohës që Kompania në fjalë, Euroлона me 540 ha tokë sa është privatizuar nga AKP si dhe fshatrat përreth, të përfshihen në të ardhmen nën sistemin e ujitjes në këtë hidrosistem.



Harta 11 Rrjeti i ujitjes dhe objektet hidroteknike

Sistemi i ujitjes sipas Ligjit për Rregullimin e tokës nënkupton objektet hidroteknike, të cilat shërbejnë për qëllime të ujitjes dhe nevoja tjera të një territori të caktuar.

Me këtë Planifikohet që gjitha tokat bujqësore të cilat janë të përshtatshme për ujitje të hyn në sistem të ujitjes duke e e aktivizuar dhe duke e vënë në funksion rrjetin e vjetër të ujitjes.

- Të largohen gypat të cilët janë të dëmshëm për shëndetin e popullatës,
- Sistemi i tubacioneve të shtrihet sipas rrjetit të rrugëve bujqësore duke ofruar qasje në sistem të ujitjes në secilën parcelë.
- Të sigurohen edhe burime tjera për ujitje me shpime, sisteme të akumulacioni të ujit etj.
- Në disa pjesë për shkak të kursimit të ujit preferohet sistemi pik pik i ujitjes dhe sistemi digjital;
- Duhet që sistemi i tubacionit të mbrohet dhe të jetë i shënjuar në mënyrë që të mos dëmtohet nga punimet tjera.

Kriteret e menaxhimit të sistemit të ujitjes

Kriter kryesor i është shpërndarja e barabartë e sasisë së ujit, koha e shpërndarjes në përputhje me grafikun e ujitjes, efienca e ujitjes, shpërndarja e barabartë si për fermerët në fillim të kanalit ashtu dhe për ata në fund të kanalit, cilësia e mirëmbajtjes dhe funksionalitetit të skemës, shkalla e mbledhjes së tarifave, rendimenti i prodhimit për njësi sipërfaqe të ujitur dhe qëndrueshmëria e skemës ujitëse.

Plani i Shërbimeve të Ujitjes do të hartohet çdo vit, së paku një muaj para fillimit të sezonit të ujitjes. Ky plan normalisht përbëhen nga shtatë komponentë. Ata janë:

1) Përcaktime të matshme të standardeve të shërbimit që do të sigurohen, si shpërndarja dhe furnizimi i ujit, mirëmbajtja e sistemit etj;

- 2) Shërbimet (p.sh. lëvizja e ujit, shpërndarja, kullimi);
- 3) Mirëmbajtja dhe riparimet apo përmirësimet që duhen;
- 4) Buxheti, tarifa e shërbimit të ujitjes dhe procedurat e administrimit financiar;
- 5) Aktivitetet menaxheriale dhe institucionale;
- 6) Monitorimi i performancës së administrimit dhe aspekteve mjedisore; dhe
- 7) Mbajtja e proces-verbaleve dhe përgatitja e raporteve.

7.7. Rrjeti i shpërndarjes lokale me energji elektrike

Duke u bazuar në planet zhvillimore sektoriale të hartuara si pjesë e Planit Zhvillimor Komunal, Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Rregullues Urban të Fushë Kosovës, dhe duke marrë për bazë gjendjen ekzistuese të rrjetit energjetik dhe atij të telekomit, është analizuar në tërësi, në të njëjtin janë nxjerrë përfundimet si dhe nevojat për zgjerimin e kapaciteteve energjetike në komunën e F. Kosovës.

Nga plani zhvillimor komunal kanë qenë këto dy objektiva të cilat është dashur të plotësohen:

- Rekomandimet e Master Planit për Zhvillimin e Sistemit Distributiv të Kosovës deri në 2015:
- Eliminimin gradual të TS 35/10kV dhe kalimin në TS 110/20kV
- Kalimin nga rrjeti distributiv 10kV në rrjetin distributiv 20kV
- Zëvendësimin e TS 10/0.4kV me ata 20/0.4kV.
- Zëvendësimin i Linjave Ajrore 230/400V me kablo bistek apo edhe kablo nëntokësorë varësisht nga zona urbane -rurale.
- Rregulloret e IEC, IEEE dhe ANSI për projektet e reja, linjat urbane të furnizimit me energji elektrike dhe ato telekomunikuese të ndjekin të njëjtat trase dhe të ndërtohen njëkohësisht.

Gjithashtu nga PZHK për rrjetin energjetik është nxjerrë caku nr 10:

- Përmirësimi i rrjetit për furnizim me energji elektrike dhe rrjetit të telefonisë e internetit.

7.7.1. Shtrirja e rrjetit dhe instalimeve elektrike

Objektet energjetike të rëndësisë shtetërore

Ndërtesa energjetike me rëndësi të veçanta për shtetin e Kosovës e që janë të lokalizuara në territorin komunal të Fushe Kosovës janë:

- Linja Energjetike Transmetuese (LP)
- Linja 400 kV nr 420/1 Kosova B-Ferizaj 2 (zona afër autostradës)
- Linja 110 kV nr 1114 Kosova A -Prishtina 1 (zona afër autostradës)
- Linja 110 kV nr 112 Kosova A- F Kosova ⁽¹⁾
- Linja 110 kV nr 112/1 F Kosova -Lypiani.⁽²⁾

⁽¹⁾⁽²⁾ Nga kjo linjë do të furnizohet nënstationi i ri në F Kosovë ashtu që do të pritët linja e lartpërmendur dhe nga ajo do të krijohen dy linja

Nënstationet (NS)

Në periudhën e ardhme dy vjeçare në Fushe Kosovë do të ndërtohet nënstationi:

- NS Fushë Kosova 110/10(20) kV, 2x40 MVA

Ky nënstation do të ndërtohet në vendin e nënstationit ekzistues të NS 35/10 kV i cili me ndërtimin e nënstationit të ri do të rrënohet.

- NS 35/10 kV Fushë Kosova (Do të rrënohet)

Korridoret e linjave si dhe lokacionet ku janë të ndërtuara pajisjet energjetike sipas këtij plani do të merren në konsideratë duke pasur parasysh:

- Plotësimin e kriterëve tekniko teknologjike
- Parandalimin e ndikimeve negative në mjedis.

Kahja e tanishme zhvillimore është që të bëhet rikonstruimi i linjave dhe nënstacioneve energjetike si në nivel të distribuimit ashtu edhe në atë të transmisionit. Hapësirat për ndërtimin e NS 110/10(20) kV duhet të definohen me plan urbanistik të detalizuar nga komuna, me rastin e lëshimit të lejes ndërtimore nga kompania energjetike (KOSTT/KEK/KEDS, etj.)

Në rrugët ku parashihet të shtrihen linjat energjetike është e nevojshme të sigurohet shtrirja e instalimeve me plan ashtu që në njërin anë të rrugës të alokohen pajisjet energjetike, ndërsa ana tjetër për pajisje telekomunikuese dhe ato të furnizimit me ujë, ndërsa në mesin e rrugës të vendosen tubacionet për ujëra atmosferike dhe kanalizime.

7.7.2. Kapacitetet egzistuese dhe ato të planifikuara

Komuna e Fushë Kosovës momentalisht furnizohet me energji elektrike nga nënstacioni 35/10 kV në të cilin janë të vendosura 4 trafo secila me fuqi prej 8MVA, pra gjithsej 32 MVA. Në periudhën deri në vitin 2020 ky nënstacion do të dekomisionohet (rrënohet) ndërsa do të vazhdoj ti furnizoj konsumatorët deri në vitin 2020. Në tabelë është paraqitur gjendja e tanishme e furnizimit si dhe pajisjet që janë në shërbim të furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike.

Linjat 35kV				
	Linja 35 kV NS Kosova A-NS F Kosova.			5 km
	Linja 35 kV NS Prishtina 1-NS F Kosova.			4.63 km
Nënstacionet 35/10 kV				
	T1+T2 (8+8) MVA	T3 8 MVA	T4 8 MVA	32 MVA
Linjat ajrore dhe kablloviqe 10 kV				
1.	Miradi	Kuzmini -Ujesjellesi	F Kosova 1	17 dalje 10 kV ajrore / kablloviqe
2.	Apolloni	Udhëkryqi Kabllorik	Mulliri	
3.	Vragolia	F Kosova 2	F.e U. Kafsheve	
4.	Pozhegu	Ndertesat Bresje	Hekurudha	
5.	Bardhi i Madhe	Thertorja	Shtep . Kultures	
6.	Zona Industriale			
7.	Albana			

Tabela 20 Kapacitetet egzistuese dhe ato të planifikuara

7.7.3. Ndërtimi i Nënstacioneve (NS)

Nënstacioni 35/10 kV i cili është ndërtuar në F. Kosovë është i tej ngarkuar me 117 % të kërkesave të konsumit. Me qëllim të përmbushjes së kërkesës për furnizim është paraparë ndërtimi i nënstacionit të ri:

- NS Fushë Kosova 110/10(20) kV me fuqi 2x40=80MVA-deri në vitin 2020.

Nënstacioni i ri 110/10(20) kV do të ndërtohet në vendin ku është tani NS 35/10 kV F. Kosova.

- Ndërtimi i NS 10(20)/04 kV

Nga analiza e numrit të banorëve, kërkesës për energji, dhe shpërndarjes së vendbanimeve si dhe rritjes së kërkesës në 1.5(%) në bazë vjetore në mënyrë tabelore është paraqitur nevoja për ndërtimin e kapaciteteve të reja në rrjetin e energjisë elektrike në komunën e F. Kosovës.

Analiza përfshin konsumatorët në kategorinë e amvisërive (shtëpi banesë) ndërsa për ata komercial e të tjerë kërkesat drejtohen sipas rastit te kompania e shpërndarjes, shih tab.1 janë paraqitur kërkesat.

NR	Emri i Vendbanimit	Numri i banorëve	Fuqia instaluar në Nënstacionet Ekzistuese (kVA)	Kërkesa për energji deri ne vitin 2023 *	Nevoja për shtim te Fuqisë(+/-)	Nevoja për Nënstacion te ri
1	Fushë Kosova	21558	29710	14948	14762	
2	Nakarada	1178	1510	817	693	
3	Lismiri	1143	500	793	-293	1x400
4	Miradi e ulët	2435	1440	1688	-248	1x400
5	Vragoli	2338	1450	1621	-171	1x250
6	Miradi e përme	2281	1510	1582	-72	1x160
7	Sllatinë e madhe	2828	1530	1961	-431	2x250
8	Sllatinë e vogël	878	500	609	-109	1x160
9	Harilaq	825	520	572	-52	1x160
10	Henc	864	660	599	61	
11	Bardh i madh	4006	2680	2778	-98	1x160
12	Bardh i vogël	711	400	493	-93	1x160
13	Pomozotin	675	650	468	182	
14	Grabovc	1178	1210	817	393	
15	Kuzmin	401	400	278	122	
16	Totali	43299	44670	30023	-1566	2350

*-Kërkesat për energji deri ne vitin 2023 me nje shtim vjetor te kërkesës prej 1.5%.

Tabela 21 Kërkesat për energji deri ne vitin 2023 me nje shtim vjetor te kërkesës prej 1.5%.

- Sllatinë e Madhe..... 2x250 kVA
- Miradi e Ulët1x400 kVA
- Lismiri1x400 kVA
- Vragoli1x250 kVA
- Miradi e Epërme1x160 kVA
- Sllatinë e Vogel1x160 kVA
- Harilaq1x160 kVA
- Bardh i Madh1x160 kVA
- Bardh i Vogël1x160 kVA

Për furnizimin e konsumit duhet të nderohen $5 \times 160 = 800$ kVA , $3 \times 250 = 750$ kVA dhe 2×400 kVA me fuqi totale prej 2350 kVA do të ndërtohen linja ajrore/kablloviqe për furnizimet përkatëse të këtyre nënstacioneve.

7.7.4. Linja Energjetike-Nivele të ndryshme të tensionit(LP)

Për furnizimin e nënstacionit të ri i cili do të ndërtohet deri në vitin 2020 nevojitet të ndërtohet kjo linjë e cila është pjesërisht e dyfishtë:

Linja e dyfishtë 2×110 kV Kosova A-F.Kosova –Lipiani , ku njëra

- Linja 110 kV nr 112 Kosova A- F Kosova
- Linja 110 kVnr 112/1 F Kosova -Lipiani.*

*Nga kjo linjë do të furnizohet nënstacioni i ri në F Kosovë ashtu që do të pritët linja e lartepërmendur dhe nga ajo

Pjesa ajrore e këtyre linjave ndërtohet nga përçuesit ACSR $3 \times 360/65$ mm².

Linja nëntokësore ndërtohet -Kablli Al/XLPE/Cu-/HDPE $1 \times 1000/95$ mm² 110kV .

Në foto është paraqitur traseja e linjës 2×110 kV Kosova A-F Kosova -Lypiani



Figura 15 Pamja e trasesë së linjës 2×110 kV Kosova A-F Kosova –Lipjani (ajrore/nëntokësore)

Pas ndërtimit të nënstacionit të ri 110/10(20)kV dhe linjës 110 kV, dy linja 35kV

- Linja 35 kV Kosova A –F. Kosova
- Linja 35 kV Prishtina 1-F. Kosova

Më tutje nuk kryejnë asnjë funksion dhe komuna e Fushë Kosovës duhet të kërkojë nga KEDS-i që ti demontojë ato sepse në korridoret e këtyre linjave ka ndërtime dhe ka rrezik të vazhdueshëm për banorët që jetojnë nën ato linja.

7.7.5. Rrjeti ajror dhe kabllor 10(20) kV

Plani i propozuar i zhvillimit të rrjetit do të realizohet duke kyçur në rrjetin ekzistues 10(20) kV edhe nënstacionet e planifikuara përmes rrjetit kabllor 20 kV i cili duhet të ndërtohet sipas skemave magjistrale

unazë hapur (ku është e mundur) duke u furnizuar nga nyjet kryesore të nënstacioneve përkatës tani 110/10(20) kV F. Kosova.

Daljet për nënstacionet e reja duhet të realizohen si shtrirje e lirë e futur, shtrirje në gypa plastik apo edhe përmes kanaleve kabllorë adekuatë me kabëll 3xXHE 48 A 240 mm² posaçërisht në qytet. Realizimi i këtij plani duhet të bëhet përmes një qasje strategjike dhe duke marrë parasysh prioritete si dhe dinamiken e zhvillimit të tij ashtu që ndërtimi të mund të përcjell dhe përshtatet në raport nga fuqia e dukshme dhe aftësia bartëse e kabllorëve*.

Të gjitha pajisjet e reja të rrjetit të tensionit të mesëm duhet të jenë për tension 20 kV me qëllim të përgatitjes së rrjetit për kalim në këtë nivel tensioni sipas rekomandimit të master planit. Gjithashtu për furnizimin e nënstacioneve të propozuara në pjesët rurale të komunës së Fushë Kosovës duhet të ndërtohet rrjeti kabllor ose ajror nga shtyllat e betonit nga përçues Al/Çe 35 mm² nëse nënstacionet janë radiale, dhe nga Al/Çe 50 mm² nëse parashihen të vazhdojnë për kapacitete të tjera.

Në nivelin e tensionit 20(10) kV duhet të planifikohet ndërtimi i këtyre nënstacioneve:


- Sllatinë e Madhe..... 2x250 kVA
- Miradi e Ulët1x400 kVA
- Lismiri1x400 kVA
- Vragoli1x250 kVA
- Miradi e Epërme 1x160 kVA
- Sllatinë e Vogel1x160 kVA
- Harilaq1x160 kVA
- Bardhi i Madh1x160 kVA
- Bardhi i Vogël1x160 kVA

Gjithashtu për furnizimin e nënstacioneve të propozuara duhet të sigurohen lokacione në vendet ku kërkohet ndërtimi NS 10(20)/04 kV si dhe trasetë nga kalojnë kabllot që planifikohet të ndërtohen.

Ne vazhdim është përshkruar gjendja e tanishme, planet deri ne vitin 2023 si dhe skema e shpërndarjes së instalimeve:

Niveli i Tensionit	Gjendja Ekzistuese	Gjendja e Planifikuar	Komente
35/10 kV	NS Fushe Kosova 35/10 kV S=(4x8)=32MVA	Nuk ka te planifikuar rrjete 35kV	Ky NS do te rrenohet
110/10(20)kV	Nuk ka stabilimente 110 kV	NS Fushë Kosova 110/10(20) kV	Te funksionalizohet deri vitin 2020
110kV	Nuk ka stabilimente 110 kV	Ndërtimi i linjës 2x110kV Kosova A-F.Kosova – Lipiani	Kjo linje pritët te ndërtohet deri ne vitin 2019
35 kV	Linja 35 kV Kosova A-F Kosova Linja 35 kV Prishtina 1-f Kosova	Nuk nevojiten kur te lëshohet ne pune NS 110/10(20)kV	Është mire qe te behet dekomisionimi i linjave

Tabela 22 Planet deri ne vitin 2023 si dhe skema e shpërndarjes së instalimeve



Harta 12 Shpërndarja e instalimeve

7.7.6. Shiritat Mbrojtës rreth Stabilimenteve Energjetike

Shfrytëzimi i këtyre shiritave rregullohet me norma teknike si dhe me ligje përkatëse (UA) dhe më tutje këto konsiderohen si zona të sigurisë dhe shërbejnë, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e tyre në vazhdimësi.

- për këtë qëllim për **linja energjetike kablovike nëntokësore** duhet të sigurohen koridore :

Nr	Linja kablovike nëntokësore	Ekzistuese	Planifikuara
1	• 2x110kV	6	12
2	• 110kV	5	10
3	35 kV	3	5
4	• 20 kV	2	5
5	• 10 kV	2	5

- Largpërçuesi kur ndërtohet si **linjë ajrore** është e nevojshme që t'i sigurohet një shirit mbrojtës me dimensione të përcaktuara në tabelën e mëposhtme.

Nr	Linja ajrore energjetike	Ekzistuese	Planifikuara
1	• 2x110 kV	50	60
2	• 110 kV	40	50

3	35kV	30	30
4	• 20kV	20	20
5	• 10kV	15	15

7.7.7. E.4 Kushtet teknike dhe kërkesat e tjera

Autoriteteve komunale u takon që ta koordinojnë këtë aktivitet dhe në varësi të planeve të tyre dhe interesave të gjithmbarshme të ofrohen zgjidhje më të mira të mundshme si në aspektin e ofrimit të kushteve infrastrukturore, dhënies së lejeve dhe autorizimit, ashtu edhe në aspektin e menaxhimit të hapësirave dhe ambientit të kësaj zone ashtu që bashkë-rëndimi të mundësojë:

- Realizimi sa më konkret i planeve
- Shfrytëzimi racional i hapësirave
- Menaxhimi më i lehtë i punëve
- Ndërhijet sa më të vogla nga palët në infrastrukturën e njëri-tjetrit
- Zvogëlimi i kostove për implementim.
- Qasje më e lehtë, etj.

7.7.8. Kushtet e përgjithshme

Kushtet e mëposhtme janë bazë për ndërtimin e objekteve elektroenergjetike që duhet të respektohen me rastin e ndërtimit të infrastrukturës energjetike, që përshkruhen si më poshtë:

Para së gjithash e tërë infrastruktura energjetike e cila do të ndërtohet duhet që pa përjashtim ti plotësoj kriteret themelore si në vijim:

- Asnjë nga objektet energjetike ekzistuese apo të reja të mos jetë në grupin e objekteve që shkaktojnë ndotjen dhe ndikime aktive të ambientit.
- Aplikimi i kabllove nëntokësore të linjave në nivelet 110/20/10/0.4 kV do ta rrisë disa herë sigurinë e furnizimit dhe eliminon rrezikun e kontaktit me këtë tension dhe ndikimet vizuale në ambient, si dhe zvogëlimin e ndikimit të rrezatimit FEM (fushës elektromagnetike në ambient).
- Dizajnimi i stabilimenteve të reja duhet të përfshijë edhe forma të përshtatshme arkitektonike, dhe estetike ashtu që të përshtaten në ambient dhe të mos shkaktojnë efekte negative si (rrezatim elektromagnetik, zhurmë, ngrohje, zjarre, vibrime, etj).
- Të gjitha pjesët metalike konstruktive të këtyre stabilimenteve të vendosura brenda objekteve dhe jashtë tyre në hapësira publike dhe tjera duhet të përtokzohen ashtu që të mos paraqesin rrezik për njerëzit, shtazët, pronën dhe të tjera nëse këta të fundit jetojnë gjithnjë ose herë pas here në afërsi të këtyre stabilimenteve.
- Që pajisjet ekzistuese dhe ato të reja të garantojnë furnizim të rregullt dhe kualitativ duhet të kenë fuqi të mjaftueshme për të furnizuar të gjithë konsumatorët me tension 230/400 V(5±10%).

7.7.9. Nënstacionet energjetike

- Të gjitha pëlqimet, lejet ndërtimore si dhe aktet tjera që lëshohen nga autoritetet përkatëse komunale, duhet të jenë në pajtim të plotë me planet hapësinore komunale, kushtet dhe kërkesat teknike si dhe aktet tjera të përcaktuara me ligje në aplikim.
- Ndërtimi dhe rikonstruktimi i stabilimenteve energjetike (nënstacione, linja ajrore/kablloviqe, nënstacione, telekomunikimet, ndërtesa për këto qëllime etj) do të ndërtohen në pajtim me rregulloret teknike, standardet ndërkombëtare si dhe praktikave të vendeve të përparuara.
- Ndërtimi i kapaciteteve të reja duhet të shfrytëzojnë trasat ekzistuese të linjave si dhe lokacionet ekzistuese të stabilimenteve gjithkund ku është e mundur një gjë e tillë, por duke përjashtuar zona në afërsi të pa lejuar nga objekte ndërtimore infrastrukturore apo të destinimeve të posaçme.
- Gjithnjë ku ndërtimi në trase dhe lokacione të njëjta është i pa mundur apo i pa lejuar teknikisht këto rindërtime të konsiderohen si ndërtime të reja dhe të aplikohen rregulla si për ndërtime të reja.



- Për ndërtimin e nënstacioneve 110/XX kV duhet të sigurohet sipërfaqe e caktuar toke dhe atë

Pajisje të hapura 100x100 m.

Të mbyllur 60x60 m

- Mund të parashihen dhe lejohen ndërtimi i NS 10(20)/04 kV në hapësirat e gjelbërta dhe rreth rrugëve edhe pse kjo nuk është e paraparë me plane, por duke marrë në konsideratë që të njëjtat të akomodohen në ambiente duke mos e degraduar pamjen (peizazhin) në hapësirë.
- Nëse ky është rasti që NS 10(20)/04 kV të ndërtohen brenda zonave të mbrojtura kjo duhet të bëhet duke siguruar lejet dhe kushtet specifike nga ndërmarrja përkatëse energjetike.
- Lejohen ndryshime të traseve të linjave dhe lokacioneve të nënstacioneve me qëllim që të njëjtat të përfaqësojnë zgjidhje më të mira teknologjike ashtu që mund të vendosen teknologji GIS (gas insulated system) etj., kur hapësira e tanishme është e pamjaftueshme.
- Në rast se nënstacionet furnizojnë objekte me banesa kolektive, me qëllim të ruajtjes së ambientit përreth objekteve, atëherë kur të ketë mundësi teknike, rekomandohet vendosja e transformatorit në brendi të objektit, sipas normave dhe rekomandimeve.

Nëse nënstacioni vendoset brenda objektit përpos tjerash duhet të plotësojnë kushtet teknike të parapara me standarde për objekte të tilla, e që janë:

- Transformatorët energjetikë që vendosen brenda ndërtesës duhet të jenë të tipit "Thatë".
- Vendi i montimit të nënstacionit të ketë të siguruar qasje të lirë për mjete të transportit, pirunare, karroca, shërbime zjarrfikëse, të jetë i mbrojtur nga vërshimet dhe hapësira të ketë ventilim dhe ajrosje.
- Në bllokun e tensionit të mesëm të ketë së paku një kthinë rezervë për kycje të mëvonshme.
- Të sigurojnë që janë zbatuar të gjitha masat e sigurisë për rastet e banimit kolektiv.
- Organi komunal i cili është përgjegjës për dhënien e lejes (pëlqimit) ndërtimor kur ka të bëjë me ndërtimin e objekteve në korridorin e mbrojtur të linjave apo edhe përreth nënstacioneve duhet të kërkojë nga investitori kushtet e posaçme për ndërtimin e stabilimenteve, nënstacioneve, linjave të cilat i lëshon ndërmarrja përkatëse energjetike.

7.7.10. Linjat Energjetike

Për ndërtimin e linjave energjetike ndërmarrjet energjetike duhet të ju përmbahen rekomandimeve dhe rregulloreve teknike edhe kur ato kalojnë nëpër territore të komunave, ato duhet ti njoftojnë, dhe të kërkojnë pëlqime nga organet kompetente komunale ashtu që shiritat mbrojtës për linja të mos bien ndesh me infrastrukturën ekzistuese si dhe harmonizimin me planet komunale të asaj komune.

Ndër të tjera gjatë ndërtimit të infrastrukturës duhet të merren parasysh kushtet e mëposhtme:

- Shfrytëzimi dhe rregullimi i hapësirës brenda shiritave (korridoreve) të mbrojtura të linjave duhet të jetë në pajtim me udhëzimet e posaçme teknike dhe kushteve të organeve përgjegjëse ose personave juridik të autorizuar.
- Ndërtimi mbi kanalet kabllorike të linjave është i ndaluar, përjashtimisht është i lejuar ndërtimi i parkingjeve, terreneve sportive, infrastrukturës së ulët por duke siguruar qasje të lirë për hapjen e kanaleve të të njëjtëve.
- Hapësira nën largpërçues në parim nuk është e dedikuar për ndërtim të objekteve ndërtimore për banim, rekonstruktiv të objekteve banesore, rritje të bimëve të larta etj.
- Në rast të rindërtimit në objekte ndërtimore banesore – kur rritet lartësia e këtyre objekteve kjo duhet të bëhet në pajtim me normat dhe standardet teknike ashtu që të mos cenohet korridori i linjave.
- Kabllot e tensionit të lartë 110 kV e edhe nivelit me të lartë, duhet të ndërtohen në trase përgjatë rrugëve në pjesët e tyre ku frekuenca e transportit është më e vogël dhe duke shmangur këmbët e urave, trotualet etj.
- Në vendet ku linja ajrore kalon në kabllorike duhet të sigurohet hapësira për rreth shtyllës për vendosje të pajisjeve të TL me qasje të pa penguar në pajtim me rregulloret teknike.
- Gjatë ndërtimit të një linje energjetike kabllorë nëse kryqëzohet apo edhe ndërtohet në afërsi të infrastrukturës tjetër, atëherë duhet të respektohen normat mbi distancat përkatëse, ashtu që të mos manifestohen ndikime tjera negative.

- Rikonstruktimi i infrastrukturës energjetike duhet të behet duke shfrytëzuar korridoret ekzistuese dhe në pajtim me rregulloren teknike, gjithnjë ku kjo është e mundur.

- Në të gjitha rrugët e asfaltuara, e posaçërisht në zona urbane në njërin anë të trotuarit, duhet rezervuar për ndërtimin e kanalit kabllor për shtrirjen e linjave dhe instalimeve tjera siç është paraqitur në figurën “kanalizimi kabllor”.

Numri dhe dimensionet e gypave fleksibil të vendosur në kanalizim kabllor përcaktohet në varësi nga nevoja dhe do të ishte dashur të definohet në projektin detal – zbatues.

7.7.11. Rrjeti i tensionit të ulët 400/220V

Gjatësia me e madhe e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike është në këtë nivel, pasi që rrjeti është i shpërndarë deri te secili konsumator.

Në varësi nga numri dhe shpërndarja e konsumatorëve, këto rrjeta ndërtohen si ajrore, kabllorë (nëntokësore) apo edhe kombinim i këtyre dy formave.

Rrjeti i tensionit të ulët ndërtohet duke marrë në konsideratë kushte si me poshtë :

- Për kyçje në rrjetin e shpërndarjes së secili konsumator duhet të kërkojë leje për kyçje nga operatori i shpërndarjes, ndërsa për secilin konsumator komuna përmes trupave inspektues do të kujdeset për mbarrëvajtjen.
- Ndërtimi i rrjetit të TU në pjesën e planifikuar urbane dhe tjetër, duhet të realizohet duke përdorur kabllorë të tipit PPOO ose XPOO varësisht nga vendi dhe mënyra e shtrirjes kabllorë / ajrore.
- Rrjeti duhet të planifikohet si rrjetë trefazore radiale për arsye të shpërndarjes së shpenzuesëve sipas trafo regjioneve dhe duhet që secili grup i shpenzuesëve të analizohet se si ndikon në shpërndarjen e tërësishme brenda atij trafo regjioni dhe me gjerë.
- Për ndërtimin e rrjetit kabllor të tensionit të ulët aplikohen kriteret e njëjta si për rrjetin (20)kV të cilin e trajtojmë më lartë, por në pjesët periferike të përfshira në zonën e planifikimit urban rrjeti mund të jetë edhe ajrore –në pjesët ku shtëpitë janë të shpërndara.
- Rrjeti i TU i ndërtuar me kabllorë ajrore të tipit bistek (tufë) vendoset në shtylla nga betoni i armuar, por kjo duhet të realizohet duke aprovuar projekte sipas një plani strategjik dhe jo si rrjet ad-hock sepse shkakton degradimin e hapësirave dhe pamundëson realizimin e këtij plani, gjithashtu edhe vendosja e pajisjeve duhet të implementohet duke shikuar edhe anët estetike dhe ndikimeve në ambientin e zonës.
- Furnizimi i banesave kolektive do të bëhet me kabllorë që u ceken me seksion jo më të vogël se 4 x 95 mm² ose 3x75+51.5 mm² (apo sipas projektit).
 - Furnizimi bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga NS deri në kuadrin e banesave ndërsa për dalje ajrore duhet të nxjerrin dalje deri në shtyllën e parë nga NS.
 - Daljeve ajrore duhet të ju sigurohen nga një fije rezerve për rastet e varësive.
 - Në të gjitha kabllorët në fillim dhe mbarim të tyre duhet të kenë lëshues katodik përkatës për secilin nivel të tensionit.
 - Nga NS që do të ndërtohen duhet të kenë nga 8-12 dalje (varësisht nga fuqia) në anën e tensionit të ulët.
 - Mbrojtja nga mbingarkesa dhe lidhjet e shkurtra sigurohet duke vendosur siguresa në fillim të rrjetit në pajtim me kërkesat teknike.
 - Mbrojtja nga tensioni i rrezikshëm i prekjes duhet të bëhet sipas sistemit TN-C deri në vendin e kyçjes së kabllorit të TU në objekt.
 - Duhet të kushtohet kujdes mbrojtjes nga zjarri gjatë montimit të rrjetit, kjo sidomos në hapësirat e destinimeve të veçanta dhe atyre publike.
 - Në objekte të banimit kolektiv të sigurohen mjete për shuarjen e zjarrit
 - Investitori është i obliguar që të sigurojë dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e lejes së ndërtimit dhe të sigurojë mbikëqyrjen profesionale të punimeve dhe paraqitjen e kërkesës për shfrytëzim të objektit.

7.7.12. Planifikimi i ndriçimit të rrugëve

Ndriçimi aktual i lagjeve nuk është i kompletuar në të gjitha rrugët ashtu si duhet. Për këtë arsye duhet të përshihen të ndriçohen të gjitha rrugët dhe hapësirat publike ne lagje. Duhet planifikuar që ndriçimi të bëhet me llamba ekonomike të teknologjive më të reja LED- eficientë, të vendosura në shtylla metalike apo edhe ne shtylla betoni ne zonat rurale. Numri i llambave për ndriçimin e rrugëve të lagjes do të përcaktohet me projekt detal-zbatues dhe duke u bazuar në standardet ndërkombëtare për ndiçmi të rrugëve.

Furnizimi i këtyre llambave do të bëhet nga nënstacionet ekzistuese dhe ato te reja te vendosura ne ato lagje, ku edhe do të vendoset grupi i matjes se energjisë së nevojshme për ndriçim. Pajisjet për komandim të ndriçimit të jashtëm duhet të vendosen në trafo stacione ne kuadër të veçantë.

Këto pajisje duhet të mundësojnë kyçjen automatike në mbrëmje dhe shkyçjen në mëngjes dhe ne vende ku frekuenca e qarkullimit është e vogël pas orës 24 mundet qe te zvogëlohet për 50 %.

7.7.13. Ndërtimi i ndriçimit publik

Realizimi i ndriçimit publik te hapësirave publike ne vendbanime, në varësi të karakteristikave të përmbajtjeve të veçanta(banim, ndërtesë publike, rrugët, hapësirat për qarkullim monumentet e kulturës, hapësirat për rekreacion etj) edhe pse hapësirat sportive dhe rekreative duhet të trajtohen me projekt të veçantë për ndriçim.

- Kushtet e ndërtimit të ndriçimit publik do të trajtohen me leje ndërtimore dhe ne baze te planeve detale rregulluese, si dhe zgjidhjeve te bazuara ne kushtet dhe teknologji, duke respektuar kërkesat e organeve për trashëgimi kulturore, ato komunale dhe te ndërmarrjeve energjetike.
- Shpërndarja e linjave te tensionit te ulet TU te ri dhe ekzistues nuk do trajtohen por ato duhet te realizohen ne bazë te lejeve te përcaktuara dhe kushteve teknike mbi zonat e sigurisë, gjithnjë ku është e mundur.
- Me këtë plan parashihet shfrytëzimi racional i burimeve shtesë si ato eficientë apo edhe te ripërtitshme - nëse ka , duke siguruar funksionalitet dhe akomodim te këtyre stabilimenteve ne hapësira publike dhe tjera, gjithnjë duke u përshtatur me rethinën dhe ne pajtim me normat teknike .

Ndërtimi i rrejtet te ndriçimit publik te rrugëve dhe hapësirave tjera për rreth ne zonën e planifikuar, duhet ti plotësojë parametrat fotometrik te dhëne sipas normave evropiane EN 13201.

Gjatë realizimit të ndriçimit të rrugëve duhet të kihen parasysh këta faktor meritore për kualitetin e ndriçimit:

- Niveli i shkëlqimit të sipërfaqes se rrugës
- Shpërndarja e njëtrajtshme e shkëlqimit gjatësor dhe të përgjithshëm.
- Kufizimin e verbimit momental për shkak të ndriçimit jo komfort, (zvogëlimin psikologjik të blinkimit).
- Lëvizje vizuale e trafikut.
- Aspekteve estetike dhe akomodimit te pajisjeve ne hapësirat përkatëse
- Zgjedhja e llojit të ndriçimit të behet sipas standardit evropian në fuqi EN 13201

-Llambat ndriçuese duhet te vendosen ne shtyllat dy dhe tre pjesëshe te parapara për montim ne themelet e betonit te përpunuara, ashtu qe sipas nevojës te mund te demontohen, ndërsa furnizimi i ndriçimit duhet te bëhet me kablo nëntokësore duke aplikuar kablo standarde (PPOO 4x25 mm) 0.6/1 kV për ndriçimin e rrugëve dhe PPOO 4x16 mm² për hapësira te rregulluara.

- Gjatë projektimit te ndriçimit për hapësira te rregulluara kujdes i veçantë ti kushtohet pamjes estetike dhe vendosjes adekuate te ndriçimit.
- Sistemi i ndriçimit parashihet te jete për gjithë natën, dhe me mundësi te zvogëlimit te fuqisë pas orës 24.00, ndërsa kujdes ti kushtohet zgjedhjes se poqave për mirëmbajtje sa me te thjesht (lehte).
- Ne raste kur ka mundësi buxhetore te cilat detyrimisht i kthehen investitorit është mire te parashihet sistemi i kombinuar nga furnizimi me energji elektrike dhe panele solar ne periudhat kur ka rrezatim nga dielli.
- Me projekte te veçanta duhet te parashihen sisteme eficientë te ndriçimit.



- Rrënja maksimale e tensionit ne instalimin e ndriçimit nuk guxon te jete me e madhe se 5% kur furnizimi bëhet nga nënstacioni.
- Gjatë realizimit te instalimit te ndriçimit duhet te aplikohen masat e mbrojtjes nga tensioni i goditjes (mbrojtja direkt dhe indirekte), ne këtë nënkuptohet shtrirja e përtokëzuesit të përbashkët te gjitha shtyllave te instalimit te ndriçimit me shirit tokëzimi Fe -Zn 25x4 mm dhe lidhja e tije me shtylla dhe me përtokëzuesin e nënstacioneve.
- Gjithashtu te realizohet mbrojtja selektive e secilit qark dhe e secilës poqë veçanërisht.
- Te realizohen pajisje për matjen e energjisë se shpenzuar te ndriçimit si dhe komandimi (kycje -shkycje) te realizohen ose nga foto-celulat ose me mekanizëm inkuadruar i orës.
- Ndriçimi i rrugëve, shesheve dhe hapësirave tjera te nevojshme do te behet me ndriçim artificial.
- Kur jemi te rrugët një zonë e trajtuar ka disa nivele te klasifikimit te rrugëve, dhe varësisht nga kjo behet edhe klasifikimi i ndriçimit, dhe atë për rrugët automobilistike kemi klasë
- M5 -0,5 cd/m² -rrugë lokale me shpejtësi te ulet 10 e deri 40 km/h.
- M1 -2,0 cd/m² autoudhët.

Ndriçimi i këtyre hapësirave duhet te reflektoj një harmoni ndërmjet objekteve qe ndriçohen, natyrës dhe ambientit për rreth.

Për ndriçimin sa me te njëtrajtshtëm poqa do te vendoset ne shtylla me lartësi te ndryshme, duke filluar nga 3 m ne trotuare e deri 10-12 m ne rrugë, te shpërndara nga njëra tjetra nga 6-50 m.

Vendosja bëhet varësisht nga kërkesat për ndriçim dhe rëndësisë se rrugëve

- Rrugët me gjerësi deri 12 m ndriçuesit vendosen vetëm ne njëren ane.
- Rrugët me gjerësi deri 18 m ndriçuesit varen mbi rrugë.
- Rrugët me gjerësi deri 40 m ndriçuesit vendosen ne dy anët e rrugëve.

Ndriçimi i rrugëve ne kryqëzim duhet te jetë me i madh se i atyre qe kryqëzohen.

Gjithashtu edhe ndriçimi i shesheve duhet te jetë me i madhe se i rrugëve prej 50%

Kërkesat e përafërta për ndriçim te rrugëve janë:

- Rrugët kryesore ne qytet 4-8 lux/m².
- Për rrugë banimi 1-2 lux /m².

Dukuritë e shpërndarjeve jo te njëtrajtshtëme pastaj reflektime si dhe ndotje fotometrike dhe ndriçimet e deformuara duhet te evitohen. Rrjeti i ndriçimit do te shtrihet përskaaj rrugëve dhe do te jete pjesë e atyre projekteve ekzistuese (zgjerim), por ne raste te caktuara mund te ndërtohet edhe si rrjet i veçantë .

Kycja ne tension mund te realizohet edhe ne nënstacionet e tensionit 20/04 kV ne anën e tensionit te ulet por ne fazën e ndërtimit duhet te lihen dalje rezerve për kycje me tension 230/400 V si dhe kuadri për matjen e energjisë elektrike .

Gjithashtu ne vendet ku veç ekziston rrjeti i ndriçimit ai duhet te mirëmbahet dhe te adaptohet ne raport me kërkesat e këtij plani dhe te behën ndërhyrjet e nevojshme .

Për shtrirjen e kablllove për ndriçim vlejné normat për shtrirjen e kablllove tjerë te tensionit te ulet ashtu qe te ruhen distancat ndërmjet kablllove dhe instalimeve tjera.

Investitori është i obliguar qe te siguroj dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e lejes se ndërtimit dhe mbikëqyrjen profesionale te punimeve dhe lejes për shfrytëzim.

Pas përfundimit te punimeve investitori është i obliguar te paraqesë kërkesë për pranim teknik dhe pas kësaj te parashtrij kërkesë për lejen e përdorimit te objektit.

7.8. Rrjeti i shpërndarjes lokale me energji termike

Bazuar në planet zhvillimore sektoriale që rrjedhin nga : Plani Zhvillimor Komunal i Fushë Kosovës 2013-2023 si dhe Planit Zhvillimor Urban Fushë Kosova 2021+, Revidimi mund të konstatohet se fare nuk është trajtuar as ngrohja qendrore e as Rrjeti i shpërndarjes lokale me energji termike, mirëpo bazuar në kërkesat ligjore dhe nga udhëzimi administrativ dhe marr parasysh gjendjen ekzistuese është trajtuar ngrohja qendrore dhe Rrjeti i shpërndarjes lokale me energji termike në kuadër të infrastrukturës teknike, edhe atë me përmbajtjet si: kapaciteti dhe shtrirja e rrjeteve, ndërtesat përcjellëse, shiritat mbrojtës dhe pajisjet.

Nga analizat e ndryshme të bëra për mënyrat e ngrohjes në komunë, mund të konstatohet se për komunën e Fushë Kosovë sistemi i ngrohjes me kogjenerim, do ishte si formë më e përshtatshme bazuar edhe në disa studime fizibiliteti që janë në proces dhe që po kryhen nga kompani të jashtme, për këtë arsye do trajtohet vetëm kogjenerimi si një nga mundësitë e ngrohjes dhe disa rregulla teknike për instalimit e rrjetave të ngrohjes qendrore.

Andej bazuar në analizat dhe përvojën që kishim si ekipe punuese në lëmin e fushës së ngrohjes qendrore dhe disa përvoja nga punët praktike që kishin disa anëtarët të ekipeve punuese në Ndrohtoren e qytetit të Prishtinës NP "Termokos", do të ofrojmë një përshkrim të shkurtër, orientues, profesional lidhur me kogjenerimin dhe rregullave teknike të instalimit të rrjeteve të ngrohjes në qytetin dhe pjesë tjera të komunës së Fushë Kosovës.

Fillimisht sa i përket burimit të energjisë së ngrohjes të mundshme për kyçe, Ekziston mundësia për kyçe në Termocentralin Kosova A ose B, por edhe në Termocentralin Kosova e Re (Furnizimin me ngrohje të Fushë Kosovës nga Termocentrali nëpërmjet të sistem të kogjenerimit, studimi i fizibilitet-it i cili duhet të bëhet do të tregon se nga cili termocentral duhet të merret avulli për ngrohje).

Nga analizat e bëra mund të konstatohet se ngrohja e Fushë Kosovës me sistem të kogjenerimit, është ngrohje më cilësore se sa llojet të tjera të furnizimit të ngrohjes, si nga aspekti ekonomik dhe aspektet të tjera si p.sh: ngrohje me ngrohtore qendrore me kalidaja ku lëndë djegëse mund të jenë: Mazuti ose Nafta, Gazi etj.

Përparësitë e ngrohjes me sistem të kogjenerimit janë se është më:

- Efiçente;
- Ekologjike; dhe
- Siguron ngrohje cilësore 24 h pa ndërprerë.

Një kronologji e funksionimit të ngrohjes me sistem të kogjenerimit

Ngrohja nëpërmjet sistemit të kogjenerimit nënkupton ngrohja e ujit nëpërmjet avullit, ku avulli merret nga turbinat e termocentralit, ku është presioni i ulët, me i vogël se 3 bar, ky avull shkon nëpërmjet gypave të avullit në Kondensator të Nxehtësisë KN, KN duhet të instalohen në stacion afër Termocentralit. Nga ky stacion SKN Stacioni i Këmbimit të Nxehtësisë në kondensator uji ngrohet nga avulli i nxehtë, temperatura e avullit diku 150-200°C, dhe nëpërmjet rrjetit primar me pompa qarkullon në stacionin kryesor në qytet SPN Stacioni Për Pranim të Nxehtësisë, ku në këtë stacion duhen të instalohen kapaciteti i këmbyesve të nxehtësisë, i cili duhet të kalkulohet në bazë të kërkesës për ngrohje të qytetit, po ashtu nga ky stacion duhet të qarkullon uji i ngrohtë me pompa deri në nënstacionet e objekteve deri kolektorët, pastaj nga kolektorët në trupat ngrohëse(Radiatorët uji i ngrohtë qarkullon me pompa. Secili objekt banesor duhet të ketë nënstacionin termik të ngrohjen.

Në nënstacionin termik të banesave duhet të vendosen:

- kolektorët, valvolat, dhe pajisjet përcjellëse;
- Me Pompa uji i ngrohtë qarkullon në trupat ngrohës(radiatorët, etj.) nëpërmjet vertikaleve të instaluara në objektet ku nga vertikale të ujë i ngrohtë degëzohet nëpër banesa

7.8.1. Kapaciteti

Në bazë të numrit të banorëve të ofruar 50000 (pesëdhjetëmijë) banor, kalkulim i bërë duke u bërë në bazë të numrit të banorëve, të konvertuar afërsisht në metër katror, i bije diku 600000m², kjo sipërfaqe e ngrohjes rezulton kërkesën për kapacitet termik rreth 100 MWh_{Termik}. Ky është kapaciteti aktual për energji i cili duhet të furnizohet nga burimi termocentralet.

Për këtë kapacitet të ngrohjes dimensionohet gypi i rrjetit primar DN550mm në dërgim dhe kthim.

Për DN 550mm nevojitet gjerësia e trasesë 3-5m, distanca nga stacioni SKN (KEK-Obiliq) deri te stacioni kryesor në qytet SPN (Fushë Kosovë). Në distanca të drejta mbi 100m duhet të vendosen kompensatorët aksial(ose metoda prestresing).

Mbi rrjetin primar të kogjenerimit primar nuk guxon të ketë ndërtime të vrazhda (objekte, mure, etje).

Parcela ku është i shtrirë rrjeti primar mund të trajtohet si servitut, dhe si segmente të servitutit nga Obiliqi nëse kalon nëpër toka bujqësore atëherë do lejoheshin të mbjellurat bujqësore.

Në trase nuk duhet të ketë instalime të tjera përveç rrjetit të kogjenerimit.

Në raste të atakimit me ndonjë infrastrukturë tjetër, për shkak të natyrës së kogjenerimit dhe gypave duhet që të shikohet mundësia e zgjedhjes teknike nga ekspertet.

Për instalim të rrjetit duhet të respektohen standardet DIN EN për këtë lloj të instalimit.

Nga stacioni i cili ndërtohet në qytet(periferi) shtrirja e rrjetit duhet të jetë në harmoni me standardet teknike për instalim të rrjetit sekondar nga stacioni deri te nënstacionet e objekteve banesore.

Nga rrjeti sekondar duhet të ndërtohen pesetat të cilët shërbejnë për degëzime nga rrjeti sekondar ngrohja të shpërndahet në nënstacionet e objekteve. Në pusët duhet të ketë valvola , dhe drenazhim të ketë në puseta.

Nënstacioni i objekteve duhet të ketë sipërfaqe të mjaftueshme për instalim të stabilimenteve termoenergjetike, këmbyesve të nxehtësisë valvolave, si dhe pajisjet përcjellëse. Nënstacioni duhet të ketë ventilim e preferueshem si ventilim natyror(me dritare).

Nga nënstacionet nëpërmjet pompave në pjesën sekondare uji i ngrohtë qarkullon nëpër banesat, lokalet, qarkullimi cikël. Në këmbyes të nxehtësisë këmbëhet nxehtësia nga pjesa sekondare në pjesën terciare.

Sipërfaqja minimale e nevojshme e nënstacionit në objektet banesore (preferohet të vendoset nënstacioni në bodrum të objekteve të banimit) është varësisht nga kapaciteti për ngrohje diku sillet sipërfaqja nga 10-20m².

7.8.2. Kushtet

Mbi rrjetin e ngrohjes nuk lejohet të ndërtohen ndërtimet e vrazhda. Në zona ndër-urbane kërkohet që në pronat ku është instaluar rrjeti i ngrohjes të trajtohet si servitut (edhe ky servitut mundet të sigurohet me bonuse zonimi).

Distanca minimale nga maja e gypit në pjesën e sipërme të gypit deri mbi tok duhet të jetë 1m sipas standardit DIN EN.

Standardi DIN EN jep të dhënat teknike sa duhet të jetë distanca mes gypave për dimensione të ndryshme.

Rrjeti sekondar në pjesën urbane vendoset në kanal ose në tokë zakonisht në trotuare.

Kalimet nga njëra anë e rrugës në anën tjetër të rrugës rajonale, bëhet duke i vendosur gypat e ngrohjes në gypat mbrojtës nga çeliku, ndërsa në rrugë urbane me prerje të asfalteve instalimi në tokë duke respektuar standardet teknike për instalim të gypave të ngrohjes.

Në rast të pamundësisë së shmangies së vijës së planifikuar të rrjetit të ngrohjes, gypat të ujësjellësit kanalizimit duhet të vendosen mbi gypat e ngrohjes (ose të kërkohet një zgjidhje në atë pikë nga ekspertë për këtë lëmi.

Nga stacioni kryesor ngrohja bartet me pompa të instaluar nëpërmjet rrjetit sekondar, ku rrjeti fillon me dimension DN550mm dhe duke paraparë uljet (ramjet) e presionit në metër gjatësi duhet edhe të përshtatet dimensionit i diametrit DN duke u zvogëluar në mënyrë që presioni në pikën e fundit të ruhet sipas normave teknike. Nëpërmjet degëzimeve uji i ngrohtë i kalon në nënstacionet e ndërtesave, ku kalkulohet kapaciteti ngrohës, dhe bëhet dimenzionimi i gypave furnizues të ngrohjes deri te nënstacioni(kolektorët në nënstacion, nga kolektor instalohen pompat të cilat e furnizojnë banesat lokale me ngrohje nëpërmjet vertikaleve të cilat duhet të vendosen në objekte.

Duke ditur që Qyteti i Fushë Kosovës ka pozitë të rrafshet gjeografike, nuk nevojitet të ndërtohen nënstacionet në rrjetë sekondarë. D.m.th uji i këmbyer nga stacioni kryesor në qytet SPN ngrohja bartet me pompa nga stacioni direkt në trupat ngrohës të objekteve të banimit lokalet, etj.

Është e preferueshme që gypat e rrjetit sekondar të vendosen në kanale të betonit, dhe zakonisht rrjetat e qytetit vendosen nën trotuare, duke i respektuar rregullat e instalimit të gypave, distancën thellësinë e gypave, etj.

Në trase e rrjetit primar dhe sekondar duhet të respektohen distanca minimale mes të tangjentes së gypit në pjesën e sipërme dhe nivelit mbi sipërfaqes, e cila duhet të jetë minimum 1m, si dhe të vendosen zhavorri nën gyp 10cm dhe mbi gyp 10cm të jetë me zhavorr.

Kurse të rrjeta sekondare e qytetit ku është e mundshme të vendosen në kanale, ku në kanal duhet të parashihet mirëmbajtja e gypave.

Kushtet për objekte me shumë njësi banimi është sigurimi e sipërfaqes minimale për nënstacion në bodrum të objektit, me sipërfaqe që duhet të sillet nga 10-20 m², dhe me ventilim natyror, me dritare.

7.9. Rrjeti i grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave mbitorësore dhe nëntokësore

Sipas informatave nga PZHK dhe PZHU sasia e mbeturinave që krijohen në Fushë-Kosovë për kokë banori është rreth 1.8 kg në ditë. Gjatë viteve të fundit, Komuna e Fushë Kosovës ka punuar në mënjanimin e deponive të egra të mbeturinave dhe shpërndarjen e sistemuar të kontejnerëve për mbeturina.

Ngritja e një sistemi efikas të menaxhimit të mbeturinave është prioritet për komunën në pesë vitet e ardhshme. Komuna do të ndërmarrë masat e nevojshme për trajtimin e mbeturinave. Ajo duhet të shqyrtojë politikën e selektimit të mbeturinave dhe riciklimit, me qëllim mbrojtjen e ambientit dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Trajtimi i mbeturinave në nivel komunal përmban:

- Mbyllja e deponive ilegale të mbeturinave - identifikimi, dekontaminimi, pastrimi dhe rinatyrimi i tyre;
- Krijimi dhe funksionalizimi i sistemit publik të menaxhimit të mbeturinave;
- Promovimi i riciklimit të mbeturinave për mbrojtje të mjedisit, njëkohësisht zhvillim ekonomik.

Komuna, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, do të ndërmarrë masa për konsolidim të tokës në zonat e deponive ilegale.

Komuna duhet të vendosë sistemin për menaxhim të mbeturinave, bazuar në ligjin dhe kompetencat e deleguara, duhet të përmirësojë shërbimet për menaxhim të mbeturinave në Komunën e Fushë Kosovës.

Mënyra e trajtimit të hedhurinave;

Komuna do të hartojë konceptin detaj të Menaxhimit të Mbeturinave për zonën urbane të Fushë Kosovës dhe vendbanimeve.

Komuna duhet të krijojë një rrjet funksional të mbledhjes dhe deponimit stacionar të mbeturinave dhe dërgimin e tyre në deponinë rajonale.

Deponia rajonale gjendet në Mirash, dhe në të mbledhen të hyra për shërbimin e hedhjes së mbeturinave dhe ujërave të zeza.

Komuna duhet të ndërtojë një politikë për mbledhjen e materialeve sekondare si dhe për riciklimin e mbeturinave. Komuna e Fushë Kosovës, së bashku me kompaninë publike rajonale për menaxhimin e mbeturinave, duhet të organizojnë ndarjen, mbledhjen dhe riciklimin e mbeturinave.

7.9.1. Objektivat dhe targetat e Strategjise dhe Planit Nacional për Menaxhimin e Mbeturinave

Sipas Strategjisë dhe Planit Nacional të Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave qëllimi i kryesor është krijimi i një kornize masash, të cilat do të synojnë zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që krijohen në burim, zvogëlimin e sasisë së tyre që shkojnë në deponi dhe zhvillimin e një infrastrukture për ngritjen e një sistemi të integruar për menaxhimin e mbeturinave. Gjatë periudhës kohore 10 vjeçare 2013-2022 të zbatimit të saj, strategjia ka vendosur tre periudha kohore të rëndësishme (2015 – 2019 – 2022) dhe targetat përkatëse:



Ndarja në fraksione e mbeturinave komunale



Trajtimi i mbeturinave



Sasia e mbeturinave të hedhura në deponi



Sasia e mbeturinave të biodegradueshme të hedhura me mbeturinat komunale



Figura 16 Grumbullimi i mbeturinave komunale

Siç mund ta shohim, strategjia synon rritjen e shkallës të mbulimit me shërbim, rritjen e përqindjes të ndarjes dhe grumbullimin e ndarëndarë të mbeturinave, rritjen e përqindjes të trajtimit të mbeturinave, si dhe zvogëlimin e sasisë të mbeturinave që shkojnë në deponi dhe zvogëlimin e sasisë të mbeturinave të biodegradueshme që grumbullohen me ato komunale. Trajtimi i mbeturinave në deponitë mbetet një nga mënyrat përfundimtare të trajtimit të mbeturinave në Republikën e Kosovës deri në fund të dhjetëvjeçarit të strategjisë (2022).

7.9.2. Objektivat e Ligjit për Menaxhimin e Mbeturinave

Në Ligjin nr. 04/I-060 "Për menaxhimin e mbeturinave", 2012 përcaktohet detyrimi për hartimin dhe zbatimin e planit lokal të menaxhimit të mbeturinave si dhe rregulloreve përkatëse për të gjithë komponentët e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave nga Komuna. Konkretisht komuna ka si detyrim ligjor:

- i) Hartimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, i cili duhet të jetë në harmoni me planin nacional;
- ii) Zbatimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave;
- iii) Hartimin e rregulloreve me përgjegjësitë dhe detyrimet për organizimin dhe ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave në territorin e tyre;
- iv) Krijimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi për informimin e publikut dhe raportimin mbi punën e bërë dhe përgatitjen e një raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave;
- v) Identifikimin e deponive të egra në territorin e tyre dhe zhvillimin e projekteve për rehabilitimin e tyre;
- vi) Përcaktimin e tarifave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale;
- vii) Aplikimin e procedurave të prokurimit për përzgjedhjen e personave të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave në territorin e tyre;
- viii) Mbikëqyrjen dhe kontrollin e aktiviteteve të menaxhimit të mbeturinave në territorin e tyre përmes inspektorëve të mjedisit në komunë;
- ix) Bashkëpunimin ndërvendor midis dy ose më shumë komunave për menaxhimin e mbeturinave;
- x) Përcaktimin e sasisë dhe llojit të mbeturinave që pritet të krijohen duke identifikuar llojin dhe origjinën e tyre;
- xi) Hartimin e skemave dhe programeve për mbledhjen e mbeturinave (nga amvisëritë, bizneset dhe industria);
- xii) Hartimin e programeve për grumbullimin e ndarëndarë, sidomos grumbullimin e rrymave të rrezikshme;
- xiii) Hartimin e propozimeve teknike të duhura në lidhje me ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave;
- xiv) Hartimin e programeve për ngritjen e vetëdijes publike dhe edukimin në lidhje me menaxhimin e mbeturinave;

- xv) Vlerësimin dhe llogaritjen e kostove për aktivitetet/projektet e planifikuara për menaxhimin e mbeturinave dhe identifikimin e fondeve për zbatimin e tyre.

Plani do të fokusohet drejtpërdrejtë në dhënien e zgjidhjes për mbeturinat e parrezikshme nga amvisëritë dhe bizneset e vogla komerciale, të cilat prodhojnë mbeturina komunale. Në lidhje me kategoritë e tjera të mbeturinave, plani do të japë disa konsiderata të përgjithshme, të cilat duhet t'i ketë parasysh për të siguruar që ato të mos hidhen nga gjeneruesit e tyre në kontejnerë të kolektivë.

Në diagramën më poshtë jepet skema e mbeturinave komunale, përgjegjësi e komunës për t'u menaxhuar:




Figura 17 Skema e grumbullimit të mbeturinave komunale [Burimi: nga PLMM]

Ky ligj gjithashtu, në *Kreun VI të tij "Përgjegjësitë dhe Detyrimet për Menaxhimin e mbeturinave"* përcakton përgjegjësitë dhe detyrimet për aktorët e mëposhtëm të cilët janë pjesë e ciklit të menaxhimit të mbeturinave:

- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e zotëruesit të mbeturinave** – zotëruesi i mbeturinave është personi i licencuar përgjegjës për mbledhjen, grumbullimin, transportimin, trajtimin, përpunimin, magazinimin, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave;
- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e prodhuesit dhe importuesit e produkteve** - Prodhuesi i mbeturinave dhe importuesi i mallrave me potencial për krijimin e mbeturinave janë përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave të krijuara nga produktet e tij;
- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e prodhuesit të mbeturinave** – përgjegjës për menaxhimin e plotë të mbeturinave që prodhon ose dorëzimin e tyre për trajtimin dhe deponim tek personat e licencuar;
- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e transportuesit të mbeturinave** – ata duhet të jenë të licencuar për transportin e mbeturinave, dhe duhet të kryejnë këtë proces bazuar në kushtet e licencës për transport;
- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e operatorit për trajtimin dhe përpunimin e mbeturinave** – këta operatorë duhet të jenë të licencuar për trajtimin dhe përpunimin e mbeturinave në impiantin e tyre bazuar në kushtet e licencës;
- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e operatorit në deponi të mbeturinave** - këta operatorë duhet të jenë të licencuar për deponimin e mbeturinave në impiantin e tyre bazuar në kushtet e licencës.

7.9.3. Hartimi dhe përshkrimi i masave për të arritur objektivat

Duke u bazuar në 6objektivat që dalin nga Plani lokal për menaxhimin e mbeturinave të cilët do të detajohen në aktivitete konkrete sipas afateve kohore dhe përgjegjësi përkatese. Bazuar në analizën e kryer të gjendjes ekzistuese dhe planeve që ka komuna në të ardhmen, në plan propozohet që ndarja në tre zona ekzistuese të vazhdojë të jetë si një ndarje mbi bazë të së cilës do të orientohen edhe objektivat. Konkreisht në Komunë Fushë Kosovë këto tre zona tashmë janë të mirë stabilizuara, ku praktikisht në zonat A dhe B shërbimi është

kryesisht kolektiv, ndërsa në zonën C ky shërbim është derë më derë. Në tabelën tregohen njësitë për secilën zonë, popullsia e tyre dhe sasia totale e mbeturinave që prodhon secila zonë e komunës, duke marrë si normë gjenerimi vlerën 0.6kg/banorë/ditë:

ZONA	NJËSIA	Nr. Popullsisë	Sasia e mbeturinave që gjenerohet (ton/vit)
Zona A	Fushë Kosova	12,919	2,829
Zona B	Bresja, Miradi e Epërme, Miradi e Poshtme	8,667	1,898
Zona C	Nakarade, Miradi e Epërme, Miradi e Poshtme, Lismir, Bardh i Madh, Graboc i Poshtëm, Pozmatin, Kuzmin, Sllatinë e Vogël, Bardh i Vogël, Fragoli, Henc, Harilaq, Sllatinë e Madhe	13,241	2,900
Totali		34,827	7,627

Tabela 23 Zonat funksionale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën Fushë Kosovë [Burimi: PLMM]

Ndërkohë në hartën më poshtë tregohet më qartë ndarja e Komunës në këto tre zona:




Figura 25 Zonat funksionale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Fushë Kosovë [Burimi: PLMM]

7.9.4. *Konsolidimi i strukturës brenda komunës*

Kjo strukturë që do të krijohet në komunë do të jetë përgjegjëse për hartimin e një sërë instrumentesh, të cilët do të drejtojnë organizimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave. Këto instrumente do të fokusohen në krijimin e një inventari të plotë të klientëve (gjeneruesit e mbeturinave) në territorin e Komunës, duke u pasuar më pas në hartimin e programeve rregullatore, planifikuese dhe vetëdijësuese. Konkreisht instrumentet që duhet të zhvillojë komuna janë si më poshtë:

- Krijimi i një databaze për shërbimin/hartimi i indikatorëve;
- Hartimin e fushatave vetëdijësuese;
- Hartimin e projekteve për minimizimin e mbeturinave;
- Hartimin e rregulloreve të brendshme/fraksione të veçanta;
- Përditësimin e planit lokal të menaxhimit të mbeturinave në varësi të zhvillimeve të ndryshme;
- Monitorimin e shërbimit nga zyrtari i ambientit apo zyrtari për menaxhimin e mbeturinave.

7.9.5. *Hartimi i një sistemi monitorimi për matjen e performancës të shërbimit*

- Hartimi i indikatorëve të cilësisë së shërbimit
- Krijimi i formateve të raportimit
- Krijimi i një sistemi për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave në GIS, ku do të regjistrohen:
 - i. Të gjithë konsumatorët që janë pjesë e sistemit të inkasimit dhe mundësohen me shërbim;
 - ii. Të gjitha pikat e grumbullimit kolektiv të mbetjeve, deponitë e depozitimin e mbeturinave;
 - iii. Modelimi i itinerarëve që mjetet teknologjike do të kryejnë në komunë

7.9.6. *Hartimi i një programi vetëdijësimi për minimizimin e mbetjeve*

Në Planin Lokal për Menaxhim të Mbeturinave janë paraparë 4 module për sistemin e menaxhimit të mbeturinave në të cilat është bazuar HZK. Komunitetet dhe nevoja për të ndryshuar sjelljen janë çështjet kyçe të një programi për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave, megjithatë depërtimi në sjelljen e konsumatorit dhe biznesit do të rrisin efikasitetin e masave të zgjedhura. Një përjasje e integruar e këtyre masave është e domosdoshme, që në mënyrë substanciale të adresohet problemi i menaxhimit të mbeturinave dhe të ndryshohet mentaliteti dhe mënyra e menaxhimit të burimeve deri tani.

Një program për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave në nivelin komune duhet të jetë një plan i detajuar, i cili integron interesat dhe shqetësimet e palëve të interesuara dhe të prekura (aktorëve), bazuar në një angazhim të tyre për të marrë pjesë në këtë program. Detyra kryesore e një programi për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave është të ofrojë një vizion të përgjithshëm dhe një përjasje që mbështetet mbi iniciativat ekzistuese, duke harmonizuar dhe integruar masat plotësuese efikase dhe efektive. Për të hartuar një program të tillë është e këshillueshme që komuna të ndjekë një përjasje me hapat e mëposhtëm:

- Vizioni se si sistemi i përgjithshëm ekonomik i komunës, i cili gjeneron mbeturina mund dhe duhet të punojë në një periudhë - për shembull 10 vjeçare;
- Objektivat të cilat do të drejtojnë programin;
- Zonat prioritare se ku do të fokusohet programi;
- Zgjedhja dhe kombinimi i masave që do të sjellin me efikasitet ndikime më të ultë në sistemet mjedisore.

Në secilin prej hapave fokusi fillimisht duhet të jetë i hapur për të përfshirë të gjitha opsionet efikase dhe pastaj duhet të ngushtohet drejt filtrimit të opsioneve më të efektshme. Ndërkohë që objektivat dhe masat e

përzgjedhura duhet të lejojë programin për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave të përmbushin detyrën e tij, siç përmbledhet në figurën e mëposhtme.





Figura 27 Detyrat e programit të parandalimit të mbeturinave [Burimi: adoptuar nga Jackson 2005³]

Nisur nga sa më lart komuna duhet të hartojë dhe promovojë një strategji për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave bazuar në tre shtylla kryesore: i) Programet e informimit; ii) Programet e promovimit; iii) Programet rregullatorë. Në figurën më poshtë mundësohet një informacion më i zgjeruar në lidhje me tre shtyllat e kësaj strategjie:

³Jackson, T. (2005): Motivating sustainable consumption. Sustainable Development Commission, Stirling, UK.



7.9.6.1. Figura 28 Kategoritë e Strategjisë për parandalimin e mbeturinave [Burimi: PLMM]

Disa prej masave kryesore që komuna mund të zhvillojë janë:

- Ndërtimi i kapaciteteve brenda komunës për të asistuar aktivitetet e parandalimit të gjenerimit të mbeturinave për komunitetin dhe aktivitetet tregtare
- Analiza i gjenerimit të mbeturinave në territorin e komunës
- Përgatitja e fushatave për parandalimin e mbeturinave bazuar në kushtet lokale
- Hartimi dhe prezantimi i iniciativave drejtuar amvisërive, bizneseve dhe autoriteteve lokale për reduktimin e gjenerimit të mbeturinave
- Programi për parandalimin e mbeturinave nga amballazhi – ndihmon bizneset për të minimizuar përdorimin e materialeve të amballazhit
- Programi për minimizimin e mbeturinave në ambientet e punës dhe për të rritur përdorimin e materialeve të ndërtimit dhe riciklimin e tyre
- Prezantimi i skemave të menaxhimit mjedisor për bizneset lokale për të mbështetur reduktimin e mbeturinave
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e një platforme në faqen e internetit të komunave për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave, duke dhënë informacionin e mëposhtëm:
 - Shpjegime për principin e parandalimit të gjenerimit të mbeturinave: (përkufizimi, mjetet, instrumentat dhe mekanizmat për arritjen e tij)
 - Udhëzuesi për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave në shtëpi dhe në zyra
 - Udhëzuesi për realizimin e kompostit individual
- Promovimi i përmirësimit të infrastrukturës për ripërdorimin e produkteve të ndryshme (ndërtimi i një rrjeti dyqanesh të dorës së dytë) shoqëruar me publikimin e udhëzuesëve për riparimin, riciklimin dhe rishitjen e produkteve.

7.9.7. Ndërtesat dhe hapësirat për riciklim dhe dekompozim

Sipas informatave që kemi nga dokumentet dhe institucionet që merren me qeshjet e menaxhimit të mbeturinave, aktualisht në Komunën Fushë Kosovë riciklimi bëhet në baza vullnetare dhe private nga kompani private që operojnë në komunë (rreth 5 të tilla) dhe nga vetë qytetarët. Mbetjet të cilat riciklohen janë plastika, letra dhe metalet me ngjyra.

Sot tregu i mbeturinave të riciklueshme në Kosovë është në hapat e para të zhvillimit të tij. Megjithatë, në shumë komuna, si dhe në Komunën Fushë Kosovë kanë filluar aktivitetin kompani të ndryshme, të cilat grumbullojnë, paketojnë ose përpunojnë fraksione të ndryshme të mbeturinave të riciklueshme, si letrën,

plastikë, alumin etj. Furnizuesi kryesor të këtyre kompanive është sektori informal. Ky sektor vepron mbi baza individuale dhe në kushte aspak higjieno – sanitare, duke grumbulluar mbeturinat e riciklueshme, kryesisht në kontejnerët publik apo në deponitë ilegale. Kompanitë private grumbullojnë lëndën e parë nga sektori informal, kundrejt një çmimi të caktuar për cilin fraksion:

- i) 17-23 cent/kg plastika;
- ii) 3-6.5 cent/kg letra dhe kartoni;
- iii) 80 cent/kg alumini. Zakonisht sasia mesatare e fraksioneve të grumbulluara nga këto kompani varion nga 8-10 ton mbeturina për secilin fraksion (burimi: PLMM dhe PLVM).

Kryesisht këto kompani kryejnë disa procese në stabilimentet e tyre: **i)** në rastin e plastikës ata mund ta kompresojnë dhe më pas e shesin, ose mund ta përpunojnë në formën e petezave dhe e shesin si lëndë të parë tek sektori i ambalazheve; **ii)** në rastin e letrës apo të kartonit, kryesisht grumbullohet dhe presohet për t'u shitur në treg. Pjesa më e madhe e produkteve të këtyre kompanive furnizon tregun e brendshëm.

Në sajë të një iniciative midis Asociacioni "Pamkos", KRM "Pastrimi" Sh.A. Prishtinë dhe GIZ, komuna Fushë Kosovë ka filluar aplikimin e projektit "Grumbullimi i ndarë i mbeturinave", i cili ka filluar të aplikohet nga Shtatori i vitit 2016. Projekti ka filluar të realizohet përgjatë rrugës Dardania në qytetin e Fushë Kosovës, e cila konsiderohet si një ndër lagjet më të populluara, ashtu siç tregohet edhe në figurën më poshtë.

Komuna në të ardhmen do të ndërtoj impiant për dekompostim të mbetjeve të biomasës të cilat janë veprimtari profitabile e që mund të zhvillohen edhe me forma të partneriteti publiko-privat. Këto impiante mund të zhvillohen afër transdeponive kryesisht në zonat industriale.



7.9.7.1. Figura 12 Zona e projektit për grumbullimin e ndarë të mbeturinave[Burimi: PLMM]

7.9.8. Deponia Qendrore dhe transdeponitë

Harta Zonale Komunale duke mos precizuar sakt lokacionet, parasheh transdeponi në të cilat bëhet grumbullimi, selektimi i mbeturinave, kurse mbeturinat të cilat nuk riciklohen barten për në deponinë qendrore në Mirash e ndërtuar nga AER në vitin 2005 e cila menaxhohet nga Kompania e Deponive në Kosovë (KMDK), i cili është një organ shtetëror. Kjo deponi ndodhet në Komunën e Olibiliqit, shumë pranë Deponisë të deponimit të hirit të TC Kosova B.. Kryesisht. Ndërkaq transdeponi mund të ndërtohen në zonat industriale dhe larg nga vendbanimet së paku një distanc 1 km. Mbetjet e kafshëve dhe mbeturinat medisionale janë problem i nivelit qendrorë i cili do të merret me formën dhe mënyrën e deponimit të këtyre mbetjeve.



7.9.8.1. Figura 13 Pamje satelitore nga deponia e Mirashit

8. INFRASTRUKTURA RRUGORE

Bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe marr parasysh gjendjes ekzistuese planifikohet rrjeti i infrastrukturës rrugore, duke specifikuar llojin, sipërfaqen, kapacitetet dhe kushtet teknike për projektim dhe ndërtim të:

- Rrugët publike, të motorizuar dhe jo të motorizuar me kategorizimin dhe nivelimin;
- Rrjeti hekurudhor, i lehtë dhe i rëndë;
- Ndërtesat dhe sipërfaqet për transport ajror; dhe
- Ndërtesat dhe sipërfaqet për transport publik urban dhe rural; dhe
- Sipërfaqet publike për vendparkim.

Në rast se zonat e propozuara për zhvillim të mëtutjeshëm nuk përmbajnë rrugë, komuna specifikon në pjesën tekstuale standarde dimensionale dhe projektuese për zhvillim të ardhshëm të rrugëve brenda asaj zone dhe kushtet e sigurimit të qasjes në parcelë kadastrale.

Performanca dhe zhvillimi i infrastrukturës rrugore ndikon në mirëqënien e qytetarëve dhe është bazë për çdo zhvillim. Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës për të krijuar një rrjet funksional dhe të sigurt të transportit, duke shfrytëzuar përparësitë e secilës formë, është parakusht për ngritjen e shtrirjen e ndërtimeve, zhvillimin ekonomik dhe ngritjen e mirëqenies sociale.

- Me qëllim të përmbushjes së normave teknike dhe standardeve, hartimi i hartës zonale për infrastrukturë rrugore është bazuar në:
- Ligjin NR. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor
- Ligjin mbi rrugët
- Normat teknike të planifikimit hapsior
- Udhëzimin administrativ (MI) Nr. XX/2017 për sinjalizim dhe rregullat e trafikut rrugor
- Ligjet dhe rregulloret mbi mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjes në punë.
- Ligjin për mbrojtjen e mjedisit.

Në pozicionet për të cilat në Republikën e Kosovë nuk ka standarde të aprovuara, projektuesi mund të rekomandojë edhe përdorimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se (EURO COD), si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

8.1. Rrugët publike të motorizuara

Lloji (kategorizimi) i rrugëve në Komunën e Fushë Kosovës

Rrjeti rrugor në Komunën e Fushë Kosovës është i kategorizuar në autoudhë, rrugë nacionale dhe rrugë rajonale, që janë nën administrimin e Ministrisë së Infrastrukturës (MI), ndërsa nën administrimin e komunës janë rrugët lokale kryesore, rrugë lokale dhe rrugë tjera të pa kategorizuara.

Me qëllim të shfrytëzimit të tokës dhe planifikimit të transportit është paraqitur hierarkia e rrugëve në komunën e Fushë Kosovës:

	Kategoria	Përgjegjësi
1	Autoudhë	Ministria e Infrastrukturës
2	Rrugë nacionale	Ministria e Infrastrukturës
3	Rrugë rajonale	Ministria e Infrastrukturës
4	Rrugë kryesore lokale	Komuna
5	Rrugë lokale	Komuna

6 Rrugëtjera

Komuna

Tabela 24 Kategorizimi i rrugëve


Kjo hierarki e rrugëve ka për qëllim të ndikojë që trafiku t'i gjejë vijat më të përshtatshme dhe të minimizojë ndërhyrjet nëpër zonat në të cilin kalon. Ajo shërben edhe si bazë për përcaktimin e prioriteteve të sigurisë në rrugë, mirëmbajtjes dhe menaxhimit të trafikut.

8.1.1. Autoudhët

Autoudha "Ibrahim Rugova" ose "Rruga 7" e cila përfshinë segmentin Morinë – Prishtinë – Merdare, me gjatësi rreth 118 kilometra, kalon nëpër territorin e Fushë Kosovës. Pjesa e autostradës "Ibrahim Rugova", konsiderohet të jetë e një rëndësie të veçantë rajonale, sepse ndër tjera, lidhet me autostraden "Arbër Xhaferi" ose "Rruga 6" e cila është edhe rrugë ndërlidhëse me korridorin VIII në drejtim të Shkupit, e që mendohet dhe pritët të lidhë në të ardhmen Prishtinën me Malin e Zi.

8.1.2. Rrugët nacionale

Nëpër Fushë Kosovë kalon rruga nacionale M9 e cila lidhë Prishtinën me Pejen. Rruga M9, shtrihet nga kufiri lindor me Serbinë, përmes Prishtinës në Pejë dhe në kufirin perëndimor me Malin e Zi. Kjo rrugë ka momentalisht rëndësinë më të madhe kombëtare pasi që lidh dy qytetet e mëdha të Kosovës.



8.1.2.1. Figura 13 Rrugët nacionale

8.1.3. Rrugët Rajonale

Rruga rajonale R-120 e cila lidhë qytetin e Lipjanit me Obiliqin kalon nëpër territorin e Komunës së Fushë Kosovës.

8.1.4. Rrugët lokale

Është e ditur se kushtet e rrugëve lokale nuk mund të krahasohen me kushtet e rrugëve kryesore dhe rajonale, që në përgjithësi janë në kushte të pranueshme, përkundër mungesës së mirëmbajtjes. Rrugët rajonale janë të

dizajnuara sipas standardeve të ish- Jugosllavisë, me një gjërësi standarde të shtresës prej 6 m⁴. Dizajni i rrugëve lokale përcjellë shpesh standardin e rrugëve rajonale, pasi që nuk ekziston ndonjë standard specifik, por mund të jetë më i ulët me një gjërësi të shtresës prej 3 m., ose më pak (kryesisht për rrugë të pashtuara).

8.1.5. *Brezi mbrojtës rrugor*

Në qendrat e banuara, për ndërtimet ekzistuese dhe të reja, riparimet, rikonstruktionet dhe zgjerimet, janë vendosur kriteret për mbrojtjen e rrugës, të matura nga kufiri rrugor.

Sipas normave teknike të planifikimit hapësinor, brezi mbrojtës rrugor është një hapësirë e vazhdueshme tokësore, në të dy anët e rrugës, distanca e të cilit kalkulohet nga cepi përfundimtar i brezit mbrojtës rrugor, dhe shërben përveç për mbrojtjen e rrugës dhe trafikut që realizohet nëpër të, gjithashtu edhe për kufizimin e llojit dhe shtrirjes së zhvillimit në të (Fig.2).

Brezi mbrojtës rrugor ndalon hapjen e minierave, ndërtimin e liqeneve artificiale, fabrikave dhe ndërtesave të tjera të ngjashme, në distancë më të vogël se:

- 100 m nga autoudhat;
- 60 m nga rrugët nacionale;
- 40 m nga rrugët rajonale; dhe
- 30 m nga rrugët lokale.

Brezi mbrojtës rrugor ndalon ndërtimin e ndërtesave të banimit, administrative, hapjen e puseve të ujit dhe hapjen e gropave septike, ngritjen e instalimeve të transmetuesve elektrik dhe të ngjashme, në distancë më të vogël se:

- 40 m nga autoudhat;
- 20 m nga rrugët nacionale; dhe
- 10 m nga rrugët rajonale dhe lokale.

Brezi mbrojtës rrugor nuk vlen për rrugët urbane brenda vendbanimeve.

⁴Ministria e Infrastrukturës, Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 dhe Plan i veprimit 5 vjeçar.





Figura 13 Brezi mbrojtës rrugor

8.1.6. SIPËRFAQJA E RRJETIT RRUGOR NË KOMUNËN E FUSHË KOSOVËS

Sipërfaqja e rrjetit aktual rrugor në komunën e Fushë Kosovës është dhënë në tabelën vijuese:

Kategoria	Km	Gjerësia (m)	Sipërfaqja (m ²)
Autoudhë	2.322	2322	116100
Rrugë nacionale	11.084	11084	254932
Rrugë rajonale	10.99	10990	87920
Rrugë lokale	276.724	276724	2519237.15



Harta 13 Rrjeti rrugor në Komunën e Fushë Kosovës

8.2. Kapaciteti i rrugëve

Kapaciteti është definuar si madhësia maksimale e qarkullimit të automjeteve të cilat mund të kalojnë nëpër pjesën e vëzhguar të shiritit qarkullues të rrugës në periudhën e caktuar kohore nën ndikimin e kushteve të komunikacionit në rrugë.

Kapaciteti i autostradës “Ibrahim Rugova”

Autostrada “ Ibrahim Rugova “ ose “Rruga 7 – R7” e cila përfshinë segmentin Morinë – Prishtinë – Merdare, është në funksion nga viti 2012, ndërsa pjesa e kësaj autostrade e cila kalon nëpër territorin e Fushë Kosovës është lëshuar në funksion nga viti 2013. Në aspektin e projektimit, kjo autostradë është ndërtuar sipas standardeve dhe me elemente geometrike sipas kriterëve teknike për autostrada. Bazuar në shpejtësinë e lëvizjes së automjeteve në autostradë, gjerësinë e korsive dhe numrin e tyre (2+1), kapaciteti potencial sillet 3500 – 4000 aut/h/kahe.

Kapaciteti i rrugës nacionale M9

Rruga magjistrale “Nënë Tereza” (M-9) e cila lidhë Prishtinën me Pejen kolon nëpër pjesën qendrore të Fushë Kosovës. Kjo rrugë ka karakter nacional dhe është nën menagjimin e Ministrisë së Infrastrukturës (MI). Në bazë të matjeve të fluksit të qarkullimit, nëpër rrugën “Nënë Tereza” qarkullojnë rreth 60 000 aut/ ditë⁵.

⁵ Mott Mac Donald: Pristina Sustainable Urban Mobility Plan (SUMP), 2017.

Bazuar në gjerësinë dhe numrin e korsive (3 korsi për kahe), kapaciteti potencial për kahe sillet rreth 3500 - 4000 aut/h.

Kapaciteti i rrugëve lokale

Pjesa më e madhe e rrjetit rrugor në qytetin e Fushë Kosovës është e përbërë nga rrugë lokale. Sipërfaqja e përgjithshme e rrugëve lokale sillet rreth... (Tabela 1.) Gjendja dhe elementet gjeometrike të këtyre rrugëve janë të ndryshme, duke filluar nga 4.0 – 6.5 m. Bazuar në gjerësitë dhe gjendjen e rrugëve, kapaciteti i rrugëve lokale sillet nga 500 – 800 aut/h/kahe.

8.3. Kushtet e përgjithshme teknike për projektim dhe ndërtim

Rrugët në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës (MI)

Autoudha

Nëpër territorin e Komunës së Fushë Kosovës kalon një pjesë e autoudhës “Ibrahim Rugova” – R7 dhe “Arbër Xhaferi-R7”. Në aspektin e projektimit dhe ndërtimit, këto pjesë të autoudhëve, në territorin e Komunës së Fushë Kosovës janë përfunduar, ndërsa në aspektin e normave teknike të planifikimit, me qëllim të ruajtjes së brezit brojtës rrugor, duhet të respektohen kriteret:

- Brezi mbrojtës rrugor ndalon hapjen e minierave, ndërtimin e liqeneve artificiale, fabrikave dhe ndërtesave të tjera të ngjashme, në distancë më të vogël se **100 m nga autoudhat (Fig.3)**.
- Brezi mbrojtës rrugor ndalon hapjen e minierave, ndërtimin e liqeneve artificiale, fabrikave dhe ndërtesave të tjera të ngjashme, në distancë më të vogël **40 m nga autoudha (Fig.3)**.

Rruga nacionale M9

Nëpër Fushë Kosovë kalon edhe rruga nacionale M9 e cila lidhë Prishtinën me Pejen. Kjo rrugë ka momentalisht rëndësinë më të madhe kombëtare pasi që lidhë dy qytetet e mëdha të Kosovës. Kjo rrugë është nën kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës dhe riprojektimi i kësaj rruge ka rezultuar me bashkimin e korsive për kahe (2 korsi për kahe +1 korsi e ndarë në kahe të njëjtë) deri në kufirin kadastral të Komunës së Fushë Kosovës, respektivisht në eliminimin e rrugës së ndarë fizikisht dhe tani janë tri korsi për kahe.

Bazuar në PZHK dhe PZHU të Komunës së Fushë Kosovës, për këtë pjesë të rrugës nacionale, kërkohet përmirësimi i shkallës së sigurisë dhe kapacitetit në trasenë ekzistuese (Pika 4.1.3- Plani 6.3).

Prandaj, me qëllim të rritjes së shkallës së sigurisë për këtë pjesë të rrugës, e cila kalon në pjesën urbane në qytetin e Fushë Kosovës, duhet të përmirësohen dhe plotësohen kriteret:

- Kufizimi i shpejtësisë së lëvizjes në 60 km/h, ndërsa në afërsi të udhëkryqeve dhe rrethrotullimeve shpejtësia e lëvizjes të kufizohet në 40 km/h,
- Për shkak të gjerësisë së rrugës dhe numrit të madh të automjeteve të cilat qarkullojnë në këtë pjesë të rrugës, në pjesët e rrugës me frekuentim të madh të këmbësorëve, për trupimin e rrugës të planifikohen nënkallime/mbikalime (sidomos në afërsi të shkollave),
- Në pjesët e rrugës në të cilat numri i këmbësorëve të frekuentuar është më i vogël, vendkalimet për këmbësorë të projektohen me ndriçim të vendkalimit dhe të përdoret sinjalizimi me dritë vezulluese në gjysmëportal, i cili paralajmëron ngasësit për ngritje të vemendjes në afërsi të vendkalimit për këmbësorë,
- Vendkalimet për këmbësorë të jenë në funksion të mobilitetit,
- Të mbrohet dhe të shënohet me sinjalizimin përkatës shtegu për çiklist,
- Shtegu për çiklist të jetë në disnivel dhe të ndahet fizikisht nga pjesa tjetër e rrugës (së paku me gurin skajor),
- rirregullimi fazor në semaforë, duke eliminuar punën e semaforëve me kohë fikse,
- rivendosjen e programuar e rregullimit të qarkullimit përmes paisjeve inteligjente.

8.4. Rrugët në kompetencë të komunës së fushë kosovës

Bazuar në PZHK dhe PZHU (Caku 6) të Komunës së Fushë Kosovës, janë paraparë ndërtime të rrugëve të reja si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese në rrjetin komunal automobilistik e hekurudhor. Rrugët e parapara janë:

- Rruga e cila do të lidhë fshatrat Lismir, Kuzimin dhe Vragoli dhe
- Rruga e cila do të lidhë fshatrat Miradi e Poshtme dhe Miradi e Epërme.

8.5. Kushtet e përgjithshme teknike për projektim dhe ndërtim të rrugëve të reja

Në kuadër të PZHK-së dhe PZHU-së, lidhur me ndërtimin e rrugëve të reja është paraparë lidhja funksionale e fshatrave të Fushë Kosovës përmes ndërtimit të rrugëve të reja.

Projekti për rrugët e reja në nivel lokal duhet të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjate zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Në pozicionet për të cilat në Republikën e Kosovë nuk ka standarde të aprovuara, projektuesi mund të rekomandojë edhe përdorimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se (EURO COD), si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat dhe standardet e miratuara për personat me aftësi të kufizuar, të verberit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

8.5.1. Projektet dhe elaborati gjeodezik

Qëllimi i hartimit të dokumentacionit gjeodezik është që të formohet baza e shënimeve për punimin e dokumentacionit teknik- projektit, bartjen e shënimeve në terren dhe mirëmbajtjen e të dhënave gjeodezike gjatë eksploatimit të rrugës.

Gjithsesi të bashkëngjiten të dhënat për koordinatat e pikave të rrjetit gjeodezik të vërtetuar nga organi kompetent.

Projektuesi duhet të incizoj gjendjen ekzistuese të terrenit në aspektin horizontal dhe vertikal, duke u lidhë në rrjetin gjeodezik referent të Republikës së Kosovës “KosovaRef 01 apo Pozicionimi Satelitor i Kosovës (KOPOS)“.

Të gjitha matjet gjeodezike, llogaritjet dhe barazimet duhet të bëhen me saktësi sipas Kornizave të Matjeve Kadastrale në Republikën e Kosovës.

Të gjitha matjet dhe punët gjeodezike duhet të kryhen sipas Ligjit për Kadastër të Republikës së Kosovës.

Të gjitha objektet e incizuara në terren si: objektet ekzistuese, largpërçuesit, shtyllat elektrike, urat, lëshesat, pikat gjeodezike, pikat detale, kufijtë e njësive kadastrale, rrethojat prej materiali të ndryshëm, instalimet nëntokësore dhe mbitokësore (të paraqiten me shenja topografike përkatëse sipas çelësit topografik) të vizatohen- paraqiten në planin e situacionit në përpjesë $P= 1: 1\,000$, e cila do të shërbejë si bazë për hartimin e projektit ndërtimor dhe projekteve të veçanta.

Gjerësia e incizimit gjeodezik duhet të jetë minimum 50.00 m majtas dhe 50.00 djathtas nga aksi i rrugës ekzistuese, te objektet, udhëkryqet, devijimet e rrugës dhe rrugët lidhëse në gjerësi të nevojshme si dhe të gjitha njësit kadastrale me të cilat kufizohet toka rrugore (për shkak të elaboratit të shpronësimit).

Në bazë të incizimeve të bëra duhet të dorëzohet elaborati gjeodezik i cili do të jetë pjesë e veçantë dhe përbërëse e projektit ndërtimor.

8.5.2. *Elaborati i shqyrtimeve Gjeoteknike (Gjeomekanike)*

Për punimin e projektit kryesor të rrugës dhe strukturave (mureve mbrojtëse dhe urave, pjerrësive të skarpateve) duhet të bëhen shqyrtimet gjeoteknike.

Shqyrtimet gjeoteknike, përfshijnë punimin e shpimeve adekuate dhe sondave, me qëllim të definimit të profilit gjatësor gjeoteknik dhe aftësisë bartëse të tokës.

Në bazë të nxjerrjes së sondave dhe ekzaminimeve laboratorike, duhet të punohet Elaborati Gjeoteknik.

Numri i shpimeve do ta përcakton projektuesi, ashtu që niveli i ekzaminimeve të ep numër të mjaftueshëm të dhënave për përcaktimin e stabilitetit të gjurmimit, mbushjes, përcaktimit të konstruksionit të rrugës dhe fundimit të objekteve.

Në Elaborat të paraqitet Raporti me të dhënat e nevojshme, pas shqyrtimeve gjeomekanike.

Elaborati i mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes në punë

Projektuesi duhet të punoj elaboratin e mbrojtjes së mjedisit. Gjatë projektimit nevojitet që të parashihen të përdoren materialet që kanë testet e pranuar ndërkombëtare, në pikëpamje të mbrojtjes së mjedisit dhe punëtorëve. Duhet të parashihet deponimi i materialeve teprice sipas rregullativës për deponimin e hedhurinave. Në lokacionet ku parashihet që niveli i zhurmës të jetë për 5dB më e lartë se lejuar, duhet të parashihen barriera për pengimin e zhurmës, sipas tipit dhe standardeve të aprovuara në shtetet e BE. Për parandalimin e erozioneve të dëmshme duhet që në vend të drunjëve të prerë të parashihet mbjellja e fidanëve të reja dhe të mbjellët bari në pjerrësitë e mbushjeve dhe gjurmimeve. Dislokimi i rrjedhave të ujërave atmosferike, mund të bëhet vetëm në rastet e domosdoshme. Duhet ti largohemi mbushjeve shumë të ulëta, në pjesët e rrugës nëpër teren të rrafshët. Gjatë projektimit duhet ti largohemi gjurmimeve të thella. Mbrojtja e ujërave nëntokësor duhet të bëhet përmes drenazheve adekuate.

8.5.3. *Projekti i sinjalizimit dhe pajisjes së rrugës*

Në bazë të shënimeve nga projekti ndërtimor (situacioni- planimetria), projektuesi duhet të hartoj projektin e sinjalizimit dhe pajisjeve të rrugës, në përputhje me rregullativen ligjore në fuqi mbi projektimin e sinjalizimit horizontal dhe vertikal (Udhëzim administriv (MI) Nr. XX/2017 për për sinjalizim dhe rregullat e trafikut rrugor).

8.5.4. *Projekti i strukturave (Urave, nënkalimeve, mbikalimeve dhe mureve mbrojtëse).*

Projektuesi duhet të punoj projektin kryesor të urave, mbikalimeve, nënkalimeve për automjete dhe këmbësor, mureve mbrojtëse dhe strukturave tjera.

Pozicioni, gjatësia dhe forma e mureve mbrojtëse dhe strukturave do të caktohet nga projektuesi.

8.5.5. *Elaborati i Shpronësimit*

Ligjet dhe Standardet për Hartimin e Elaboratit të Shpronësimit

Gjatë punimit të "Hartimi i Elaboratit të Shpronësimit ", hartuesi i këtyre Elaboreteve duhet ti përmbahet Ligjeve dhe plotësimeve të tyre:

- Ligjit për Kadastër.
- Kornizave për matje kadastrale në Republikën e Kosovës.
- Ligjit mbi RDPP.
- Ligjit mbi Shpronësimin e pronave të paluajtshme.
- Ligjit mbi rrugët të Republikës Kosovës.
- Ligjeve dhe rregulloreve mbi mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjes në punë.

8.5.5.1. Kushtet teknike për rrugët e propozuar Lismir - Kuzmin - Vragoli dhe Miradi e Epërme - Miradi e Poshtme

Në përputhje me normat e planifikimit dhe me qëllim të përmbushjes së strukturës dhe kërkesave për qarkullim këto rrugë duhet të plotësojnë këto kriteret teknike:

- Rrugë me dy korsi me qarkullim dykahor me gjerësi minimale 6.0 m (3.0 m për secilen korsi),
- Shpejtësi të kufizuar 50 km/h në pjesën jashtë vendbanimit, ndërsa në pjesën e vendbanimit kufizimi i shpejtësisë maksimale duhet të jetë 40 km/h,
- Shtegu për këmbësorë me gjerësi minimale 1.20 m. Nëse gjatë projektimit paraqiten probleme të shtrirjes së shtegut për këmbësorë, atëherë në pjesë të caktuara të rrugës, gjerësia mund të zvogëlohet, por nuk duhet të jetë më e vogël se 0.80 m.
- Për shkak të sigurisë së lëvizjes, në pjesët e rrugës jashtë vendbanimit të projektohen shtigjet për çiklist të ndara fizikisht nga pjesa e rrugës qarkulluese, ndërsa në vendbanime, nëse nuk ka sipërfaqe të mjaftueshme për shteg të ndarë për çiklist, atëherë të projektohet korsi e shënuar për çiklist në sipërfaqen qarkulluese të rrugës,
- Korsi/shteg për çiklist në të dy anët e rrugës me gjerësi minimale 1,5 m. Nëse gjatë projektimit paraqiten probleme të shtrirjes së shtegut për çiklist, atëherë në pjesë të caktuara të rrugës, gjerësia mund të jetë 1.0 m.
- Nëse korsi/shtegu për çiklist projektohet vetëm në njërin anë, atëherë gjerësia e korsisë duhet të jetë me gjerësi 2.0 m - 2.5 m.
- Nëse në pjesën e rrugës është e nevojshme qetësimi i trafikut (në afërsi të shkollave ose institucioneve tjera arsimore), duhet të vendosen masat për qetësimin e trafikut dhe sinjalizimi përkatës për reduktimin e shpejtësisë në 20-30 km/h (zonë 30km/h).
- Sinjalizimin horizontal dhe vertikal i cili mundëson informimin, orientimin dhe sigurinë e lëvizjes për të gjithë pjesëmarrësve në trafik.
- Elementet horizontale dhe vertikale të trasesë së re duhet ti përshtaten rrugës ekzistuese duke bërë përmirësimet e domosdoshme të kthesave horizontale dhe vertikale në disa pjesë të trasesë.
- Pjesët e rrugëve të cilat shtrihen në vendbanim duhet të jenë të ndriçuara sipas normave teknike për ndriçimin e rrugëve publike.
- Brezi rrugor për rrugën e propozuar duhet të jetë në të dy anët e rrugës me gjerësi min. 1.00 m.
- Brezi mbrojtës rrugor (i cili ndalon hapjen e minierave, ndërtimin e liqeneve artificiale, fabrikave dhe ndërtesave të tjera të ngjashme) nuk duhet të jetë në distancë më të vogël se 30 m.
- Brezi mbrojtës rrugor (i cili ndalon ndërtimin e ndërtesave të banimit, administrative, hapjen e puseve të ujit dhe hapjen e gropave septike, ngritjen e instalimeve të transmetuesve elektrik dhe të ngjashme) nuk duhet të jetë në distancë më të vogël se 10 m.
- Brezi mbrojtës rrugor nuk vlen për rrugët urbane brenda vendbanimeve.
- Gjatë projektimit, projektuesi duhet të ketë konsideratë për kryqëzimet me largpërçuesit, rrjetin e telefonisë, rrjetin e ujësjellësit si dhe instalimet tjera që janë trupin e rrugës, brezin e rrugës dhe brezin mbrojtës të Rrugës dhe kyçet e objekteve rreth rrugës. Për të gjitha instalimet nëntokësore dhe mbitokësore, projektuesi duhet të ofroj zgjidhje teknike për dislokimin eventual si dhe paramasat me parallogaritë.
- Ndërtimi i rrugëve kryesisht duhet të bëhet konformë PZHU-së të Komunes. Në pjesët e rrugës kur hasë ne zgjerimin e rrugës, projektuesi duhet të propozoj zgjidhje alternative e cila do t'i prezantohet Komisionit për aprovim.
- Vendimi për shtrirjen e trasesë së rrugës (nëpër trasenë sipas Planit Zhvillimor Urban ose trase të re do të merret, pas shqyrtimit të varianteve të prezantuara nga projektuesi në Projektin ideor dhe arsyeshmërinë e dhënë zgjidhjes së variantit më të favorshëm).
- Elementet (horizontale) kryesore të trasesë së rrugës në Planin e Situacionit (kthesat horizontale, kaluese, drejtimet), elementet (vertikale) në profilin gjatësor (kthesat vertikale, pjerrtësitë gjatësore, përdredhjet e rrugës, rëniet tërthore) dhe profilet tërthore, duhet të punohen në bazë të rregulloreve për projektimin e rrugëve.
- Rënia tërthore e rrugës në drejtim, duhet të jetë në të dy anët e rrugës, min. 2.5 %, ndërsa në kthesa horizontale në njërin anë të rrugës (varësisht nga rrezja e kthesës).

- Zgjidhja e largimit të ujërave nga rruga duhet të jetë kryesisht tipi i mbyllur (kanalizim atmosferik) për pjesën urbane dhe pjesërisht tipi i hapur (kanale atmosferike) për pjesën rurale.
- Dimensionimi i konstruksionit të rrugës të bëhet duke u bazuar në kategorinë e tokës, kategorinë e rrugës, numrit të parashikuar të automjeteve dhe ngarkesave boshtore prej 115 KN.
- Strukturat (ura dhe objekte tjera inxhinierike) duhet të projektohen sipas normave Evropiane EURO COD.
- Në segmente të caktuara hapësira e lirë nga niveleta e re e përvetësuar e rrugës deri te pika më e ultë e strukturave duhet të jetë min. 4.80 m.
- Vendndalimet e autobusëve të punohen jashtë sipërfaqes së asfaltit, për ndalimin e një autobusi.
- Kualiteti i të gjitha materialeve të cilat përdoren për ndërtim, si dhe dimensionet e shtresave të konstruksionit të rrugës, duhet të jenë në përputhje me standardet dhe normat bashkëkohore për ndërtimin e rrugëve. Projektuesi mund të rekomandojë edhe përdorimin e standareve të reja, për përafrimin me normat e BE-se (EURO COD, EN), si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

Struktura e rrugës-Pavement structure-Fahrbahnbefestigung




Figura 18 Struktura karakteristike e rrugës

8.5.6. Rrugët lokale – përmirësimi i elementeve gjeometrike

Sipas normave teknike të Planifikimit Hapsinor, rrugët lokale janë rrugët që lidhin vendbanimet rurale apo fshatrat, me përjashtim të atyre që zyrtarisht janë kategorizuar si rrugë nacionale apo regionale.

Rrjeti rrugor në Komunën e Fushë Kosovës përbëhet nga rrugë me gjerësi të ndryshme. Në kuadër të PZHK-së dhe PZHU-së, përpos ndërtimit të rrugëve të reja është paraparë edhe përmirësimi i rrugëve ekzistuese (Caku 6).

Në përputhje me Normat e Planifikimit Hapsinor, me rastin e përmirësimit të rrugëve ekzistuese, rrjeti i infrastruktures rrugore duhet të plotësojë normat e planifikimit si në vijim:

- ≤ 40 km/h, gjerësia e korsisë është: 2.75 m;
- ≤ 60 km/h, gjerësia e korsisë është: 3.00 m;

Numri i korsive përcaktohet në baze të intensitetit të rrjetit.

Minimumi i gjerësisë së profilit për infrastrukturën e rrugëve publike urbane që do të shërbejnë gjatë përcaktimit të vijave rregulluese që përcaktojnë profilin e infrastrukturës rrugore publike janë:

- Rrugë transite nëpërmjet vendbanimeve- fshatrave- 9,50 m;
- Rrugë përmbledhëse/ shpërndarëse- 10,50 m;
- Rrugë servitore- 9,00 m;
- Rrugë banesore- 8,50 m;
- Rrugë industriale- 10,00 m;
- Rrugë qasëshe/ dy kahëshe- 5,50 m; dhe
- Rrugë qasëshe/ një kahëshe- 3,5 m.

8.5.7. Kriteret për projektin

Kushtet e lokacionit (kushtet për zgjedhjen e vendndodhjes së udhëkryqeve sipërfaqësore në planin e situacionit dhe në profilin gjatësor). Distanca ndërmjet udhëkryqeve dhe qasja e kontrolluar (respektimi i kriterëve të sigurisë gjatë kyçjes në rrugë varësisht nga kategorija). Plotësimi i kushteve të sigurisë për udhëkryqet sipërfaqësore, si: të vërehet në kohë adekuate, i dukshëm dhe i kuptueshëm, me dukshmëri të mjaftueshme në të gjitha degët hyrëse të udhëkryqit, i përshtatshëm për lëvizje, respektivisht të mundësojë lëvizje adekuate dhe të sigurt në varësi të strukturës së automjeteve.

Për funksionimin e mirë dhe funksional të udhëkryqeve sipërfaqësore, është e nevojshme ndarja e fluksit të trafikut në hyrje të udhëkryqeve (drejt, majtas, djathtas). Në hyrje të udhëkryqeve me sipërfaqe të mjaftueshme dhe me qarkullim më të madh të automjeteve, rrjedha e qarkullimit të trafikut mund të ndahet fizikisht (përmes ishujve kahëzues) me qëllim të zvogëlimit të pikave të konfliktit. Pjesa funksionale e udhëkryqeve sipërfaqësore duhet të përmbajë: zonat e perceptimit, rrjeshtimit, konfliktit dhe nxitimit.

8.5.8. Rrezja e rrumbullakësimit (harku) në udhëkryqe sipërfaqësore

Me qëllim të akomodimit të të gjitha automjeteve (varësisht nga struktura e automjeteve) dhe plotësimit të kriterëve të sigurisë gjatë lëvizjes nëpër udhëkryqe sipërfaqësore, në udhëkryqe duhet të plotësohen kriteret minimale teknike për rrezet e rrumbullakësimit.

Lloji i automjeteve	Rrezja e rrumbullakësimit R (m)		
	Kthimi majtas	Kthimi djathtas	
		Me ishull ndarës	Pa ishull ndarës
Automjetet	6	10	6
Kamiona dhe BUS	10	12	10
Kamionat me rimor.	12	15	12
Autobusët e mëdhenj	15	25	15

Tabela 25 Vlerat minimale të rrezes së rrumbullakësimit (harkut) në udhëkryqe


Ndriçimi i rrugëve duhet të projektohet në atë mënyrë që të siguroj:

- Dukshmëri të mirë dhe ngasje të sigurt në kushtet e natës,
- Vërejtjen me kohë të rrezikut potencial, orientim të mirë dhe siguri të përgjithshme për këmbësorë,
- Të gjithë pjesëmarrësve në trafik, vërejtje të sipërfaqeve të nevojshme dhe detale të rëndësishme të mjedisit gjatë lëvizjes.

Niveli i ndriçimit të rrugëve duhet të jetë në përputhje me Normat Teknike të Planifikimit, Ligjin për rrugët dhe aktet nënligjore për ndriçimin e rrugëve. Projektuesimund të rekomandojë edhe përdorimin e standardeve të reja, për përafrimin menormat eBE-se (EN -The European Norm for Road Lighting), si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

8.5.9. Kriteret për vendosjen e udhëkryqeve sipërfaqësore dhe udhëkryqeve në disnivel

Në fazat fillestare të përmirësimit të elementeve gjeometrike të rrugëve dhe udhëkryqeve, duhet të identifikohen problemet e sigurisë, kapacitetit dhe çasjes. Varësisht nga karakteri i rrugëve dhe ngarkesa e trafikut në hyrje të kryqëzimeve, është e nevojshme të projektohen edhe tipet e kryqëzimeve. Krahas parametrave të përgjithshëm, duhet të respektohen kriteret teknik për përzgjedhjen dhe vendosjen e udhëkryqeve sipërfaqësore, me qëllim që përmirësimit të sigurisë, rritjes së kapacitetit dhe kontrollimin e çasjes në rrugë.

									
Udhëkryqet në disnivel									
Udhëkryqet me semafor									
Rrethrotullime		Në rast se trafiku është i limituar	Në rast se trafiku është i limituar	Nuk ka kontroll të trafikut					
Udhëkryqet me shenja të trafikut			Jasht qytetit	Jasht qytetit	Në rast se trafiku është i limituar	Nëpër trotuare			
Udhëkryqet me prioritet								Sipas nevojës edhe në trotuare	Sipas nevojës edhe në trotuare

Legjenda

Tipologjia e rrjetit

 Rrjeti rrugor primar

 Rrjeti rrugor sekondar

 Rrjeti rrugor terciar/lagje

Masat që duhen ndërmarrë

 E nevojshme (përvetësuar)

 E mundshme

 E papranuar

Për të krijuar

8.6. Trafiku i

pamotorizuar

favorizuar përdorimin e rrugës nga këmbësorët dhe biçikletat, si dhe për promovuar një kulturë të re për trafik të pamotorizuar, paraprakisht duhet kushtet për lëvizje të lirë dhe të sigurt.

8.7. Sipërfaqet për lëvizje të këmbësorëve

Këmbësori është pjesëmarrësi më i shpeshtë, më i ngadalshëm dhe më i pasigurt nga të gjithë pjesëmarrësit në trafik. Secili drejtues i mjeteve është edhe këmbësor potencial. Sjellja e tij individuale kërkon edhe siguri të veçant, kryesisht në kushte urbane, aty ku drejtimet e tij të lëvizjes ballafaqohen me pjesëmarrësit tjerë në trafik. Për këtë arsye këmbësorët kanë nevojë për sipërfaqet e tyre të lëvizjes.

Meqenëse në PZHK dhe PZHU janë paraparë masat për përmirësimin e shkallës së sigurisë për këmbësorë (Pika 5.2.5), atëherë për përmirësimin e kushteve të sigurisë për këmbësorë në rrjetin ekzistues duhet respektuar këto kritere:

- Shtegu i këmbësorëve nënkupton sipërfaqen e rregulluar për lëvizjen e këmbësorëve dhe duhet të jetë i ndarë nga korsite automobilistike,
- Gjerësia minimale e shtegut për këmbësorë për një kahe (varg) të këmbësorëve duhet të jetë min. 0.80 m,
- Gjerësia minimale e shtegut për këmbësorë për lëvizje në dy kahe duhet të jetë min. 1.60 m,
- Për të siguruar lëvizjen e papenguar të personave me aftësi të kufizuara, gjerësia e shtigjeve për këmbësorë duhet të jetë të paktën 1.80 m, përjashtimisht 1.50 m, ndërsa gjerësia e kalimeve ndërmjet pengesave fikse duhet të jetë të paktën 0.90 m.
- Rampat për qasje të personave me aftësi të kufizuara në hapësirë janë të ndërlidhura dhe të përshtatura për orientimin, dhe me pjerrësi të cilat nuk mund të jenë me të mëdha se 5%, përjashtimisht 8%.




Figura 20 Gjerësia minimale e shtegut për këmbësorë për një kahe (varg) të këmbësorëve




Figura 21 gjerësia e kalimeve ndërmjet pengesave fikse

8.7.1. Korsitë dhe shtigjet për biçikleta

Në kuadër të Udhëzimit administrativ të MMPH për normat teknike të planifikimit hapsinor, sipërfaqet e dedikuara për lëvizje të biçikletave, ndahen në korsi dhe shtigje për biçikleta (Fig.8).

Korsitë për biçikleta janë pjesë e rrugës, e destinuar për qarkullimin e biçikletave, e shënuar me shenja përkatëse të komunikacionit. Korsitë për biçikleta planifikohen në rrugë ku shpejtësia e lëvizjes së automjeteve nuk kalon 50 km/h.

Shtigjet për biçikleta janë hapësire qarkulluese e destinuar për qarkullimin e biçikletave, e zbatuar ndaras nga profili tërthor i rrugës i shënuar me shenjat e duhura të komunikacionit. Shtegu mund të jetë i përbashkët për biçikleta dhe këmbësor.




Figura 22 Shtegu dhe korsi për biçikleta

Komuna e Fushë Kosovës ka një konfiguracion mjaft të përshtatshëm të terrenit për zhvillimin e çiklizmit. Mirëpo edhe përkundër këtij terreni mjaft të përshtatshëm për zhvillimin e çiklizmit, një formë e tillë e lëvizjes nuk është promovuar sa duhet. Në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal janë paraparë shtigjet për çiklist, por ende nuk është arritur që të ndërtohen shtigje të reja dhe funksionalizohen shtigjet ekzistuese.

Përgjatë rrugës magjistrale “Nënë Tereza”, e cila është në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës (MI), në dy kahe të lëvizjes, janë paraparë korsitë për çiklist, por shfrytëzimi i tyre ende nuk është në funksion të plotë. Numri i vogël i çiklistëve të cilët lëvizin nëpër rrugët e qytetit të Fushë Kosovës, ndajnë rrugën e përbashkët me automjetet motorike, respektivisht nëpër trotualet e dedikuara për lëvizjen e këmbësorëve.

Sipas standardeve të projektimit dhe normave të planifikimit (Udhëzimit administrativ të MMPH) për përmirësimin e sipërfaqeve për lëvizje të biçikletave në rrugët ekzistuese dhe për rrugët e reja të planifikuara, duhet që:

- Shtigjet për biçikleta jashtë vendbanimeve duhet të planifikohen si të ndara, me një brez të gjelbër të gjerësisë adekuate dhe pa pengese mbrojtëse, nga profili i tërthor i rrugës. Përfundimisht, për shkak të mungesës së hapësirës për planifikim të një brezi të gjelbër, shtegu për biçikleta duhet të sigurohet me një pengesë mbrojtëse nga çeliku.
- Gjerësia optimale/minimale dhe lartësia e shtegut për biçikleta jashtë vendbanimit: shteg njëdrejtësh, në të dyja anët e rrugës:
 - me gjerësi: 1.50/ 1.00 m,
 - me lartësi: 2.50 m.

Për arsye të sigurisë nuk rekomandohet zbatimi i korsive për biçikleta jashtë vendbanimeve.

Në pjesët e rrugëve në të cilat shpejtësia e lëvizjes planifikohet të jetë më e madhe se 50 km/h, atëherë duhet të planifikohet edhe brezi mbrojtës.

Gjerësia minimale e brezit mbrojtës të korsive dhe shtigjeve për biçikleta duhet të jetë: ≥ 0.75 m përgjatë kufizimit me korsi të rrugës, por vetëm nëse ajo është e ndare me sipërfaqe të ngritur dhe ≥ 0.75 m përgjatë kufizimit me shtigje për këmbësor apo vend-parkingje gjatësore, por vetëm nëse ajo është e ndare me sipërfaqe të ngritur, të gjelbër apo me elemente standarde ose të ngjashme.

Parkimi i biçikletave duhet të vendoset ashtu që të mos pengojë qarkullimin e këmbësorëve si dhe aty ku mund të sigurohet kontrolli,

Kriteret teknike për vendosjen e sipërfaqeve për parkim të biçikletave të jenë në përputhje me normat teknike të planifikimit dhe standardet teknike,

Vend-parkimet për biçikleta duhet të përbëhen nga: hapësira e vend-parkimit prej 1.20 m²/ biçiklete dhe hapësira qasëshe në vend-parkim, me gjerësi: 1.50/ 1.80 m.

Në vendet ku ka mundësi të vendosjes së parkingjeve për biçikleta, të respektohen normat dhe standardet teknike për parkingje të biçikletave.

Përshkrimi i përmbajtjes së ndërtesës	Numri minimal i vend-parkimeve për biçikleta (VPB)
Përmbajtjet tregtare dhe komunale	5 VPB/ 100 m ² të bruto sipërfaqes së ndërtuar (BSN) për vizitor
Përmbajtjet e bizneseve dhe publike	1 VPB/ 100 m ² të bruto sipërfaqes së ndërtuar (BSN) për të punësuar
Përmbajtjet arsimore	1 VPB/ 5 nxënës, për vizitor + 1 VPB/ 10 të punësuar
Përmbajtjet kulturore- teatro dhe muze	10 VPB/ 100 ulëse, për vizitor
Përmbajtjet shëndetësore- spitale	10 VPB/ 100 shtretër, për vizitor
Përmbajtjet sportive dhe rekreative	10 VPB/ 100 ulëse, për vizitor

Tabela 26 Numri i vend-parkingjeve për biçikleta

Kriteret për planifikimin e infrastrukturës për biçikleta

Me rastin e planifikimit ose përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese për biçikleta në kushte urbane, duhet të merren parasysh kriteret teknik dhe të sigurisë për infrastrukturën për biçikleta. Kriteret teknike për përdorimin, respektivisht mospërdorimin e sipërfaqes së përbashkët nga këmbësorët dhe çiklistët.

Këmbësorë/h nëse gjerësia e shtegut është 1 metër	Planifikimi i shtegut
< 100	Sipërfaqe e përbashkët
100-160	Vetëm ndarje vizuale
160 - 200	Ndarje vizuale dhe ndarje në nivel
>200	Nuk mund të shfrytëzohet sipërfaqja e njëjtë (përbashkët)

Tabela 27 Kriteret për shfrytëzimin e infrastrukturës së përbashkët nga çiklistët dhe këmbësorët


Lloji i sipërfaqes për biçikleta	Optimale	Minimale
Korsia për biçikleta	1, 50	1, 00
Shtegu njëkahorë për biçikleta	2, 00	1, 50
Shtegu dykahorë për biçikleta	2, 50	2, 00
Rruga për biçikleta	3, 50	2, 50

Tabela 28 Gjerësia e sipërfaqeve për lëvizje të biçikletave SISTEMI I TRANSPORTIT PUBLIK

Shërbimet e transportit publik kanë rol qenësor për të mundësuar lëvizjen drejt vendeve të punës, arsim dhe edukim, shëndetësi, tregti, përmbajtje publike dhe rekreacion. Shërbimet e transportit me autobusë dhe minibusë janë e vetmja mënyrë e transportit brenda komunës - nga Fushe Kosova drejt vendbanimeve dhe

lidhja e vendbanimeve mes veti. Transporti urban në qytetit e Fushë Kosovës realizohet nga linjat e organizuara nga “Trafiku urban” i Prishtinës, ndërsa lidhja me fshatrat mundësohet përmes linjave ndërurbane.

Planifikimi i rrjetit të transportit publik është i lidhur ngushtë edhe me Planin e Qëndrueshëm të Mobilitetit Urban të Komunës së Prishtinës i cili është në hartim e sipër. Në kuadër të këtij plani, është paraparë funksionalizimi i linjave dhe modelimi i rrjetit urban në tërësi, me ç’rast Linja nr.1. ndikon direkt në transportin urban të Fushë Kosovës.



Harta 14 Rrjeti i transportit urban

Për shkak të madhësisë së qytetit dhe bizneseve të shumta përgjatë rrugës magjistrale M9, linja e transportit publik urban propozohet të kalojë vetëm përgjatë rrugëve kryesore. Veprimet bazë të paraqitura në planin e veprimit (PZHK), të cilat janë ndare në tre kategori, janë ende aktuale dhe të rëndësishme për përmirësimin e transportit urban në Komunën e Fushë Kosovës:

- Vendosija e linjës urbane (autobus/tren), në relacionin Aeroport-Fushë Kosovë- Prishtinë, organizimi i transportit publik në qytet, stacionet - pikat e ndaljes përgjatë rrugëve kryesore dhe inkurajimi i përpjekjeve për shërbimet e përbashkëta transportit hekurudhor dhe transportit rrugor. Komuna duhet të caktoj pikat e ndaljes së transportit publik, kryesisht në vendet më të frekuentuar duke pasur parasysh kritetret e vendosjes së stacioneve dhe të sigurojë për to infrastrukturën e nevojshme.
- Rritja e numrit të autobusëve për transport urban dhe intervalit të lëvizjeve, sidomos në relacionin Prishtinë –Fushë Kosovë dhe anasjelltas, me qëllim të uljes së shkallës së motorizimit për automjetet individuale.
- Vendosija e linjave të reja dhe të rregullta me autobusë për lidhje me fshatrat përreth.
- Qarkullimi duhet të sigurohet në të dy kahet e rrugës.
- Zona e mbulimit për transport publik duhet të jetë 400m - 600m.
- Stacionet e propozuara të transportit publik përveç stacionit kryesor të autobusëve duhet të jenë të vendosura në atë mënyrë që të mbulojnë distancat e ecjes prej 5-10 minuta.

Ndërtesat dhe sipërfaqet për transport publik urban dhe rural

Komuna e Fushë Kosovës nuk ka stacion të autobusëve dhe ndonjë objekt me infrastrukturën përcjellëse me qëllim të ofrimit të shërbime për operatorët e transportit rrugor të udhëtareve. Për shkak të afërsisë me Komunën e Prishtinës dhe me stacionin qendror të autobusëve në Prishtinë, të gjitha shërbimet në nivel të Kosovës dhe me destinacion ndërkombëtar, realizohen nga stacioni i autobusëve në Prishtinë.

8.8. Rrjeti hekurudhor

Rrjeti hekurudhor i Kosovës shtrihet në një gjatësi prej 333 km. Përfshin linja të paelektrifikuara standarde njëdrejtimshme.

Linja kryesore shtrihet nga kurfiri verior i Kosovës, në veri të Mitrovicës e deri në Han të Elezit, në kufi me Maqedninë dhe kalon përmes Fushë- Kosovës, afër Prishtinës. Kjo linjë e gjatë 141 km. është pjesë e Rjetit hekurudhor qëndror të SEETO-s, Rruga 10, dhe lidhë Shkupin (IRJM) me korridoret VIII dhe X të SEETO-s.

Linjat tjera përfshijnë linjat Fushë - Kosovë- Pejë, Klinë-Prizren (Klina gjindet në linjën mes Fushë- Kosovës dhe Pejës) dhe Fushë- Kosovë-Prishtinë-Podujevë. Disa nga këto linja nuk janë në funksion, sidomos ato në drejtim të kufirit me Serbinë, ndër to edhe lidhja hekurudhore me Podujevën, pastaj lidhja hekurudhore me Prizrenin, ndonës kanë rëndësi për qytetarët e këtyre rajoneve.

Nuk ka linjë hekurudhore direkte që lidhë Kosovën, Malin e Zi dhe Shqipërinë.

Sipas normave të Planifikimit Hapsinor, brezi mbrojtës hekurudhor është një hapësirë e vazhdueshme tokësore, në të dy anët e hekurudhës, gjerësia e të cilit kalkulohet nga boshti i binarit përfundimtar dhe shërben për mbrojtjen e hekurudhës dhe trafikut që realizohet nëpër të

- brezi mbrojtës hekurudhor i përgjithshëm është me gjerësi 8.00 m;
- brezi mbrojtës hekurudhor në hapësira të populluara është me gjerësi 6.00 m;
- Brezi mbrojtës hekurudhor përfshin tokën nën hekurudhë dhe hapësirën ajrore në një lartësi prej 14 m. Brezi mbrojtës hekurudhor, gjithashtu përfshin edhe hapësirën tokësore të vendeve zyrtare (stacioneve, ndalesave, kryqëzimeve, 'nivelatave', etj) që përfshin gjithçka që është teknike- ndërtesat teknologjike, instalimet dhe qasjet deri në rrugën publike më të afërt në rast të zjarrit.




Figura 23 Brezi mbrojtës dhe rregullues hekurudhor

Duke e pasur parasysh që vendkalimet e pa mbrojtura paraqesin rrezik permanent për sigurinë e komunikacionit, me rastin e ndërtimit të rrugëve të reja të cilat janë në nivel të njëjtë me hekurudhë, duhet:

- Të eliminohen vendkalimet e pa nevojshme ose sigurimi i tyre të bëhet me barijera,
- Të gjitha vendkalimet të cilat për momentin janë të siguruara vetëm me barriera manuale, të sigurohen me barriera në mënyrë automatike,
- Ndërtimi kapaciteteve dhe infrastrukturës efikase për menaxhimin e sigurisë,

- Vendorsja e stabilimenteve sinjalo – siguruese, sipas kritereve dhe standardeve më të larta të sigurisë.

8.8.1. Terminali

Në rajonin e Fushë Kosovës (Miradi), ndodhet terminali i mallrave. Rëndësia e këtij terminali është e një rëndësie të veçantë, për Hekurudhat e Kosovës në tërësi, e në veçanti për Komunën e Fushë Kosovës.

Në përputhje me strategjinë sektoriale dhe transportit multimodal 2015-2025⁶, duhet të bëhet modernizimi i terminalit në Fushë Kosovë. Me qëllim të ofrimit të shërbimeve të transportit multimodal, është e nevojshme:

- Përmirësimi i terminalit multimodal ekzistues në Miradi, në mënyrë që të pranojë trenat e gjatë 550 m që vijnë nga BE, dhe shqyrtimi i mundësive për ndërtimin e terminaleve tjera në Republikën e Kosovës.
- Modernizimi i terminalit të mallrave në Miradi, me qëllim të rritjes së ofrimit të shërbimeve të TMM;

8.9. Vendparkimet

Vendparkimi është hapësirë e projektuar, e shënuar dhe teknikisht e pajisur për të akomoduar dhe lënë një automjet. Vendparkimet mund të jenë të akomoduar në vend-parkime të rregulluara, në rrugë dhe në garazhe.

Problemi i parkimit, ka rezultuar për shkak të rritjes së qytetit, rritjes së numrit të mjeteve motorike, pa përgatitja e qyteteve për pranim të automjeteve dhe rritjes së standardit të jetesës së popullatës. Në situatën e tillë, për zgjidhjen e këtij problemi, domosdo, duhet një mënyrë e organizuar, planifikuar dhe profesionale. Të interesuar për zgjidhje, janë jo vetëm ngasësit (si shfrytëzues), por edhe tregtarët, aktivitetet biznesore dhe aktivitetet e tjera në qytet, të cilat janë shkaktar për afrimin e automjeteve, dhe në fund, vetë qyteti i cili është i interesuar për funksionimin e plot efektiv të trafikut, prandaj edhe të parkimit.

Sipas PZHK dhe PZHU lidhur me vend-parkimet, janë dhënë disa standarde të nevojshme në varësi të objekteve.

Standardet numrin e vend-parkimeve, varësisht nga përmbajtja, janë dhënë në tabelën vijuese:

Numri i vend-parkimeve për automjete në varësi nga përmbajtja			
Përmbajtja	Lloji i ndërtesës, përshkrimi i përmbajtjes së Ndërtesës	Numri minimal i vend-parkimeve (VP) apo vendeve për garazhin për 100 m ² të bruto sipërfaqes së ndërtuar (BSN)	
Banimi	Ndërtesat e banimit të mesëm dhe të lartë/ ndërtesat e banimit dhe biznesit	2 VP/ 100 m ² , por jo me pak se numri i njësive të banimit për pjesën e ndërtesës së banimit	Nga numri i obligueshëm i VP, se paku 20% duhet të jetë për shfrytëzim publik, ndërsa gjatë hartimit të planeve operative, për pjesë të pa ndërtuara, të planifikohen edhe se paku 10% për

⁶ Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 dhe Plan i veprimit 5 vjeçar, MI, 2015



Numri i vend-parkimeve për automjete në varësi nga përmbajtja			
			shfrytëzim publik
	Ndërtesat e banimit të ulët/ ndërtesat e banimit dhe biznesit	2 VP/ 100 m ² , por jo me pak se numri i njësive të banimit për pjesën e ndërtesës se banimit	Gjatë hartimit të planeve operative për pjese të pa-ndërtuara, domosdoshmërisht të planifikohet edhe 1 VP/ 1 ndërtesë të banimit të ulet
	Ndërtesat e banimit të ulët- vilat (deri në 4 njësi maksimal)	3 VP/ njësi banimi	-
Hoteleria dhe turizmi	Ndërtesat e hoteleve deri në 3*	0.2 VP/ një shtrat	-
	Ndërtesat e hoteleve me 4*	0.5 VP/ një shtrat	-
	Ndërtesat e hoteleve me 5*	0.75VP/ një shtrat	-
	Ndërtesat e restoranteve, kafeneve dhe të përmbajtjeve të tjera të ngjashme	4 VP/ 100 m ²	-
Tregtia dhe përmbajtjet komunale	Ndërtesa e tregtisë	4 VP/ 100 m ² të hapësirës shitëse	-
	Ndërtesa/ hapësirat e tregjeve	3 VP/ 100 m ² të hapësirës shitëse	-
	Ndërtesat e depove	1 VP/ 100 m ²	-
Biznes dhe publik	Ndërtesat e bizneseve	4 VP/ 100 m ²	Për sipërfaqe me të vogla se 100 m ² , të sigurohen se paku 2 VP
	Ndërtesat administrative (publike)	2 VP/ 100 m ²	
Industria dhe zanatet	Ndërtesat e industrive	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat e zanateve	2 VP/ 100 m ²	-
Kultura dhe arsimi	Ndërtesat e kopshteve/ çerdheve të fëmijëve	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat e shkollave fillore	0.5 VP/ 100 m ²	Për ndërtesat e sallave të sporteve në kompleks të shkollës, kalkulohet vetëm hapësira e sallës
	Ndërtesat e shkollave të mesme	1 VP/ 100 m ²	-




Numri i vend-parkimeve për automjete në varësi nga përmbajtja			
	Ndërtesat e fakulteteve dhe instituteve	1 VP/ 100 m ²	Për sipërfaqet e komplekseve, nr. i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta, përkatësisht me plane operative.
	Ndërtesat e kinemave, teatrove, sallave për mbledhje publike	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat religjioze- xhamitë, kishat, etj	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat e muzeve, galerive dhe bibliotekave	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat/ sallat e kongreseve	1 VP/ 100 m ²	-
Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	Ndërtesat e spitaleve, klinikave, qendrave të rehabilitimit dhe të përmbajtjeve të tjera të ngjashme	1 VP/ 100 m ²	-
	Ndërtesat e ambulancave, poliklinikave dhe shtëpive të shëndetit	3 VP/ 100 m ²	Numri i VP duhet të jetë jo me i vogël se numri i ambulancave
	Shtëpitë për të moshuar	0.5 VP/ 100 m ²	-
Sporti dhe rekreacioni	Ndërtesat e sporteve në shërbim të ndërtesave të banimit (fushat sportive dhe fushat e lojës të hapura për fëmijë)	-	Numri i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta
	Ndërtesat e sporteve të hapura dhe të mbyllura pa spektator	-	Numri i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta.
	Ndërtesat e sporteve dhe fushave sportive me spektator	-	Numri i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta.
Terminalet e udhëtareve	Ndërtesat e terminaleve të autobusëve	-	Për ndërtesat e terminaleve duhet të
	Ndërtesat e terminaleve të trenit	-	hartohet projekti i teknik i trafikut,

Numri i vend-parkimeve për automjete në varësi nga përmbajtja			
	Ndërtesat e terminaleve të aeroporteve	-	me kalkulimin e numrit të VP, në veçanti për: ▪ Vendqëndrimet (ngarkim/ shkarkim); ▪ parkim afat-shkurtë; ▪ parkim afat-gjatë

Tabela 29 Numri i vendparkimeve varësisht nga përmbajtja

Sipas normave të planifikimit hapsinor, janë katër llojet themelore të parkimit:

- **Vendparkim rrugor**, nënkupton vend-parkimin në rrugë dhe mund të jetë vend-parkim në formë gjatësore, të pjerrët dhe tërthore;
- **Vendparkim jashtërrugor publik**, nënkupton vend-parkimin jashtë rrjetit rrugor, por të qasshëm si edhe rrugët publike;
- **Vendparkim jashtërrugor privat**, nënkupton vend-parkimin si pjesë përbërëse e një ndërtese, të një qendre biznesi ose komerciale;
- **Vendparkim jashtërrugor privat për banor**, nënkupton vend-parkimin jashtë rrjetit rrugor të ndërlidhur me ndërtesat e banimit individual dhe në bashkëpronësi.






Figura 24 Llojet e vendparkimeve

Vendparkimi rrugor për automjete

Vendparkimi rrugor është pjesë e profilin tërthor rrugor të vendbanimeve. Vend-parkimet rrugore mund të planifikohen në format në vijim:

- Parkimi i automjeteve për nevoja të ndërtesës së banimit projektohet me dokumentet e planifikimit hapësinor si hapësirë nëntokësore, mbitokësore i hapur ose i mbuluar, në kuadër të objektit garazhe ose i kombinuar.
- Numri i vend parkimit të automjeteve për njësitë e banimit duhet të jetë minimum një vend parkim për një banesë.
- Numri i vend parkimit të automjeteve për njësitë afariste, në kuadër të ndërtesës, duhet të jetë minimum një vend parkim për 30 m² neto sipërfaqe afariste, nëse me dokumente të planifikimit hapësinor nuk parashihet ndryshe.
- Largësia nga vend parkimi i fundit deri te hyrja e ndërtesës duhet të jetë jo me shume se 100 m nëse me dokumente të planifikimit hapësinor nuk parashihet ndryshe.

Dimensionet minimale për hapësirat e parkimit në varg për automjete motorike standarde do të jenë si më poshtë:

- Vend parkimi në 90° - 250 cm x 455 cm;
- Vendparkimi në 60° - 250 cm x 485 cm;
- Vendparkimi në 45° - 250 cm x 485 cm ;
- Vendparkimi në 30° - 250 cm x 425 cm;
- Vendparkimi paralel - 215 cm x 640 cm;
- Vendparkimi i rrethuar - 270 x 550 cm
- Varësisht nga pozita e parkingut në buzë të rrugës:

Vendparkimet për qëllime të veçanta

Vend-parkimet për qëllime të veçanta iu përkasin vend-parkimeve të rezervuara për qasje të personave me aftësi të kufizuara:

- Vendparkimet për qasje të personave me aftësi të kufizuara, përveç hapësirës normale për parkim të automjetit, përmbajnë edhe hapësirë shtesë për hyrje/ dalje nga automjeti;
- Së paku 5% e numrit të gjithmbarshëm të parkingjeve duhet të jenë për qasje të personave me aftësi të kufizuara;
- Vendparkimi duhet të jetë i vendosur me afër hyrjes në ndërtesë dhe duhet të plotësoj këto kushte:
- Dimensionet bazë të vendparkimit, gjatësor, në pjerrësi dhe pingul, për një automjet janë: 3.70 x 5.00 m;

- Dimensionet bazë të vendparkimeve, gjatësore, në pjerrësi dhe pingul, për dy automjete janë: 5.90 x 5.00 m, me një distancë vend-kalim shtesë për hyrje-dalje ndërmjet tyre prej 1.50 m;
- Vendkalimi shtesë për hyrje-dalje nga vendparkimi në shtigjet e këmbësorëve të siguruar me gurin skajor nuk lejohet të ketë pjerrtësi më të madhe të se 10% dhe gjerësi më të vogël se 1.20 m.
- Vendparkimet për qasje të fëmijëve në automjete transportuese të veçanta:
- Vendparkimet për qasje të fëmijëve të vegjël deri në 6 vjeç në automjete transportuese të veçanta, shënohen në mënyrë që të ju lehtësojnë prindërve marrjen e fëmijëve dhe të pajisjes së tyre. Përveç hapësirës normale për parkim të automjetit, këto vendparkime përmbajnë edhe hapësirë shtesë për hyrje/ dalje nga automjeti;
- Gjerësia shtesë në të dyja anët e vend-parkimit është nga 1.00 m, apo 2.00/ 2.30 m në tërësi.




Figura 25 Vend-parkimet për qëllime të veçant

8.10. Lëvizshmëria dhe rregullimi i qarkullimit dhe transportit

Me qëllim që njerëzit të ecin në mënyrë të sigurt, të përshtatshme, efikase dhe të qetë, u nevojitet një mjedis dhe infrastrukturë e projektuar mirë për të përmbushur nevojat e tyre të udhëtimit. Prandaj, me qëllim të sigurimit të qasjes sa më të lehtë për lëvizjet ditore dhe shërbime tjera, përmirësimin e shkallës së sigurisë, zvogëlimin e ndotjes së ambientit, rritjen e efikasitetit dhe ekonomicitetit gjatë transportit të njerëzve dhe të mallrave, rritjen e atraktivitetit dhe kualitetin e mjedisit urban, është e nevojshme që për Komunën e Fushë Kosovës të hartohet PLANI I MOBILITETIT TË QËNDRUESHËM URBAN.

Nevoja për hartimin e planit të mobilitetit urban, është paraparë edhe me PZHK të Fushë Kosovës (pika 5.2.5), në të cilin është potencuar se, duhet të hartohet koncepti detaj i mobilitetit (përfshirë edhe transportin publik,



këmbësorët dhe çiklistët) për komunën e Fushë Kosovës. Ky koncept duhet te përcillet me plan detaj për zhvillimin e turizmit.

Qëllimi i hartimit të planit të mobilitetit për Fushë Kosovën duhet të definojë plane te veprimit afatshkurtër/afatmesëm dhe një planifikim afatgjatë strategjik për funksionalizimin e rrjetit rrugor dhe për ta bërë Fushë Kosovën një vend të qëndrueshëm dhe atraktiv për të jetuar dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik.



9. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

Bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe marr parasysh gjendjes ekzistuese planifikohet infrastruktura publike dhe sociale, duke specifikuar llojin, lokacionin, kapacitetin dhe kushtet teknike për projektim dhe ndërtim të:

- Parqeve publike dhe hapësirave të hapura;
- Fushave sportive dhe hapësirave rekreative;
- Hapësirave dhendërtimet për shërbime mjekësore;
- Ndërtesat për shërbime sociale;
- Ndërtesat e institucioneve parashkollore;
- Shkollat dhe universitetet;
- Qendrat administrative;
- Hapësirat dhe ndërtesat e sigurisë publike; dhe

9.1. Parqet publike dhe hapësirat e hapura

Bazuar në planin Zhvillimor Komunal të Fushë Kosovës me fokus në kutrajtohen sheshet dhe parqet të: Strategjia 5 – Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese. Në PZhK është paraparë:

- Plani 5-1 Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale
- Krahës ngritjes së kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve sociale (në arsim, shëndetësi, shërbime publike, kulturë) ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale është i nevojshëm për të plotësuar shpërndarjen gjithë-përfshirëse të këtyre shërbimeve dhe njëdhimisht sigurimin e cilësisë në këto shërbime. Plani zhvillimor komunal ka paraparë të nevojshme ndërtimin e këtyre objekteve dhe hapësirave të reja për përmirësimin e rrjetit të infrastrukturës sociale: Sheshe dhe parqe (në pronën publike në territorin komunal)

Drejtoritë përkatëse komunale në koordinim me institucionet përkatëse dhe komunitetit duhet të hartojnë programin dhe projektin për ndërtimin e këtyre objekteve dhe hapësirave të infrastrukturës sociale.

Plani 5-2 Përmirësimi i objekteve dhe hapësirave ekzistuese komunale të infrastrukturës sociale

Objektet dhe hapësirat ekzistuese të infrastrukturës sociale në territorin e komunës së Fushë Kosovës duhet të mirëmbahen dhe të monitorohen vazhdimisht për të siguruar funksionalitet dhe cilësi të infrastrukturës sociale në shërbim të banorëve të komunës. Objektet dhe hapësirat ekzistuese si:

- Hapësirat e gjelbëruara dhe
- Parqet

Për kundër që në PZHK nuk kemi specifikime të lokacioneve specifike por në varësi të funksionit të tyre ato duhet të mirëmbahen, dhe në rast të dëmtimit apo amortizimit të përmirësohen për të mundësuar funksionimin e tyre dhe shërbimin për banorët e vendit ku do që gjenden.

Përmirësimi i shërbimeve sociale implikon edhe nevojën për përmirësimin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimin e objekteve të reja që shërbejnë për këtë qëllim. Komuna e Fushë Kosovës ka mungesë për shtimin e objekteve dhe hapësirave me përmbajtje publike dhe për shërbime publike.

Bazuar në Hartën Zonale të Komunës së Fushë Kosovës, çdo strukturë banimi brenda zonës urbane dhe zonave kryesore rurale, duhet të ketë në një rreze prej 400 metrash, të paktën një hapësirë të gjelbër.

Në zonën Urbane të Fushë Kosovës të blloqet pjesërisht të hapura (që paraqesin inversin e blloqeve të mbyllura)- duhet të përmbajnë këto veçori: pjesët e brendshme të bllokut duhet të janë në shfrytëzim të hapësirave publike si: parqet, hapësirat për kohezion shoqëror, fushë-lojërat për fëmijë, hapësirat për sport



dhe rekreacion, etj. Këto kërkesa minimale hapësinore janë përcaktuar duke marrë parasysh shërbimet ekzistuese dhe funksionaliteti i tyre, kërkesat për shërbime të reja si dhe disponueshmërinë e ambienteve të përshtatshme.

Sa i përket kapaciteteve të **Parqeve publike dhe hapësirave të hapura** ato duhet plotësojnë kapacitetet e lagjeve, vendbanimeve, brezave, brezat e gjelbër përgjatë rrjedhave ujore në harmoni me numrin e banorëve dhe normat.

Te hapësirat e gjelbra si:

- Parqet publike ose hapësirat e lira për shfrytëzim nga këmbësorët ose çiklistët
- Fushat e hapura sportive dhe rekreative.

Në harmoni me normat e planifikimit dhe në harmoni me normat minimale për sipërfaqen e parcelës së hapësirave të gjelbra, duhet që sigurohen hapësira të gjelbra publike prej së paku:

- 1.00 m²/banor park publik në kuadër të lagjes;
- Parqet publike në kuadër të vendbanimit: 2.00 m²/banor;
- Brezat e gjelbër përgjatë rrugëve: 1.00 m²/banor;
- Brezat e gjelbër përgjatë rrjedhave ujore: 2.00 m²/banor.

Ndërsa kushtet teknike për projektim dhe ndërtim duhet të jenë ato pozitive që shfrytëzohen në vend.

Bazuar në analizat e bëra vlerësohet se komuna nuk ka hapësira të mjaftueshme për parqe dhe hapësira të hapura andej mund të shfrytëzohen **bonuset e zonimit** për të mundësuar krijimin e këtyre hapësirave.

9.2. Fushave sportive dhe hapësirave rekreative

Fushë Kosova ka një qendër rekreimi në kuadër të shkollës (sallë sporti e mbyllur në qytet). Fushat tjera publike janë kryesisht të hapura dhe në kuadër të shkollave. Ato private janë të hapura dhe të mbyllura, por të cilësisë së ulët. Për zhvillimin e komunës parashihet ndërtimi i një qendre rekreimi sipas standardeve bashkëkohore (Caku5). Në PZhK është paraparë:

- planit 4-5 Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së përmbytjeve për sport e rekreim, ku planifikohet që përmbytjet për sport dhe rekreim të ofrohen në tërë territorin komunal dhe cilësia e përmbytjeve për sport e rekreim në komunë duhet të ngriten, duke kërkuar për të;

Strategjitë dhe planet e veprimit për zhvillim social për të:

- Siguruar hapësira për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe rekreative në cilësi të lartë
- Siguruar shpërndarje gjithëpërfshirëse të përmbytjeve për sport e rekreim në territorin e komunës dhe ku theksohet se këto veprimtari dhe përmbytjet për sport e rekreim mund të ofrohen në kuadër të shkollave, qendrave lokale të komunitetit, sallave dhe terreneve për sport, vlen të theksohet se edhe brenda planit 5-2 vihet në theks përmirësimi i objekteve dhe hapësirave ekzistuese komunale të infrastrukturës sociale.

Objektet dhe hapësirat ekzistuese të infrastrukturës sociale duhet të mirëmbahen dhe të monitorohen vazhdimisht për të siguruar funksionalitet dhe cilësi të infrastrukturës sociale në shërbim të banorëve të komunës. Ndër këto objekte dhe hapësira ekzistuese janë edhe:

- Objekte shkollore
- Objekte për sport dhe rekreim

Të tillat bazuar në funksionet e tyre duhet të mirëmbahen, dhe në rast të dëmtimit apo amortizimit të përmirësohen për të mundësuar funksionimin e tyre dhe shërbimin për banorët e vendit.

Përmirësimi i shërbimeve sociale implikon edhe nevojën për përmirësimin e objekteve



ekzistuese dhe ndërtimin e objekteve të reja që shërbejnë për këtë qëllim. Komuna e Fushë Kosovës ka mungesë për shtimin e objekteve dhe hapësirave me përmbajtje publike dhe për shërbime publike edhe në kuadër të planit të veprimtari kemi të cekur si në vijim:

	Strategjia	Veprimet	Korniza institucionale	Afati kohor	Kosto e realizimit ⁷
13	Plani 4-5 Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së përmbajtjeve për sport e rekreim	Komuna, MKRS, MPMS	Afatmesëm	E mesme	1

Bazuar në 5.2.2. Kushtet për rregullimin e hapësirës: PZHK përmes kornizës së zhvillimit hapësinor ka përcaktuar kushtet dhe masat për rregullimin e sipërfaqeve të destinuara: kushtet për rregullimin e hapësirave për sport e rekreacion.

Në përgjithësi, kushtet për rregullimin e hapësirave duhet të bëhen sipas rregullave të përcaktuara nga korniza e zhvillimit hapësinor të Planit, si dhe rregullave të veçanta të përcaktuara me ligje përkatëse dhe ato të përcaktuara me aktet ligjore të planifikimit (Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimit Hapësinor për kushtet e lokacionit, Kushtet ndërtimore dhe Leje ndërtimore të cilat rregullohen kushtet e lokacionit të objekteve ndërtimore, në 5.2.4. Kushtet për vendosjen e veprimtarive publike; PZHK ka një politikë të mençur që do të udhëhiqet nga ana e komunës, për të mbrojtur zonën e infrastrukturës me interes për komunën, zgjerimin e zonave të aktivitetit publik në përputhje me funksionin e vendbanimit – qendra kryesore, nënqendra, qendër lokale dhe fshat.

Zonat e destinuara për sport dhe rekreacion duhet të jenë të furnizuara me shtigje, infrastrukturë dhe gjelbërim. Në kuadër të këtyre zonave do të lejohet vetëm ndërtimi i objekteve të hapura dhe të mbyllura sportive, hapësira për parkim, restorante të vogla dhe dyqane për blerjen dhe marrjen me qira të pajisjeve sportive. Maksimumi i indeksit të shpëtës nuk guxon të kalojë 10% të sipërfaqes së ngastrës, si dhe 5.2.9. Masat për parandalimin e ndikimit negativ social; Komuna duhet të ofrojë infrastrukturë të nevojshme sociale në mes tjerash atë sportive që të shmanget ndikimi negativ social i zhvillimit. Një seri e masave për infrastrukturë duhet të jenë sipas funksionit të vendbanimit (qendra kryesore, qendra lokale). Dendësia e vendbanimit duhet të harmonizohet dhe të jetë në pajtim me zhvillimet sociale të vendbanimit.

Edhe me PZHU janë definuar në 4.4.2. Kushte të përcaktuara nga qeveria lokale mbi çështje të rëndësishme për zhvillimin dhe shfrytëzimin e tokës në qytet dhe me 4.4.2.1 Kushtet për përcaktimin e destinimit të sipërfaqeve në territorin e qytetit; E në qytetin e Fushë Kosovës, plani përcakton në mesin e destinimeve tjera të sipërfaqeve edhe atë për sport dhe rekreim. Njëjtë si të PZHK edhe të PZHU janë përcaktuar: në 4.4.2.2. Kushtet për rregullimin e hapësirës, në 4.4.2.4. Kushtet për vendosjen e veprimtarive publike, Standardet për parkim ku është specifikuar se në ndërtesat sportive duhet të ketë: 1 VP / 20 ulëse, si dhe në 4.4.2.9. Masat për parandalimin e ndikimit negativ social.

Pasi që PZHK nuk ka definuar hapësirat për sport dhe rekreim sipas nomenklaturës së Sistemit Hierarkik të Klasifikimit të Shfrytëzimit të Tokës (HILUCS) një territor duhet të karakterizohet sipas dimensionit funksional të shfrytëzimit ekzistues të tokës- siç ka qenë, dhe në mënyrë efektive siç është akoma në jetën reale; dhe të shfrytëzimit të planifikuar të tokës- i cili korrespondon me planet hapësinore në këtë rast me PZHK, të përcaktuara nga autoritetet e planifikimit hapësinor, të cilat përcaktojnë shfrytëzimin e mundshëm të tokës në të ardhmen.

Kjo nomenklaturë e shfrytëzimit të tokës është e obligueshme të përdoret gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor në këtë rast HZK-së, brenda shërbimit kulturor, argëtues dhe rekreativ 3.4.3



Infrastrukturë sportive Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve, si infrastrukturën sportive, si stadione, salla sportive, pishina, palestra, impiante të skive, fusha golfi dhe infrastruktura të tjera sportive dhe 3.4.4 Hapësire e hapurrekreative Kjo klasë përfshinë hapësira rekreative në ajër të pastër, p.sh. parqet urbane, terrenet sportive, parqet kombëtare dhe zonat natyrore që përdoren për qëllime rekreative (p.sh. pyjet, malet, zonat bujqësore, pellgjet, liqenet, lumenjtë).

Pasi që brenda PZHK-së dhe PZHU-së janë trajtuar si caqe apo qëllime ku planifikohet ndërtimi i një qendre rekreimi sipas standardeve bashkëkohore (Caku5) si dhe ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së përmbajtjeve për sport e rekreim dhe për të siguruar hapësira për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe rekreative në cilësi të lartë si dhe siguruar shpërndarje gjithëpërfshirëse të përmbajtjeve për sport e rekreim në territorin e komunës, sa i përket llojit të infrastrukturës e institucioneve sportive dhe hapësirave rekreative përbëhen nga:

1. Ndërtesat e stadioneve;
2. Ndërtesat e sallave sportive;
3. Ndërtesat sportive shumëfunksionale;
4. Fushat sportive-rekreative shumëfunksionale;
5. Shtigjet për gara motorike;
6. Shtigjet për kalërim;
7. Shtigjet për ngjitje dhe marshim alpin;
8. Shtigjet për çiklizëm;
9. Shtigjet për skijim;
10. Shkëmbinjtë natyrorë dhe artificialë për ngjitje;
11. Fushat e golfit.

Në përmbushje të Planit 5-1 Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale të Strategjisë 5 – Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese të PZHK-së, Harta Zonale ka paraparë ndërtimin e infrastrukturës:

- Palestër sportive në Miradi e Ulët
- Sallë sportive për sporte marcialë pranë ShF Selman Riza
- Sallë sportive Vragoli
- Sallë sportive Miradi e Epërme
- Sallë sportive Mesbardh
- Sallë sportive Henc
- Sallë sportive Grabovc
- Sallë sportive Halilaq
- Ndërtimi i shtigjeve të çiklistëve dhe objekteve tjera rekreative në Sllatinë të Vogël

Tetë hapësirat rekreative në Komunën tonë duhet të përmbushin kushteve zhvillimore në vijim:

- Kushtet zhvillimore për ndërtimin e Palestër sportive në Miradi e Ulët janë:

Lloji:	Palestër sportive për zhvillimin e sporteve në parket
Lokacioni:	QMF te Kompleksi 300
Kapaciteti (ulëse):	1,200
Etazhiteti:	P+1



-
- ISHPKZh: 50%
- Kushtet zhvillimore për ndërtimin e sallës sportive për sporte marcialle pranë ShF Selman Riza janë:
 - Lloji: Sallë sportive për sporte marcialle
 - Lokacioni: Pranë ShF Selman Riza
 - Kapaciteti (ulëse): 200
 - Etazhiteti: P+1
 - ISHPKZh: 60%
 - Kushtet zhvillimore për ndërtimin e sallës sportive në Vragoli janë:
 - Lloji: Sallë sportive për institucion arsimor para-universitar
 - Lokacioni: Vragoli
 - Kapaciteti (banorë): 2000
 - Etazhiteti: P+1
 - ISHPKZh: 60%
 - Kushtet zhvillimore për ndërtimin e sallës sportive në Miradi të Epërme janë:
 - Lloji: Sallë sportive për institucion arsimor para-universitar
 - Lokacioni: Miradi e Epërme
 - Kapaciteti (banorë): 2000
 - Etazhiteti: P+1
 - ISHPKZh: 60%
 - Kushtet zhvillimore për ndërtimin e Sallës sportive në Mesbardh janë:
 - Lloji: Sallë sportive për institucion arsimor para-universitar
 - Lokacioni: Mesbardh
 - Kapaciteti (banorë): 2000
 - Etazhiteti: P+1
 - ISHPKZh: 60%
 - Kushtet zhvillimore për ndërtimin e Sallës sportive në Henc janë:
 - Lloji: Sallë sportive për institucion arsimor para-universitar
 - Lokacioni: Henc
 - Kapaciteti (banorë): 2000
 - Etazhiteti: P+1
 - ISHPKZh: 60%
 - Kushtet zhvillimore për ndërtimin e Sallës sportive në Grabovc janë:
 - Lloji: Sallë sportive për institucion arsimor para-universitar
 - Lokacioni: Grabovc
 - Kapaciteti (banorë): 2000
 - Etazhiteti: P+1
 - ISHPKZh: 60%
 - Kushtet zhvillimore për ndërtimin e Sallës sportive në Halilaq janë:



Lloji:	Sallë sportive për institucion arsimor para-universitar
Lokacioni:	Halilaq
Kapaciteti (banorë):	2000
Etazhiteti:	P+1
ISHPKZh:	60%

- Kushtet zhvillimore për ndërtimin e shtigjeve çiklisteve dhe objekteve tjera rekreative në Slatinë të Vogël janë:

Lloji:	Kompleks i hapur rekreativ
Lokacioni:	Sllatinë e Vogël
Kapaciteti (gjatësi):	6 Km
Etazhiteti:	P
ISHPKZh:	20%

Kushtet zhvillimore për ndërtimin e infrastrukturës së institucioneve për fusha sportive dhe hapësira rekreative përmes bonueseve të zonimit

Në zona të caktuara zhvillimi i fushave sportive dhe hapësirave rekreative, të cilat nuk e kanë të përcaktuar pronësinë, Komuna do të do të negocioj me aplikuesin përmes bonuseve të zonimit, që të zhvillojë infrastrukturën e nevojshme për zona të caktuara duke respektuar kushtet zhvillimore vijuese në përputhje me Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor:

Në komunën e Fushë Kosovës zhvillimet në fushën e sportit dhe rekrimit do bëhen në harmoni me Normat e planifikimit, përkatësisht normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve sportive dhe fushave rekreative janë si në vijim:

1. Numri i banorëve në vendbanim:

1.1. ≤ 5000 banor: $2.50 \text{ m}^2/\text{banor}$;

1.2. $\geq 5001 - 20000$ banor: $4.50 \text{ m}^2/\text{banor}$;

1.3. > 20001 banor: $5.00 \text{ m}^2/\text{banor}$.

Të përcaktohen duke marrë parasysh shërbimet ekzistuese dhe funksionaliteti i tyre, kërkesat për shërbime të reja si dhe disponueshmërinë e ambienteve të përshtatshme, ku:

- Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh) për ndërtesa ndërtës sportive nuk tejkalon 60% të sipërfaqes së parcelës kadastrale.
- Distanca optimale shërbyese, respektivisht rrezja optimale shërbyese në vijë ajrore, për fushasportive dhe rekreative nuk tejkalon lagrësine prej 800m.

Ndërsa kushtet për përzgjedhjen e lokacionit do jenë si në vijim:

1. në lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;

2. në lokacion të rrafshët pranë burimeve dhe pasqyrave ujore.

(Shënim: Në rast të pamundësisë së plotësimit të ndonjërit nga kriteret e kërkuar me sipër, autoriteti përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor është i obliguar të paraqesë alternativë, në konsultim me autoritetin përgjegjës për zbatimin e këtij dokumenti)

Elementet strukturore hapësinore bëjnë ndërmjetësimin në mes të shkalles së ndërtesave arkitektonike dhe njësive më të mëdha të vendbanimeve. Ato prezantohen në forma dhe gjeometri të ndryshme në organizimin e vendbanimeve.

Format themelore të elementeve strukturore hapësinore dhe karakteristikat përkatëse, janë si në vijim:

3. Blloqet pjesërisht të hapura (paraqesin inversin e blloqeve të mbyllura)- të cilat përmbajnë këto veçori:
 - 3.1. përbëhen nga një apo një numër i parcelave kadastrale zhvillimore;
 - 3.2. janë të qasshme dhe të orientuar nga pjesa e brendshme- pjesa e përparme e ndërtesave është e orientuar nga ana e brendshme, ndërsa pjesa e prapme nga ana e jashtme;
 - 3.3. janë pjesërisht të shkëputura nga sistemi i rrugëve publike dhe shesheve, prandaj mundëson integrim të pjesshëm funksional me strukturën e vendbanimit përreth;
 - 3.4. pjesët e përparme të ndërtesave të cilat formojnë bllokun, janë të orientuara drejt pjesës së brendshme;
 - 3.5. pjesët e brendshme të bllokut janë e pjesërisht të hapura;
 - 3.6. pjesët e brendshme të bllokut janë në shfrytëzim të hapësirave publike si: parqet, hapësirat për kohezion shoqëror, fushe-lojërat për fëmijë, hapësirat për sport dhe rekreacion, etj.;

Numri i vendparkimeve për automjete në varësi nga përmbajtja, për fushën kulturore dhe arsim, të cilat mund të kenë përmbajtje sportive duke filluar nga ndërtesat e shkollave fillore 0.5 VP/ 100 m², Për ndërtesat e sallave të sporteve në kompleks të shkollës, kalkulohet vetëm hapësira e sallës, Sporti dhe rekreacioni. Ndërtesat e sporteve në shërbim të ndërtesave të banimit (fushat sportive dhe fushat e lojës të hapura për fëmijë), Ndërtesat e sporteve të hapura dhe të mbyllura pa spektator, Ndërtesat e sporteve dhe fushave sportive me spektator - Numri i VP përcaktohet nëpërputhje me rregulloret e veçanta.

Vendparkimet për biçikleta përbëhen nga: Përmbajtjet sportive dhe rekreative 10 VPB/ 100 ulëse, për vizitor. Kapacitetet e objekteve të infrastrukturës sportive dhe rekreative varen nga lloji i infrastrukturës që do ndërtohet pasi në PZHK nuk është saktësuar, numrit të banorëve që do t'i shërbejnë dhe bazuar në normat e planifikimit të lartshënuara, do të llogariten kapacitetet.

Synimi i komunës së Fushë Kosovës ishte zhvillimet të ndodhin në pronat e komunës ose që komuna do ta ketë më të lehtë qasjen nga aspekti financiar, komuna dhe kompetentët tjerë për të siguruar cilësinë e kërkuar me PZHK duhet të përgatiten edhe për eksproprijim dhe shfrytëzimin e bonuseve të zonimit.

9.3. Hapësirat dhe ndërtimet për shërbime mjekësore

Në PZHK është paraparë Plani 4-2 Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve në shëndetësi

Shëndetësia në Komunën e Fushë Kosovës duhet të zhvillohet konform planeve kombëtare për zhvillimin e shëndetësisë në vend si dhe nevojave lokale të komunës në fjalë. Cilësia e zhvillimit të shëndetësisë në komunë duhet të ngritet duke:

- Siguruar funksionimin e qendrave të mjekësisë familjare dhe punkteve shëndetësore, në komunë sipas standardeve ndërkombëtare
- Siguruar shpërndarje gjithëpërfshirëse të shërbimeve të shëndetësisë në territorin e komunës dhe qasje për të gjithë banorët në shërbimin shëndetësor.

Hapësirat dhe ndërtimet për shërbime mjekësore ekzistuese duhet të mirëmbahen dhe të monitorohen vazhdimisht për të siguruar funksionalitet dhe cilësi të infrastrukturës sociale në shërbim të banorëve të komunës.

Krahas ngritjes së kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve tjera sociale edhe tek hapësirat dhe shërbimet mjekësore, ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës është i nevojshëm për të plotësuar sigurimin e cilësisë në këto shërbime. Plani zhvillimor komunal ka paraparë të nevojshme ndërtimin e këtyre objekteve dhe hapësirave të reja për përmirësimin e rrjetit të infrastrukturës sociale.



Në përmbushje të Planit 5-1 Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale të Strategjisë 5 – Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese të PZhK-së, Harta Zonale ka paraparë ndërtimin e:

- Rindërtimi i QMF ekzistuese te Kompleksi 300 dhe shndërrimi i saj në QKMF
- Ndërtimi i AMF-së në Lagjen 28 dhe 29
- Ndërtimi i AMF-së në Rugën Fehmi Ldrovci

Përpos kushteve zhvillimore të sipërme dhe kushteve ndërtimore, përderisa ato nuk shfuqizohen nga Udhëzues tjerë të ri të gjitha institucionet e shërbimit mjekësor duhet të përmbushin kushtet zhvillimore të projektimit dhe ndërtimit të përcaktuara nga MSh në UDHËZIM ADMINISTRATIV MSH – NR. 02/2015 ORGANIZIMI, PËRCAKTIMI I SHËRBIMEVE DHE VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE TË KUJDESIT PARËSOR SHËNDETËSOR(KPSH).

Tre institucionet vijuese të shërbimit mjekësor të planifikuara në Komunën tonë duhet të përmbushin kushteve zhvillimore në vijim:

- Kushtet zhvillimore për ndërtimin e QKMF në Komunën pranë Kompleksit 300 janë:

Lloji:	Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare
Lokacioni:	QMF te Kompleksi300
Kapaciteti (banorë):	10,000
Etazhiteti:	B+P+3
ISHPKZh:	50%

- Kushtet zhvillimore për ndërtimin e Ambulantave të Mjekësisë Familjare në Rugën Fehmi Ldrovci dhe Lagjen 28 dhe 29 janë:

Lloji:	Ambulancë e Mjekësisë Familjare
Lokacioni:	Lagja 28 dhe 29
Kapaciteti (banorë):	2000
Etazhiteti:	P+1
ISHPKZh:	50%

- Kushtet zhvillimore për ndërtimin e Ambulantave të Mjekësisë Familjare në Rugën Fehmi Ldrovci janë:

Lloji:	Ambulancë e Mjekësisë Familjare
Lokacioni:	Rugën Fehmi Ldrovci
Kapaciteti (banorë):	2000
Etazhiteti:	P+1
ISHPKZh:	50%

Kushtet zhvillimore për ndërtimin e infrastrukturës së institucioneve për shërbime mjekësore përmes bonueseve të zonimit

Në zona të caktuara zhvillimi i institucioneve të shërbimeve mjekësore të cilat nuk e kanë të përcaktuar pronësinë, Komuna do të do të negocioj me aplikuesin përmes bonuseve të zonimit, që të zhvillojë infrastrukturën e nevojshme për zona të caktuara duke respektuar kushtet zhvillimore vijuese në përputhje me Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor:

Kushtet zhvillimore për ndërtimin eqendrave mjekësore familjare janë:

- Të zhvillohet në një lokacion që përmbush kërkesat e Normave Teknike për parcelë kadastrale prej së paku 0.20m²/banorë;

- Të zhvillohet me një indeks të shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh): 50 %;
- Të zhvillohet me kapacitete për të shërbyer numrin e prognozuar të banorëve për vitin 2026 që planifikohet të jetojnë brenda rrezes së vijës ajrore prej 10km;
- Të shërbëjë banorët që jetojnë brenda 10 km distancë optimale shërbyese, respektivisht rreze optimale shërbyese në vijë ajrore.

Infrastruktura e institucioneve të shëndetësore të nivelit dytësor, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:

- Në parcela kadastrale për zhvillim të cilat mundësojnë zgjerim të mundshëm në të ardhmen;
- Në lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
- Në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
- Në largësi nga lokacionet e ndotura;
- Në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore, hekurudhore dhe ajrore);
- Në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
- Në largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret;
- Në largësi më të madhe se 800 m nga ndërtesat industriale;

9.4. Ndërtesat për shërbime sociale

Bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe marr parasysh gjendjes ekzistuese brenda Hartës Zonale të Fushë Kosovës është planifikuar infrastruktura publike dhe sociale, edhe atë duke specifikuar llojin, lokacionin, kapacitetin dhe kushtet teknike për projektim dhe ndërtim të **Ndërtesave për shërbime sociale**;

Në PZhK është paraparë Plani 5-1 Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale.

Krahas ngritjes së kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve sociale ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale është i nevojshëm për të plotësuar shpërndarjen gjithëpërfshirëse të këtyre shërbimeve, dhe rrjedhimisht sigurimin e cilësisë në këto shërbime. Plani zhvillimor komunal ka paraparë të nevojshme ndërtimin e këtyre objekteve dhe hapësirave të reja për përmirësimin e rrjetit të infrastrukturës sociale:

Qendër ditore ku obligohen drejtoritë përkatëse komunale në koordinim me institucionet përkatëse dhe komuniteti që të hartojnë programin dhe projektin për ndërtimin e këtij objekti dhe hapësirave përcjellëse të infrastrukturës sociale

Në përmbushje të Planit 5-1 Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale të Strategjisë 5 – Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese të PZhK-së, Harta Zonale ka paraparë:

- Krijimin e një qendre ditore për pleq në kuadër të Shtëpisë së Kulturës që planifikohet të rindërtohet;
- Renovimi i shtëpive ekzistuese të banimit social në Miradi të Epërme.

Qendra ditore e planifikuar në Komunën tonë duhet të përmbushin kushteve zhvillimore në vijim:

Lloji:	Qendër ditore për pleq
Lokacioni:	Shtëpia e kulturës ekzistuese
Kapaciteti (pleq):	300
Etazhiteti:	Në përdhese të ndërtesës së re
ISHPKZh:	15%

Kushtet zhvillimore për ndërtimin e infrastrukturës së institucioneve për shërbime sociale përmes bonueseve të zonimit

Në zona të caktuara zhvillimi i institucioneve sociale të cilat nuk e kanë të përcaktuar pronësinë, Komuna do të do të negocioj me aplikuesin përmes bonuseve të zonimit, që të zhvillojë infrastrukturën e nevojshme për zona të caktuara duke respektuar kushtet zhvillimore vijuese në përputhje me Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor:

- Kushtet për zhvillimin e institucioneve të mirëqenies sociale dhe komunitetit, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:
- Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve të mirëqenies sociale dhe komunitetit për ndërtesat e institucioneve për shërbime sociale dhe familjare është 0.25 m²/banor;
- Të përcaktohen duke marrë parasysh kërkesën e shërbimeve dhe disponueshmërinë e ambienteve të përshtatshme.
- Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve të mirëqenies sociale dhe komunitetit për e institucioneve të komunitetit: 0.20 m²/banor.
- Të përcaktohen në bazë të nevojës, duke pasur parasysh aspiratat e komunitetit dhe konsiderata të tjera relevante.
- Kushtet për përzgjedhjen e lokacioni për ndërtesat e Infrastrukturës së institucioneve mirëqenies sociale dhe komunitetit, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:
- në terren të rrafshët;
- në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
- në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
- në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore, hekurudhore dhe ajrore).

9.5. Ndërtesat e institucioneve parashkollore

Bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe marr parasysh gjendjes ekzistuese brenda Hartës Zonale të Fushë Kosovës është planifikuar infrastruktura publike dhe sociale, edhe atë dukespecifikuar llojin, lokacionin, kapacitetin dhe kushtet teknike për projektim dhe ndërtim të **Ndërtesave e institucioneve parashkollore**;

Në PZhK është paraprë Plani 5-1 Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale.

Krahas ngritjes së kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve sociale, ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale është i nevojshëm për të plotësuar shpërndarjen gjithëpërfshirëse të këtyre shërbimeve, dhe rrjedhimisht sigurimin e cilësisë në këto shërbime. Plani zhvillimor komunal kap arapapë të nevojshme ndërtimin e këtyre objekteve dhe hapësirave të reja për përmirësimin e rrjetit të infrastrukturës sociale: Pesë (5) çerdhe (Fushë Kosovë 3, Sllatinë e Madhe 1, Miradi e Ultë 1).

Obligohen drejtoritë përkatëse komunale në koordinim me institucionet përkatëse dhe komuniteti që të hartojnë programin dhe projektin për ndërtimin e këtij objekti dhe hapësirave përcjellëse të infrastrukturës sociale.

Kushtet zhvillimore për ndërtimin e infrastrukturës së institucioneve të arsimit parashkollor përmes bonuseve të zonimit

Në zona të caktuara zhvillimi i institucioneve parashkollore të cilat nuk e kanë të përcaktuar pronësinë, Komuna do të do të negocioj me aplikuesin përmes bonuseve të zonimit, që të zhvillojë infrastrukturën e nevojshme për zona të caktuara duke respektuar kushtet zhvillimore vijuese në përputhje me Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor:

- Kushtet zhvillimore për ndërtimin e çerdheve në Fushë Kosovë duhet të zhvillohen në lokacione që përmbushin kërkesat e Normave Teknike për parcelë kadastrale sipas numrit fëmijëve sipas grupeve vijese:
- për një grup: 30 m²/fëmijë;
- për dy grupe: 25 m²/fëmijë;
- për tri grupe: 25 m²/fëmijë;
- për katër grupe: 20 m²/fëmijë;



- për dhjetë grupe: 40 m²/fëmijë;
- për njëzet grupe: 30 m²/fëmijë.
- Të zhvillohen në lokacione që përmbushin kërkesat e Normave Teknike për parcelë kadastrale sipas numrit fëmijëve prej 0.30 m²/banor;
- Të zhvillohet me një indeks të shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh): 30 %;
- Të zhvillohet me kapacitete për të shërbyer numrin e prognozuar të banorëve për vitin 2026 që planifikohet të jetojnë brenda rrezes së vijës ajrore prej 300m;
- Të shërbëjë banorët që jetojnë brenda 300m distancë optimale shërbyese, respektivisht rreze optimale shërbyese në vijë ajrore.
- Kushtet zhvillimore për ndërtimin e kopshteve në Fushë Kosovë duhet të zhvillohen në lokacione që përmbushin kërkesat e Normave Teknike për parcelë kadastrale sipas numrit fëmijëve sipas grupeve vijese:
- nga një deri në dy grupe: 24- 32 m²/fëmijë;
- nga tri deri në katër grupe: 20- 25 m²/fëmijë;
- nga pesë deri në gjashtë grupe: 18- 22 m²/fëmijë.
- Të zhvillohen në lokacione që përmbushin kërkesat e Normave Teknike për parcelë kadastrale sipas numrit fëmijëve prej 1.00m²/banor;
- Të zhvillohet me një indeks të shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh): 25 %;

Të zhvillohen me kapacitete për të shërbyer numrin e prognozuar të banorëve për vitin 2026 që planifikohet të jetojnë brenda rrezes së vijës ajrore prej:

- 500m për zonë urbane; dhe
- 900m për zonë rurale;
- Të shërbëjë banorët që jetojnë brenda 500m në zonë urbane dhe 900m në zonë rurale distancë optimale shërbyese, respektivisht rreze optimale shërbyese në vijë ajrore.
- Infrastruktura e institucioneve të arsimit parashkollor, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:
- në kuadër të zonës së banimit;
- në lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël;
- në lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
- në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
- në largësi nga lokacionet e ndotura;
- në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
- në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore dhe hekurudhore);
- në largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret;
- në largësi më të madhe se 800 m nga ndërtesat industriale.

9.6. Shkollat dhe universitetet

Bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe marr parasysh gjendjes ekzistuese brenda Hartës Zonale të Fushë Kosovës është planifikuar infrastruktura publike dhe sociale, edhe atë dukespecifikuar llojin, lokacionin, kapacitetin dhe kushtet teknike për projektim dhe ndërtim të **Shkollave dhe universiteteve**.

Në PZhK është paraprë PZhK Plani 4-1: Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve në arsim, specifikon se arsimi në Komunën e Fushë Kosovës duhet të zhvillohet konform planeve kombëtare për zhvillimin e arsimit në vend si dhe nevojave lokale të komunës në fjalë. Cilësia e zhvillimit të arsimit në komunë duhet të ngritet duke:

- Siguruar funksionimin e shkollave, në të gjitha nivelet e arsimit në komunë sipas standardeve ndërkombëtare.



- Siguruar shpërndarje gjithëpërfshirëse të shërbimeve të arsimit në territorin e komunës.
- Siguruar transportin publik për nxënësit e lagjeve /fshatrave që janë në distancë më të largët se 15 minuta ecje nga shkolla.

Objektet dhe hapësirat ekzistuese të infrastrukturës arsimore duhet të mirëmbahen dhe të monitorohen vazhdimisht për të siguruar funksionalitet dhe cilësi të infrastrukturës sociale në shërbim të banorëve të komunës. Objektet dhe hapësirat ekzistuese krahas rolit në ngritje të cilësisë së shërbimeve sociale, ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës arsimore është i nevojshëm për të plotësuar shpërndarjen gjithëpërfshirëse të këtyre shërbimeve dhe rrjedhimisht sigurimin e cilësisë në këto shërbime. Plani zhvillimor komunal ka paraparë të nevojshme ndërtimin e këtyre objekteve dhe hapësirave të reja për përmirësimin e rrjetit të infrastrukturës arsimore:

- Shkollafillore në Nakër;
- Përkrahja e kapaciteteve të kolegjit AAB

Drejtoritë përkatëse komunale në koordinim me institucionet përkatëse dhe komunitetit do të hartojnë programin dhe projektin për ndërtimin e këtij objekti dhe hapësirave përcjellëse të infrastrukturës social.

Në përmbushje të Planit 5-1 Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale të Strategjisë 5 – Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale si dhe përmirësimi I atyre ekzistuese të PZhK-së, Harta Zonale ka paraparë ndërtimin e pesë shkollave fillore dhe të mesme të ulëta.

Përpos kushteve zhvillimore të sipërme dhe kushteve ndërtimore, përderisa ato nuk shfuqizohen nga Udhëzues tjerë të ri të gjitha shkollat duhet të përmbushin kushtet zhvillimore të projektimit dhe ndërtimit të përcaktuara nga MASHT në:

- UDHËZUESIN PËR NORMAT DHE STANDARDET E NDËRTESAVE SHKOLLORE UDHËZIMET E PËRGJITHSHME, VËLLIMI 1, dhe
- UDHËZUES PËR NORMAT DHE STANDARDET E NDËRTESAVE SHKOLLORE UDHËZIMET SPECIFIKE, VËLLIMI 2

Pesë shkollat fillore vijuese të planifikuara në Komunën tonë duhet të përmbushin kushteve zhvillimore në vijim:

- Kushtet zhvillimore për ndërtimin e shkollës fillore dhe të mesme të ulëta në Komunën pranë Kompleksit 300 janë:

Lloji:	Arsim Bazik Themelor 3 cikle
Lokacioni:	Kompleksi 300
Kapaciteti (nxënës):	1080
Etazhiteti:	P+2
ISHPKZh:	40%

- Kushtet zhvillimore për ndërtimin e shkollës fillore dhe të mesme të ulëta në Komunën në Lagjen 28 dhe 29 janë:

Lloji:	Arsim Bazik Themelor 3 cikle
Lokacioni:	Lagja 28 dhe 29
Kapaciteti (nxënës):	1080
Etazhiteti:	P+2
ISHPKZh:	40%

- Kushtet zhvillimore për ndërtimin e shkollës fillore dhe të mesme të ulëta në Komunën në Nakerade janë:

Lloji:	Arsim Bazik Themelor 3 cikle
--------	------------------------------



Lokacioni:	Nakeradë
Kapaciteti (nxënës):	1080
Etazhiteti:	P+2
ISHPKZh:	40%

- Kushtet zhvillimore për ndërtimin e shkollës fillore dhe të mesme të ulëta në Komunën në pjesën jug-lindore janë:

Lloji:	Arsim Bazik Themelor 4 cikle
Lokacioni:	Jug-lindje të zonës urbane
Kapaciteti (nxënës):	1440
Etazhiteti:	P+2
ISHPKZh:	40%

- Kushtet zhvillimore për ndërtimin e shkollës fillore dhe të mesme të ulëta në Komunën te Gjikollët janë:

Lloji:	Arsim Bazik Themelor 4 cikle
Lokacioni:	Te Gjikollët
Kapaciteti (nxënës):	1440
Etazhiteti:	P+1
ISHPKZh:	40%

Kushtet zhvillimore për ndërtimin e infrastrukturës së fushave sportive dhe hapësirave rekreative përmes bonuseve të zonimit

Në zona të caktuara zhvillimi i infrastrukturës së fushave sportive dhe hapësirave rekreative të cilat nuk e kanë të përcaktuar pronësinë, Komuna do të do të negocioj me aplikuesin përmes bonuseve të zonimit, që të zhvillojë infrastrukturën e nevojshme për zona të caktuara duke respektuar kushtet zhvillimore vijuese në përputhje me Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Kushtet zhvillimore për ndërtimin e kopshteve në Fushë Kosovë duhet të

1. Zhvillohen në lokacione që përmbushin kërkesat e Normave Teknike për parcelë kadastrale, si vijon:

- Ndërtesat e shkollave fillore: 1.60 m²/banor;
- Ndërtesat e shkollave të mesme të ulëta: 1.20 m²/banor;
- Ndërtesat e shkollave të mesme të larta: 1.00 m²/banor.
- Të zhvillohet me një indeks të shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh), si vijon:
- Ndërtesat e shkollave fillore: 40%;
- Ndërtesat e shkollave të mesme të ulëta: 40%;
- Ndërtesat e shkollave të mesme të larta: 60 %.

2. Zhvillohet me kapacitetete për të shërbyer numrin e prognozuar të banorëve për vitin 2026 që planifikohet të jetojnë brenda rrezes së vijës ajrore prej:

- 600 m për ndërtesat e shkollave fillore në zonë urbane;
- 1900 m për ndërtesat e shkollave fillore në zonë rurale;
- 600 m për ndërtesat e shkollave të mesme të ulëta në zonë urbane;
- 1900 m për ndërtesat e shkollave të mesme të ulëta në zonë rurale;
- 1500 m për ndërtesat e shkollave të mesme të larta në zonë urbane; dhe
- 4700 m për ndërtesat e shkollave të mesme të larta në zonë rurale;



3. Shërbejë banorët që jetojnë në largësi prej:

- 600 m për ndërtesat e shkollave fillore në zonë urbane;
- 1900 m për ndërtesat e shkollave fillore në zonë rurale;
- 600 m për ndërtesat e shkollave të mesme të ulëta në zonë urbane;
- 1900 m për ndërtesat e shkollave të mesme të ulëta në zonë rurale;
- 1500 m për ndërtesat e shkollave të mesme të larta në zonë urbane; dhe
- 4700 m për ndërtesat e shkollave të mesme të larta në zonë rurale;

4. Planifikohet në lokacione, si në vijim:

- në afërsi të zonës së banimit në vendbanime urbane;
- në kuadër të zonës së banimit në vendbanime rurale;
- në lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël;
- Në lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
- në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
- në largësi nga ndërtesat të cilat krijojnë ndotje të mjedisit dhe zhurmë;
- në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
- në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore dhe hekurudhore);
- në largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret; dhe
- në largësi më të madhe se 800 m nga ndërtesat industriale.

9.7. Qendrat administrative

Bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese brenda Hartës Zonale të Fushë Kosovës, është planifikuar infrastruktura publike dhe sociale, edhe atë duke specifikuar llojin, lokacionin, kapacitetin dhe kushtet teknike për projektim dhe ndërtim të **Qendrave administrative**;

Në PZhK është paraparë Plani 4-3: Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve publike

Shërbimet publike në Komunën e Fushë Kosovës duhet të zhvillohet konform planeve kombëtare për zhvillimin e shërbimeve publike në vend si dhe nevojave lokale të komunës në fjalë. Cilësia e shërbimeve publike në komunë duhet të ngritet duke:

1. Siguruar funksionimin e shërbimeve publike, në komunë sipas standardeve ndërkombëtare
2. Siguruar shpërndarje gjithëpërfshirëse të shërbimeve publike në territorin e komunës. Qendrat e komunitetit duhet të themelohen në të gjitha bashkësitë lokale.

Kushtet zhvillimore për ndërtimin e infrastrukturës së institucioneve administrative

Të përcaktohen duke marrë parasysh kërkesën e shërbimeve dhe disponueshmërinë e ambienteve të përshtatshme.

1. Normat minimale të parcelës së infrastrukturës së institucioneve administrative duhet të plotësojnë këkresën minimale pret 0.62 m²/banor, për numrin e prognozuar të banorëve të cilat synohet të i shërbejnë.
2. Indeksit të shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh) të ndërtesave të institucioneve të administratës publike (me përjashtim të burgjeve) është 80%.

9.8. Hapësirat dhe ndërtesat e sigurisë publike

Bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe marr parasysh gjendjes ekzistuese brenda Hartës Zonale të Fushë Kosovës është planifikuar infrastruktura publike dhe sociale, edhe atë duke specifikuar llojin, lokacionin, kapacitetin dhe kushtet teknike për projektim dhe ndërtim për **Hapësirat dhe ndërtesat e sigurisë publike**;

Objektet dhe hapësirat ekzistuese të infrastrukturës sociale duhet të mirëmbahen dhe të monitorohen vazhdimisht për të siguruar funksionalitet dhe cilësi të infrastrukturës sociale në shërbim të banorëve të komunës. Objektet dhe hapësirat e planifikuara për siguri publike është ndërtimi i një strehimore.

9.9. Varrezat

Në PZhK nuk ka specifika për varreza. Bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe marr parasysh gjendjen ekzistuese brenda Hartës Zonale të Fushë Kosovës është planifikuar infrastruktura publike dhe sociale, edhe atë duke specifikuar llojin, lokacionin, kapacitetin dhe kushtet teknike për projektim dhe ndërtim të **Varrezave**.

Ndonëse varrezat nuk janë trajtuar me PZhK por:


- hapësirat e destinuara dhe të cilat shfrytëzohen për varreza duhet menaxhuar dhe mirëmbajtur
- pajisur me përmbajtje të cilat mundësojnë ceremoni cilësore
- specifikon zonat ku duhet hapësira plotësuese

Infrastruktura publike dhe sociale duhet të plotësojnë normat e planifikuara për infrastrukturë përcjellese të paraqitura në tabelën për infrastrukturën përcjellese të zonave të banimit të vendosura në nënkapitujt 5.4.-A dhe 5.5 – B.

10. ARSYETIMI PËR NEVOJËN E HARTIMIT TË PLANEVE RREGULLUESE TË HOLLËSISHME TË PLANIFIKUARA

Komunat, varësisht nga nevojat për zhvillim hapësinor mund të përgatisin Plane Rregulluese të Hollësishme për të gjitha ose për cilëndo nga zonat e përcaktuara me Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale të Komunës. Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo zona rurale siç është përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale.

Komuna e Fushë Kosovës e vlerëson si të nevojshme në funksion të zhvillimit hapësinor të përgatisin Plane Rregulluese të Hollësishme për: **Zonën urbane të Fushë Kosovës** si dhe për **Bardh të madh, Sllatinë e Madhe, Grabovc VJF, Rrafshinë VJF, Brezi i biznesit, Zona Industriale Sllatinë e Madhe, Zona Industriale Harilaq** të përcaktuara me Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale të Komunës.



Harta 15 Zonat që duhet trajtuar me Plane Rregulluese të Hollësishme

Me këto Plane Rregulluese të Hollësishme të përcaktuara për hartim vlerësohet se ka:

- Nevojë për zhvillim më të detajuar hapësinor në zonat e caktuara, Këto zona janë definuar në mënyrë specifike me kufijtë e këtyre zonave që do të jenë pjesë e Planeve Rregulluese të Hollësishme.
- Gjatë hartimit të këtyre Planeve Rregulluese të Hollësishëm mund të plotësohen por jo edhe të ndryshohen kushtet e Hartës Zonale të Komunës, përveç nëse Harta Zonale e Komunës është ndryshuar dhe plotësuar siç është paraparë me Udhëzim Administrativ.
- Pas miratimit të Planit Rregullues të Hollësishëm, Komuna përditëson Hartën Zonale të Komunës me shtimin e çfarëdo kushti shtesë për zhvillim dhe informatat kartografike në Planin Rregullues të Hollësishëm.

Përgatitja e Planeve Rregulluese të Hollësishme të cilat nuk janë paraparë me PZHK ose HZK



Përpos zonave të përcaktuara në këtë dokument për të u trajtuar përmes Planeve Rregulluese të Hollësishme, për shkak të zhvillimeve apo synimeve të reja të Komunës, Komuna mund të trajtojë zona tjera të cilat nuk janë paraparë me PZHK ose HZK me Plane Rregulluese të Hollësishme, mirëpo në këto duhet të ndjekur procedurat sipas Udhëzimit Administrativ për Plane Rregulluese të Hollësishme, siq është përshkruar në vijim.

Para se të merret vendimi për Plan Rregullues i Hollësishëm i cili nuk është paraparë me PZHK ose HZK, autoriteti i planifikimit hapësinor duhet të përgatit një raport të arsyeshmërisë për të shpjeguar qartë pse nevojitet hartimi i Planit Rregullues të hollësishme në vend se të përfshihen të gjitha kushtet përkatëse në hartën zonale përkatëse.

Para procesimit të propozim-vendimeve për hartimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme duhet t'i bashkëngjitet programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i cili përmban të dhënat në vijim:

- Arsyetimi i nevojës për përgatitjen
- Llojin dhe përkufizimin e dokumentit të planifikimit hapësinor;
- Qëllimin e hartimit;
- Kufirin e territorit;
- Subjektin përgjegjës për hartimin;
- Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim.

Të gjitha Planet Rregulluese të Hollësishme hartohen vetëm në rastet kur nevojiten kushte zhvillimore hapësinore më të hollësishme për këto hapësirë specifike, përveç asaj që është ofruar në hartën zonale përkatëse. Kushtet për rregullimin e hapësirës përfshirë shfrytëzimet e tokës, kushtet zhvillimore, kushtet ndërtimore dhe masat mbrojtëse në nivel parcele kadastrale. Këto janë kushte dhe masa shtesë që nuk janë specifikuar tashmë me ndonjë dokument të planifikimit hapësinor të nivelit më të lartë d.m.th. në Hartën Zonale të Fushë Kosovës ose Plan Zhvillimor Komunal.

Këto Plane Rregulluese të hollësishme do shërbejnë për nevoja të rregullimit, teknike dhe operacionale të planifikimit hapësinor, për të përcaktuar kushtet shtesë më të hollësishme për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nëpërmjet projekteve konkrete. E nevojat për hartimin e PRRH-ve përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në vendosjen e kushteve për rregullimin e hapësirave në pjesë të caktuara të zonave apo sipërfaqeve të planifikuara duke përfshirë kushtet ndërtimore, kushtet për rregullimin e hapësirës janë më të hollësishme se kushtet e përcaktuara në Hartën Zonale të Komunës dhe dokumentet tjera të planifikimit hapësinor të nivelit më të lartë.

Duhet theksuar se për shkak të ngarkesave dhe komplikimeve që ka komuna e Fushë Kosovës sidomos në Zonën urbane të Fushë Kosovës si dhe në zonën **Brezi i biznesit, Zona Industriale Sllatinë e Madhe, Zona Industriale Harilaq** përkundër kushteve në nivel zone të cilat krijojnë bazë të mirë për dhënien e kushteve dhe lejes ndërtimore për shkak të formave të çrregullta të parcelave, plotësimit të normave dhe standardeve, si dhe plotësimit të parimeve të trajtimit të barabartë të parcelave dhe pronarëve dhe parimeve tjera demokratike ka nevojë për detajime më të mëdha dhe duhet trajtuar me prioritet, ndërsa në rastin e Bardhit të Madh, Sllatinës së Madhe varet shumë nga arsyshmëria që do ta paraqesë autoriteti i planifikimit hapësinor, përndryshe ka një trajtim të mirë me HZK, ndërsa sa i përket VJF-ve, trajtimi dhe rregullimi i tyre do ishte mjaft me rëndësi, andaj vlerësohet se me PRRH përfundimisht do trajtoheshin VJF-të Grabovc dhe Rrafshinë.

11. TRAJTIMI I VENDBANIMEVE JOFORMALE

Komuna e Fushë Kosovës me qëllim të rregullimit dhe përfshirjes të vendbanimeve joformale përcakton kushte zhvillimore të zbatueshme sipas legjislacionit në fuqi.

Informacione nga PHhK Fushë Kosovë

Në Fushë Kosovë janë evidentuar dy (2) vendbanime joformale: në Grabovc dhe Rafshnaltë. Këto vendbanime duhet të trajtohen sipas udhëzimeve të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit për Vendbanimet Joformale. Me Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikim hapësinor, **Vendbanimet joformale** janë definuar si: vendbanime ku banorët nuk gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm të jetesës, të banimit dhe nuk kanë zotërim ligjor të pronës ose qasje adekuate në shërbimet publike dhe qeverisje, si dhe jetojnë në një mjedis me rrezikshmëri të lartë.

Tabela. Vendbanimet joformale në komunën e Fushë Kosovës

Numri	Vendbanimi /emërtimi	S= ha	Nr. i Shtëpive	Banorë	Urgjenca	Plani që rregullon	Madhësia	Kontesti
								urban/ rural
1	Lagjia e Berishëve (Grabovc i ulët)	43	16	100	Afatmesme	PZHK dhe HZK	e Madhe	Rural
2	Lagje re mbi fshatin Sllatinë e madhe (Rafshnaja)	45	27	150	Afatmesme	PZHK dhe HZK	e Madhe	Rural

Tabela 30 Vendbanimet joformale në komunën e Fushë Kosovës

Bazuar në udhëzimet e Planit Zhvillimor Komunal, përkatësisht në kuadër të caceve prioritare për zhvillim të komunës:

Caku 4 – Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve në arsim, shëndetësi dhe shërbimet tjera publike / komunale

Caku 5 – Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave të reja të infrastrukturës sociale si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese

Caku 6 – Ndërtimi i rrugëve të reja si dhe përmirësimi i atyre ekzistuese në rrjetin komunal të trafikut automobilistik e hekurudhor

Caku 7 – Përmirësimi i lidhjeve të transportit publik në tërë komunën, me fokus të veçantë në vijën Aeroport - Fushë Kosovë – Prishtinë

Caku 8 – Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza dhe përmirësimi i rrjetit të kanalizimit

Caku 9 – Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit dhe shtimi i kapaciteteve prodhuese të ujit

Caku 10 – Përmirësimi i rrjetit për furnizim me energji elektrike dhe rrjetit të telefonisë e Internetit

Caku 11 – Mbrojtja e mjedisit dhe trashëgimisë natyrore


Caku 12 – Parandalimi i ndotjes nga ndotësit lokal dhe fqinj, në koordinim me MMPH dhe komunat fqinje.

Caku 13 – Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore

Komuna e Fushë Kosovës obligohet që të drejtojë dhe organizojë punën në këtë fushë sipas udhëzimeve administrative, rregullave dhe ligjeve në fuqi të shtetit, ashtu që të administrojë HZK-në edhe atë ta administrojë sa më mirë që është e mundur duke siguruar qëndrueshmëri.

Komuna duhet të kujdeset që bonuset e zonimit, përjashtimet, kushtet zhvillimore dhe të gjitha përmbajtjet e HZK-së së Fushë Kosovës, për të gjitha zonat, zonat mbishtresore, infrastrukturën teknike, rrugore e sociale, veçanërisht ato që konsiderohen si administrim i një pasurie ose për një vlerë të Fushë Kosovës, e si të tilla e bëjnë stacioni kryesor hekurudhor dhe hekurudhat, pozita në harmoni me aeroportin, pasuritë nëntokësore, korridoret, pozita afër kryeqytetit etj, që të menaxhohen mirë, sipas rregullave, bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe duke marrë parasysh gjendjes ekzistuese, t'i mbrojë dhe të qeverisë me to bazuar në parimet dhe kushtet e HZK-së, të mbarështrojë cilësinë dhe zhvillimet në dobi të përgjithshme; të përdorë ose të administrojë vlerat, të ardhurat, fondet në funksion të zbatimit të HZK-së, dhe krejt në fund të administrojë pasurinë e përbashkët-pronën, në funksion të zonimit dhe kushteve të parapara me këtë Hartë.

Administrimi i zbatimit të HZK-së së Fushë Kosovës nënkupton kryerjen e disa aktiviteteve dhe veprimeve sistematike që duhet të bëhen nga autoritetet kompetente që do prezantojmë si më poshtë:

Kuvendi i Komunës së Fushë Kosovës është përgjegjës për aprovimin e fondeve për zbatimin e HZK-së, si dhe për vlerësimin dhe aprovimin e raportit vjetor për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria e Urbanizmit), bashkërendon aktivitetet e zbatimit dhe monitorimit të HZK-së, duke bashkërenduar dhe koordinuar aktivitetet e përgatitjes së planeve sektoriale vjetore të çdo drejtorie. Ky autoritet përgjegjës komunal, përkrah, përcjell dhe monitoron zbatimin dhe përgatit raportin vjetor për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së.

Drejtoritë komunale sektoriale zbatojnë dhe monitorojnë aktivitetet sektoriale përkatëse të tyre sipas procesit të monitorimit dhe vlerësimit në Planin e Veprimit, përgatisin planet e tyre vjetore për zbatim, përgatisin raportin sektorial vjetor për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së nga sektori i tyre.

Drejtoritë sektoriale, përmes anëtarit të tyre në Ekipin Punues, pasi ta kenë hartuar, e dorëzojnë raportin sektorial vjetor për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së tek autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (udhëheqësi i Ekipit nga drejtoria e Urbanizmit).

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor harton dhe dorëzon raportin vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së, për miratim tek Kuvendi i Komunës.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, dorëzon raportin e miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së në Ministri.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor siguron se raporti i miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së publikohet në faqen e internetit të komunës dhe ofrohet në kopje të letrës sipas kërkesës.

Komuna e Fushë Kosovës në funksion të administrimit të zbatimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të Hartës Zonale Komunale do të formojë Ekip Punues për përkrahje në zbatim të këtij dokumenti. Komuna e Fushë Kosovës në funksion të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të HZK-së ka paraparë që me vendim të kryetarit të komunës të formojë Ekipin Punues që do të shërbejë edhe si një mekanizëm për administrim të zbatimit, zbatim, monitorimin dhe vlerësimin e progresit të komunës drejt arritjes së të gjitha aspekteve të Hartës Zonale në bazë të treguesve të matshëm.

Një rol të pa kontestuar në administrimin e zbatimit të HZK-së është roli i veçantë që ka inspektorati i komunës së Fushë Kosovës

Për administrim cilësor rol kanë të gjitha organet e komunës, por duhet specifikuar Zyra e informimit dhe Teknologjisë informative.

Administrimi i zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të HZK-së së Fushë Kosovës është procesi sistematik dhe i vazhdueshëm i cili do të udhëhiqet nga autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria e Urbanizmit) e cila është përgjegjës për zbatimin e Hartës Zonale të Komunës në koordinimin dhe bashkëpunimin me drejtoritë sektoriale brenda komunës, me një koordinim dhe administrim praktik nga Ekipi Punues dhe akterët tjerë të lart përmendur, komuna për administrim cilësorë sidomos për trajtimin e bonuseve të zonimit, përjashtimeve dhe përmbajtjeve tjera që vijnë si kërkesa pas aprovimit të HZK-së mundet të krijoj edhe komisione profesionale për marrjen e vendimit apo këshillim përkatës mbi kërkesat për përjashtim ose çfarëdo kërkesë tjetër.

Administrimi i zbatimit është përmbajtësor dhe jashtëzakonisht i rëndësishëm, andaj i takon autoritetit përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria e Urbanizmit) të propozojë mekanizma, ekipe profesionale, alokim mjetesh ashtu që komuna të marrë vendimet meritorë për të siguruar administrim, zbatim e monitorim cilësor.

13.2. Zbatimi i Hartës Zonale Komunale të Fushë Kosovës

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria e Urbanizmit) pas aprovimit të Hartës Zonale Komunale në Kuvend Komunale dhe publikimit zyrtar, fillon të kryej përgjegjësitë ligjore që ka lidhur për zbatimin e Hartës Zonale të Komunës, në këtë drejtim drejtoria e Urbanizmit do të fillojë me një punë mjaft komplekse dhe të vështirë në koordinimin dhe bashkëpunimin me drejtoritë sektoriale brenda komunës.

Duhet theksuar se zbatimi i Hartës Zonale Komunale varet nga shumë faktorë në mënyrë direkte dhe indirekte. Pos punës brenda sektorëve të komunës, në funksion të krijimit të një sistemi transparent dhe të qëndrueshëm, sistem i cili prezanton edhe një nga kërkesat ligjore, duhet punuar edhe me grupet tjera të interesit, punë e cila nuk mund të bëhet pa ngritur edhe cilësinë e informimit dhe komunikimit si dhe fuqizimin e faktorëve të tjerë.

APKPMH dhe Ekipi punues në rend të parë zbatimin do ta bëjnë në harmoni me Planin e Veprimit për Zbatim të Hartës Zonale të Fushë Kosovës, i cili është punuar bazuar në aktivitetet e parapara në Planin e Veprimit nga Planin Zhvillimor Komunal, bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese, përmes zhvillimit të projekteve konkrete të rrjetit të infrastrukturës teknike, publike dhe sociale për çdo vit pasues, ku janë përcaktuar:

- vendndodhja e dedikuar, përfshirë edhe shpronësimet eventuale;

- koston e përafërt të zbatimit;
- burimet e parapara të financimit;
- periudhën e zbatimit; dhe
- institucioni përgjegjës për zbatim.

Komuna e Fushë Kosovës në kuadër të planit të veprimit, për nga karakteri hapësinor, ka paraparë aktivitete shtesë nga ato që janë kërkuar në Planin e Veprimit nga Plani Zhvillimor Komunal ku janë paraparë kushte dhe masa mbrojtëse.

13.2.1. *Formimi i ekipit*

Një nga faktorët e fillestar dhe të rëndësishëm të zbatimit të HZK-së është krijimi i Ekipit Komunal të Fushë Kosovës. Ky Ekip komunal do ketë obligimet për përkrahje në zbatim të HZK-së, por edhe për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit, në të njëjtën kohë pasi që komuna e Fushë Kosovës nuk ka Ekip edhe për zbatim dhe monitorim të PZHK-së, ky Ekip duhet t'i kryej edhe ato detyra.

Komuna e Fushë Kosovës në funksion të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të HZK-së, si pjesë e këtij dokumenti, e parasheh krijimin e këtij Ekipi, që për pos rëndësisë së madhe në zbatim, do të shërbejë edhe si një mekanizëm për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të komunës drejt arritjes së të gjitha aspekteve të planit, në bazë të treguesve të matshëm.

Ky Ekip Punues duhet të themelohet nga Kryetari i Komunës, i cili bazuar në kompetencat ligjore që ka ose e themelon vet ose i propozon Kuvendit të Komunës emërimin e Ekipit Punues për zbatimin e Hartës Zonale të Fushë Kosovës, si dhe për Monitorim dhe Raportim lidhur me zbatimin e Hartës. Për arsye praktike Ekipi i njëjtë do ketë obligimet e njëjta edhe për PZHK-në e Fushë Kosovës, sepse komuna deri më tani nuk ka të emëruar ndonjë Ekip për përcjelljen e zbatimit të PZHK-së që nga aprovimi i saj.

Në kuadër të vendimit duhet përshkruhet përbërja e Ekipit, detyrat lidhur me zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit, periudhat e raportimit, kompensimin nëse aplikohet etj.

Ekipi Punues përbëhet nga përgjegjësit e të gjitha drejtorive, e udhëheqësi i Autoritetit Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor (Drejtorisë së Urbanizmit) është edhe koordinatori i Ekipit.

Detyrat e Ekipit janë të koordinojë dhe bashkërendojë aktivitetet, lidhur me përgatitjen e Planeve Vjetore, për çdo drejtori brenda komunës së Fushë Kosovës, Planet vjetore duhet përgatitur për: Drejtorinë e Administratës, Drejtorinë për Financa dhe Buxhet, Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mbikëqyrje, Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Tatim në Pronë, Drejtorinë e Inspeksionit, Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtorinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Drejtorinë për Shërbime Publike.

Është detyrë e secilit përgjegjës që është pjesë e ekipit, nga secila drejtori të kujdeset për këto Plane Vjetore, dhe e koordinorit të Ekipit të kujdeset për planin e drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbikëqyrje, por në cilësinë e koordinorit dhe si udhëheqës i Ekipit Punues edhe të koordinojë dhe të ndihmojë edhe planet vjetore të drejtorive të tjera.

Detyrë tjetër e Ekipit është që të verifikojë se Planet Vjetore Sektorale të jenë të bazuara dhe në harmoni me Planin e Veprimit për Zbatim nga HZK-ja.

Ekipi duhet edhe të përcjell, koordinojë dhe bashkërendojë zbatimin praktik të projekteve dhe komponentës hapësinore në baza ditore, javore e mujore të punës.

Ekipi do të marrë edhe shënime për mundësitë, sfidat dhe problemet e zbatimit ashtu që të mundësojë përmirësimin e zbatimit në vitin tjetër të radhës.

Ekipi Punues dhe anëtarët nga të gjitha drejtoritë komunale, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë dhe funksionalizojnë Sistemin e Zbatimit të Planit si dhe Raportimin. Ekipi, nëpërmjet Zyrës për Informim, informon edhe qytetarët 15 ditë para datës së raportimit në një tubim të qytetarëve për gjetjet në procesin e

zbatimit të planeve, dhe në atë takim kërkon edhe propozimet e qytetarëve për masa, zhvillime dhe projekte që, do të mund të futeshin në rishikim të buxhetit dhe KAB, përmes: Shpalljeve publike të vendosura në objektet publike, dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës, mediave lokale, Ueb faqes zyrtare të Komunës.

Koordinatori i Ekipit, bashkë me Ekipin, ftojnë përfaqësuesit e Drejtorive, që të marrin pjesë në takime për t'u konsultuar dhe diskutuar lidhur me zbatimin e planeve, dhe përfaqësuesit e Drejtorive raportojnë për zhvillimet, por edhe propozojnë masat e aktiviteteve që i kontribuojnë zbatimit të planeve.

Konsultime organizohen edhe me kryetar të Këshillave Lokale të fshatrave, të Vendbanimeve, të Lagjeve Urbane dhe përfaqësues të Shoqërisë Civile që, të kontribuojnë me propozime, sugjerime dhe komente gjatë procesit të zbatimit të planeve për të gjitha fushat; Informojnë nëpërmes formave të ndryshme për zhvillimet ilegale në vendbanimet, lagjet urbane dhe përgatiten për projekt-propozimet; Masat dhe zhvillimet e parapara me plane në periudhën e dëgjimeve publike për buxhet; Tubimet e rregullta publike; Takimet për planifikim strategjik që organizohen nga Komuna, përkatësisht Kuvendi i Komunës ose Kryetari.

Së paku një anëtar i Këshillit Lokal të Fshatit, të Vendbanimit apo të Lagjes urbane duhet të jetë person kontaktues për Zbatimin të Planit në fshat, vendbanim apo lagje urbane. Ky person, mund të jetë personi i cili, me rregulloren për Këshilla të Fshatrave, është përfshirë në grupet punuese komunale për planifikim të planit zhvillimore komunal.

Kryetari i Komunës, duhet që të organizojë (së paku) dy takime në vit me Ekipin Punues. Takimet, duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj, edhe pse preferohet çdo tre muaj të ketë takime. Për rendin e ditës, duhet të konsultohen edhe nëse konsiderohet se raportimi për zhvillimet lidhur me zbatimin e planeve dhe përgatitja e raporteve gjashtëmujore dhe njëvjeçare, duhet të jetë pika kryesore. Kuvendi i Komunës, mund të kërkojë një opinion nga Ekipi për çështje të caktuara me interes për qytetarët dhe institucionet.

Procesi i zbatimit mbështet në parimin e Ligjshmërisë sipas të cilit parim, Komunitat ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre brenda Kushtetutës, ligjeve dhe akteve të tjera normative të Republikës së Kosovës. Zbatimi i këtij parimi, nënkupton edhe zbatimin e parimit të transparencës dhe në këtë mënyrë komunitat, promovojnë transparencën e organeve Legjislative, Ekzekutive dhe Administrative, duke e rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në zbatimin e planeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës.

13.2.2. Informimi dhe Komunikimi në procesin e Zbatimit të HZK-së së Fushë Kosovës luajnë një rol të jashtëzakonshëm

Komuna e Fushë Kosovës dhe akterët e tjerë relevantë, duhet të kontribuojnë ndjeshëm në krijimin e kushteve për përkrahje në zbatimin Hartës Zonale. Fusha e informimit dhe e komunikimit në funksion të zbatimit të këtij dokumenti, ka nevojë për mbështetje të madhe të drejtuesve të institucioneve dhe të vetë institucioneve komunale.

Ndërtimi i marrëdhënieve të mira me publikun, do të ndikonte drejtpërdrejt në përmirësimin e praktikave të zbatimit të planeve, në përmirësimin e mbledhjes dhe përdorimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, në përdorimin efektiv të aseteve të komunës, në krijimin e një klime miqësore me bizneset, në inkurajimin e shoqërisë civile dhe të sektorit privat etj. Nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm të buxhetimit me pjesëmarrje, do të inkurajohen qytetarët në përfshirjen e tyre në zbatimin e kushteve, masave dhe përmbajtjeve të HZK-së, në vlerësimin e nivelit të shërbimeve publike dhe në rritjen e transparencës në përdorimin e fondeve publike. Komuna është e detyruar të zbatojë kuadrin ligjor në lidhje me transparencën dhe informimin e publikut, në lidhje me tërë veprimtarinë ekonomiko-financiare të komunës dhe në këtë funksion, plani i informimit dhe i komunikimit do të përmbushte edhe këtë kërkesë, nga kuadrin ligjor.

Në vijim, Komuna e Fushë Kosovës do të respektojë me rigorozitet procedurat ligjore të transparencës edhe gjatë zbatimit të Hartës Zonale. Planin i informimit dhe i komunikimit, është baza mbi të cilën duhet të

zhvillohet procesi i zbatimit transparent të HZK-së, dhe i sigurimit të përkrahjes së gjerë nga të gjithë akterët në proces të zbatimit. Në këtë drejtim, komuna do t'i shfrytëzojë të gjitha mjetet e informimit dhe të komunikimit, për qasje sa më të gjerë dhe të qëndrueshëm në institucione dhe dokumente, aty ku ligjërisht është e mundur për publikun dhe akterët e tjerë relevant. Në këtë drejtim në funksion të zbatimit të dokumentit rekomandohet: Të ketë komunikim dhe motivim lidhur me strategjinë dhe planin e informimit dhe komunikimit me të gjithë akterët, duhet mbahet plani në fokus të të gjithëve. Informatat dhe udhëzimet lidhur me zbatimin e Hartes Zonale duhet të publikohen në mjete të informimi, në faqen elektronike të komunës, sepse do të ndihmojnë për të ndërtuar dhe fuqizuar dinamikën e zbatimit të planit.

Një udhëzim tjetër i dobishëm në këtë drejtim, është një "Memo vjetore", dërguar nga Kryetari i Komunës të gjithë liderëve të vendbanimeve, shoqatave jo qeveritare, bizneseve, qeverisë qendrore, institucioneve publike etj. Kjo memo, i përkujton ata në lidhje me Hartën Zonale aktuale dhe me këtë rast nga anëtarët e grupeve të tjera të interesit, mund të kërkojnë komente dhe sugjerime lidhur me informimin, me komunikimin, zbatimin e dokumentit si dhe për çështjet tjera me interes. Si shumë me interes për zbatim të Hartës konsiderohet analiza, informimi dhe komunikimi adekuat, cilësor etj., me të gjithë akterët dhe veçanërisht, me ata që ndihmuan në hartimin e planit. Njerëzit të cilët kanë ndihmuar me inpute, duhet mbajtur të përfshirë në vazhdimësi, përmes fuqizimit të informimit dhe të komunikimit, si një komponentë e rëndësishme dhe strategjike e zbatimit.

13.2.3. *Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në funksion të zbatimit të planeve*

Përkundër që në komuna e Fushë Kosovës mund të thuhet lirisht se kishte një proces cilësor gjatë përgatitjes së HZK-së në kuptimin e gjithëpërfshirjes edhe të zbatimit të ligjit në fuqi, përkundër që bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në mes të drejtorive gjatë hartimit të dokumentit ishte i mirë por, vlerësohet se ende ka mjaft shumë hapësirë për informim, bashkëpunim dhe bashkëveprim në mes të drejtorive, sidomos sa i përket zbatimit të Hartës Zonale të Komunës.

Në këtë drejtim, çdo drejtori duhet të jetë e përgatitur që të jetë në funksion të zbatimit të dokumentit, duhet të jetë e pajisur me të gjithë mekanizmat dhe mjetet e nevojshme duke filluar: nga posedimi i kopjeve të shtypur dhe digjitale të Hartës, stafi i secilës drejtori duhet të informohet me përmbajtjen, detyrat, si dhe me obligimet që dalin nga HZK-ja. Drejtoritë, duhet të komunikojnë dhe t'i koordinojnë veprimet për kushtet, masat dhe përmbajtjet tjera të HZK-së por edhe aktivitetet që janë rezultat i Hartës, por edhe të jenë të informuara për zhvillimet tjera që janë të veçanta brenda drejtorive, si dhe duhet komunikuar edhe për kufizimet dhe mundësitë ligjore nga fushat e tyre kompetente që prekin drejtoritë por, edhe zhvillimet, aktivitetet dhe projektet e tjera.

Vlerësohet shumë i rëndësishëm krijimi i një sistemi digjital, i cili do të mundësojë komunikimin adekuat, azhurnimin e shpejtë dhe cilësor, transparencën në mes të drejtorive, por edhe transparencën ndaj akterve të tjerë. Një sistem i tillë, e ngritë shkallën e zbatimit (implementimit) të Hartës dhe mundëson informim dhe koordinim efikas, cilësor dhe në masë të madhe e ngritë edhe shkallën e zbatimit të detyrave, si dhe përgjegjësinë dhe transparencën ndaj të gjithë akterëve relevantë. Krijimi i sistemit të përbashkët të GIS-it, shihet si domosdoshmëri nga që është edhe mundësi shumë më e madhe e informimit dhe e komunikimit të shpejtë dhe të saktë në mes të drejtorive. Por, deri sa të krijohet ky sistem, drejtoritë duhet t'i shfrytëzojnë mjetet më pak të sofistikuara ose, ato mjete që i kanë në dispozicion.

Drejtoritë komunale, gjithsesi duhet të vazhdojnë të i shkëmbejnë informatat, të bashkëpunojnë dhe të bashkëveprojnë në mënyrë cilësore mes tyre për zbatim të dokumentit. Zbatimi i Hartës, i aktiviteteve dhe i zhvillimeve të tjera fillon menjëherë pasi që ato të jenë aprovuar nga Kuvendi Komunal, mirëpo për lehtësimin e zbatimit të Hartës Zonale Komunale vlerësohet hartimi i planeve të punës për çdo drejtori dhe zbatimi i tyre sipas sektorëve përkatës, bazuar edhe në plane të lartpërmendura. Këto plane sektoriale, do të prezantohen para Ekipit Punues për Zbatim për t'u analizuar, për koordinim të aktiviteteve por edhe për të ndihmuar në

zbatimin e tyre. Nga fusha e bashkëpunimit dhe e bashkëveprimit në mes të të gjitha drejtorive, duhet theksuar se një rol të madh dhe strategjik ka Drejtoria e Inspektoratit, ose inspektorët e fushave të ndryshme të nivelit komunal. Zbatimi i dokumentit është i lidhur ngushtë edhe me punën inspektorëve të fushave përkatëse. Vlerësohet mjaft i rëndësishëm dhe duhet bashkëpunuar ngushtë për t'i informuar ata me zhvillimet e planifikuara, si dhe për t'i pajisur me harta (të shtypura me përpjesë të duhur ose digjitale) adekuate për këto zhvillime, dhe për kufijtë ndërtimorë në veçanti, por edhe për zhvillime të tjera. Kjo bëhet pastaj, edhe për ta funksionalizuar bashkëpunimin dhe bashkëveprimin në mes të drejtorive në funksion të zbatimit sa më efikas dhe cilësor të planit.

Vlen të theksohet se rolin kryesor në fushën e bashkëpunimit me inspektoratin ose edhe me inspektorët, e mbanë Drejtoria e Urbanizmit dhe mbikëqyrjes por, në funksion të zbatimit të planit një rol të rëndësishëm e ka edhe Ekipi Punues për Zbatim, si dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror.

Drejtorinë për Financa dhe Buxhet dhe Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Tatim në Pronë janë ndër drejtoritë komunale të cilat duhet të jenë të informuar për zhvillimet e parapara me plan, sidomos duhet të jenë të informuara me projektet dhe me masat konkrete nga plani si dhe për prioritetet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjatë. Duhet që sa më shumë projekte, zhvillime të parapara me HZK të futen në parashikimet buxhetore të trevjeçarit të ardhshëm që njihet si KAB Korniza Afatmesme Buxhetore. Vetëm me futjen e këtyre kushteve, zhvillimeve, masave dhe projekteve në kalendarët buxhetor dhe aprovimin e tyre në nivelin komunal dhe qendror, jemi një hap më përpara në zbatimin e tyre.

Mund të konstatohet se në funksion të zbatimit të Hartës Zonale Komunale në këtë rast, por edhe çfarëdo dokumenti tjetër, bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në mes të drejtorive gjatë zbatimit duhet fuqizohet dhe avancohet.

13.2.4. *Sektori privat, Shoqëria Civile dhe përfaqësuesit e Lagjeve dhe të Vendbanimeve*

Bashkëpunimi me sektorin privat, me shoqërinë civile dhe me përfaqësuesit e lagjeve dhe të vendbanimeve në komunë, është shumë i rëndësishëm si në të gjitha fazat e hartimit të dokumentit edhe në zbatimin e tij. Sektori privat është forca shtytëse kryesore e zhvillimeve, prandaj në funksion të zbatimit të Hartës me këtë sektor, duhet krijuar një traditë të informimit, të komunikimit dhe të bashkëpunimit cilësor, dhe duhet shfrytëzuar të gjitha mjetet në këtë drejtim. Ajo që është e planifikuar, duhet ofruar për zbatim këtij sektori dhe mënyra e ofrimit duhet jetë e qëndrueshme dhe transparente. Duke e njohur rolin dhe fuqinë e sektorit privat, Drejtoria e Urbanizmit dhe e Mbikëqyrjes, Ekipi Punues dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror, në funksion të zbatimit të Hartës duhet t'i ofrojnë kushte për mes HZK-së për thithje të investimeve, dhe këtë sektor ta orientojnë në zhvillime të planifikuara dhe të qëndrueshme.

Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile, por edhe përfaqësues të tjerë të Lagjeve dhe të Vendbanimeve, janë po aq të rëndësishëm: sa në përgatitjen e Hartës, po aq edhe në zbatimin e sajë. Prandaj, duhet fuqizuar bashkëpunimin me ta, sikurse edhe me sektorin privat dhe duhet krijuar një traditë të informimit, të komunikimit dhe të bashkëpunimit cilësor, dhe gjithsesi duhet shfrytëzuar të gjitha mjetet në këtë drejtim. Shpeshherë, përfaqësuesit e OJQ-ve, janë bartës të projekteve të ndryshme. Do të ishte mirë, që edhe ata të jenë në funksion të ngritjes së vetëdijes për zbatim të HZK-së ose edhe të kushteve, masave e të zhvillimeve që rrjedhin nga HZK-ja. Në këtë drejtim, informimi dhe komunikimi me ta, është i një rëndësie jetike. Bashkëpunimi, mund të ngritët në atë nivel që, përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e lagjeve e të vendbanimeve, të arrijnë që të marrin përgjegjësi për projekte, për masa dhe zhvillime, e deri te roli i kujdestarit për zhvillime të pa planifikuara dhe ilegale. Niveli më i lartë i bashkëpunimit në këtë drejtim, arrihet atëherë kur Zonat e caktuara që dalin nga Harta, janë të përbashkëta.

13.2.5. *Bashkëpunimi me Gjykata*

Në zbatim të dokumenteve, disa zhvillime të caktuara bëhen çështje e gjykatave: prej atyre komunale, e deri te nivelet e më të larta gjyqësore. Vlerësohet si i domosdoshëm bashkëpunimi me gjykatat dhe krijimi i një vije

komunikimi dhe bashkëpunimi cilësor me to, në funksion të marrjes së vendimeve adekuate dhe me peshë të duhur. Ky bashkëpunim, është shumë i rëndësishëm sepse, është në funksion adekuat të parandalimit dhe të amortizimit të zhvillimeve të pa planifikuara. Duke e ditur se gjykatat tona janë shumë të ngarkuara, lëndët që vijnë nga kjo fushë duhet parë dhe duhet trajtuar me prioritet sepse, pasi që të bëhet zhvillimi apo implementimi në këtë drejtim, edhe tentimi për revidim ose edhe sanksioni eventual është i pa vlerë dhe jo efikas.

Nëse nuk krijohet një urë e bashkëpunimi efikas me gjykatat, lejohen apo stimulohen edhe më shumë zhvillimet e pa planifikuara dhe jo legale. Duke njohur rolin dhe fuqinë e gjykatave, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbikëqyrjes, e në funksion të zbatimit të HZK-së edhe Ekipi Punues si dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror, duhet ofruar kushte, duhet krijuar komunikimin dhe bashkëveprimin të duhur në mënyrë që aty ku është e domosdoshme (madje edhe duke bashkëpunuar edhe me mekanizma të tjerë, siç është policia), të pengohen ndërtimet e pa planifikuara dhe ilegale në funksion të zbatimit efikas dhe cilësorë të HZK-së.

13.2.6. *Bashkëpunimi me Byro Projektuse*

Bashkëpunimi me Byro Projektuese dhe me Institute adekuate si dhe me institucione që merren me projekte zhvillimore në mënyrë profesionale, është i rëndësishëm dhe në funksion të zbatimit të HZK-së, e të informimit adekuat. Komunikimi dhe bashkëpunimi në këtë drejtim, është shumë i rëndësishëm. Nëse vendosen ura të bashkëpunimit dhe të komunikimit dhe ngritet niveli i bashkëpunimit në shkallë adekuate, këto institucione nuk do të hartojnë projekte pa qenë të bazuara në kushtet zhvillimore dhe ndërtimore të parapara me HZK dhe pa qenë brenda shfrytëzimeve që lejohen, lejohen me kushtë ose me kushte të veçanta. Në të njëjtën kohë, këtyre institucioneve duhet bërë të kuptojnë se për veprime të jashtëligjshme, mund edhe të dënohen madje, edhe t'u ndalohet veprimtaria. Paralajmërimi si dhe shqiptimi i sanksioneve, besojmë se kontribuon direkt në zbatim e mirëfilltë të HZK-së. Në këtë drejtim, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbikëqyrjes por edhe Ekipi Punues si dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror, duhet ta luajnë rolin e vetë të informimit, të komunikimit dhe të bashkëveprimit me këto institucione.

13.2.7. *Bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror*

Pasi që HZK-ja është dokument multisektoral, lirisht mund të themi se edhe kompetencat, përgjegjësitë dhe ndikimet janë të ndryshme (si për nga niveli, ashtu edhe për nga fushëveprimtaria), bashkëpunimi në mes të institucioneve të caktuara, është njëra ndër shtyllat tjera ku duhet mbështetur për zbatim të HZK-së. Në këtë drejtim, aktivitetet dhe masat për zbatim, do të jenë një bazë e mirë për informim, për komunikim dhe për bashkëpunim dhe bashkëveprim drejt zbatimit të HZK-së. Dihet fare mirë se, çfarë roli ka MMPH-ja, MBPZHR-ja, Ministria e infrastrukturës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit por edhe ministritë e tjera në zbatim dhe në përcjellje të zbatimit të HZK-së.

Është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi në mes të niveleve të caktuara për zbatim të HZK-së. Dihet se ministritë e ndryshme si për shembull MMPH-ja, mundet që edhe të lëshoj leje. Siç thuhet në ligjin për planifikim, autoritetet duhet t'i lëshojnë lejen secilit aplikues, derisa propozimi për ndërtim përputhet me dispozitat e ligjit të planifikimit, dhe me ligjet e tjera dhe planet zhvillimore komunale dhe hartat Zonale dhe dokumentet tjera të planifikimit, duke e ditur edhe kompetencat për ujë, për Tokën dhe për ajrin që i ka (në këtë rast) MMPH-ja, një fuqizim i bashkëpunimit do të ndihmonte shumë në zbatimin e dokumentit.

Qeveria e vendit, me propozim të MMPH-së ka nxjerr akt të veçantë me të cilin, e rregullon mbikëqyrjen, por edhe ndëshkimin dhe marrjen e masave të përcaktuara me ligj të planifikimit. Prandaj, mbikëqyrja e akteve të përgjithshme dhe veç e veç, e kushteve dhe e mënyrës së punës të personave të juridik dhe fizik dhe marrja e masave është e përcaktuar po me këtë ligj dhe nga ministria nëpërmjet inspektorëve. Në këtë drejtim, për pos procesit të nxjerrjes së dokumenteve dhe të akteve të tjera, zbatimin e tyre, si dhe aplikimin e procedurave i inspekton MMPH.

Bashkëpunimi, informimi dhe komunikimi është çelësi i zbatimit të HZK-së. Një rol të rëndësishëm, e ka edhe MBPZHR, e cila është kompetente për zhvillime të qëndrueshme bujqësore por, edhe për zhvillime të pyjeve. Në këtë drejtim, edhe mbrojtja e tokës bujqësore, është fushë ku gërshetohen interesat e nivelit lokal dhe qendrorë. Në këtë drejtim, planet për zbatim do të jenë një bazë e mirë për informim, për komunikim dhe për bashkëpunim dhe bashkëveprim drejt zbatimit. Fuqizimi i lidhjeve me këtë ministri, është çelës i mbrojtjes së tokës bujqësore për çka është i themeluar edhe Inspekcioni i Bujqësisë i cili me anë të inspektorëve të tij kryen punë inspektuese në fushat e bujqësisë: në tokat bujqësore, në sferën e Pylltarisë dhe të Gjetisë, të mbrojtjes së Bimëve, të Blegtorisë dhe të Peshkatarisë, si dhe të Veterinarisë dhe të sigurisë së Ushqimit. Edhe përmes kësaj ministrie si dhe përmes inspektoratit të saj, duhet fuqizuar informimin, komunikimin dhe bashkëpunimin dhe bashkëveprimin për mbrojtjen e tokës bujqësore, si dhe të fushave të tjera relevante dhe ky, do të konsiderohej si një hap i rëndësishëm drejt zbatimit të HZK-së.

Pasi që planifikimi është multisektoral, gati të gjitha ministrinë dhe të gjitha agjencionet e tjera publike, kanë një fushëveprimtari, kompetencë dhe ndikim që prek edhe zbatimin e HZK-së. Vlerësohet se, një bashkëpunim cilësor duhet krijuar në funksion të zbatimit të HZK-së edhe në mes të niveleve, dhe dihet mirë se zonat e veçanta arkeologjike, arkitektonike janë fusha për zhvillim të përbashkët, mbrojtje por edhe zbatim, njëjtë si edhe një pjesë e madhe e granteve që vijnë nga niveli qendror. Lirisht, duhet theksuar se cilësia e këtij bashkëpunimi, konsiderohet si mjaft përmbajtësore për zbatim të HZK-së.

13.2.8. Mbështetja administrative

Komuna e Fushë Kosovës, duhet të ofrojë një mbështetje cilësore administrative për zbatim të HZK-së, duke e synuar lirimin nga vonesat burokratike dhe duke reaguar me cilësi ndaj vështirësive ligjore, duke vendosur afate dhe orare të duhura etj. Parashikohet edhe shfrytëzimi i teknologjive, si dhe i aplikimeve online për zhvillime.

Informimi, komunikimi dhe bashkëpunimi për thjeshtim sa më të madh të procedurave administrative, ndikon dukshëm në zbatim të dokumentit. Në këtë drejtim aplikimi online, matja e kohës se për sa kohë pala e interesuar e merr përgjigjen, janë parametra shumë të rëndësishëm për zbatim, por edhe për transparencë në zbatim.

Për t'u mundësuar zbatimi i HZK-së, si mbështetje administrative duhet ofrohet mundësia e detajimeve më të mëdha në disa pjesë të trajtuara me HZK, Zona në të cilat mund të jepen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore, por për shkak mos trajtimit në nivel parcele, dhe mundësisë për trajtim jo të barabartë të parcelave dhe pronarëve të ndryshëm, në funksion të sigurimit të hapësirave publike, gjelbërimit dhe përmbajtjeve tjera urbane, duhet trajtuar me PRRH, ose mundësuar propozimet për detajime më të mëdha të vijnë nga pronarët dhe një komision profesional t'i trajtojë konceptet e propozuar për detajet, sepse HZK nuk i ofron të gjitha detajet.

Duhet theksuar se si një mundësi e detajimeve të mëtejme që do preferohej, është një lloj komasacioni urban, ku disa pronarë do t'i bashkonin parcelat dhe do e propozonin një zgjidhje për zonën me disa parcela dhe të gjithë do t'i definonin interesat e përbashkëta me përqindje të pjesëmarrjes dhe përfitimeve, do të ofronin infrastrukturën publike dhe përmbajtjet tjera urbane, të cilat me marrëveshje do të barteshin si pronë publike dhe me të njëjtën marrëveshje do përfitonin bonuse zonimi. Marrëveshja e tillë do bëhej me nënshkrimin e të gjithë pronarëve te noteri, me nënshkrimet të cilat i bartin të drejtën një zhvilluesi privat te noteritë, dhe nga ana e komunës me aprovim në kuvendin komunal, në këtë rast si pjesë e marrëveshjes do të ishte edhe bartja kadastrale dhe bartja e drejtës së ndërtimit, edhe varianti tjetër me një lloj të komasacionit urban, sipas marrëveshjes së të gjithë pronarëve brenda zgjidhjes urbane në zonë, do ofronin infrastrukturën publike dhe përmbajtjet tjera urbane, të cilat me marrëveshje do barteshin si pronë publike, dhe me të njëjtën marrëveshje pronarët do përfitonin bonuse zonimi, marrëveshja e tillë do bëhej me nënshkrim të gjithë pronarëve te noteri, me nënshkrimet të cilat i bartin të drejtën e pronës te pronarëve, në parcelat e ri parceluara te noteri, dhe nga

ana e komunës me aprovim në kuvendin komunal dhe bartja kadastrale e parcelave të reja, ku banorët do ndërtonin ose kryenin zhvillime të caktuara në parcelat e reja me bonuse zonimi.

Kodi i ndërtimit për projektim dhe ndërtim duhet nga momenti që aprovohet me ndihmën e administratës komunale të gjej zbatim, dhe deri në atë fazë si draft të shfrytëzohet si bazë për projektim dhe ndërtim.

13.3. Monitorimi i zbatimit

Brenda kapitullit të V -Zbatimi dhe Monitorimi i Zbatimit, ekipet hartuese të Hartës Zonale Komunale të Fushë Kosovës kanë sqaruar përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me monitorimin e zbatimit të këtij dokumenti.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria e Urbanizmit) pas aprovimit të Hartës Zonale Komunale në Kuvend Komunal dhe publikimit zyrtar, fillon të kryej përgjegjësitë ligjore që ka lidhur edhe me monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, në këtë drejtim drejtoria e Urbanizmit do të fillojë me një punë mjaft komplekse dhe të vështirë në koordinimin dhe bashkëpunimin me drejtoritë sektoriale brenda komunës.

Duhet theksuar se monitorimi i zbatimit të Hartës Zonale Komunale është një aktivitet i vazhdueshëm me qëllim të sigurimit të informatave në mënyrë të rregullt dhe sistematike, përmes treguesve kuantitativ dhe kualitativ të cilët do të masin progresin e arritur në zbatimin e HZK-së së Fushë Kosovës me qëllim të vlerësimit se a janë arritur rezultateve e planifikuara por edhe identifikuar vështirësitë, sfidat dhe problemet.

Monitorimi trajton në mënyrë sistematike raportin ndërmjet gjendjes së zbatuar dhe asaj që është planifikuar me HZK por edhe pritjeve bazuar në treguesit e paracaktuar. Është mënyra sistematike e mbledhjes dhe e analizës së të dhënave të grumbulluara nga drejtoritë komunale dhe burimet tjera/informacionit, në lidhje me zbatimin e planeve për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm të zbatimit.

Monitorimi, është procesi nëpërmjet të cilit, zbatuesit e Hartës Zonale Komunale të Fushë Kosovës do të sigurohen që kushtet, masat dhe aktivitetet që janë duke u zbatuar, janë në përputhje me ato të planifikuara në Hartë dhe brenda afateve të caktuara. Është një përpjekje sistematike për të krahasuar punën në zbatim por edhe performancën e HZK-së me kushtet zhvillimor, ndërtimore, zhvillimet e parapara, projektet, masat, aktivitetet dhe standardet e caktuara për të vlerësuar nëse, po bëhet progres. Gjithashtu, parashikon dhe marrjen e masave korrigjuese ku ka devijime, parashikimin e vështirësive para se të shfaqen dhe kryerjen e korrigjimeve të nevojshme për ta mbajtur Hartën brenda detyrimeve të tyre.

Monitorimi, është procesi i vazhdueshëm i mbledhjes së të dhënave dhe i matjes së progresit drejt arritjes së kushteve zhvillimore, zhvillimeve të parapara, projekteve, masave dhe aktiviteteve të planifikuara me HZK. Procesi sistematik dhe i vazhdueshëm i mbledhjes dhe analizës së të dhënave, për një ndërhyrje të caktuar.

Monitorimi, vlerëson shkallën sipas të cilës Harta po zbatohet në përputhje me planin e Veprimit për zbatim të HZK-së ose edhe përmbajtjeve tjera të HZK-së dhe vlerëson se sa po i adreson nevojat e grupit ose grupeve të synuar.

Ky kapitull, përmban pjesën mjaft të rëndësishme të Hartës Zonale të Komunës së Fushë Kosovës, që paraqitet si obligim ligjor dhe për fokus ka monitorimin e zbatimit si në aspektin kuantitativ po ashtu edhe në aspektin kualitativ, dhe që nuk është kërkuar më parë (në dokumentet e punuara me ligjin e kaluar), kapitull përfundimisht që e bën ndryshimin dhe nëse pas 4 viteve nuk vlerësohet se Harta Zonale e Fushë Kosovës është zbatuar mbi 40%, dokumenti duhet të rishikohet dhe plotësohet.

Bazuar në përvojat e kaluara ekziston nevoja për zhvillimin të një sistemi qëndrueshëm për monitorimin e zbatimit të dokumenteve të planifikimit e sidomos HZK-së në këtë rast, Komuna e Fushë Kosovës është e bindur se përpos një planifikimi i qëndrueshëm dhe hartimit të dokumenteve cilësore, po aq është i rëndësishëm është edhe aplikimi i tij në praktikë dhe përkrahje më të madhe që komuna, institucionet dhe sektorët e tjerë kompetentë duhet bëjnë për gjetjen e rrugëve adekuate për zbatim.

Komuna e Fushë Kosovës e konsideron këtë kapitull si një përpjekje për të ndërtuar një sistem dhe koncept të monitorimit dhe vlerësimit të planit në praktikën e përditshme dhe në procesin e planifikimit hapësinor.

Komuna e Fushë Kosovës ka edhe për qëllim që të kontribuojë sa më shumë në orientimin dhe profesionalizimin jo vetëm të administratës dhe autoriteteve lokale por dhe të aktorëve të tjerë të përfshirë në

këtë proces. Do të përshkruhen në mënyrë të thjeshtë, të përmbledhur dhe të saktë të gjithë hapat që duhen ndjekur për të monitoruar zbatimin e HZK-së, dhe njëkohësisht të përgatiten raportet e nevojshme për Kuvendin Komunal, MMPH-në dhe që i duhen çdo pale të interesuar për zbatimin e HZK-së.

Monitorimi i zbatimit të HZK-së së Fushë Kosovës bëhet në baza ditore, ndërsa Raportimi i monitorimit kryhet në intervale kohe të ndryshme: mujore, dy mujore, tre mujore por për qëllime praktike më i rëndësishmi është ai gjashtë mujore dhe vjetore, por edhe për çdo vit radhazi, për katër dhe tetë vite, pasi që HZK-ja është dokument i cili planifikohet për disa vite, intervalet tjera kohore për raportin e monitorimit mund të caktohen varësisht edhe nga zhvillimet brenda drejtorive por edhe asaj që është paraparë me plan zbatimit, një raport përmbledhës i monitorimit të zbatimit të HZK-së përgatitet nga Ekipi Punues i cili udhëhiqet nga koordinatori, e koordinatori raportin përfundimisht e trajton dhe përmbyll brenda Autoritetit përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtorisë së Urbanizmit), raport i cili prezanton Monitorim dhe Vlerësim e zbatimit të HZK-së, edhe atë në intervale kohore të arsyeshme gjashtë mujore për nevoja të brendshme të komunës, dhe vjetore i cili është për nevoja të brendshme të komunës por edhe për raportim në MMPH.

Monitorimi i Zbatimit të HZK-së bazohet në: Projektet, kushtet, masat dhe përmbajtjet tjera të parapara në Planin e Veprimit për Zbatimin e HZK-së, plan i cili duhet jetë bazë për përgatitjen e planit vjetor sektorial të zbatimit të HZK-së.

Monitorimi i zbatimit trajton edhe projektet, kushtet, masat dhe përmbajtjet tjera të cilat nuk janë paraparë me Planin e Veprimit për Zbatimin e HZK-së, rrjedhimisht as me plan vjetor sektorial të zbatimit të HZK-së, dhe të cilat mund të konsiderohen si zhvillime të momentit, të pa planifikuara .

Kush është përgjegjës për monitorimin e zbatimit

Caktimi i stafit nëpër drejtori dhe i mjeteve për mbledhjen e të dhënave, që mund të ndryshojë nga drejtoria në drejtori, por edhe nga projektet, kushtet, masat dhe aktivitetet që do monitorohen (fillimisht do preferohej që një staf i cili është trajnuar për matjen e performances së Komunës të jetë pjesë e procesit të monitorimit).

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës në koordinim dhe bashkëpunim me drejtoritë përgjegjëse sektoriale të komunës.

Drejtoritë komunale sektoriale brenda komunës së Fushë Kosovës përgatisin raportin monitorues të zbatimit të planeve zhvillimore sektoriale në baza vjetore si obligim ligjor dhe sipas nevojës bazuar në intervalet e lartpërmendura, Raportet vjetore duhet përgatitur për: Drejtorinë e Administratës, Drejtorinë për Financa dhe Buxhet, Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mbikëqyrje, Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Tatim në Pronë, Drejtorinë e Inspeksionit, Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe sport, Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtorinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Drejtorinë për Shërbime Publike.

Drejtoritë sektoriale komunale përgatisin Raportin Monitorues të zbatimit të Hartës Zonale të Komunës dhe e dorëzojnë në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim, pasi të jetë integruar nga autoriteti komunal përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria për Urbanizmit dhe Mbikëqyrje) dhe pas shqyrtimit dhe miratimit të raportit nga Kuvendi i Komunës, në baza vjetore dorëzon në Ministri raportin informues për gjendjen e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës.

Raportet vjetore të monitorimit të zbatimit përfshijnë rekomandime për veprim dhe prezantohen para Kuvendit Komunal, Kryetarit të Komunës dhe Ministrisë me statistika financiare për çështjet e zonimit në baza vjetore dhe për rishikimin katër (4) vjeçar dhe tetë (8) vjeçar.

13.3.1. *Raportet vjetore të monitorimit bazohen në analizat e:*

Informatave bazë: gjatë gjithë procesit duhet të sigurohen informata; informatat duhet siguruar në të gjitha drejtoritë dhe instancat tjera. Këto informata sigurojnë bazë të mirë për analizën dhe vlerësimin e zbatimit të HZK-së së Fushë Kosovës.

Raporti vjetor i monitorimit dhe raportet sektoriale bazohen në analizat e këtyre informatave bazë: Informatat për projektet, kushtet dhe masat dhe përmbajtjeve tjera të HZK-së, të planifikuara në secilin sektor, që në rastin e komunës së Fushë Kosovës bëhet bazuar në informatat e zbatimit të planit sektorial të zbatimit të Hartës. Raporti vjetor bazohet edhe në analizat informatave që pasqyrojnë, kushte, masa, projekte, zhvillime që nuk kanë qenë të planifikuara me HZK por janë ndërtua ose zhvillu në ndërkohë.

Ndër informatat tjera të rëndësishme në të cilat raporti dhe raportet vjetore të monitorimit bazohen janë edhe informatat që pasqyrojnë:

- Numrin e lejeve ndërtimore dhe numrin e certifikatave të shfrytëzimit të lëshuara sipas kategorisë së ndërtimit;
- Statusi i mjedisit të rrezikuar;
- Shkalla e prodhimitarisë;
- Shkalla e ngritjes së cilësisë të shërbimeve publike dhe sociale;
- Shkalla e ngritjes së cilësisë të shërbimeve transportuese dhe teknike;
- Përqindja e investimeve kapitale publike dhe publiko-private të zbatuara, sipas planifikimeve për vitin përkatës si: ndërtimin e infrastrukturës teknike, sociale dhe publike;
- Shkalla e investimeve private të mëdha të planifikuara, nëse posedohen informata;
- Anketimi i familjeve bujqësore; dhe
- Rishqyrtimi i sasisë së përmbajtjes dhe përmasave të zbatimit të ndryshim plotësimeve, përjashtimeve dhe bonuseve të zonimit.

13.3.2. *Cilët janë treguesit*

Për të pasur një monitorim të zbatimit të HZK-së së Fushë Kosovë duhet siguruar që informatat bazë të pasqyrojnë treguesit adekuat për zbatim, ata tregues të cilët do të jenë kuantitativ (numra, përqindje) dhe tregues kualitativ. Çdo drejtori bazuar në Planin e Veprimit për Zbatim të HZK-së përgatit Planin vjetor sektorial për Zbatimin e HZK-së, dhe brenda këtij plani duhet definuar edhe treguesit e qartë për monitorimin e zbatimit të kushteve, zhvillimeve, të masave ose të projekteve të parapara.

Si i përcaktojmë treguesit për zbatim?

Duhet të Sigurohemi që ka një pajtim mbi treguesit para aplikimit të tyre (gjatë përgatitjes së planit sektorial vjetor për zbatim nga të gjithë amtarët e ekipit).

- Miratoni treguesit që janë të qartë dhe të kontrollueshëm.
- Miratoni treguesit që janë të matshëm, të afërt dhe konsistentë.
- Miratoni treguesit që janë të rëndësishëm për kontekstin komunal.
- Miratoni treguesit që janë të ndjeshëm ndaj kushteve të ndryshueshme, dhe që mund të azhurnohen lehtë.
- Miratoni tregues që janë të krahasueshëm me programet apo planet tjera.
- Ndërlidheni monitorimin me ndikimin në mjedis dhe studimet e revidimit.
- Ndërlidheni monitorimin me auditimet tjera të aktiviteteve të qytetit, zonave rurale, fondit të ndërtimeve, etj.
- Ndërlidhni problemet e zhvillimeve aktuale me sistemin e monitorimit, që të mund të zgjerohet apo ndryshohet edhe përdorimi i treguesve.

Për ilustrim:

Nëse në planin vjetor sektorial, bazuar në Planin e Veprimit për Zbatim të HZK-së së Fushë Kosovës kemi potencuar se për 5% të zonës synohet të jepen lejet e ndërtimit gjatë vitit 2018 dhe 5% nënkupton 100 leje ndërtimi.

Treguesi do jetë numër dhe në fund të vitit bazuar në informatat bazë mund të themi se kemi lëshuar 50, 100 ose 200 leje dhe në këtë formë analizojmë zbatimin e HZK-së nga fusha e banimit, duke realizuar 50%, 100% ose edhe 200 % .

Nëse në planin vjetor sektorial, bazuar në Planin e Veprimit për Zbatim të HZK-së së Fushë Kosovës kemi potencuar se synohet të jepet leja e ndërtimit të një shkolle në fshatin e caktuar, ku ka nevojë për eksproprijim ose do sigurohet hapësira me bonuse zonimi gjatë vitit 2018.

Treguesi do jetë fillimisht numerik një shkollë, treguesi i dytë do jetë a janë respektuar kushtet zhvillimore dhe ndërtimor nga HZK-ha dhe tregues i tertë do jetë a është zhvilluar me eksproprijim ose me bonuse zonimi .

Në të njëjtën formë përcaktohen treguesit për monitorimin e zbatimit të HZK-së si pjesë e planit vjetor sektorial, për të gjitha aktivitetet, bazuar në Planin e Veprimit për Zbatim të HZK-së së Fushë Kosovës

Caktimi i standardeve të monitorimit

Standardet e monitorimit i përcaktojmë në fazën e planifikimit të monitorimit: kushtet zhvillimore, kushtet ndërtimore, infrastruktura rrugore, sociale, teknike, projektet, aktivitetet, masat dhe afatet kohore zërthehen në tregues sasior dhe cilësor për monitorim të zbatimit, këta tregues duhet të jenë të kuptueshëm dhe të pranuar nga të gjithë, dhe do trajtohen si pjesë e integruar në zbatimin e Hartës, ky standard i monitorimit për fillim do ketë për bazë të gjitha ato që konsiderohen të rëndësishme për standardin e Kosovës, nga cila do fusha e zbatimit të Hartës, e që lidhet me monitorimin e zbatimit, mirëpo ma vonë do shikohen edhe mundësitë e një standardi që do ta caktonte standardin e treguesve sasiorë dhe cilësorë, që do të shërbenin edhe për matje të performancave ndërkombëtare, pos atyre për interes komunal dhe qendror.

Ngritja e një sistemi/mekanizmi/fidbeku/ushqyerje me informacion

Efektiviteti i monitorimit varet nga saktësia dhe besueshmëria e informacionit. Për këtë qëllim duhet ngritur një mekanizëm që siguron mbledhjen e informacionit, statistikave, të dhënave, raporteve etj, që sigurojnë bazën për posedim të vazhdueshëm të një informacioni të vlefshëm.

Mekanizmi i fidbek- ut, ushqyerja me informacion mund të jetë me të dhëna gojore (vizita në terren), ose me shkrim (informatë, formularë raportimi).

Ekipi Punues do të trajtohet si trupi ose mekanizmi kryesor në këtë funksion dhe drejtoritë, institucionet, grupet e individët do futen në shërbim për këtë qëllim nga mekanizmi kryesor.

Matja dhe vlerësimi i performancës

Një nga qëllimet e monitorimit është edhe sigurimi i informatave për matjen e performancës/ punës në zbatim të HZK-së, tregues të cilët nuk na ofrojnë informata, vetëm me matjen dhe vlerësimin e performancës, në kuptimin e asaj çfarë ka ndodhur me zbatimin e kushteve zhvillimore, kushteve ndërtimore, infrastrukturës rrugore, sociale, teknike, projekteve, aktiviteteve, masave dhe afateve kohore por do të shfrytëzohet si bazë edhe për të parashikuar, se çfarë do të ndodhë. Kjo do të thotë se devijime, mungesa, mbivendosje, parashikohen me kohë dhe ndërmerren masa korrigjuese.

Marrja e masave korrigjuese

Kur vihen re devijimet nga plani për zbatim në kuptimin e kushteve zhvillimore, kushteve ndërtimore, infrastrukturës rrugore, sociale, teknike, projekteve, aktiviteteve, masave dhe afateve kohore, kostove financiare duhen marrë masa korrigjuese. Kjo do të thotë ndryshim të planit të zbatimit, ndryshim në institucionet dhe në personelin kompetent, mbikëqyrje më e rreptë, vizita më të shpeshta në terren, motivim të pjesëmarrësve dhe grupit të synuar, procedura me të thjeshta financiare etj.

13.3.3. Cila do jetë metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit në procesin e Zbatimit të HZK-së së Fushë Kosovës

Duke e trajtuar metodologjinë si tërësinë e metodave që përdoren në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të Zbatimit të HZK-së së Fushë Kosovës në përgjithësi për dokumentin por edhe në fusha të caktuara sektoriale.

Lirisht mundet të thuhet se këto metoda bazohen në Planin e Veprimit për Zbatim të HZK-së si dhe në Planet Sektoriale për Zbatim ku janë paraparë: kushtet zhvillimore, kushtet ndërtimore, infrastruktura rrugore, sociale, teknike, projektet, aktivitetet, masat dhe afatet kohore, kostot financiare dhe pritjet nga zbatimi i tyre, thjesht duke krahasuar gjendjen e planifikuar dhe gjendjen e realizuar.

Metoda e cila preferohet të shfrytëzohet është metoda e orientuara në rezultate dhe në gjendjen faktike në terren.

Ekipi punues duhet të përdorë metodat statistikore dhe mund të përdorë edhe metodat tjera sipas nevojës dhe përcaktimeve edhe në plan pune për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit.

Metodologjia e punës do të ndjek hapat e njëjtë të cilat duhet të jenë edhe pjesë e planit të punës për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të HZK-së dhe planeve sektoriale, duke ndjekur këta hapa:

Hapi 1-Identifikimi: Identifikimi i Qëllimeve, Objektivave, kushteve zhvillimore, kushteve ndërtimore, infrastrukturës rrugore, sociale, teknike, projekteve, aktiviteteve, masave, afateve kohore, kostove financiare të cilat duhet të jenë edhe pjesë e planit të punës për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të HZK-së dhe planeve sektoriale të cilat duhet zbatohen gjatë vitit vijues kalendarik

Hapi 2- Definimi i treguesve: Në varësi të asaj se çka është pjesë e planit të veprimit për zbatim të HZK-së, dhe planeve sektoriale të cilat duhet zbatohen gjatë vitit vijues kalendarik duhet përcaktohen tregues të cilët do të jenë kuantitativ (numra, përqindje) dhe tregues kualitativ për më shumë në materialin e lartpërmendur: Cilët janë treguesit dhe materialet tjera.

Hapi 3: Përcakto metodat e grumbullimit të të dhënave dhe afatet kohore

Grumbullimi i të dhënave:

Grumbullimi i të dhënave bëhet, duke u bazuar në formularët e përgatitur për monitorim sipas specifikave të zhvillimeve dhe drejtorive.

Treguesit kuantitativ dhe kualitativ mblidhen në baza ditore dhe hedhja e tyre në databaze bëhet në baza javore;

Në rast se do të duket e nevojshme, mund organizohen intervista, pyetësorë dhe metoda tjera të grumbullimit të informatave.

Grumbullimi i informatave bëhet edhe nga burimet tjera pos burimeve zyrtare të komunës.

Hapi 4: Identifikoni Rolet dhe Përgjegjësitë e Monitorimit dhe Vlerësimit

Në kuadër të planit të monitorimit përcaktohen edhe Rolet dhe Përgjegjësitë e Monitorimit dhe Vlerësimit për përgjegjësit e drejtorive, stafin brenda secilës drejtori për më shumë shih materialin më lartë: Kush është përgjegjës për monitorimin e zbatimit dhe materialet tjera

Hapi 5: Krijë një Plan Vlerësimi dhe Format të Raportimit

Duke konsideruar se të dhënat bazë (treguesit dhe të dhënat tjera) duhet vlerësuar për të konstatuar dhe raportuar progresin e zbatimit, duhet hartuar një Plan transparent dhe profesional Vlerësimi dhe Format të Raportimit

Hapi 6: Kompletimi i Raportit dhe raportimi në Kuvendin komunal të Fushë Kosovës dhe në MMPH

Kompletimi i Raportit përfundimtar duhet bëhet nga autoriteti kompetent komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor doke integruar dhe strukturuar vlerësimet nga raportet e secilës drejtori lidhur me vlerësimin e zbatimit, raport i cili duhet prezantohet në Kuvendin komunal të Fushë Kosovës dhe në MMPH.

13.3.4. Vlerësimi i hartës zonale të komunës

Kuptimi i Vlerësimit

Vlerësimi, do të thotë gjetja e vlerës në përqindje (%) të realizimit të Hartës Zonale Komunale dhe cilësisë së zbatimit,

Vlerësimi, thjesht i referohet procedurave të fakteve të gjetura, të cilat janë grumbulluar dhe sistemuar gjatë procesit të monitorimit

Vlerësimi përbëhet nga vlerësimet nëse janë apo jo zhvillimet, masat, aktivitetet, projektet, trajtimi, ndërhyrjet në përputhje me rezultatet e planifikuara në Planin e Veprimit për Zbatim të HZK-së, Planet sektorale të Zbatimit dhe me standardet e pranuar përgjithësisht profesionale.

Për çdo të dhënë, informacioni që është marrë nga procesi i monitorimit dhe rezultati i ndërhyrjeve, trajtimit apo të zhvillimeve, masave, aktiviteteve dhe projekteve të parapara me HZK, ndryshimi i dy gjendjeve konsiderohet të jetë vlerësimi.

Vlerësimi është i determinuar për të siguruar informacione sistematike, të besueshme dhe të vlefshme mbi sjelljen, ndikimin dhe efektivitetin e zhvillimeve, masave, aktiviteteve dhe projekteve të parapara me HZK.

Komuna e Fushë Kosovës do orientohet kryesisht në Vlerësimin e brendshëm i cili është bërë në nga stafi i komunës, vetë bordi i drejtorëve, kryetari i komunës dhe përfituesit.

Mirëpo komuna e Fushë Kosovës mund të angazhojë edhe vlerësim dhe monitorim të jashtëm, ky vlerësim mund të bëhet nga një trupi jashtë strukturave të komunës.

Metodat e vlerësimit

Gjatë viteve, një shumëllojshmëri e metodave janë evoluar nga akademikët, institucionet dhe profesionistët për vlerësimin e çdo zhvillimi, mase, aktiviteti dhe projekti. Disa prej praktikave të përdorura zakonisht janë dhënë më poshtë.

Informacione të dorës së parë:

Një nga metodat më të thjeshtë dhe më e lehtë e vlerësimit nga marrjen e informacionit të dorës së parë në lidhje me progresin e performancës, etj, problem zonat e një zhvillimi, mase, aktiviteti dhe projekti nga një mori e stafit, ekipi komunal për monitorim dhe vlerësim, të personelit në terren, specialistë të tjerë dhe publiku që lidhen direkt me zhvillimin, masën, aktivitetin dhe projektin. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë dhe dëgjimi në lidhje me ecurinë, rrit shanset e një vlerësimi efektiv.

Raportet formale/Informale periodike:

Vlerësimi bëhet edhe përmes raporteve formale dhe joformale.

Vlerësimi bazohet në një listë të treguesve të paracaktuar për të siguruar zbatimin e vlerësimit, rezultatet dhe përputhshmërinë e vlerësimit, gjegjësisht bazohet në metodologjinë e vlerësimit të përcaktuar në planin e monitorimit.

Vlerësimi do jetë pjesë e raportit të monitorimit të zbatimit të HZK-së dhe do bëhet në çdo fund vit, por edhe në baza mujore e gjashtëmujore.

Katër vite pas fillimit të zbatimit dhe monitorimit, duhet të kryhet një vlerësim afatmesëm i zbatueshmërisë së HZK-së.

Monitorimi duhet të planifikohet ashtu që, në më pak se katër vite duhet të ketë të dhëna të mjaftueshme për vlerësim të HZK-së.

Nëse vlerësimi rezulton se zbatueshmëria e HZK-së është më pak se 40% nga ajo çka është planifikuar për katër vitet e para, vendimi për të reviduar HZK-në është i detyrueshëm. Në rast të vendimit për të reviduar HZK-në, planifikimi i një HZK-je të re, do të bazohet në raportet e monitorimit dhe të vlerësimit, mbi të cilat do të vendoset orientimi i HZK-së së re.

Një prezantim i raportit të vlerësimit, bëhet si më poshtë:

- Hyrje.
- Përshkrim i ndërlidhjes me HZK-në dhe me raportet paraprake të monitorimit (vjetore, raportit afat mesëm katër vjeçar).
- Përmbledhje e zhvillimit të ndodhur.

- Prezantimi i raporteve monitoruese.
- Rezultatet paraqiten me tekst, grafikone dhe diagrame, sipas kritereve të paracaktuara të vlerësimit.
- Vlerësimi dhe diskutimi i rezultateve të monitorimit.

Këtu jepet vlerësimi i dokumentit, ku analizohen rezultatet e monitorimit. Jepet përmbledhje e mospërputhjeve ndërmjet zhvillimeve të parashikuara dhe të zbatuara dhe ofrohen rekomandime për vendimmarrje nga autoritetet.

Duke u bazuar në raportin dhe rezultatet e vlerësimit, vendimmarrësit mund të marrin vendim për revidim të HZK-së.

13.3.5. *Kush do t'i përgatit raportet e monitorimit*

Ekipi punues mund të angazhohet në përgatitje të Raportit të Monitorimit. Ky ekip përbëhet nga koordinatori i cili vjen nga autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor si dhe nga përgjegjësit e drejtorive. Pastaj do të sqarohet se kush do përgatit raportin e monitorimit nga organet e caktuara duke e kuptuar se ekipi punues do të bartë këtë proces.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, bashkërendon aktivitetet për përgatitjen e Raportit të Monitorimit të zbatimit të HZK-së.

Drejtoritë komunale sektoriale zhvillojnë aktivitetet sektoriale përkatëse të tyre për përgatitjen e Raportit sektorial të Monitorimit të zbatimit të HZK-së.

Drejtoritë sektoriale hartojnë dhe dorëzojnë Raportet sektoriale vjetore të Monitorimit të zbatimit të HZK-së tek autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor harton dhe dorëzon raportin vjetor të Monitorimit të zbatimit të HZK-së, për miratim tek Kuvendi i Komunës.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, dorëzon raportin e miratuar vjetor të Monitorimit të zbatimit të HZK-së në Ministri.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor siguron se raporti i miratuar vjetor të Monitorimit të zbatimit të HZK-së publikohet në faqen e internetit të komunës dhe ofrohet në kopje të letrës sipas kërkesës.

Komuna mund të angazhojë kompani konsulente për kapitullin e zbatimit, monitorimit të zbatimit dhe vlerësimit, e cila do të përkrahë Ekipin dhe Autoritetet në këtë proces.

Raportimi nga Ekipi Komunal për Zbatim, Monitorim dhe Vlerësim duhet të jetë i atillë që do t'i mbajë drejtuesit e komunës të informuar për atë që po ndodh dhe të sigurojë raportet e progresit në zbatimin e HZK-së. Ky raportim në lidhje me ecurinë e zbatimit, dhe i bënë ata pjesë të procesit dhe aty ku mund të hasen probleme. Ekipi, duhet të jetë në gjendje për t'i adresuar shqetësimet apo për të propozuar ndryshime të mundshme.

Treguesit e monitorimit janë të bashkangjitur në **Shtojcën 6**.

14. NDRYSHIM PLOTËSIMET DHE PËRJASHTIMET

Fillimisht duhet sqaruar pas aprovimit të HZK-së së Fushë Kosovës cilat janë mundësitë ligjore për ndryshim dhe plotësim të HZK-së dhe cilat procedura duhet kalojmë

Duke e ditur se ndryshimi dhe plotësimi – nënkupton ndryshimet në pjesët tekstuale dhe hartografike të Hartës Zonale të Komunës, të cilat do të bëhen vetëm në përputhje me nenin 35 të aktit nënligjor, ku është përcaktuar se pjesët tekstuale ose hartografike të hartës zonale në këtë rast të komunës së Fushë Kosovë mund të ndryshohen plotësohen me vendim të Kuvendit të Komunës dhe ndryshim plotësimi duhet të miratohet nga Ministria (MMPH).

Ndryshim plotësimet mund të propozohen nga:

- Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës;
- Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor; ose
- Pronarët e parcelave kadastrale të sipërfaqes e cila do të jetë subjekt i ndryshim plotësimi të propozuar.

Ndryshim plotësimet nuk përdoren për ti dhënë privilegje ndonjë pronari të veçantë të pronës.

Ndryshim plotësimet përdoren vetëm për të përshtatur dispozitat e Hartës Zonale të Komunës si rezultat i ndryshimeve të kushteve rishtas të identifikuara, ose t'i shërbej për një interes bindës publik.

Ndryshim plotësimet përbëhen nga një proces dy-hapësh:

Hapi 1: Propozimin për fillimin e procedurës së ndryshim plotësimi e cila miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës; dhe

Hapi 2: Propozimin për ndryshim plotësimin e Hartës zonale të Komunës që miratohet nga dy të tretat (2/3) e votave të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Kemi edhe raste kur propozimi për ndryshim plotësimin e Hartës Zonale të Komunës bëhet nga ndonjë subjekt tjetër e jo nga komuna

Nëse propozimi për ndryshim plotësimin e Hartës Zonale të Komunës dorëzohet nga ndonjë subjekt tjetër e jo nga komuna, të gjitha shpenzimet për hartimin e këtij ndryshim plotësimi kompensohen nga aplikuesi.

Të gjitha propozimet për ndryshim plotësim duhet t'i dorëzohen Komunës në formë fizike dhe në formë digjitale (GIS).

Komuna e Fushë Kosovës do sqarojë edhe si bëhet propozimi për të nisur procedurën e ndryshim plotësimi Para dorëzimit të propozimit për ndryshim plotësim të Hartës Zonale të Komunës, aplikuesi së pari dorëzon propozimin përmes autoritetit përgjegjës komunal për planifikimin dhe menaxhim hapësinor (Drejtorisë së Urbanizmit të Fushë Kosovës) në Kuvendin e Komunës ku kërkon miratimin për fillimin e procedurës së ndryshim plotësimi.

Aplikimet për fillimin e procedurave të ndryshim plotësimi përfshijnë arsyetimin, një përshkrim të shkurtër dhe përshkrimin e hapësirave që do të përfshihen nga ndryshim plotësimi i propozuar. Kuvendi i Komunës mund të kërkojë informata shtesë para se të vendosë për propozimin.

Çka duhet të përmbajë propozimi për ndryshim plotësimin e Hartës Zonale të komunës së Fushë Kosovës

Propozimet për ndryshim plotësimin do të përmbajnë të dhëna të mjaftueshme për komunën për të marrë një vendim. Dokumentacioni që kërkohe, përfshin por nuk kufizohet në:

- Harta e pronave apo sipërfaqeve të propozuar për ndryshim plotësimin;
- Përshkrimi i gjendjes ekzistuese;
- Plani i lokacionit të propozuar për zhvillim me ndryshim plotësim;
- Përshkrimi i hollësishëm i propozuar për ndryshim plotësim si shfrytëzimi dhe kërkesat hapësinore; dhe

- Arsyetimi me shkrim për ndryshim plotësimin e propozuara.

Duhet sqaruar se nuk merren parasysh ndryshim plotësimi për zvogëlimin e kërkesave hapësinore për parkingje dhe sipërfaqe të hapura, që janë të përcaktuara me kushtet zhvillimore sipas Hartës Zonale të Komunës.

Kuvendi i Komunës para miratimit të propozimit për ndryshim plotësim të Hartës Zonale të Komunës, nga Autoriteti përgjegjës komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor kërkon rekomandim me shkrim, të cilat hyjnë në procesverbal.

Autoriteti përgjegjës komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor (Drejtoria e Urbanizimit) apo komisioni që ka themeluar komuna për të trajtuar çështjet e planifikimit hapësinor (i cili mund të themelohet) shqyrton propozimet për ndryshim plotësime dhe harton rekomandime në bazë të kriterëve, si:

- Në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal;
- Në harmoni me zonimin dhe shfrytëzimin e lejuara të parcelave kadastrale fqinje dhe karakterin e zonës në atë shkallë dhe intensitet që lejon një cilësi të lartë të jetesës për banorët, përfitime të arsyeshme për zhvilluesit dhe kosto të arsyeshme infrastrukturore për tatimpaguesit;
- Në harmoni me shfrytëzimet në zonë të propozuara me ndryshim plotësim për parcelat kadastrale që përfshihen nga ndryshim plotësim;
- Kapacitete të mjaftueshme dhe të përshtatshme të shërbimeve dhe infrastrukturës publike për shfrytëzimet e lejuara brenda zonës së propozuar; dhe
- Në harmoni me ligjet tjera, përfshirë Ligjin për Tokën Bujqësore.

Procesi për miratim të çfarëdo ndryshim plotësimi

Para miratimit të çfarëdo ndryshim plotësimi të kërkuar, Kuvendi Komunal do të caktojë dhe njoftojë për shqyrtimin publik, në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr.05/2014.

Njoftimi për shqyrtimin publik përfshin:

- Datën, kohën dhe vendin e dëgjimit publik dhe afatet e shqyrtimeve publike;
- Një përshkrim të konceptit të ndryshim plotësimi të propozuar;
- Listën me të gjitha parcelat kadastrale që përfshihet nga ndryshim plotësimi i propozuar;
- Kontaktin me zyrtarin e komunës nga i cili mund të merren informata shtesë;
- Kohën dhe vendin ku ndryshim plotësimi i propozuar mund të shikohet nga çdo person i interesuar para shqyrtimit publik, dhe
- Vegzën ku mund të gjendet ndryshim-plotësimi i propozuar në faqen zyrtare elektronike të komunës.

Kur ndryshim plotësimi i propozuar vlen vetëm për një parcelë kadastrale të veçantë apo për disa parcela kadastrale, komuna njofton me shkrim për shqyrtimin dhe dëgjimin publik përmes postës me rekomandim, së paku tridhjetë (30) ditë para dëgjimit publik dhe i adresohet:

- Pronarëve të të gjitha parcelave kadastrale që janë subjekt i ndryshim plotësimi të propozuar;
- Pronarëve të parcelave kadastrale brenda rrezes prej së paku 150 metra (m) nga subjekti i ndryshim plotësimi i propozuar;
- Komunën fqinje në rast se është brenda rrezes prej së paku 150 metra nga sipërfaqja që është subjekt i ndryshim plotësimi të propozuar; dhe

Nëse numri i personave që kanë të drejtë të pranojnë njoftimin sipas asaj që e shkruam më lart tejkalon një qindëshin (100), atëherë komuna nuk ka nevojë të sigurojë njoftim me postë me rekomandim, por së paku 8 ditë para fillimit të shqyrtimit publik, duhet të shpall njoftimin në tri gazeta ditore dhe në ueb-faqen e komunës.

Kur një ndryshim plotësimi i propozuar vlen vetëm për një parcelë kadastrale të veçantë apo për disa parcela kadastrale, komuna kërkon nga aplikuesi të postojë një informim/pllakatë për së paku 15 ditë, që përmban njoftimin e kërkuar nga ky nen në pronën në fjalë. Informimi/pllakata të jetë së paku i formatit A1,

i qëndrueshëm ndaj kushteve atmosferike dhe i postuar në pronë në vend të dukshëm nga çdo anë e pronës që kufizohet me rrugë.

Në dëgjimin publik, komuna lejon të gjitha palët e interesuara, komentet e pranuar me gojë dhe me shkrim dhe dërgon propozimin për ndryshim plotësim për miratim sipas procedurave.

Miratimi i ndryshim plotësimit të propozuar apo ndryshim plotësimit të reviduar kërkon miratimin nga dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Përfshirë në mënyrë specifike personat që kanë të drejtë në njoftim me postë me rekomandim sipas këtij neni të paraqesin pikëpamjet e tyre gojarisht ose me shkrim lidhur me ndryshim plotësimin e propozuar.

Të paktën një përfaqësues nga autoriteti përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor, merr pjesë gjatë gjithë dëgjimeve publike të organizuar nga komuna në përputhje me këtë nen.

Pas shqyrtimit publik komuna shqyrton për të përfshirë të gjitha komentet, sugjerimet dhe propozimet, në raportin e shqyrtimit publik jepen edhe arsyetimet për ose kundër

Harta Zonale e Komunës së Fushë Kosovës mund të revidohet pas 4 vite

Revidimi i Hartës Zonale të Komunës së Fushë Kosovës bëhet katër (4) vite pas miratimit përfundimtar të tij, sipas procedurës së përcaktuar për hartimin dhe miratimin e tyre paraprak, në rast se nga të gjitha masat e parapara në Hartën Zonale të Komunës për këtë periudhë, më pak se dyzet për qind (40%) të jenë zbatuar;

Harta Zonale e Komunës së Fushë Kosovës është hartuar për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

15. PËRJASHTIMET

Duhet sqaruar se në Hartën Zonale të Fushë Kosovës Përrjashtimet – nënkuptojnë një devijim të lejuar nga kushtet zhvillimore apo kushtet ndërtimore, në përputhje me bazën ligjore

Dhe komuna e Fushë Kosovës mund të lejojë përrjashtime nga kushtet zhvillimore vetëm në rastet kur dëshmohet privimi i mundësisë së zhvillimit të një parcele kadastrale sipas kritereve të poshtë shkruara.

Përrjashtimi nga kushtet zhvillimore mund të jepet nëse aplikuesi e dëshmon se ka një privim që e bën atë jashtëzakonisht të vështirë për pronarin e tokës t'u përmbahet kushteve zhvillimore dhe nuk ka të bëjë me nevojat personale apo dëshirat e pronarit.

Për ta dëshmuar privimin duhet të dëshmojë se:


1. Karakteristikat e veçanta të tokës e bëjnë të pamundur që aplikuesi t'u përmbahet të gjitha kushteve zhvillimore;
2. Përrjashtimi kërkohet për shkak të kushteve unike të pronës e jo për shkak të kushteve të përgjithshme të lagjes;
3. Përrjashtimi nuk ka efekt dëmtues në mjedis ose në hapësirën gjithëpërfshirëse;
4. Privimi nuk është rezultat i veprimeve të marra nga pronari i tokës ose ish pronari;
5. Përrjashtimi nuk do të krijojë ndikime negative në pronat fqinje ose pronave të tjera në afërsi duke ndikuar në:
 - diellzimin dhe ajrosjen e pronave fqinje;
 - trafik të shtuar dhe vështirësi në qarkullim të koridoreve transportues në afërsi;
 - sigurinë publike duke përfshirë dhe rritjen e rrezikut nga zjarri ose rreziqet tjera të mundshme;
 - vlerat e pronave fqinje; dhe
 - shfrytëzimin dhe zhvillimin e pronave fqinje.

Përrjashtimet mund të lejohen edhe për nevojat e personave me aftësi të kufizuar.

- Përrjashtimi mund të bëhet edhe për qëllime të bërjes së parcelës dhe ndërtësës të qasshme për personin me aftësi të kufizuara që jeton në pronë;
 1. Përrjashtimi mund të jetë i kufizuar me kohëzgjatjen e aftësisë së kufizuar ose me kohën derisa personi jeton në atë pronë.
- Përrjashtimet vendosen nga autoriteti komunal përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor. Komuna mund të themelojë një komision profesional të vendos apo këshillojë mbi kërkesat për përrjashtim.
 2. Përrjashtimet shqyrtohen në një takim dëgjimor që është i hapur për publikun.
 3. Minutat dhe vendimet e takimeve shpallen në faqen zyrtare të komunës. Takimet mbahen sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin për Procedurën Administrative.
- Përrjashtimet mund të jepen vetëm nëse:
 4. Struktura dhe shfrytëzimi i propozuar plotëson kushtet zhvillimore të Hartës Zonale të Komunës, përveç dispozitës specifike nga e cila kërkohet lehtësim;
 5. Aplikuesi dëshmon kriteret e përcaktuara në këtë nen.
- Përrjashtim mund të jepet me kushte të veçanta sipas nevojës, për të parandaluar dëmin ndaj parcelave dhe ndërtësave tjera në zonë, ndaj shërbimeve apo infrastrukturës publike dhe për të zvogëluar ndikimet tjera negative.
 6. Kushtet e veçanta të përrjashtimit përfshihen në vendimin për miratimin e përrjashtimit dhe në çdo leje ndërtimore të lëshuar më pas në bazë të përrjashtimit.
 7. Shkelja e kushteve të veçanta të përrjashtimit është shkelje e hartës zonale të komunës.

Në rastet kur miratohet përjashtimi, aplikuesi aplikon për leje ndërtimore sipas procedurës së rregullt. Aplikacioni për leje ndërtimore dorëzohet brenda një (1) viti pas vendimit për miratim të kushteve të veçanta për përjashtim, kurse pas këtij afati kohor përjashtimi bëhet i pavlefshëm.

Dhe krejt në fund pjesa ndryshim plotësimet dhe përjashtimet, bazuar në legjislacionin në fuqi, është pjesa dinamike e Hartës Zonale të Fushë Kosovës dhe të gjitha ndryshim plotësimet dhe përjashtimet që janë bërë pas hartimit të Hartës Zonale të Komunës, duke ndjekur procedura e lartpërmendura, duke plotësuar edhe kushtet e lartpërmendura, pas aprovimit nga kuvendi i komunës së Fushë Kosovës bazuar edhe në pëlqimin paraprak të MMPH-së, komuna obligohet të njëjtat ndryshim-plotësime dhe përjashtime t'i shtojë këto në këtë pjesë, atëherë ndryshim plotësimet dhe përjashtimet bëhen zyrtare dhe zëvendësojnë ato parcela, zona nga HZK për të cilat është aplikuar për ndryshim plotësimet dhe përjashtimet.



Harta 17 Shembull i ilustrimit të përjashtimeve nga kushtet zhvillimore ku parcelat siç shihen nuk kanë qasje në parcelë.

Komuna përshkruan procedurat dhe përgjegjësitë për detyrat lidhur me zonimin,

- Përfshirë shqyrtimin e përputhshmërisë me zonimin,
- Lëshimin e lejeve ndërtimore dhe vendimeve për zonim,
- Interpretimin e shfrytëzimeve dhe kushteve zhvillimore,
- Marrjen e vendimeve për kërkesat për ndryshime dhe përjashtime si dhe procesin e ankimit.

Sqarimi i procedurave përfshin deklaratën se komuna do të ndjekë procedurat e përcaktuara me ligj kur të bëjë shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për miratim të zonimit dhe të gjitha kërkesat për zonim do të shqyrtohen shpejt dhe arsyet për refuzim të kërkesës për miratim të zonimit do të jepen me shkrim.

Kjo pjesë u shërben qytetarëve të marrin informata shtesë për Hartën Zonale të Komunës dhe proceset e zonimit dhe se si mund të dorëzohen pyetjet dhe kundërshtimet.

16. JO KONFORMITETET


Jo konformitet është një shfrytëzim, ndërtim apo parcelë kadastrale ekzistuese që nuk është në përputhje me kërkesat aktuale të zonimit.

Jo konformiteti që ka ekzistuar para se të miratohet Harta Zonale e Komunës lejohet të vazhdojë edhe nëse nuk është në përputhje me shfrytëzimet dhe kushtet zhvillimore të caktuara me Hartën Zonale të Komunës për atë që jo konformiteti vazhdon të plotësojë kërkesat e ligjeve të tjera.


Rregulloret në fuqi që promovojnë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien publike, duke përfshirë por duke mos u kufizuar kërkesat ndërtimore kundër zjarrit dhe shëndetësore zbatohen ndaj jo konformiteteve.

Komuna zbaton kushtet zhvillimore ndaj jo konformitetit në rastet kur:

- Shfrytëzimi jokonform është ndryshuar; ose
- Ndërtimi jokonform është zgjeruar, ndryshuar apo edhe rindërtuar si shfrytëzim jokonform për arsye tjera që nuk janë me rëndësi madhore.
-



Harta 18 Shembulli ku zona është e parapar për industri kurse në zonë kemi objekt të banimit.



Harta 19 Shembulli ku objekt me vlera arkitektonike i cili ndodhet në zonë të banimit kolektiv

Zona në të cilat janë zhvillimet jo konforme me zonat, harta 1 është objekt me vlera arkitektonike i cili ndodhet në zonë të banimit kolektiv, kurse harta 2 ka zhvillime jo konforme përshkak se si zonë është e paraparë për industri, kurse në zonë kemi objekt të banimit.

17. BONUSSET E ZONIMIT

Komunat mund të miratojnë rregullore për të përcaktuar dhe zbatuar bonuse të zonimit.

Bonuset e zonimit janë stimulime që jepen nga komuna në këmbim të ofrimit të një përfitimi publik. Bonuset e zonimit duhet të jenë brenda normave teknike të planifikimit hapësinor dhe përfshijnë si më poshtë:

- zvogëlim të kërkesave për tërheqje të vijave të ndërtimit;
- zvogëlim apo lirim nga taksat për leje ose tarifatat për infrastrukturë;
- zvogëlim të kushtit për sipërfaqen minimale të parcelës, gjerësi dhe thellësi;
- rritje e përqindjes së sipërfaqes së shfrytëzueshmërisë së shputës në raport me parcelën kadastrale;
- rritje të lartësisë dhe kateve maksimale të ndërtesës;
- rritje të dendësisë; dhe
- stimulim i propozuar nga zhvilluesi ose komuna për të integruar dhe përmirësuar vendbanimet joformale.

Rregulloret e tilla komunale janë në përputhje me qëllimet, objektivat, vizionin dhe strategjitë e Planit Zhvillimor Komunal dhe përdoren për të:

- rritur hapësirat e hapura ose sipërfaqet e gjelbra;
- ofruar përmirësim të trafikut dhe lëvizje të këmbësorëve;
- ruajtur sipërfaqet kulturore dhe historike;
- ruajtur tokën bujqësore;
- krijuar ndërtesa dhe hapësira publike dhe sociale prej të cilave përfiton komuniteti;
- përfshirë dhe përmirësuar vendbanimet joformale; ose
- ofruar mundësi të tjera të dëshiruara nga komuna në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal.

Rregulloret komunale përmbajnë:


1. përshkrimin e Bonusit të Zonimit që lejohet;
2. përshkrimin e strategjive me sqarime se si përfiton komuniteti nga Bonusi i Zonimit që është zgjedhur;
3. listën e të gjitha llojeve dhe kategorive të përfitimeve të komunitetit që mund të pranohen nga zhvilluesit;
4. sipërfaqet dhe standardet për zhvillim të përfitimeve publike;
5. kërkesat për përfitimet publike do të vihen në dispozicion të përhershëm për komunitetin duke respektuar ligjet dhe rregulloret përkatëse në fuqi përmes:
 - Bartjes së pronësisë në komunë ose ndonjë organi tjetër publik; ose
 - Kërkesës që pronari i pronës të ofrojë mirëmbajtje të përhershme dhe ta mbajë të hapur për publikun së paku gjatë orarit zyrtar të punës; dhe
 - Kërkesës që pronari i pronës të ofrojë garancion bankar duke garantuar zbatimin e bonusit të zonimit deri në marrjen e lejes së përdorimit, si për: bartje të pronësisë në komunë ose te ndonjë organ tjetër publik; ose kërkesës që pronari i pronës të ofrojë mirëmbajtje të përhershme dhe ta mbajë të hapur për publikun së paku gjatë orarit zyrtar të punës.
6. Identifikimi saktë i zonës në të cilën Bonuset e Zonimit mund të lejohen;
7. Procedurat për marrjen e një Bonusi Zonimi; dhe
8. Dispozitat për të siguruar njoftim dhe shqyrtim publik për projektin e propozuar që është përcaktuar sipas Nenit 36 të këtij udhëzimi administrativ.

Për të zbatuar çfarëdo Bonusi të Zonimit, komuna dhe aplikuesi do të:

- Nënshkruajnë marrëveshje për zhvillim, me qëllim të përcaktimit të bonuseve të sakta ose stimulimeve të tjerë që pranon zhvilluesi dhe përfitimin e saktë publik të cilin zhvilluesi ofrojë në këmbim për këto bonuse ose stimulime;
- Publikimin e të gjitha marrëveshjeve për zhvillim në faqen zyrtare elektronike të komunës;
- Vlerësimin nëse infrastruktura publike ekzistuese që do të shërbejë për densitetin e shtuar mund të jetë e kënaqshme për zhvillimin shtesë; dhe
- Sipas kërkesave ligjore mjedisore përgatitet vlerësimi i ndikimit në mjedis për përmbajtjen e propozuar.

Zonat në pjesën jugore të Fushë Kosovës mund të zhvillohen me bonuse të zonimit për shkak se zona ka rrugë të ngushta, kurse me HZK janë paraparë që këto rrugë të zgjerohen duke i shfrytëzuar Bonuset e zonimit. Ngjashëm në këtë zonë do të krijohen edhe hapësirat për parqe dhe rekreim si dhe parkingjet për automjete. Duke u bazuar nga nevoja e madhe që sot ka Fushë Kosova për parkingje parashihet që në këto zona të ndërtohen parkingje (objekt garazha) të cilat mund të zhvillohen duke i shfrytëzuar bonuset e zonimit.

Bonuset e Zonimit duhet të plotësojnë normat e planifikuara për infrastrukturë përcjellëse të paraqitura në tabelën për infrastrukturën përcjellëse të zonave të banimit të vendosura në nënkapitujtë 5.4.-A dhe 5.5 – B.



Harta 20 Zonat ku mund të aplikohen bonuset e zonimit.

18. INTERPRETIMI

Harta Zonale e Komunës parashihen të jenë e hollësishme dhe gjithëpërfshirëse, për çështje praktike Harta Zonale e Komunës nuk mund të adresojë çdo çështje specifike të zonimit.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor është përgjegjës për interpretimin e rregulloreve të zonimit. Sidoqoftë, ky autoritet i interpretimit të rregulloreve të zonimit nuk ka për qëllim të shtojë apo ndryshojë përmbajtjen thelbësore të Hartës Zonale të Komunës.

Interpretimet nga Autoriteti përgjegjës komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor për të gjithë subjektet fizike dhe ligjore : **Përkufizimet ose Shprehjet** e përdorura në këtë dokument , Hartë Zonale e Fushë Kosovës ,përkundër disa tendencave për interpretime profesionale ose akademike, nga disa subjekte fizike dhe ligjore duhet të kuptohen vetëm dhe saktësisht si është definuar me ligjin NR. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe aktet nënligjore ,dhe si të tilla janë përdorur gjatë përgatitjes së Hartës Zonale të komunës .

Krijimi dhe Precizimi i zonave,zonave mbi-shtresore si dhe aktivitetet,masat,projektet që lidhen me zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Veprimtari që rrjedh nga Plani Zhvillimor Komunal është bërë kryesisht duke u bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe marr parasysh gjendjen ekzistuese dhe duke analizuar e sqaruar arsyet ligjore, mjedisore, ekonomike, financiare dhe sociale për krijimin dhe precizimin e tyre duke marrë në konsideratë parimet e përcaktuara në nenin 5 të Udhëzimit Administrativ dhe ligjit,Raportin e shqyrtimit publik si dhe obligimet të cilat rrjedhin nga dokumentet e planifikimit hapësinor për rajonin më të gjerë e të cilat ndikojnë në identifikimin e hapësirave dhe përcaktimin e zonave.

Shfrytëzimet e tokës: shfrytëzimet të lejuara, dytësore, të lejuara të veçanta , të përkohshme dhe të ndaluara ,janë të definuara në të gjithë territorin e Komunës së Fushë Kosovës, dhe janë dhënë për të gjitha zonat dhe territorin e komunës,eventualisht nëse trajtohet ndonjë shfrytëzim i pa definuar ose diçka që nuk është përfshirë, atëherë i vetmi organ kompetent për interpretim është Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor

Rasti 1:Për të gjitha parcelat zhvillimor për të cilat shfrytëzimet dhe kushtet zhvillimore (dhe kushtet ndërtimore si pjesë e kushteve zhvillimore) janë të mjaftueshme për ti dhënë kushtet dhe lejen e ndërtimit komuna procedon me leje.

Rasti 2:Për të gjitha parcelat zhvillimor për të cilat shfrytëzimet dhe kushtet zhvillimore (dhe kushtet ndërtimore si pjesë e kushteve zhvillimore) janë të mjaftueshme për ti dhënë kushtet dhe lejen e ndërtimit por forma e parcelave,hapësirat publike dhe faktorët tjerë e pengojnë procesin,preferohet të ofrohen kushtet dhe bonuset e zonimit në nivel të parcelës zhvillimore ose edhe zonës(pas një koncepti ose komasacioni urban në nivel parcelës zhvillimore apo zonës),me pëlqim të pronarëve dhe të mundësohen përfitimet për pronarët dhe për komunën,dhe të jepen kushtet dhe komuna të procedon me leje.

Rasti 3:dhe në rastin e fundit nëse duhen detajime të mëtejme që nuk janë as pjesë e rasti 1 por as e rasti 2 atëherë komuna duhet të përgatis Planin Rregullues të Hollësishëm

Sa i përket **Infrastrukturës teknike,Infrastrukturës rrugore, Infrastrukturës publike dhe sociale** kushtet,sqarimet dhe specifikat tjera janë planifikuar bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe marr parasysh gjendjes ekzistuese por nuk interpretohen si projekte kryesore por si përmbajtje mbi të cilat përgatitet projektet.

e **Projektimi dhe ndërtimi** bazohen në draft kodin e Ndërtimit dhe në momentin që aprovohet dhe hyn në fuqi,plotësisht duhet punuar sipas kodit të ndërtimit.

Në **rast se hyn në fuqi ndonjë plan** i nivelit më të lartë sidomos për siguri dhe emergjencë,akte nënligjore, standarde, norma të reja etj,të njëjtat duhet zbatuar me HZK duke zëvendësuar të mëparshmet ose duke u promovuar për herë të parë .

Kërkesat për Jo konformitet – që nënkupton kërkesën nga subjektet fizike ose ligjore në rastet kur shfrytëzimi ekzistues, ndërtesa ose parcela kadastrale nuk është në harmoni me kërkesat aktuale të zonimit nga HZK-ja trajtohen gjatë procesit të hartimit të HZK-së por edhe pas miratimit dhe duhet trajtohen në pajtim me nenin

38 të Udhëzimit Administrativ të MMPH - nr. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.

Përjashtimet – që nënkupton kërkesën nga subjektet fizike ose ligjore në rastet kur kërkohet një devijim i lejuar nga kushtet zhvillimore apo kushtet ndërtimore, gjatë procesit të hartimit të HZK-së por edhe pas miratimit, dhe rastet e tilla duhet trajtohen në përputhje me nenin 37 të Udhëzimit Administrativ të MMPH -nr. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.

Bonuset e zonimit – që nënkupton kërkesën nga subjektet fizike ose ligjore në rastet kur mundet të përdoret ky mjet planifikimi që lejon komunat të mund të sigurojnë përfitime të komunitetit (të tilla si rritja e sipërfaqes së hapur, parqeve, shtigjeve për këmbësorë, etj.) në këmbim të një ndryshimi në kushtet e ndërtimit (zakonisht në formën e dendësisë së rritur, lartësia së shtuar, apo cilësisë më të lartë të kushteve zhvillimore kapacitete shtesë për drenazhim, të menaxhimit të peizazhit, etj.), të ofruara nga aplikuesi, dhe rastet e tilla duhet trajtohen në përputhje me Udhëzimin Administrativ të MMPH - nr. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës. Komunat mund të miratojnë rregullore për të përcaktuar dhe zbatuar bonuse të zonimit

Në rastet kur janë planifikuar **korridoret** për zhvillimin e infrastrukturës ,dhe ndodhë që gjatë hartimit të projektit kryesorë në segmente të caktuara për arsyet ligjore, mjedisore, ekonomike, financiare dhe sociale nuk është siguruar gjerësia ose thellësia e duhur gjatë hartimit të HZK-së, kur përgatitet projekti komuna ose duhet ti siguroj këto me bonuse zonimi, eksproprijim ose bashkëpunoj në ofrimin e zgjidhjes tekniko inxhinier-ike të duhur.

Në rast të kërkesave për saktësim ose edhe interpretim të kushteve ndërtimore, sidomos: Vijës rregulluese, Vijës ndërtimore, Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri i parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike, Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri anësor dhe i pasmë i parcelës kadastrale, Përqindja e sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale, Përqindja e sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit për absorbim të reshjeve atmosferike në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale, Përqindja e sipërfaqes së përgjithshme e ndërtimit brenda parcelës kadastrale të lejuar në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale, Përqindja e sipërfaqes nëntokësore e shfrytëzueshme në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale, Kërkesat minimale për vendparkingje, E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese, Materialet që lejohen të përdoren në sipërfaqet e jashtme të ndërtimeve të reja, Kushtet e qasjes adekuate në rrugë publike dhe infrastrukturë teknike, Kufizimet e ndotjes mjedisore dhe të zhurmës sipas legjislacionit përkatës në fuqi; dhe Masat për mbrojtjen e vlerave natyrore, historike dhe kulturore.

Autoriteti përgjegjës komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor (ose komisioni profesionale) bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shkrim për saktësim ose edhe interpretim të kushteve ndërtimore, por çdo saktësim ose edhe interpretim duhet jetë brenda kushteve të Hartës Zonale (dhe nëse vija ndërtimore sillet nga 2-6, bazuar në gjendjen në teren dhe arsyet ligjore, mjedisore, ekonomike, financiare dhe sociale e saktëson nga 2 deri 6)

Kërkesa për interpretim mund të bëhen edhe te Pjesa Hartografike e Hartës Zonale të Komunës, për sistemin zyrtar të planifikimit hapësinor në platformë të GIS-it, hartat. Për mos ndryshimin eventual që lidhet me përditësimin e bazës së të dhënave hapësinore dhe pjesës së printuar të Hartës Zonale të Komunës për të gjitha ndryshim plotësimet dhe përjashtimet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas miratimit të tyre nga ana e komunës së Fushë Kosovës.

dhe për mos ndryshimin eventual që lidhet me përditësimin e bazës së të dhënave hapësinore dhe pjesës së printuar të Hartës Zonale të Komunës me të gjitha lejet ndërtimore të lëshuara.

Komuna mundet të formoj edhe **komisione profesionale** për qëllime të caktuara të Hartës Zonale komunale e që mundet mu lidh me përgjigjeje në kërkesa mirëpo edhe me interpretimin.

për çdo pakënaqësi nga subjektet fizike ose ligjore me interpretimin e nivelit komunal mundet të kërkoj te Autoriteti përgjegjës për planifikim hapësinor në nivel qendrorë interpretimin.

procedimi për aplikim bëhet sikurse është paraparë me procedura normale administrative. Autoriteti përgjegjës komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor bën shqyrtimin dhe merr vendim me shkrim pas kërkesës me shkrim për **interpretim të zonimit brenda 30 ditësh**.



19. ANKESAT

Ankesat ndaj vendimeve të nxjerra sipas këtij Udhëzimi Administrativ bëhen në pajtim me Ligjin për Procedurën Administrative.

20. PJESA HARTOGRAFIKE

Pjesa Hartografike e Hartës Zonale të Komunës së Fushë Kosovës përbëhet nga hartat e integruara sipas fushave tematike zhvillimore të tërë hapësirës së komunës së Fushë Kosovës të përgatitur në sistemin zyrtar të planifikimit në platformën GIS në programin ArcGIS 10.5, i cili paraqet informacione thelbësore në formë gjeodatabaze për ti shpjeguar publikut për mundësitë e shfrytëzimit të tokës, kushtet zhvillimore dhe masat mbrojtëse. Këto harta përfshijnë: